



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 29 MARS DHE 4 PRILL 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 29. MARTA I 4. APRILA 2013. GODINE**

**MARS/PRILL - MART/APRIL
2013**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar për gjendjen ekonomike në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,
2. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011,
3. Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Parlamentarna debata o ekonomskom stanju na Kosovu, po zahtevu PG Demokratski savez Kosova,
2. Razmatranje Izveštaja o performanse javnih preduzeća za 2011. godinu,
3. Izbor jednog (1) člana Odbora Nezavisne komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: I nderuari zëvendëskryeministër!

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar për gjendjen ekonomike në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës

Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 15, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me gjendjen ekonomike në Kosovë.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, në cilësinë e propozuesit të çështjes, e ftoj deputeten Hykmete Bajrami. Deputete, e ke fjalën!

HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar!

Përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Në bazë të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 15, pika 8, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit debat parlamentar për gjendjen ekonomike në Kosovë, sipas këtij arsyetimi:

Gjendja ekonomike në Kosovë sa vjen e përkeqësohet. Të dhënat për papunësinë tregojnë se mbi 70% e të rinjve janë të papunë, ndërsa varfëria është thelluar tej mase. Shumë familje, sidomos ato që nuk kanë të punësuar, mezi i plotësojnë nevojat elementare për jetë. 5 vjet pas shpalljes së pavarësisë, institucionet e Kosovës karakterizohen me joefikasitet, korrupsion e nepotizëm.

Qeveria e Kosovës, e dhënë pas interesave ditore, politike, i ka harruar qytetarët dhe bizneset. Rritja e ngarkesës tatimore për bizneset e vogla ka bërë që një numër i madh i tyre të shkojnë në falimentim, ose të dalin në informalitet. Si rezultat, sot varfëria dhe papunësia janë më të larta se para 5 vjetëve, kur u shpall pavarësia e Kosovës dhe të gjitha të dhënat e tregojnë këtë konstatim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për të qenë sa më të saktë në paraqitjen e gjendjes, në të cilën kjo Qeveri e ka sjellë vendin, analizën dhe konstatimin tonë e mbështetim në të dhënat reale nga situata në terren, krahasimin me vitet e mëhershme dhe premtimet elektorale të zotit Thaçi dhe planet e kësaj Qeverie për t'i realizuar ato.

Premtimi i Qeverisë, i thënë decidivisht në planin e vizionit, thotë se brenda periudhës së ardhshme afatmesme do të arrihet norma e rritjes reale ekonomike prej 7 deri në 8%. Të gjithë e dini gjendjen faktike. Derisa në vitin 2008 rritja e GDP-së ka qenë 6,9%, në vitin 2012, sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kosova kishte një rritje prej 2,7% të GDP-së. Parashikimet për rritjen e GDP-së për vitin 2013, gjithmonë sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, janë 3,2%, duke i siguruar qytetarët e Kosovës se prapë do të mbeten më të varfrit në rajon. A e dini se çfarë thotë plani i Qeverisë për zbutjen e papunësisë? Ai thotë, ndër të tjera, se brenda periudhës së ardhshme afatmesme do të arrihet një ulje e numrit të personave të regjistruar si të papunë, prej 8 deri në 10% për vit.

Sot në Kosovë, papunësia është 45%, që do të thotë që në çdo dhjetë burra punojnë vetëm tre, dhe në çdo dhjetë gra në punë është vetëm një. Ne dhe ju e dini se çdo vit në tregun e punës hyjnë 25 000 deri 30 000 të rinj, ndërsa vendet e reja të punës të krijuara nuk janë as sa çereku i këtij numri. Sipas Administratës Tatimore, në vitin 2008, vendet e reja të krijuara në Kosovë ishin 18 750. Në vitin 2012, gjithmonë sipas Administratës Tatimore të Kosovës, kemi vetëm 6 500 vende të reja të punës, bile edhe ato nuk janë të qëndrueshme. Kjo dëshmon se papunësia në vend nuk po zvogëlohet, përkundrazi ajo po rritet.

Plani i Qeverisë flet gjithashtu për rivitalizimin e bujqësisë. Çfarë është bërë këtë drejtim? Gjendja tregon se importet janë më të mëdha se eksportet, derisa deficitit tregtar në vitin 2007 ka qenë 1,4 miliard, në vitin 2012 deficitit tregtar është rritur për 60%, në 2,2 miliardë, dhe arsyetimi është se bujqit dhe prodhuesit kosovarë nuk mund të konkurrojnë me prodhimet nga importi, sepse u duhet të paguajnë shtrenjtë për ujitjen e tokës, për plehrat, për farat, për naftën që e blejnë për traktor, që e ka çmimin e njëjtë sikur atyre që vozitin X5 e X6, për furnizim me energji elektrike e tjera.

Në mungesë të prodhimit vendor, vetëm produkte bujqësore Kosova importon rreth 560 milionë euro në vit. Kjo është sipas Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, e dhënë e vitit 2011, agjenci kjo në kuadër të Kryeministrit.

Objektiv tjetër i kësaj Qeverie ishte premtimi për përmirësimin e ambientit të biznesit. Cila është gjendja sot? Investimet e jashtme në vitin 2007 ishin 429 milionë, investimet e jashtme në vitin 2012 ishin 233 milionë, 45% më pak. Ja çfarë progresi!

Krejt çfarë është bërë në këtë aspekt është eliminimi i disa licencave dhe thjeshtësimi i procedurave për regjistrim, por kjo nuk po i jep efektet e dëshiruara në ekonomi, sepse askush nuk i mbron investitorët e huaj, askush nuk u siguron atyre për ekzekutimin e kontratave për zgjedhjen e kontesteve dhe zbatimin e ligjit. Askush nuk mund t'i garantojë ata që në Kosovë nuk ka korrupsion, derisa organet e mandatura për ta luftuar këtë dukuri të shëmtuar janë të involvuar vetë në afëra korruptive, siç ishte rasti i Ministrisë së Mbrojtjes, vjedhjet në Dhomat e Dëshmimeve, shumë afëra korruptive nëpër komuna dhe ndërmarrje publike.

Sektori privat është shkatërruar, të paktën sa i përket sektorit të prodhimit. Ka shumë pak produkte vendore që konsumohen nga qytetarët e Kosovës. Këto produkte mungojnë

plotësisht në tregun e jashtëm. Pjesëmarrja e sektorit privat në produktin e brendshëm bruto është gjithnjë e më e vogël.

Premtimet dhe planet e kësaj Qeverie ishin të shumta. Ja një tjetër - rritja e qëndrueshmërisë makrofiskale, ku thuhet se me qëllim të rritjes dhe zhvillimit ekonomik dhe sigurimit të qëndrueshmërisë ekonomike, Qeveria angazhohet për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike dhe të të hyrave buxhetore. A kemi pasur efikasitet të shpenzimeve?

Ne vlerësojmë se ka ndodhur pikërisht e kundërta dhe ja shembuj për këtë: si askund në botë, Qeveria Thaçi2 i ka 19 ministri, janë 64 zëvendëskryeministra, ministra dhe anëtarë të kabineteve qeveritare, që marrin paga nga buxheti i varfër i Kosovës. Vetëm brenda Kabinetit të kryeministrit janë 623 persona që punojnë dhe paga mesatare e tyre, duke përfshirë mëditjet edhe shtesat, është rreth 1 500 euro, që është rreth 5 herë më e lartë se paga e një mjeku, apo një mësuesi, dhe 33 herë më e lartë se pensioni bazik që merr një i moshuar mbi moshën 64-vjeçare.

Buxheti është i paqëndrueshëm. Të hyrat ende mbledhen nga Dogana. Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka kapacitete për t'i mbledhur tatimet në brendi të vendit. Në këtë formë ajo po i ngarkon shumë bizneset vendore. Ekonomia informale është e lartë, borxhi publik po rritet, sepse Qeveria po shet letra me vlerë për t'i financuar shpenzimet e saj operationale.

Për më tepër, investimet publike janë strategjikisht të gabuara. Shumica e investimeve publike po bëhen pa analizë paraprake për normën e kthimit apo përfitimit publik dhe privat nga këto investime. Investimet në autostradë nuk po japin asnjë efekt për ekonominë vendore për shkak të përjashtimit të firmave vendore nga ky projekt dhe efektet zero në zvogëlimin e kostove të transportit të bizneseve.

Kontrata për autostradën Morinë-Merdar asnjëherë nuk u bë transparente, as për deputetët, e as për qytetarët. Ndërrohet traseja e autostradës në kundërshtim me projektin e aprovuar. Kostoja është shumë e lartë, 10 milionë euro për një kilometër katror. Punësohen punëtorë kosovarë që punojnë me vetëm 90 centë për një orë. Shpronësimi i tokave të autostradës përcillet me pakënaqësi të madhe nga qytetarët, e që zgjidhet me zgjatjen e dorës së fortë të politikës dhe assesi me zbatimin e plotë të ligjit. Për më tepër, vlerësimi i pronave private po bëhet në baza diskriminuese, çmimi i paguar për një ar tokë të shpronësuar në rrethinat e Malishevës është disa herë më i lartë se çmimi i tokës për një ar të shpronësuar në rrethinat e Prishtinës, dhe këto janë të dhëna zyrtare që ju mund t'i shihni në ueb-faqen e Ministrisë së Financave.

Shpërndarja e investimeve publike nëpër sektorë dhe komuna nuk reflekton nevojat reale që ka vendi, por bëhet mbi baza politike dhe të strukturave të lidhura me biznesin. Investimet në energjetikë, në hekurudha, në edukim dhe shëndetësi, janë larg nga nevojat e vendit dhe janë shumë më të vogla, krahasuar me investimet që bëhen në rrugë.

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se edhe politika tatimore është e gabuar. Qeveria po i ngarkon me shumë taksa qytetarët me të ardhura të ulëta dhe mesatare dhe bizneset e vogla, ndërkohë që po i liron nga taksat qytetarët me të ardhura të larta dhe korporatat e mëdha. Kjo Qeveri e ka trefishuar normën e tatimit në pronë, e ka rritur tatimin mbi vlerën e shtuar nga 15 në 16% dhe e ka rritur 80% ngarkesën për bizneset e vogla, nga 5 deri 9%.

Të nderuar deputetë,

Normat e larta të interesit që i aplikojnë bankat komerciale, e bëjnë të pamundur zhvillimin e sektorit privat, sidomos financimin e projekteve të mëdha investive. Këto norma vijnë si rezultat i mosefikasitetit të institucioneve që merren me rregullimin e marrëdhënieve ekonomike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYTARI: Regjia, vazhdoja fjalën!

HYKMETE BAJRAMI: ...kontestet ekonomike ndërmjet palëve marrin vite për t'u zgjidhur. Po ashtu, Banka Qendrore ka qenë krejtësisht neglizhente në këtë drejtim, duke lejuar bankat komerciale që vazhdimisht t'i rritin çmimet e shërbimeve të tyre për klientë dhe t'i mbajnë normat e larta të interesit. Pavarësisht hyrjes së bankave të reja dhe rritjes së konkurrencës, normat e interesit nuk kanë rënë dhe kushtet e kredidhënies për biznese nuk janë përmirësuar aspak.

Të nderuar deputetë,

Kjo Qeveri po luan me pronën e qytetarëve të Kosovës. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe publike po përcillet me probleme të mëdha. Me këtë Qeveri gjithçka është në rrezik. Qytetarët, si të vetmit pronar të pronës publike, vetëm po humbin nga procesi i privatizimit, e asgjë nuk po fitojnë.

Distribucioni dhe Furnizimi me Energji shitet me çmim qesharak prej 26,3 milionë euro. Në rrjetin e Distribucionit vetëm në 5 vjetët e fundit janë investuar 55 milionë, e për këtë ekzistojnë dëshmi të gjalla, janë të gjitha faturat, duke mos e përfshirë këtu projektin e instalimit të orëve digjitale, projekt ky mbi 9 milionë euro, i cili po implementohet edhe sot e kësaj dite. Nuk është e qyrtë se çfarë do të ndodhë me pjesën e Distribucionit energjetik në pjesën veriore të Mitrovicës, e cila është e lidhur me rrjetin energjetik të Serbisë. Korporata financiare ndërkombëtare, së fundi ka deklaruar se privatizimi nuk është bërë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Procesi i privatizimit të 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës është stërzgatur, është përsëritur disa herë në mungesë të investimit të firmave relevante. Çmimi i prituri i privatizimit, i presupozuar në buxhetin e Kosovës, ka dhënë sinjal të keq te investitorët potencialë për pritjet e ulëta që ka Qeveria nga shitja e këtij strategjik. Afati i pranimit të ofertave u shty për të katërtën herë, e ne vlerësojmë se kjo është në kundërshtim me çdo praktikë në procesin e privatizimit.

Keqpërdorimet e vazhdueshme në këtë kompani kanë bërë që vlera të ulet dukshëm. Kjo kompani, siç e dini, është përdorur për punësim masiv të militantëve të PDK-së.

Të nderuar qytetarë,

Kjo Qeveri po i politizon institucionet e pavarura, të cilat do të duhej të ishin gardianët e ekonomisë së tregut dhe të ekonomisë së lirë. Në krye të Bankës Qendrore është vënë një funksionar i lartë i PDK-së, i cili deri para dy muajve ishte ministër. Banka Qendrore duhet të mbikëqyrë qindra miliona depozita të qytetarëve dhe të bizneseve në bankat komerciale. Ky person dhe kjo Qeveri, e kontrabanduar në Kuvendin e Kosovës, Ligjin për bankat dhe institucionet mikrofinanciare, tash do të përkujdesen që të përfitojnë milionat nga OJQ-të mikrofinanciare, të cilat i kanë ngarkuar qytetarët e varfër me deri në 30% kamata, derisa në krye të Agjencisë së Privatizimit gjithashtu është vënë një eksponent i lartë i PDK-së dhe ish-zëvendësministër.

Tash ky person do të përkujdeset që t'ua shesë edhe më tutje tokën bujqësore eksponentëve të tjerë të PDK-së me vetëm 2 euro për ar, siç ka ndodhur deri më tani.

Të nderuar deputetë,

Niveli i lartë i korrupsionit, importi i lartë, kostoja e lartë e prodhimit për shkak të çmimit të lartë të imputeve, kontrabanda me mallra nga veriu dhe problemet tjera i bëjnë prodhuesit vendorë që të mos konkurrojnë me mallra që vijnë nga importi, e tregjet e jashtme ka kohë që janë humbur për produktet kosovare. Rritja e varfërisë dhe shtrenjtimi i kostos së jetës së qytetarëve dhe rritja e papunësisë konfirmojnë se Qeveria Thaçi ka devijuar plotësisht nga agjenda zhvillimore e vendit. Qytetarët po përballen me shtrenjtimin e energjisë elektrike prej 9%, si rezultat i rritjes së tantimës. Rritja e kostos së jetës dhe inflacionit po i varfëron edhe më tutje qytetarët e Kosovës. Kjo u konfirmua...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Krasniqi!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

E nderuara deputete Bajrami,

Faleminderit për fjalën tuaj dhe iniciativën për këtë debat për zhvillimin ekonomik në Republikën e Kosovës, ju dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Një debat i tillë ka qenë i nevojshëm dhe kam qenë mirëkuptues në kuptimin e ballafaqimit të ideve dhe koncepteve që kemi për zhvillimin ekonomik, por edhe për prezantimin e realiteteve jo të motivuara politikisht, por të realitetit, të angazhimeve dhe realizimit të projekteve dhe programeve që kemi si koalicion qeverisës, por natyrisht edhe të ballafaqimit me idetë dhe projektet e çdo partie politike në Republikën e Kosovës.

Kam besim se ky debat do ta ndihmojë edhe Qeverinë, por edhe opozitën në qartësimin e pozicioneve që Qeveria të punojë edhe më tepër dhe opozita në të njëjtën kohë të jetë edhe më e qartë. Që në fillim dua të theksoj se si udhëheqës i Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare, për aq sa jam përkushtuar për realizimin e prioriteteve strategjike në rrafshin politik për Republikën e Kosovës, jam përkushtuar edhe për realizimin e orientimeve strategjike në rrafshin ekonomik. Ky përkushtim mbështetet në besimin tim në atë se krahas lirisë dhe stabilitetit politik, parakusht për ngritjen e mirëqenies sociale dhe materiale të qytetarëve është edhe rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që shkurtimisht ta përmbledh punën e realizuar në zbatimin e platformës ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë këtyre 5 vjetëve. Tani jemi në vitin e gjashtë të qeverisjes. Po ashtu, më lejoni që të ju informoj mbi efektet që kjo punë ka pasur në përmirësimin e standardit tuaj jetësor.

Rritja dhe zhvillimi ekonomik, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rregullimi ekonomik bazohet në parimet e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, prandaj që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e ka vazhduar procesin e tranzicionit, duke adaptuar reformat legale dhe ato institucionale, si parakusht për themelimin e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë.

Gjatë këtyre 5 vjetëve, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje mesatare ekonomike prej rreth 5%. Kjo mesatare e rritjes reale ekonomike gati dy herë më e lartë se mesatarja e rritjes reale ekonomike në 5 vjetët para shpalljes së pavarësisë. Ky fakt tregon se politikat ekonomike kanë qenë të suksesshme në shënimin e progresit ekonomik. Përveç kësaj, kjo tregon gjithashtu edhe për suksesin e tyre në ruajtjen e qëndrueshmërisë ekonomike gjatë kësaj periudhe krize në ekonominë globale.

Gjithashtu, të ardhurat për kokë banori kanë shënuar rritje të vazhdueshme gjatë kësaj periudhe. Gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare kemi arritur që nëpërmjet këtyre politikave adekuate ekonomike të krijojmë kushte për rritjen e të ardhurave për kokë banori për dy herë më shpejt se gjatë 5 vjetëve para shpalljes së pavarësisë. Pra, gjatë kësaj periudhe ato janë rritur mbi 70%, derisa kjo rritje gjatë 5 vjetëve para shpalljes së pavarësisë ka qenë vetëm rreth 40%.

Kjo rritje dëshmon se mirëqenie materiale dhe shoqërore e qytetarëve të Kosovës është përmirësuar dukshëm gjatë kësaj periudhe. Politikat fiskale, pra politikat tatimore dhe lehtësimet fiskale, në bazë të rregullimit kushtetues, e ripërsëris, Republika e Kosovës, në mënyrë analiterale ka filluar ta përdorë euron si mjet të vlefshëm për pagesë. Kjo ka ndikuar që instrumenti i vetëm për mirëmbajtjen e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë makrofiskale të mbetet politika fiskale. Në këtë drejtim, synimi im është që duke e ruajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makrofiskale, politika fiskale të shërbejë si instrument për nxitjen e rritjes dhe zhvillimit ekonomik në vend, nëpërmjet kësaj edhe ngritja e standardit jetësor të qytetarëve kosovarë.

Qeverisa e Kosovës gjithmonë ka dizajnuar dhe do të vazhdojë t'i dizajnojë politikat fiskale asisoj që ta fuqizojë sektorin privat dhe ta shndërrojë atë në motor të rritjes dhe të zhvillimit ekonomik. Duke e fuqizuar sektorin privat, ne do të krijojmë kushte për krijimin e vendeve të reja të punës. Me fjalë tjera ,fuqizimi i sektorit privat do të shndërrohet në ngritje të mirëqenies shoqërore dhe materiale të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në filozofinë e rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe të përcjellë me stabilitet makrofiskal, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë e kemi dizajnuar platformën reformatore ekonomike të Republikës së Kosovës.

Në vitin 2009 e kemi përgjysmuar normën e tatimit në fitim dhe e kemi përgjysmuar secilën prej normave margjinale në të ardhurat personale. Nga ky lehtësim fiskal kanë përfituar të gjithë qytetarët dhe të gjitha bizneset.

Qëllimi i kësaj reforme fiskale ka qenë që të gjithë të të punësuarve në Kosovë t'u mundësohet që të kenë të ardhura personale neto më të larta. Kjo direkt ka ndikuar në përmirësimin e standardit jetësor të tyre.

Po ashtu, qëllimi i këtij lehtësimi fiskal ka qenë që nëpërmjet ngarkesës më të vogël tatimore të stimulohet zgjerimi dhe fuqizimi i sektorit privat dhe kështu të përshpejtohet rritja dhe zhvillimi ekonomik në vend. Të dyja këto qëllime janë realizuar. Qytetarët tani kanë të ardhura neto më të larta se sa më herët, pra kanë standard jetësor shumë më të mirë.

Jemi të vetëdijshëm se duhet të bëjmë edhe më tepër.

Aktiviteti ekonomik është shtuar, pra ekonomia e vendit është rritur me normë dy herë më të lartë se sa gjatë periudhës së 5 vjetëve para qeverisjes aktuale.

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik ka ndikuar në zgjerimin e bazës tatimore, gjë që ka mundësuar që të hyrat buxhetore të rriten në vitet në vazhdim prej rreth 14%. Kjo ka mundësuar edhe rritjen e investimeve kapitale, e cila është e dukshme dhe e prekshme kudo, në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës. Pra, edhe pse i kemi ulur normat e tatimeve, ne kemi realizuar të hyra buxhetore më të larta.

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik është reflektuar direkt në rritje ekonomike më të madhe gjatë viteve në vazhdim. Sërisht me qëllim të krijimit për përshpejtimin e rritjes dhe zhvillimit ekonomik, ne e kemi dizajnuar pakon e re fiskale. Në kuadër të kësaj, janë ofruar lirimet doganore për mallrat që shfrytëzohen si lëndë e parë, gjysmëprodukte, ambalazh dhe makineri, të cilat shërbejnë për prodhim, duke përfshirë këtu edhe linjat e prodhimit.

Me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve është bërë edhe lirimi doganor i disa kategorive të barnave esenciale dhe lirimi nga TVSH-ja i shërbimeve shëndetësore dhe

atyre të arsimit të lartë. Nëpërmjet kësaj pakoje të re fiskale do të fuqizohet sektori privat nëpërmjet uljes së kostos së prodhimit dhe ngritjes së aftësisë konkurruese.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Duke qenë të zotuar për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve, ne kemi punuar në politikat e rritjes së pagave. Për ta ngritur cilësinë dhe rritur efektivitetin e shërbimeve publike, gjatë periudhës që e kam udhëhequr vendin, kemi marrë dy herë vendime për ngritjen e pagave të kategorive të ndryshme në sektorin publik. Ky vendim ka qenë i motivuar edhe nga fakti se ka qenë koha për ta përshtatur pagën, ngritjen e produktivitetit në punë.

Ju e dini se punëtorët kosovarë më tepër kanë jetuar me ndihma sociale sesa me pagat e dinjitetshme, dhe qëndrimi im dhe premtimi im ka qenë që ato ndihma sociale të hiqen njëherë e përgjithmonë, ai trajtim që ka qenë prej institucioneve të Kosovës - trajtim fyes, dhe t'ia kthejmë dinjitetin punëtorisë kosovare. Prandaj, Qeveria që e udhëheq unë, pagat në sektorin e shëndetësisë i kemi rritur rreth 90%. Pagat për policët janë rritur mbi 55%, pagat e profesorëve universitarë mbi 100%, kemi këtu edhe profesorë universitarë dhe të tjerë; pagat e arsimtarëve dhe mësuesve mbi 50%, pagat për prokurorët dhe gjyqtarët janë rritur mbi 150%, pagat për zjarrfikësit mbi 45%, pagat për të gjithë shërbyesit civilë mbi 45%, pagat për doganierët mbi 45%, pagat për inspektorët tatimorë mbi 45%, pagat për familjet e dëshmorëve mbi 70%, për invalidët e luftës mbi 70%, pensionet mbi 50%.

Tash Qeveria është duke i marrë përgjegjësitë për herë të parë edhe për përkujdesjen institucionale shtetërore për të gjithë veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

E di se ndokush mund të thotë janë shumë 57 000, por jam i zotuar që sakrificën e asnjë njeriu as edhe për një minutë të mos ia humb askujt. Prandaj, trajtim institucional, përkujdesje institucionale, dhe Qeveria që e udhëheq unë do të ketë, jo për 57 000, por për të gjithë ata veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, sepse për mua, në një formë apo në formën tjetër, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës janë çlirimtarë. Aplikimi ka ndodhur, ai aplikim do të verifikohet. Nuk jam unë ai që e përcaktoj numrin, por ekipet profesionale dhe Qeveria e Kosovës do ta kryejë atë obligim që e ka marrë për ta rritur përkujdesjen ndaj të gjithë veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës.

Prandaj, edhe ju të gjithëve ju ftoj që këtë proces në asnjë rrethanë të mos lejoni ta politizoni, apo të partizohet. Të gjithë luftëtarët kanë luftuar për Kosovën dhe për asnjë parti. Kanë luftuar për shtetin, e jo për interesat e asnjë partie të vetme. Sot, unë zotohem përsëri, jam i vetëdijshëm se këto rritje të pagave nuk kanë qenë të lehta. Ju e dini që ka pasur edhe zhurmë të madhe, edhe ndërpartiake, se nëse rriten pagat do të ndalen projektet e mëdha infrastrukturore. Edhe i kemi rritur pagat, edhe të gjitha projektet infrastrukturore kanë vazhduar. Përkundrazi, i kemi filluar dhe projektet tjera infrastrukturore.

Prandaj, sot, duke pasur parasysh edhe përgjegjësitë e reja që i kemi, por edhe domosdoshmërinë e rritjes së mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës, të punëtorisë kosovare, Qeveria që e udhëheq unë nuk do të mjaftohet vetëm me rritjen e pagave për punëtorët e shëndetësisë me 90%, as për policët me 55, as për profesorët me 100 ose 50%, as me pagat për prokurorët dhe gjyqtarët, që ka ndodhur deri në 150%, apo për zjarrfikësit, shërbyesit civilë, doganierët, inspektorët tatimorë, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, pensionet, por ne jemi duke i shqyrtuar mundësitë më të mira dhe do të marrim vendime në kohën e duhur për rritjen tjetër të pagave gjatë këtij mandati për punëtorët e shëndetësisë, për policët e Kosovës, për profesorët universitarë, për punëtorët e shkollave të mesme, fillore, parafillorë, për prokurorët, për gjyqtarët, për zjarrfikësit, për shërbyesit civilë, por doganierët, për inspektorët tatimorë, për familjet e dëshmorëve, për të gjithë invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve, veteranët e luftës, por edhe për pensionet, që ka ndodhur 50%, do të ketë rritje.

Në anën tjetër, duke e respektuar kontributin e jashtëzakonshëm të të gjithë të burgosurve politikë, Qeveria që e udhëheq unë ka marrë përsipër përkujdesjen institucionale për 2 700 deri në 2 800 të burgosur politikë, që nga pas-Lufta e Dytë Botërore e deri në ditën e largimit të Serbisë nga Kosova.

Ajo përkujdesje do të rritet, do të fillojë së implementuari në momentin që fillon aplikimi dhe përmbyllet verifikimi i të gjithë të burgosurve politikë. Verifikimi apo aplikimi për verifikim të të burgosurve politikë do të fillojë më 4 prill, prandaj unë besoj që do të fillojë suksesshëm. Këtu e kemi edhe kryetarin e Shoqatës së të Burgosurve politikë, zotin Hyseni, dhe besoj që edhe ne të tjerët, që jemi të dënuar në mungesë, do të na trajtojnë së paku me nder dhe krenari.

Sido që të jetë, ne do të punojmë maksimalisht, nuk do të kërkojmë benificione, por së paku atë që e meritojmë. Po qeshin disa këtu që janë në sallë të burgosur dhe të dënuar në mungesë.

Këto rritje të pagave, pra, janë bërë në mënyrë shumë të matur dhe hapat tanë të mëtutjeshëm do të jenë në të njëjtën kohë të përgjegjshëm. Pra, krahas rritjes së pagave në sektorin publik, gjë për të cilin ju e dini se kemi pasur debate jo të lehta me mekanizmat ndërkombëtarë, në veçanti me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ka pasur edhe kritika të fuqishme, por gjendja ka qenë më e rëndë për qytetarët, për punëtorinë kosovare, sesa ato kritika që i kemi marrë prej Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Më vjen tepër mirë që e kemi realizuar me sukses edhe projekte kapitale infrastrukturore të nevojshme për Kosovën. Pra, Qeveria ka arritur ta mirëmbajë qëndrueshmërinë makrofiskale, edhe me rritjen e pagave, edhe me vazhdimin e projekteve infrastrukturore.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar edhe për realizimin e reformës të të bërit biznes me qëllim të përforcimit të ekonomisë së tregut, përmirësimit të

infrastrukturës ligjore, si dhe të stimulimit, të kalimit nga ekonomia joformale në atë formale.

Ne jemi duke e realizuar reformën për eliminimin e licencave në sistemin e gijotinës, bazuar në shqyrtimin e shëndetit, sigurisë, efikasitetit në nivelin qendror. Është thjeshtësuar procedura për regjistrimin e bizneseve. Me qëllim të krijimit të lehtësirave dhe mbështetjes së bizneseve nëpërmjet thjeshtimit të procedurave në Administratën Tatimore dhe Doganë.

Nga 9 dokumente që janë kërkuar për zhdoganim të mallit, tani kërkojnë 4 sosh. Gjithashtu është zvogëluar edhe koha e nevojshme dhe në të njëjtën kohë edhe kundërvajtjet doganore janë ulur nga 5 000, sa ishin minimum, në 500 euro. Falë këtyre reformave, sipas raportit të Bankës Botërore, të nderuar deputetë, qytetarë të Republikës së Kosovës, në të bërit biznes Republika e Kosovës ka shënuar progres në përmirësimin e ambientit afarist duke e zvogëluar ngarkesën administrative ndaj bizneseve.

Sipas këtij raporti, Kosova ka avancuar për 28 vende më e mirë se në vitin e kaluar.

Politika e investimeve publike - në kuadër të politikës fiskale, përveç lehtësimeve fiskale të njëpasnjëshme, nga të cilët kanë përfituar edhe bizneset dhe ekonomitë familjare, ne kemi zhvilluar politikë të fuqishme duke i rritur gjithnjë investimet publike.

Që nga viti 2008, Qeveria e Kosovës ka bërë rritje enorme të investimeve kapitale. Në vitin e shpalljes së pavarësisë, në krahasim me vitin paraprak, kjo kategori ka shënuar rritje prej 11%, duke arritur kështu në 10% të GDP-së. Kjo kategori ka shënuar rritje edhe në vitet në vazhdim, duke mundur që nivel i tyre vazhdimisht të jetë rreth 10% e GDP-së. Gjithashtu, çdo vit jemi kujdesur që shpenzimet kapitale të përbëjnë rreth 40% të shpenzimeve totale buxhetore. Nëpërmjet këtyre investimeve, e kemi realizuar platformën për rritje dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, gjithmonë duke pasur parasysh mirëqenien sociale dhe materiale të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Investimet publike janë bërë kryesisht në infrastrukturë, në arsim dhe në shëndetësi. Infrastruktura rrugore, zonja Hykmete, se më herët e refuzojë ndërtimin e autostradës, sot e mallkove, për herë të parë në historinë e Republikës së Kosovës ka filluar puna në autostradë, përkatësisht në rrugën 7, e cila e lidh Republikën e Kosovës me Shqipërinë. Ky projekt ka qenë historik, projekt i ëndrrave të qytetarëve, jo vetëm të Kosovës, por gjithë shqiptarëve, dhe me këtë energji negative të diskutueses paraprake, mendoj se ky dëshpërim do të vazhdojë gjatë, sepse rruga po i ofrohet Prishtinës. Autostrada ka ardhur në Prishtinë. Rrugës për Fushë-Kosovë i sheh këmbët e urës. Nëse të pengojnë mbylli sytë, por ai projekt do të përmbyllet. Je intelektuale, prandaj hapi sytë!

Ky projekt do të përfundojë së shpejti. Do ta shikojmë me mendje pak më të hapur. Tani e kemi filluar rrugën për rrugën 6, që do ta lidhë Republikën e Kosovës me Maqedoninë. Pra i kemi filluar procedurat dhe jemi në fazën finale. Edhe ky projekt do të fillojë së realizuari dhe do të përmbyllet. Përveç këtyre, është shtuar edhe një numër i madh i

rrugëve lokale, edhe në nivel rural, por edhe i rrugëve regjionale. Këto projekte e kanë për qëllim përmirësimin e infrastrukturës rrugore, gjë që ul koston e të bërit biznes.

Por, në të njëjtën kohë dëshiroj të theksoj se investime kanë ndodhur në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës. Unë këtu i kam edhe shënimet për çdo komunë dhe nëse dëshironi mund të bëjmë krahasimet e Qeverisë që ju keni pasur, por i nderuar zoti Kryeziu, po thotë kursena, ok-ej po ju kursej si opozitë, por realiteti është kështu.

Po, investimet më të fuqishme ka ndodhur në Prishtinë, të nderuar deputetë, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, qoftë në infrastrukturën rrugore, qoftë në arsim, qoftë në shëndetësi, i nderuar zoti Beqiri. Po nëse dëshironi krahasimet, i kam këtu, por ndoshta do të ishte mirë që edhe deputetët të prezantojnë.

Pra, rruga në mes të Prishtinës dhe Shkupit do të fillojë gjatë këtij viti. Përveç këtyre pra janë ndërtuar me dhjetëra, qindra kilometra rrugë në anë të ndryshme të Kosovës. Natyrisht, të pjesa e parë e kësaj infrastrukture të fuqishme ka ndodhur gjatë koalicionit PDK-LDK, ndërsa tash me koalicionit PDK-AKR, zotin Pacolli, por do të vazhdojmë që këto rrugë, këto projekte të implementohen dhe të jenë në shërbim të gjithë qytetarëve e jo të partive. Prandaj, ju falënderoj për punën e përbashkët që kemi bërë edhe si Lidhje Demokratike e Kosovës.

Për të siguruar furnizim të rregullt me energji elektrike, gjë që mund të them lirisht do të punohet maksimalisht, ju e dini se kur kemi filluar ne të qeverisim, Kosova ka qenë me rrugë me baltë, Kosova ka qenë me sistem energjetik, mund të them lirisht, të territ, tani kemi filluar projekte për Kosovën, me energji 24 orë.

Kosova do të fillojë pra ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re dhe të investojë në ndërtimin dhe përmirësimin e sistemit të ngrohjes.

Infrastruktura e telekomunikimit. Edhe në këtë fushë sikurse në fushat tjera janë realizuar projekte me qëllim të përmirësimit të standardit jetësor të të gjithë qytetarëve. Për herë të parë në Republikën e Kosovës është mundësuar konkurrenca në sektorin e telekomunikimit përmes dhënies së licencës operatorit të dytë.

Është duke u bërë punë e madhe edhe rreth privatizimit të një pjese të operatorit publik të telefonisë mobile, me qëllim të ngritjes së konkurrencës.

Të gjithë e dinë që konkurrenca në treg ndikon pozitivisht te konsumatorët përmes ofrimit të shërbimeve më cilësore, shumë shpesh me kosto më të ulët.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kabinet qeveritar,
Kur kemi filluar se qeverisuri në vitin 2007, 2008 është e pabesueshme ndoshta për ju deputetë të nderuar, por është e besueshme për ata që kanë përjetuar, fëmijët e Kosovës i

kemi gjetur në kontejner edhe pas nëntë vjet pas luftës duke mësuar dhe kjo ka qenë me të vërtetë diçka e paimagjinueshme dhe ndihem tepër mirë që kemi ndryshuar atë realitet.

Pra, në arsim kemi bërë investime të jashtëzakonshme, duke përfshirë këtu investimet në infrastrukturë dhe në përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Gjatë kësaj periudhe kemi ndërtuar rreth 100 objekte shkollore të reja anë e kënd Kosovës dhe shumë të tjera i kemi rinovuar. Po ashtu kemi ndërtuar edhe objekte të fakulteteve të ndryshme, por edhe institute të ndryshme këtu në Prishtinë. Kemi ndërtuar edhe dy konvikte të reja për t'ua akomoduar dhe lehtësuar studentëve jetën e re.

Kemi ndarë edhe shumë bursa për të përkrahur shkollimin e qytetarëve tanë. Kemi investuar në projekte që do të mundësojnë zhvillimin e shkathtësive të mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë informative. Përveç kësaj, vitin e kaluar, ne kemi zotuar 10 milionë euro për programin e lidershit transformues me qëllim të përgatitjes së një gjenerate të re të liderëve kosovarë të profesioneve të ndryshme.

Po e përsëris edhe një herë se të gjitha këto investime publike janë reflektuar në përmirësimin e mirëqenies shoqërore dhe materiale të çdo qytetari të Republikës së Kosovës, ndërsa ju e dini zotimin tim që jemi duke e realizuar si Qeveri e Kosovës që të vazhdojmë hapjen e universiteteve publike. Tani Universiteti publik i Prizrenit veç ka filluar të konsolidohet, ka filluar punën edhe Universiteti publik tjetër në Pejë, ka filluar ndërtimi i Universitetit tjetër publik në qytetin e Mitrovicës, të cilin edhe do ta vizitoj sot, do të fillojë më 1 tetor punën Universiteti publik tjetër, në Gjilan. Jemi në fazën e përgatitjeve intensive për Universitetin publik në Gjakovë dhe do të punojmë maksimalisht për krijimin e kushteve dhe rrethanave të përshtatshme edhe në Ferizaj.

E di se këtu kemi ide dhe koncepte të ndryshme sa i përket kësaj qasje, por ky është premtimi im dhe unë do ta realizoj.

Sa i përket bujqësisë, në këtë sektor me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës, zëvendësimit të importit përmes rritjes së prodhimitarisë vendore, Qeveria është fokusuar në përkrahjen direkte financiare, përkrahjen përmes shërbimeve profesionale këshillimore si dhe përmirësimeve infrastrukturore.

Si rezultat i mbështetjes së masave të pagesave të drejtpërdrejta nga ana e Qeverisë tek fermerët përfitues është rritur prodhimtaria deri në 46%. Gjithashtu si rezultat i kësaj mbështetjeje, produktiviteti në ferma është rritur nga 15 deri 20 herë. Ashtu siç është pritur kjo rritje e prodhimitarisë ka ndikuar edhe në krijimin e vendeve të reja të punës.

Anëtarësimet në organizata ndërkombëtare dhe marrëveshjet bilaterale. Me përkushtimin tonë maksimal dhe përkrahjen nga partnerët tanë ndërkombëtarë, ne kemi arritur që të anëtarësojmë shtetin e Kosovës në tri institucione financiare ndërkombëtare shumë të rëndësishme: në Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Me të gjitha këto organizata, institucionet e vendit kanë përgatitur strategjinë për Republikën e Kosovës dhe tani janë duke u realizuar projekte të ndryshme.

Përveç ndihmës teknike kemi pasur dhe kemi ndihmë financiare të formave të ndryshme nga këto organizata.

Ne kemi nënshkruar disa marrëveshje mbi masat preferenciale si rezultat bizneset që operojnë në Republikën e Kosovës, përfitojnë nga masat preferenciale me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Po ashtu, bizneset që operojnë në Kosovë përfitojnë nga vendosja e marrëdhënieve bilaterale me disa shtete për evitimin e tatimeve të dyfishta.

Ndërsa, sa i përket stabilitetit dhe qëndrueshmërisë makro-fiskale, dëshiroj të theksoj në fund dhe t'ju përkujtoj që të gjitha këto politika zhvillimore janë përshkruar nga parimi i konservatizmit fiskal, të qenët të përgjegjshëm në dizajnimin e politikave fiskale na ka mundësuar që rishikimet e marrëveshjeve sten bay me Fondin Monetar Ndërkombëtar të jenë pozitive.

Deficiti primar ka qenë gjithmonë brenda parametrave të rekomanduar dhe asnjëherë nuk ka tejkaluar 3% të GDP-së.

Borxhi publik ka arritur në 8.8 të GDP-së që është shumë më i ulët se sa që lejohet me Ligjin për borxhin publik, e nderuara deputete Hykmete.

Bilanci bankar është më i lartë se që është paraparë në bazë të Marrëveshjes sten bay me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Është përgatitur Rregullorja për asistencën për likuiditet. Tani jemi duke përgatitur edhe rregullore fiskale që do të jenë në funksion të ruajtjes së stabilitetit dhe qëndrueshmërisë makro-fiskale në vend.

Edhe një herë, të nderuar deputetë,

Të nderuar iniciues të këtij debati për zhvillimin ekonomik të Kosovës,

E nderuara deputete Hykmete,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, të gjithë ju deputetë të nderuar edhe unë personalisht edhe Kabineti qeveritar që kanë ardhur sot këtu, të gjitha grupet parlamentare, po flas në emër të Kabinetit qeveritar, do të jenë në shërbim të këtij debati, prandaj mos na kurseni, do të jemi në shërbim të qartësisë, të plotësisë dhe të pyetjeve tuaja, por do t'i mirëkuptojmë edhe rekomandimet e arsyeshme dhe të përgjegjshme dhe i mirëpresim. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Replikë, deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar,

E pamë një situatë, kryeministri është shumë i gjindshëm në prodhimin e shifrave aty për aty. Na tregoi që janë rritur të hyrat për kokë banorit për 70%, por unë i them kryeministrit të nderuar se GDP-ja për kokë banorit në vitin 2012 është rritur me vetëm 1.1% edhe nuk e kam në plan të replikoj gjer e gjatë, sepse është mirë t'u lihet fjala deputetëve tjerë që diskutojnë atë se çka kanë për të thënë.

Unë po i shfrytëzoj këtë treminutësh të replikës për t'i lexuar rekomandime, sepse ne rekomandimin e kërkojmë në afat prej një muaj që Qeveria të vijë dhe të raportojë për efektet e të gjitha masave të ndërmarra në fushën ekonomike. Mendoj që kjo mandej e kursen Kabinetin qeveritar dhe nuk marrin kohën e deputetëve, por kur është koha do të thotë prej sot një muaj, vijnë dhe na raportojnë.

I kemi dy rekomandime, rekomandimi i parë është që në afat prej një muaj Qeveria t'i raportojë Kuvendit për rezultatet e masave të ndërmarra deri më tani në luftimin e papunësisë dhe varfërisë, për efektet ekonomike të pakos fiskale që është implementuar në dy vjetët e fundit, për efektet ekonomike të masave të ndërmarra për përmirësimin e ambientit të biznesit në Kosovë, për efektet në rritjen e prodhimit vendor të subvencioneve të ndara për bujqësi, për efektet ekonomike nga privatizimi i ish-ndërmarrjeve publike, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", efektet e pritura nga privatizimi i Distribucionit dhe furnizimit për energji elektrike.

Në afat prej dy javësh, Qeveria të vijë dhe të raportojë në Kuvend lidhur me qëndrimet e Korporatës financiare ndërkombëtare se procesi i privatizimit të Distribucionit nuk është krye në harmoni me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Si dhe rekomandimi i dytë, të nderuar deputetë,
Është të pezullohet procesi i privatizimit të 75% të aksioneve të Postë- Telekomit të Kosovës dhe në afat prej 2 muajsh, Qeveria të sjellë në Kuvend strategjinë e re për privatizimin e PTK-së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Replikë, kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuar deputete Hykmete, po ju përmend me emër për arsye që të vazhdojmë debatin.

Jo për një muaj, por ne jemi të gatshëm sot kemi ardhur si grup, thjesht si Kabinet qeveritar që të përgjigjem në të gjitha rekomandimet tuaja dhe t'i marrim rekomandimet tuaja ato që janë të arsyeshme, por këtu shihet edhe një dallim në koncepte, sepse ju kërkon ndalimin e privatizimeve, ne jemi për ekonomi të lirë të tregut e jo koncept centralist dhe ekonomi të centralizuar të sistemit të së kaluarës.

Përsëri ju drejtohem edhe si intelektuale, kini kujdes Kosova është 15 vjet një vend i lirë, që 5 vjet vend i pavarur dhe sovran, respektoni konkurrencën e lirë.

Sa i përket Aeroportit të Prishtinës, unë ju ftoj që në pjesën e parë të vjeshtës ende nuk është caktuar data, të merrni pjesë bashkërisht të gjithë si jemi kështu, sepse do të jenë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, në ceremoninë e inaugurimit të ndërtimit të aeroportit më të mirë në rajon.

Edhe sa i përket përfitimeve zhvillimore për ndërtimin e autostradës prej kufirit të Shqipërisë deri në Prishtinë dhe tutje, gjithashtu diskutojmë qysh sot, por edhe pas një muaji edhe kurdo që të jeni të gatshëm. Edhe sa i përket projekteve tjera që ju i ngritët, urdhëro mund të diskutojmë, por në të njëjtën kohë më lejoni që edhe unë si qytetar i Kosovës edhe si banues në Prishtinë, si ju të gjithë të tjerët që kemi ardhur këtu si qytetarë të Prishtinës, por edhe si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, neve të gjithëve na shqetëson dhe unë do t'ju parashtoj edhe pyetje, pasi që kemi investuar goxha shumë në Prishtinë.

A ka mundësi ju të Lidhjes Demokratike të Kosovës, miq të nderuar, të na tregoni për programin ekonomik të LDK-së, pra cili është programi zhvillimor i LDK-së për komunën e Prishtinës, se për Kosovë nuk keni program? A ka mundësi që talentin tuaj, kreativitetin tuaj ta aplikoni në komunën më të madhe të Kosovës, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë? Cilat janë programet zhvillimore tuaja për Prishtinë, a mund të ma thoni vetëm një projekt që sot qytetari i Prishtinës ndihet mirë dhe krenar me atë investim? Cilat janë politikat zhvillimore dhe investive, cilat janë lehtësirat për bizneset në Prishtinë, përpos rrethanave renduese që janë krijuar?

Sot komunën që udhëhiqni ju, kryeqytetin e Prishtinës e ka përfshirë një burokraci, e ka përfshirë një neglizhencë, një pa zhvillim dhe mund të them lirisht një bllokadë totale e funksionimit të qeverisjes. Prandaj, unë ju ftoj që fillimisht t'ju zotoheni qytetarëve në nivel të Prishtinës që e udhëhiqni që 15 vjet dhe ju i shihni ndryshimet a ka ndodhur apo jo.

Unë ndihem tepër mirë që kam investuar në Prishtinë më shumë se ju për këto 5 vjet se sa ju 15 vjet, qoftë në infrastrukturë, qoftë në arsim, qoftë në shëndetësi, qoftë në gjithë sektorët tjerë. Ne nuk po zhvillojmë këtu garë elektorale se është herët, mirëpo sido që të jetë qytetari i sinqertë do t'ju parashtronte këto pyetje. Faleminderit, shumë!

HYKMETE BAJRAMI: Kryetar, dua replikë, kam të drejtë.

KRYETARI: Jo, ju lutem, jo nuk e keni të drejtën, e ke harxhuar të drejtën. Tash e kemi radhën e grupeve. Dëgjoni çdo grup ka të drejtën ta paraqesë pikëpamjen e vet dhe shkojmë, nuk ka ndërhyrje sa e kanë fjalën kryetarët e grupeve parlamentare, mbasandaj vazhdojmë.

Në emër të Partisë Demokratike, e ka fjalën deputeti Zenun Pajaziti.
T'i kryejmë me kryetarët e grupeve parlamentare, pastaj vazhdojmë debatin si të doni.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, për fjalën zoti kryetar i Kuvendit!
Kryeministër, Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e konsideron që është e rëndësishme të ketë debate të tilla në Kuvendin e Kosovës, ne shpresojmë që edhe nga ky debat të ketë sa më shumë ide të cilat do të ndikojnë pozitivisht edhe ata që marrin vendime që ekzekutojnë ligjet, po edhe në Kuvendin që eventualisht të ndryshojmë ligjet në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit.

S'do mend që viteve të fundit Kosova ka përjetuar një rritje të ndjeshme ekonomike dhe ka ruajtur stabilitetin makroekonomik përkundër krizave ekonomike që kanë përfshirë më gjerë edhe botën.

Kjo pasqyrohet edhe në të dhënat e fundit të cilat tregojnë se bruto-produkti vendor është rritur përafërsisht në një miliard euro që nga viti 2009, përkatësisht nga 4.007 miliardë, në 5.094 miliardë.

Po në këto vite rritja ekonomike në Kosovë ka vazhduar të shënojë progres përkundër faktit që po thuaj të gjitha shtetet evropiane ka ngelur ose kanë pasur trende negative që nga viti 2010, Kosova ka shënuar rritje konstante prej më shumë se 3% që tanimë figuron në statistika, ndërsa në vitin 2011 është shënuar rritja më e madhe ekonomike prej 5%, në vitin e kaluar bruto produkti vendor ishte 3.9%, ndërsa në këtë vit po ashtu parashikohet një rritje më e madhe se 3% dhe kjo është inkurajuese, jo ndoshta shumë e pritshme përkundër nevojave që i kemi ne, por është inkurajuese për shkak trendëve që janë rreth nesh.

Përkundër sfidave të shumta nëpër të cilat ka kaluar Kosova, në vitet e fundit kemi arritur të bëhemi anëtar të institucioneve financiare ndërkombëtare siç janë: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të cilat përmes kredive të buta ne shpresojmë që do të vazhdojnë të ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit.

Është tejet e rëndësishme që vendi ynë ka përkrahjen e këtyre institucioneve përmes të cilave do të arrihet të realizohen projektet e mbetura nga aspekti infrastrukturor, energjetik e tjera deri tek përkrahja e sektorit privat në vend.

Krahas mbështetjes të institucioneve financiare, Qeveria e vendit ka punuar në krijimin e politikave ekonomike funksionale në funksion të mbështetjes së sektorit privat dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Stagnimi ekonomik ka qenë një mësim për krijimin e politikave të reja zhvillimore përmes të cilave mund të arrihet një qëllim afatgjatë i zhvillimit ekonomik si gjenerator i ardhshëm i rritjes së eksportit dhe punësimit. Këto politika përfshijnë kriteret në bazë të cilave do të mund të realizohet anëtarësimi i ardhshëm në Bashkimin Evropian, i cili edhe mbetet qëllimi afatgjatë e strategjik i vendit tonë.

Në kuadër të këtyre politikave Qeveria ka arritur ta ruajë borxhin publik të ulët, po ashtu përmes politikave monetare e fiskale Kosova, ka arritur t'i rritë të ardhurat doganore përmes rritjes së akcizës. Në të njëjtën kohë duke mbështetur prodhuesit dhe

konsumatorët nëpërmjet heqjes së TVSH-së në disa produkte esenciale ushqimore dhe detyrimit prej 0% doganor për disa lëndë të para që importohen. Në këtë mënyrë është arritur rritja e produktit vendor dhe e punësimit dhe rritja aq të nevojshme eksportit përmes të cilit shpresohet të ulet edhe më shumë deficitin tregtar i Kosovës.

Më lejoni të përmend diçka që me të drejtë u kërkuar edhe nga ata që parashtruan këtë debat si sfidë dhe ajo është ekonomia joformale e cila ndikon dukshëm në të ardhurat e shtetit që ato të mos mblidhen në masën e mjaftueshme.

Ndërsa, në anën tjetër mungesa e gjenerimit të ardhurave shtrun nevojën e reduktimit të investimeve aq shumë të nevojshme për vendin tonë, në nivelin qendror edhe ashtu në nivelin lokal.

Konkurrenca jolojale gjithashtu ia vështirëson aktivitetin ekonomik bizneseve të ligjshme si pasojë e humbjes së të ardhurave që nxisin Qeverinë shtetërore që të ngrisë taksat.

Nga pasojat e informalitetit vuajnë edhe punëtorët për të cilin punonjësit nuk paguajnë kontribute dhe në këtë mënyrë figurojnë si të papunësuar. Kjo jo vetëm që dëmton shtetin ose pamjen, por edhe punëtorët të cilët në të ardhmen nuk do të arrijnë t'i sigurojnë kontributet e tyre pensionale përkundër faktit që kanë qenë në një farë mënyrë të punësuar. Për këtë arsye në këtë moment është shumë e rëndësishme që të luftohet kjo dukuri, të formalizohen të gjithë të punësuarit dhe të rritet pagesa minimale.

Rritja e pagesës minimale do të ishte një stimul tjetër që punonjësit të mos paraqesin punëtorët ekzistues dhe në të ardhmen si synim për evitimin e zvogëlimin e shpenzimeve operative të bizneseve, krejt kjo në dëm të punëtorëve kosovarë.

Më lejoni që t'i prezantoj disa faktorë të cilët janë në funksion të shpresës që do të ketë rritje dhe të shfrytëzohen këto si kapacitete, që konsiderohen disa të dhëna që janë konsideruar si përparësi mbi bazën e cilave janë ndërtuar edhe politikat aktuale edhe të Qeverisë të vendit tonë për zhvillimin ekonomik dhe këto janë: popullata e re, pozita e volitshme gjeografike për qasjen në tregjet evropiane, euroja si monedhë zyrtare, çmimi më i ulët i pronave të tokës, potenciali i aktivizimit të resurseve natyrore e tjerë.

Pra, Kosova po shënon progres edhe në përdorimin e teknologjisë më të re informative në jetën e përditshme dhe kjo është një fakt që është për t'u admiruar.

Kështu sipas të dhënave të fundit, përdorimi i telefonisë mobile në Kosovë në vitin 2012 ka arritur në 96%, ndërsa numri i konsumatorëve në më shumë se 1.1 milion dhe përdorimit të internetit në vitin 2012, që ka arritur në 48% me shkallë më të lartë të rritjes së vazhdueshme. Pra, kemi në vazhdimësi një rritje të përdorimit të telefonisë mobile dhe internetit dhe është fjala po ashtu edhe për teknologjinë më të re informative.

Dhe, po ashtu një fakt i rëndësishëm që duhet të potencohet është përmirësimi i furnizimit me energji elektrike, ku kemi edhe procedura të reja të ndërtimit të

kapaciteteve të reja të energjisë që është inkurajuese nga ato të dhëna, të cilat ne na vijnë edhe nga Rregullatori i Energjisë dhe nga informatat që sillen nga ana e Qeverisë.

Më lejoni t'i sjell edhe disa statistika që po ashtu janë të rëndësishme për bizneset në Kosovë ose të bërit biznes.

Në vitin 2012, Kosova ka shënuar progres të ndjeshëm në raportin e Bankës Botërore me të bërit biznes. Kosova ka përmirësuar treguesin e fillimit të biznesit për 44 vende në krahasim me vitin e kaluar, treguesi për leje të ndërtimit është përmirësuar për 33 vende, ndërkohë që përmirësimet më të mëdha janë bërë në mbrojtjen e investitorëve ku Kosova ka lëvizur pozitivisht për 76 vende. Qasja në rrymë elektrike është përmirësuar në 6 vende, pagesa e taksave për 4, tregtia ndërkufitare është përmirësua për 9 vende, ndërsa zbatimi i kontratave për një vend.

Ne do të punojmë, jemi të përkushtuar si grup parlamentar që në aspekt të ndryshimit të ligjeve në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit në të gjitha fushat, në të gjithë dikasteret në të cilat parashihet e nevojshme në mënyrë që të japim kontributin tonë edhe si Kuvend në të mirë të zhvillimit ekonomik.

Më lejoni si përfundim të theksoj që Grupi Parlament i PDK-së, inkurajon Kosovën që të anëtarësohet, përveç në këto institucione që u përmendën ndërkombëtare financiare, të vazhdojë të marrë pjesë edhe iniciativa të tjera regjionale dhe ndërkombëtare dhe të bëhet anëtare e institucioneve tjera të cilat shihen me interes për vendin tonë. E inkurajojmë Qeverinë dhe Agjencinë e Privatizimit të Kosovës që të vazhdojë në procesin e privatizimit dhe të mos ketë ngecje, inkurajojmë po ashtu Qeverinë që sivjet për shkak se ka edhe mandat që të rishikojë strategjinë e energjisë. Ne do të jemi të përkushtuar të japim mbështetjen tonë në ndryshimin e ligjeve nëse ka nevojë edhe nëse parashihet në strategjinë e Qeverisë dhe do të jemi aktorë aktiv po ashtu në mbështetje të trajtimit të ndryshimit të strategjisë së energjisë. Inkurajojmë po ashtu Qeverinë në projektet e infrastrukturës edhe në Aeroportin edhe në rrugët edhe në projektet tjera dhe po ashtu të kërkohet edhe më shumë fonde në institucione të ndryshme financiare, në mënyrë që të realizohen kërkesat e qytetarëve dhe të ekonomisë së vendit. Dhe po ashtu inkurajojmë që Qeveria të mos i lë anash po ashtu politikat sociale, rritjen e pagave edhe ato që u thanë edhe prej kryeministrit, të shihet mundësia e rritjeve të vendeve të punës ose krijimi i vendeve të punës.

Po ashtu Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike inkurajon edhe Qeverinë edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Ose lexoni ose komentoje fjalimin ju lutem, edhe gjysmë minute përmbyle, janë 40 veta që janë të paraqitur.

ZENUN PAJAZITI: E inkurajojmë Qeverinë në përmbushjen e atyre që quhen kritere ose sfida në Raportin e Progresit. Ne do të luajmë rolin tonë po ashtu në pjesën që na takon për sa i përket legjislacionit dhe po ashtu njëkohësisht i ftojmë të gjithë, edhe deputetët, forcat politike të gjithë të luajnë rolin e tyre në bazë të përgjegjësiave që kanë, në mbështetjen e politikave që e qojnë vendin tonë kah rritja ekonomike dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Atë kryesisht që kishte të thoshte, e tha zonja Bajrami, sigurisht që unë shfrytëzoj rastin të them edhe fjalën time edhe në emër të Grupit, por edhe atë çfarë u tha më herët nga zoti Thaçi.

Sigurisht që sot në rend të ditës është debati për zhvillimin ose gjendjen ekonomike në vendin tonë dhe nuk është debati për zhvillimet nëpër komuna të caktuara, aq më shumë që një program ekonomik të tillë çfarë e ka pasur në nivel të vendit edhe nëpër komuna tjera ku iu ka shitur, nuk iu ka shitur në Prishtinë edhe për këtë edhe nuk e fiton votat, sepse asnjëherë program të mirëfilltë për qytetarët e Prishtinës nuk ka afruar kjo Qeveri dhe as investime asnjëherë të mirëfillta s'ka bërë dhe unë nuk dëshiroj ta ngushtoj rrethin e diskutimit tim vetëm për Prishtinën. Vetëm dua t'ia rikujtoj kryeministrit se nuk është që 15 vjet, por po i duket 15 vjet Prishtinën nuk e udhëheq LDK qe 15 vjet, por nëse e shikoni më gjatë, jemi që nga 23 vjet, nëse llogarit prej kur është themeluar LDK-ja, por nuk është fushatë elektorale po pajtohem, prandaj mos e shfrytëzoni për fushatë elektorale, sepse nëse dikush e ka penguar Prishtinën, është PDK-ja dhe ju që së pari Ligjin për Prishtinën nuk e keni bërë, është minimumi i asaj që keni mund të bëni zoti kryeministër, nuk e keni bërë. Dhe, mendoj që nuk është mirë për ta zhvendosur dhe ju të na bëni pyetjen ne, sepse ne jemi deputetë dhe po i ngremë shqetësimet tona, do të duhej të ishte e kundërta. Se politika e Qeverisë ka qenë diskriminuese karshi po e marrë tash edhe komunave që nuk i udhëheq PDK-ja, është shumë e qartë edhe në buxhetin që ka qenë për këto 2-3 vjet të kaluar, por edhe në buxhetin e këtij viti, veçmas për investimet kapitale, aspak nuk është buxhet i paraparë dhe që ka objektiva zhvillimore, por thjesht po shpërndahet dhe po bëhet në baza politike.

Duke mos e anashkaluar rëndësinë e investimeve kapitale në infrastrukturë, megjithatë rreth 60% të këtyre investimeve shkojnë për infrastrukturë dhe vetëm 4.6 e këtyre investimeve shkojnë në arsim. Vetëm 2.7% e investimeve janë të lidhura direkt me projekte që promovojnë zhvillim ekonomik. Në anën tjetër në një vend ku gjysma e popullsisë jetojnë në zonat rurale, ju e dini që në bujqësi investohen vetëm diku 1.8% të investimeve kapitale, e kam fjalën për këtë vit, sepse dëshirojmë të fokusohemi së paku në Qeverinë Thaçi 2 që është thënë dhe jo të kthehemi në një ekspozë 5 vjeçare apo 10 vjeçare.

Është shumë e qartë që qytetarët të cilët nuk e kanë votuar ose s'i kanë votuar partnerët e koalicionit në komunat e caktuara, janë të ndëshkuar në formë të ndryshme.

Në tre vjetët e kaluara në komunat që udhëhiqen nga PDK-ja është duke u investuar mesatarisht 2 herë më shumë për kokë banori se në komunat që udhëheqin partitë tjera, në këtë rast LDK-ja, por sigurisht edhe AAK-ja.

Dhe, nëse në një komunë nga PDK-ja është 11 euro për kokë banori për arsim, tek ato ku udhëhiqen nga LDK-ja, është 6 euro për kokë banori dhe këta qytetarë zoti Thaçi janë edhe qytetarë të Kosovës, pavarësisht cila komunë i udhëheq dhe nuk e di cila është arsyeja e një diskriminimi të tillë në ndarjen e buxhetit dhe të investimeve të caktuara.

Po ashtu këto dallime janë edhe më të mëdha kur analizohen secila komunë veç e veç. Keni komunë që 230 euro për kokë banori investohet më shumë se sa në kryeqytetin tonë aq të dashur për ju e për ne, të dashur me fjalë e pak me investime.

Sa i përket infrastrukturës ose investimeve rrugore, në infrastrukturën rrugore t'ju them se trefish më shumë keni investuar për kokë banori, po ashtu në komunat që udhëhiqen nga ju, që po ashtu është një dallim dhe një diskriminim i qartë. Kjo në asnjë mënyrë, sepse e di që mund të thoni që nuk duhet komunat edhe pjesët e Kosovës që ka pasur pak investime të lihen kësaj siç kanë qenë, që unë pajtohem plotësisht. Nuk e meriton asnjë pjesë e Kosovës të mbetet si para 50 vjetëve ose 40 vjetëve, absolutisht e kemi obligim ndaj të gjithëve t'ua përmirësojmë jetën, por jo me dallime të tilla të mëdha çfarë ka ndodhur gjatë kësaj qeverisje.

Ne konsiderojmë si LDK që kjo shpërndarje e investimeve kapitale nuk është bërë dhe nuk po bëhet në mënyrë të drejtë. Merreni vetëm sipas Ligjit të arsimit, realisht këto investime në shkollë kjo e drejtë është dashur kaherë t'i kalohet komunave, por kjo mbahet si e drejtë në nivel qendror, sepse pastaj investojnë ku të donë apo ku i kanë normal simpatizantët dhe votuesit e tyre.

Nga ajo që kemi vërejtur dhe shohim absolutisht të gjitha këto që gjer më sot ka ndodhur nuk sigurojnë që gjithë qytetarët përfitojnë njësoj dhe nuk po investohet në sektorët ku rritet dhe shtrohet numri i të punësuarve.

Zoti kryeministër,

Ishin disa edhe pyetje konkrete të cilat do të duhej përgjigjur. Pyetja ishte shumë e qartë - cila është kostoja e jetës sot? Është e vërtetë që ka rritje të pagave, por është e vërtetë që ka rritje të kostos së jetës dhe kjo rritje pastaj shumë e zvogëlon mundësinë që qytetarët të jetojnë ashtu siç do të duhej të kenë mirëqenie, këtë e dini edhe ju, sepse standardi ynë është rritur, çmimet janë rritur dhe kjo rritje e pagës absolutisht nuk e ka përmirësuar ose edhe më tepër është keqësuar mirëqenia e qytetarëve tanë. Cili është ai standard i qytetarëve tanë, cila është ajo shkallë e papunësisë 45%, sa veta zoti kryeministër kanë hyrë në punë në këtë vit, a kanë hyrë ose vitin e kaluar se sa 2 vjet, 3 vjet më herët? Sa janë të kënaqur pensionistët, të gjitha janë këto probleme që ne i shprehin qytetarët?

Asnjëherë LDK-ja s'ka qenë kundërt ndërtimit të autostradës, mos i ndërroni tezat, kemi qenë dhe jemi kundër mos transparencës, duhet dihet e sot s'e dimë cila ka qenë kontrata, vetëm e dimë që është më e shtrenjta për një kilometër asfalt në rajon, këtë e dimë, por që

kemi qenë kundër, asnjëherë s'kemi qenë, bile- bile e dini ju që dikush nëse e ka iniciuar këtë punë ka qenë Lidhja Demokratike e Kosovës dhe presidenti Rugova. Kjo është diçka që e dinë të gjithë qytetarët, nuk kemi qenë dhe nuk jemi kundër, por dëshirojmë ta dimë pse kushton 10 milionë euro një kilometër asfalt dhe pse është gjithë ky çmim është çmimi më i lartë në regjion?

Nuk kemi qenë dhe nuk jemi kundër privatizimit të Postës. Nuk e them as në rekomandimet tona të ndalet, por thamë të pezullohet, nuk është njësojë, të hartohet një strategji dhe ju po e shihni të qartë që këtu ka dështime, sepse po të ishte e kundërta ai ish privatizuar se ashtu, ashtu nuk ishit kah na pyesni përkundër qëndrimit të grupit tonë, një numri të deputetëve, ai u fut në procesin e privatizimit.

Zoti kryeministër,

Tregona se asnjëherë s'na keni thënë, këtu haptas keni thënë unë do t'i depolitizoj institucionet ose agjencitë e pavarura. Nuk e keni bërë zoti kryeministër, sepse keni thënë nëse AKM-ja ose ish AKM-ja, AKP-ja ka qenë e politizuar me ministra, kjo është e vërtetë në kohën e UNMIK-ut, keni thënë këtë s'do ta lejojë dhe ju e lejuat, sepse e dërguat një njeri të tuajin që mund të jetë profesionist, po që është eksponent i juaj politik dhe kjo do të thotë nuk po del që është asisoj.

Ju zoti ministër guvernatorin e Bankës e zgjodhi ky Kuvend, deputetët e juaj një njeri që deri dje ka qenë ministër dhe kjo nuk ka lidhje me depolitizim të institucioneve. Të gjitha këto zoti kryeministër, mendoj që ndikojnë edhe në zhvillimin ekonomik, sepse në momentin që politizohen institucionet ato ka mundësi edhe të mos e kryejnë atë funksion për të cilin edhe janë të formuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër e ka fjalën, po thashë ta kryejmë me grupet parlamentare, pastaj...

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Sa janë të freskëta ende.

I nderuari kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri,

Unë fillimisht e theksova, ne kemi ardhur si Kabinet qeveritar që t'i ballafaqojmë argumentet gjatë këtij debati me qëllimin më të mirë që të ruhet edhe niveli i debatit, niveli edhe politik edhe profesional. Edhe jam i bindur që ky debat, qoftë në nivel Kosove, qoftë në nivel të çdo komune, qoftë edhe në nivel të kryeqytetit, do t'i shërbejë së mirë së punës sonë apo përmirësimit të punës sonë të gjithëmbarshme.

Edhe ne jemi të vetëdijshëm se janë bërë të arritura të mëdha në nivel të Kosovës, por jemi edhe shumë të vetëdijshëm se duhet bërë edhe më tepër.

Edhe ju Lidhje Demokratike e Kosovës jeni të kënaqur me të arriturat në Prishtinë, por jam shumë i vetëdijshëm se e dini që duhet të bëni më tepër. Prandaj, edhe insistimi im është që të bëhet më tepër dhe të punohet më mirë edhe më shpejtë dhe jo i adresuar kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës, por adresimet e mia, shqetësimet e mia janë

shqetësime mund të them lirisht edhe të qytetarëve të Prishtinës edhe të vetë elektoratit tuaj që duan që të kenë punë më të mira, projekte më të mira, jetë më të mirë.

Unë përmenda 15 vjet në kuptimin edhe simbolik, ju shkuat 23 vjet, ju mund të ktheheni edhe në '45-në e deri sot, do të thotë nga '45 e deri më sot që e keni udhëhequr Prishtinën, mund të thoni.

Por, unë dëshiroj t'ju parashtroj përsëri pyetjet të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me qeverisjen tuaj në Prishtinë.

Ju zoti Beqiri keni udhëhequr vetë komunën e Prishtinës një kohë, ka qenë edhe më keq siç është sot, e vlerësoj vullnetin e zotit Mustafa për punë. Por ju keni premtuar ndërtimin e unazës në Prishtinë, ma thuaj a e keni bërë vetëm një metër unazë të Prishtinës? Ma thuaj të lutem, i keni premtuar qytetarëve të dashur të Prishtinës, ndërtimin e unazës së Prishtinës, ma thuaj a e keni planin ideor, a e keni bërë studimin, fizibilitetin dhe a e keni filluar vetëm ndërtimin e një metër unazë? Dhe mendoj që qytetarët e Prishtinës e meritojnë përgjigjen nga ju i nderuari dhe i respektuari zoti Beqiri.

Përmendët buxhetin, për çdo vit ju teprojnë para, do të thotë, është paaftësi menaxhuese dhe qeverisëse, jo mungesë buxheti. Ma thuaj, a ju teprojnë buxhet për çdo vit nga viti 2007, 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012 dhe kanë për t'ju tepruar edhe 2013-në, kjo është paaftësi menaxhuese dhe paaftësi qeverisëse. Këtu kërkohet përgjigje precize, sa metra keni filluar së shtruari të unazës dhe a ju teprojnë mjete nga buxheti i Prishtinës, apo jo?

Sa i përket buxhetit, unë ju siguroj se Qeveria që udhëheq unë ka ndërtuar më tepër shkolla se ka komuna, ka ndërtuar më tepër rrugë në Prishtinë se sa komuna, ndërsa komunës po i teprojnë paratë edhe për shkolla edhe për rrugë edhe për trotuare edhe për sistem energjetik edhe për shumë e shumë projekte të tjera, kanalizim e ujësjellës dhe projekte të tjera, një shi me rrebes nëse bie, ju e shihni po e merr Prishtinën, nuk është përgjegjëse Qeveria.

E dini sistemin e ngrohtores është përgjegjësi e Prishtinës, jo e Qeverisë, ne gjithmonë ju ndihmojmë për ta kaluar atë acar të qytetarëve të Prishtinës.

Ma thuaj zoti Beqiri çka po ndodh me sheshet e Prishtinës që punohet që 6 vjet, veç i ndërroni ato pllaka, e keni filluar ju personalisht, e kam çmuar atë punë atëherë që ndryshoi pamja e Prishtinës, i vlerësoj edhe sot përpjekjen, por qytetari i Prishtinës kërkon gjithashtu përgjigje çka po ndodh tash e 6 vjet me këto ndryshim të pllakave, herë pllakat tuaja, herë pllakat e qeverisë aktuale. Janë dy sheshe të cilat do të duhej të përmbylleshin, unë i kuptoj vështirësitë teknike, i kuptoj vështirësitë teknike edhe profesionale, por qytetari i Prishtinës e kërkon një përgjigje, e meriton një përgjigje, sepse është në qendër të Prishtinës, në qendër të Kosovës, dy sheshe tash e 6 vjet me siguri, keni për të filluar t'i ndryshoni pllakat kah vjeshtat tjera, por është përgjegjësi e juaja derisa keni besimin e qytetarëve.

Në anën tjetër, po në Prishtinë, ma thuaj sa keni investuar në hyrje dhe dalje të Prishtinës, të gjitha investimet që ka ndodhur në hyrje dhe dalje të Prishtinës janë të Qeverisë, ku ka bllokada është nga paaftësia e juaj dhe nga mos funksionalizimi i efektshëm dhe efektiv qeverisë.

Ndërsa, ndodh gjithë ai kaos në hyrje të Prishtinës, qoftë kur vjen nga Besiana, pra nga Llapi në drejtim të Prishtinës, qoftë kur të vish nga Fushë Kosova që bllokohesh përsëri në hyrje të Prishtinës, qoftë kur vish nga Ferizaj në drejtim të Prishtinës, ndërsa juve ju teprojnë para, çka po ndodh? Qeveria është fajtorë, qytetari që ju ka votuar është fajtor apo është paaftësia e juaj menaxhuese edhe mos qeverisëse e mirë? Pyetje tjetër që parashtrajnë qytetarët e Prishtinës është çka ndodh me Stadiumin e Prishtinës? Pyetje që është legjitime, çdo kush mund t'ju pyet.

Sa keni krijuar hapësirë gjelbërimi në Prishtinë, çka ka ndryshuar Prishtina në këto 15 vjet, apo vetëm në vitet e fundit. Unë përsëri, ne kemi marrë pjesë edhe bashkërisht në disa aksione për gjelbërimin e qytetit tonë të dashur të bukur, kryeqytetit tonë të dashur edhe të bukur, por s'janë të mjaftueshme.

Dhe, Ministria e Bujqësisë ka qenë aktive në këtë drejtim t'ju ndihmojë. Por ju e dini se është kryeqyteti më me pak hapësirë gjelbërim në Evropë, është e vërtetë, po, po kjo është e vërtetë.

Në anën tjetër, ma thuaj zoti Beqiri, ju e dini se biznesi në Kosovë është i koncentruar kryesisht, natyrisht në kryeqytet si çdo vend tjetër- cilat kanë qenë lehtësirat që ju i keni bërë për zhvillimin dhe krijimin e kushteve më të mira për biznesin në Prishtinë, cilat kanë qenë lehtësirat? Vetëm se iu kanë renduar kushtet dhe rrethanat për punë të bizneseve, gjë që ka ndikuar për largimin e njerëzve edhe nga puna, do të thotë e keni rritur numrin e të papunëve në Prishtinë.

Edhe kryeqyteti i Kosovës, Prishtina është një nga sferat më të rëndësishme zhvillimore të Kosovës dhe hyn në kuadër të angazhimeve dhe Qeverisë së Kosovës dhe të gjitha partive politike.

Prandaj, vazhdimisht shtrohen pyetjet cilat janë projekte zhvillimore të Prishtinës, mi thuaj 1, 2, 3 dhe qytetari i Prishtinës ju pyet zoti Beqiri. E di se s'ka. Inercioni elektoral nuk vazhdon gjithmonë.

(Reagime)

Na thuaj, zoti Beqiri, sa presin qytetarët në shërbime komunale, sa kohë humbin?

(Ndërhyrje: Ismet Beqiri: Hiç!)

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Hiç, veç nëse i përzini, se për sa presin, ju e dini. Na thuaj, zoti Beqiri, cila është gjendja e trafikut urban në Prishtinë?

Zoti Beqiri, ju keni premtuar sistem të tramvajit në Prishtinë. Ku është ai tramvaji juaj, zoti Beqiri? Ku është ai tramvaji i LDK-së, apo keni mbetur ende në mentalitetin e qerres me kalë? Qytetari të pyet dhe ne pyesim - pse po ju teprojnë paratë, ndërsa thoni ju s'kemi para. Para keni, Qeveria ju ka ndihmuar dhe do t'ju mbështesë maksimalisht në çdo projekt që e keni. Faleminderit, shumë i nderuari Beqiri!

KRYESUESI: Replikë, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues, unë s'do të reagoj më, ai le të thotë çka të dojë, mirëpo, s'keni të drejtë atij t'ia jepni 10 minuta, sepse ka hyrë në gjëra, më vjen keq që nuk është i informuar.

Zoti kryeministër po të informoj që ju asnjë cent për unazë s'e keni qitur. Prishtina i ka 3 unaza këtë s'e dinë ti se, se dinë se s'je i interesuar. Tri unaza Prishtina i ka të planifikuara, e para është e kryer, ju asnjë cent për të tjera s'e keni qitur, e para.

E dyta, sa i përket buxhetit që tepron, zoti kryeministër, janë të hyra vetjake dhe më mirë është për të tepruar se sa për t' i shkelur procedurat e për të ndjekur e për të quar në burg qysh po ndodh në shumë komunat që ju e dini këtë. Nëse ju mendoni që duhet shkelur procedurat, unë po e them publikisht shumë më mirë është për të tepruar para se sa për t' i keqpërdorur.

Zoti kryeministër ura për Fushë-Kosovë, 4 vjet Qeveria e ka ndërtuar atë, 4 vjet ka bërë, 4 vjet një urë në hyrje. Sa u përket hyrjeve, thatë në Prishtinë, nuk është e vërtetë, ato janë rrugë magjistrale. A ka mundësi të mos më pengoni... Hyrjet në Prishtinë janë rrugë magjistrale, është përgjegjësi e Qeverisë dhe për Podujevë ju asnjë cent s'e keni qitur në magjistralen Prishtinë-Podujevë, po Komuna e Prishtinës e ka bërë deri në Bardhosh, mos i dezinformonin qytetarët. Sheshet nuk janë duke u ndërtuar që 6 vjet, s'di ku po jetoni ju. Sheshi i parë është ndërtuar në vitin 2007, dy sheshe tjera janë që një vit duke u ndërtuar. Zoti kryeministër, mos dezinformoni, sepse që një vit kanë filluar sheshi i presidentit Rugova dhe sheshi "Zahir Pajaziti", që një vit. Sheshi "Nëna Terezë" është kryer në vitin 2007, po ju nuk e dini se s'ju intereson Prishtina, prandaj, mos thoni që janë që 6 vjet.

Stadiumi i Prishtinës, çka keni dhënë ju për stadiumin e Prishtinës? Komuna ka investuar në stadium, por s'kanë mjaftuar, i keni quar në komuna tjera shumë mirë, në Prishtinë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kundër replikë, ka zoti Thaçi ka. Unë s'mund t'ja marrë, Rregullorja ja jep.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Natyrisht se debati përcillet tek të dy partitë e mëdha, kështu që është edhe i natyrshëm ky debat, i nderuar zoti Beqiri, por përsëri e theksoj, ne jemi miq, nuk kemi asgjë personale, por diskutojmë në aspektin konceptual dhe ju keni kërkuar debatin, urdhëro, zhvillojmë debat, në asnjë rrethanë as ju as ne nuk do t'i ekzagjerojmë. Të gjitha pyetjet që ju i parashtuat për mua janë legjitime dhe

shqetësimet që i ngre edhe unë, besoj janë legjitime dhe nuk janë drejtuar as kundër partisë, as kundër kurrkujt individualisht.

Ju përmendët unazën. Unaza, tash po ndërtohet me ardhjen e autostradës për rreth Prishtinës, përndryshe nuk e di ku i thua unazë, nëse i thua unazë këtu përreth Parlamentit, kjo është e ndërtuar herët, është e ndërtuar, cila është kur e keni ndërtuar, po kjo është ndërtua para '80-ve, '70-ta, sepse e mbaj në mend, Profa e di më mirë zoti Hamiti, apo kush është këtu që e mban në mend atë kohë më mirë, kur ka ardhur profa në Prishtinë e di zoti Hamiti, a ka qenë në baltë, a ka qenë asfalt, tregoj zotit Beqiri. Po nëse thuhet që kemi ndërtuar rrugën përmes Parlamentit, do të thotë objekteve qeveritare këto kanë qenë kohës më të vjetër se sa lindjes së Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Ndërsa ne si Qeveri po investojmë në ndërtimin e autostradës, pra që do të marrë edhe përmasat e unazës, prej pjesës së hyrjes së Prishtinës, pjesës së hyrjes po them të Prishtinës, gjithashtu zonës industriale për të kaluar përmes pjesës së Dragodanit për të dalë në drejtim të Podujevës dhe vazhduar në Merdar, por eventualisht ndryshimin e trasesë në drejtim të Mutivodës deri në Leskoc, pra rrugës evropiane.

Teprimi i parave, pajtohem plotësisht duhet të respektohen në përpikëri procedurat, por është edhe mjeshtëria e atyre njerëzve që marrin përgjegjësi të punojnë edhe shpejtë edhe mirë, prandaj qytetarët e Prishtinës nuk kërkojnë dhe as ne si Qeveri, shkeljen e procedurave në asnjë rrethanë, por kërkohet që të punohet më shpejtë, më mirë dhe në këtë drejtim besoj që pajtohesh edhe ti zoti Beqiri. Do të thotë aty ku ka njerëz të dobët unë theksova duhet të merren dhe të punojnë njerëz që janë të përgatitur profesionalisht.

E përmendët Besianën, unë thashë i kam këtu ndryshimet e investimet që kjo ndodhur nga viti 2000 deri në vitin 2008 dhe nga viti që ne e udhëheqim bashkarish nga 3 vjet sa kemi qenë dhe tash investimet në Besianë kanë qenë diku nga 10 fish më tepër se sa investimet që i keni bërë ju, që e kemi bërë ne edhe në zonat rurale edhe në qytet edhe në magjistrale.

Sa i përket stadiumit se sa keni investuar nuk e di, por nuk e di në të njëjtën kohë edhe sasinë se sa keni marrë, por më shumë keni marrë se që keni investuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hamiti, replikë.

SABRI HAMITI: Kjo është temë e ekonomisë dhe nuk dua të bisedoj për ekonominë. Unë vetëm, zoti kryesues, po të them që është e drejta e kryeministrit që këtë bisedë ta shfrytëzojë, është e drejta e tij, po them, si propagandë parazgjedhore, është punë për të, veçse nuk është mirë që të derivojë problemi nga tema themelore dhe drejtuesi ka detyrim me Rregulloren, t'u thotë njerëzve, qoftë edhe kryeministrit, kthen në temën themelore.

(Ndërhyrje e kryeministrit Hashim Thaçi: Pse, Prishtina a s'është temë, prof?)

Nuk është sot temë Prishtina, po është Kosova, është Qeveria jote, zoteni, jo, jo, sot është temë Qeveria jote, kur të është edhe Prishtina, mund të vijë temë Prishtina këtu, sot s'është. Kjo nën një.

E dyta, thashë edhe një herë, s'dua të flas për ekonominë, le të flasim ata që thonë janë profesionalistë. Po, puna e Prishtinës është pak problem dhe nuk është mirë, nëse e duani kryeqytetin done, por mos e lakmoni. Raporti me Prishtinën i provincialistëve të Kosovës, se edhe Prishtina është një qendër provinciale në esencë, por megjithatë ka rrethe, është që e lakmojnë e s'e duan. Nëse e doni, investoni, dojeni e kërkoni përgjegjësi, mos e lakmoni. Po të ishte e keqe Prishtina nuk bëjnë turr krejt Kosova të jetojnë në Prishtinë. Është një standard kulturor më i madh, është edhe një civilizim pak më i madh, është edhe një qytet pak më i madh. Dhe, ky qytet duhet të bëhet qendër, që ditën kur Kosova është shtet, Prishtina është qytet, është kryeqytet dhe duhet të investohet, aq sa mund të investohet edhe nga vetë qyteti edhe nga Kosova, se është qendër përfaqësuese.

Edhe një herë po them, ka prishtinas dhe ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kundër-replikë zoti Thaçi, veç shkurt të lutem se...

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Hamiti ju dhe unë si të prishtinizuar, po,

(Ndërhyrje, Sabri Hamiti: ...se ti je në proces...)

Mirë de mirë, OK. I nderuar zoti Hamiti, Është e vërtetë, ne e duam Prishtinën dhe e duam si gjithë Kosovën. Por, edhe e duam të zhvilluar, e duam të modernizuar, të qytetëruar dhe në të njëjtën kohë, nuk e duam se e kemi lakmi, por e duam sepse është kryeqyteti ynë, në kuptimin e lakmisë, çfarë ju menduat, por e duam se duam ta zhvillojmë e duam se duam ta modernizojmë dhe ta bëjmë një kryeqytet evropian. Dhe, këto primesa mungojnë, i mungojnë kryeqytetit tonë, i mungojnë edhe Kosovës në masë të theksuar, por në të njëjtën kohë ju, i nderuar Hamiti, si përfaqësues i LDK-së, duke injoruar qendrat tjera të Kosovës, mendoj se lëshoheni në lajthitje. Nuk mund të injorohet Prizreni, nuk mund të injorohet as Mitrovica, s'mund të injorohet as Peja, as Gjakova, as Dukagjini, as Shala, as Gjilani, as Ferizaj.

Por, në të njëjtën kohë vazhdimisht njerëzit pyesin, çka keni bërë ju për punëtorët e shëndetësisë në Prishtinë? Sa i keni rritur pagat për punëtorë të shëndetësisë? Ndonjëherë, a keni marrë vendim si parti, për rritje të pagave? Sa keni bërë ju për Policinë e Kosovës? Kur keni marrë ndonjë vendim për rritje të pagave të Policisë së Kosovës? Kur ju keni marrë ndonjë vendim në historinë tuaj politike për rritjen e pagave të profesorëve universitar të shkollave të mesme apo fillore?

(Ndërhyrje)

Ju, more e keni qeverisur Kosovën 8 vjet. Po, mbasi po hyni në këto debate, atëherë është e drejtë imja t' ju pyes edhe unë juve.

(Ndërhyrje: Komuna...)

Po, komuna, ju vonë kenë rënë në komunë, krejt Kosovën e keni udhëhequr.

(Ndërhyrje: Ismet Beqiri: Përsëri do ta udhëheqim.)

Për përsëri, të shohim. Nëse vazhdoni kështu me këtë dështim në Prishtinë, besoj që keni për të mbetur keq edhe në Prishtinë. Por, sido që të jetë, të gjithë është mirë që në Kosovë e akceptojmë rotacionin demokratik dhe vullnetin e qytetarëve të vendit. Në të njëjtën kohë, secili sot ju pyet edhe juve, siç ju pyes edhe unë, edhe si qytetar edhe si kryeministër.

I nderuar zoti Hamiti, zoti Beqiri, ju kolegë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nëse ju mendoni ta injoroni kështu kryeqytetin e Kosovës, që Prishtina nuk është temë e zhvillimit ekonomik, kryeqyteti është baza, bërthama e zhvillimit ekonomik të një vendi dhe derisa këtu kemi stagnim, e kemi vështirë për të lëvizur edhe në...

(Ndërhyrje, Sabri Hamiti: ...bëhu serioz...!)

Jo, unë bëhem shumë serioz dhe pyetjet e mija janë shumë konkrete, të drejtpërdrejta, siç kërkon edhe qytetari, pret përgjigje nga ju, të drejtpërdrejta. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë nuk mund ta ndryshoj rrjedhën e seancës, sepse ju vetë po dëshironi të komunikoni dhe të debatonit për Prishtinën, krejt...

(Ndërhyrje, Sabri Hamiti: merrne... veç mua mos...)

Në rregull është... Krejt diskutimi i kryetarit të Grupit Parlamentar ishte për Prishtinën. Edhe i yti, zoti Sabri ishte për Prishtinën... Po, zoti kryeministër, e keni fjalën edhe një herë.

(Ndërhyrje, Sabri Hamiti: Pse po ma përmend emrin?)

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Hamiti, Ju po insistoni vazhdimisht për debat. Ju vini nga Besiana. Keni ardhur në Prishtinë.

(Ndërhyrje, Sabri Hamiti.)

Jo, jo, të lutem, unë ju pyes juve drejtpërdrejt, edhe si intelektual, edhe si deputet, si përfaqësues i popullit të Kosovës, më thuaj kush ka investuar në qytetin tuaj të lindjes në Besianë, më tepër se Qeveria që e udhëheq unë. Ma thuaj! Urdhëro, hajde i krahasojmë!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYESUESI: Zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryesues!

Kisha bërë një thirrje, veçanërisht prej teje, meqë je udhëheqës i kësaj seance, që t'i përmbahemi rendit të ditës. Edhe sot, rendi i ditës, me sa e kam parë unë me arsyetimin dhe kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së, nuk ka qenë t'i diskutojmë zhvillimet urbanistike dhe infrastrukturore në Prishtinë. Mbase edhe ka nevojë ta diskutojmë një gjë të tillë edhe mbase edhe mund ta thërrasim një debat të tillë, po sot nuk është kjo temë.

Po, unë mendoj që këto shpërthime të kryeministrit, që i pamë herë pas here këtu, domethënë, që tentonte edhe ta përqueshte këtë debat, e tregojnë edhe nivelin e dijes së tij për atë se çka është ekonomia dhe çka është shteti, për shkak se ky nisi me projektin zhvillimor për Prishtinën. Pra, i shtronte pyetje Lidhjes Demokratike, a ka Lidhja Demokratike projekt zhvillimor për Prishtinën. Dhe, unë në këtë absurd po i vazhdoj edhe disa pyetje, pra mund të na tregoni Lidhja Demokratike, cili është brutoprodhimi vendor i Prishtinës? Cila është balanca tregtare e Prishtinës? Sa është varfëria në Prishtinë, e kështu me radhë, parametra këto makroekonomik, që përdoren për shtetin, kryeministër.

Pra, komuna nuk është shteti. Sigurisht, që ka nevojë t'i diskutojmë zhvillimet nëpër të gjitha komunat e Kosovës, përfshirë Prishtinën, po sot po e diskutojmë gjendjen ekonomike në Kosovë. E këto që u folën këtu nuk kanë asnjë lidhje me gjendjen ekonomike në Kosovë. I dëgjova këtu edhe nga ministra që thanë, po është e rëndësishme, se shumica e bizneseve qenkan në Prishtinë.

Pra, sipas kësaj Qeverie, politikat komunale janë më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, se sa ato qendrore, që nënkupton që ne në fakt, nuk paskemi nevojë fare për qeveri qendrore, por vetëm për qeveri komunale, apo jo, se ato po na e zhvilluakan apo po na e pamundësuakan zhvillimin ekonomik të vendit, e jo kjo qeveri.

Atëherë, pyetja ime për tash zëvendëskryeministrat, se kryeministri s'qenka këtu, është: Çka bëni ju, meqenëse komunat po e zhvilluakan apo po e rrënuakan ekonominë e vendit, çka bëni ju, përveç që shkoni në negociata me Serbinë, çka tjetër bëni ju?

Pra, është një pyetje shumë legjitime, se ne e paguajmë shumë shtrenjtë një qeveri, e cila nga kryeministri e morëm vesh që s'po bëka bash asnjë gjë.

Unë mendoj, që për sa i përket ekonomisë, kur ta diskutojmë ekonominë, duhet ta kemi parasysh një gjë, së pari duhet ta diskutojmë modelin. Pra, është lajthitje që të mendohet se ekziston vetëm një model ekonomie, sepse pastaj në këtë model ekonomie diskutimi domosdoshmërisht, po qe se pranohen kornizat e kësaj, atëherë diskutimi do të jetë një lloj gare, në mes të asaj se kush do të jetë më i mirë përbrenda një modeli të caktuar dhe kornizave të caktuara ekonomike, që nënkupton kush është menaxher më i mirë i aspekteve të caktuara të atij modeli.

Pra, siç e përmendi zoti Thaçi, menaxhimi, shtrimi i rrugëve, pllakave, kush i ka shtruar i pari, kush i dyti, pra ky është diskutimi ekonomik në kokën e kryeministrit, që s'është fare diskutim ekonomik kur ta shikosh në fund të fundit, është më shumë çështje e urbanizmit.

Kur ta kuptosh që ekzistojnë më shumë se një model ekonomik, atëherë do ta kuptosh edhe se cili prej atyre modeleve ekonomik, edhe bazuar në parime kryesore politike, po edhe bazuar në rrethanat e një vendi të caktuar, mund të jetë më i suksesshëm për vendin. Dhe, unë po ju them, nuk ekzistojnë vetëm dy modele ekonomike, siç e përmendi kryeministri, pra ose kapitalizmi i egër zhvatës që po synon ta instalojë në Kosovë, ose centralizmi i ekstremit të majtë, po ka përbrenda tyre një vistër e gjerë modelesh të caktuara ekonomike që i kanë përdorur shtetet e ndryshme, në kohëra të ndryshme, në rrethana të ndryshme për ta zhvilluar veten.

Pra, i vetmi synim kur flasim për modelin ekonomik, duhet të jetë zhvillimi ekonomik, për shkak se zhvillimi ekonomik është e vetmja gjë e paalternativë, ndërkohë që këtu edhe te Qeveria e Kosovës e vetmja gjë e paalternativë është ekonomia e tregut të lirë. Pra, kur t'i pyesësh çka po bëni për zhvillimin ekonomik, këta thonë- po e ndërtojmë ekonominë e tregut të lirë. Kaq. A do të na sjellë ajo përfitime, apo jo, nuk ka kurrkush analizë. Ku do të shkojmë me këtë model ekonomik, askush nuk ka analizë.

Pra, këtu na foli kryeministri për disa masa që i ka marrë, disa prej tyre ekonomike, disa prej tyre sociale, që natyrisht se kanë ndikim në ekonomi dhe të gjitha këto ishin masa, të cilat pa e pasur parasysh një lloj vizioni strategjik të kryeministrit, na mbetet të përfundojmë që janë masa ad-hoc, për ta blerë një paqe sociale në kohë të caktuar dhe për të arritur një përfitim personal ose grupor në kohë të caktuar, por jo masa të cilat e drejtojnë Kosovën diku ku Qeveria vërtet dëshiron ta dërgojë Kosovën në rrafshin ekonomik.

Dhe, në këtë drejtim, konsideroj që është e rëndësishme, tejet e rëndësishme, që njëri prej parametrave më të përfolur ekonomik, jo vetëm në Kosovë, po gjithkund në botë, të mos kuptohet me këtë qasje jokritike me të cilën e përdorë Qeveria e Kosovës, e ajo është rritja e bruto produktit vendor apo rritja ekonomike, siç quhet shpesh.

Domethënë, ky është parametri i cili merret si parametër bazë për analizën e zhvillimeve ekonomike brenda secilit vend. Pra, i shihet rritja ekonomike dhe pastaj jepet një lloj vlerësimi të asaj se a ka pasur përparim apo ngecje, apo regres ekonomik të vendit. Mirëpo, kjo rritje ekonomike duhet të kuptohet të paktën dhe të analizohet nga një qasje kritike, dekonstruktuese, se jo vetëm rritja ekonomike, po çka po rritet përbrenda asaj ekonomie, është po ashtu e rëndësishme për ekonominë.

Përndryshe, nëse nuk e dimë se çka po rritet përbrenda ekonomisë, mund të lajthitemi, siç po lajthitet Qeveria, siç po lajthiten nganjëherë edhe deputetët e koalicionit qeverisës kur po i dëgjoj, që në bazë të rritjes ekonomike po thonë që punët megjithatë i kemi më mirë, për shkak se po shkojmë duke u rritur, ndërkohë, që ne në terren po e shohim për çdo ditë që punët i kemi edhe më keq, për shkak se varfëria po shkon duke u rritur, papunësia po

shkon duke u rritur. Pra, më shumë po kemi biznese që po dështojnë se sa që po kemi të suksesshme.

Dhe, në këtë drejtim unë nuk konsideroj që ky është përfitim ekonomik apo rritje ekonomike, ky është regres ekonomik, mirëpo, në përqindje ajo edhe mund të paraqitet si rritje ekonomike, për shkak se rritja ekonomike është ose reale ose nominale, varet si e mat. Nominalja është rritje e çmimeve. Po, kemi rritje të çmimeve. Dhe, në këtë drejtim mbase kemi edhe rritje të transaksioneve financiare përbrenda vendit, në mes mallit dhe parasë, për shkak se çmimi është më i madh, po kjo nuk nënkupton që po blejmë më shumë, kjo po nënkupton që po blejmë më shtrenjtë, që nënkupton se po hamë më pak, që nënkupton se po varfërohem më shumë dhe po dëmtohem më shumë. Pra, rritja ekonomike po na përkthehet në dëm ekonomik për amvisëritë edhe për individët. A është kjo rritja që po e do Qeveria? Qartazi po, se po e mbron.

Nga një studim që e ka bërë miku im, Besnik Vula, të cilit i jam referuar edhe në një deklaram më herët, jashtë rendit të ditës, ai ka ardhur në një përfundim, pas një analize të zhvillimeve ekonomike makroekonomike në Kosovë, prej vitit 2008-2011, ka ardhur në përfundim që në fakt konsumi i amvisërisë si trend përgjatë këtyre viteve ka mbetur i njëjtë, pra ka mbetur në nivelin e njëjtë, si trend po flas, për shkak se ka pasur rritje dhe ngritje natyrisht, po si trend ka mbetur i njëjtë. Ndërkohë, që investimet publike dhe investimet në përgjithësi kanë shënuar një rritje graduale.

Pra, këto investime publike, kryesisht publike po flas, se nuk kanë qenë vetëm publike, po kryesisht publike, janë faktori kryesor që e kanë nxitur rritjen ekonomike të vendit, këtë rritjen e kësaj bruto-produktit vendor, pra e kanë nxitur këto investime dhe përgjithësisht, domethënë, konsumi i Qeverisë ai që quhet konsumi publik. Dhe, duke u nisur nga kjo atëherë, nëse konsumi i amvisërisë mbetet në trendin e njëjtë dhe kemi rritje të investimeve edhe të konsumit publik, kjo i bie që në fakt ajo rritje ekonomike nuk po përkthehet në rritje të mirëqenies qytetare, pra nuk po ka rritje të të ardhurave individuale ose si fuqi blerëse, pra që në anglisht quhet 'processing pover parity', nuk po rritet për qytetarët e Kosovës, po rritja ekonomike po rritet përmes investimeve publike.

Tash, nuk kam nevojë të flas fare këtu për qëndrueshmërinë e kësaj rritjeje, për shkak se të gjithë e dimë se kjo është e paqëndrueshme dhe e pamirëmbajtur. Po, nëse e dekonstruktojmë edhe këtë pastaj e shohim që në fakt këto rritje të investimeve publike janë si rrjedhojë prej vitit 2010 të paktën drejtpërsëdrejti e një projekti publik që është projekti i autostradës, që e lidh ose supozohet ta lidhë Prishtinën me Tiranën, apo jo.

Por, çka nënkupton kjo? Kjo nënkupton që rritja ekonomike po përkthehet në rritje për disa, pra për një kompani në këtë rast, ose për disa kompani klienteliste të Qeverisë, por jo domosdoshmërisht në rritje të mirëqenies edhe së fuqisë ekonomike dhe blerëse të qytetarëve.

Madje- madje në të njëjtën studim Besnik Vula po ashtu, vjen në përfundim pas analizës, se ato rritje të konsumit të amvisërive në fakt janë duke u investuar nga rritja e kredisë nëpër bankat komerciale të Kosovës, që i bie- kush po përfiton në këtë rast? Për ta thënë

në një gjuhë shumë të thjeshtë, po përfitojnë bankat komerciale, më së shumti ProCredit, Raifaissen dhe pastaj tjerat dhe po përfiton 'Behtel-Enka'. Pra, këta janë përfituesit e rritjes ekonomike të Kosovës, formalisht. Realisht, natyrisht që është edhe komponenti tjetër, personat që janë ulur prapa, që përfitojnë, përveç pagave edhe privilegje dhe të mira të ndryshme financiare nga po ky model i ekonomisë.

Ndërkohë, që për sa i përket politikave ekonomike, keni dëgjuar që shumë herë, sa herë flet Qeveria e Kosovës për politikën ekonomike i kanë tri gjëra, që i përmendin shumë. Këto janë investimet e huaja direkte. Na flasin përherë se si po marrin masa që të tërheqin investime nga jashtë, të huaja direkte, do ta zhvillojnë vendin e kështu me radhë, ndërkohë që sipas Bankës Qendrore të Kosovës, në vitin 2011, investimet e huaja direkte kanë përbërë vetëm 9% të bruto-produktit vendor. Pra, shpresa e Qeverisë së Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

VISAR YMERI: Këto investime janë kryesisht të përqendruara, një pjesë e konsiderueshme të tyre, pra në sektorin e ndërtimit, edhe pse në trend të rënies nga më herët, pastaj në prodhimtari ku janë 18,8%, patundshmëri 16,9% dhe në sektorin financiar 17,4%. Pra, asnjëra prej këtyre, përveç prodhimtarisë natyrisht, nuk garanton rritje të qëndrueshme ekonomike.

Dhe, nëse ky është projekti i Qeverisë për rritje ekonomike, që bazohet në investime të huaja direkte, të cilët shumica prej tyre po shkojnë në ndërtim dhe në patundshmëri, atëherë faktikisht ne nuk do të kemi rritje ekonomike fare, e cila do të përkthehet pastaj në rritje të mirëqenies së qytetarëve.

Është e rëndësishme që ta kemi një model tjetër të zhvillimit. Ky model tjetër i zhvillimit është ajo që quhet shteti zhvillimor, i cili i merr masat dhe është aktor në skenën ekonomike për t'ia mundur rritjen e prodhimit, rritjen e sektorit privat, mbrojtjen e tregut për të, qasjen në financa për të, në mënyrë që kjo të bëhet e mundur dhe të rritet, të zvogëlohet papunësia dhe njëkohësisht të ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hajde, përfundoje pra.

VISAR YMERI: Dhe, nuk është këtu punë gjynahu, zoti Stavileci, është punë drejte. Diçka që ti nuk ke të drejtë me e marrë ose me e dhënë në këtë Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Visar, unë po të toleroj, atë që ti ke të drejtë. Vazhdo.

VISAR YMERI: Kështu që me këtë Qeveri dhe veçanërisht me këtë paraqitje të kryeministrit, që e pamë sot, i cili me çdo kusht mundohet që madje edhe duke

shndërruar veten në palaço, në një figurë që e shtinë për të qeshur Kuvendin, mundohet t'i ikë temës së ekonomisë, natyrisht që nuk mund të presim zhvillim ekonomik.

Në rastin më të mirë, ky kryeministër na tregoi që është më i aftë t'i shtrojë do pllaka më të mira, do sheshe më të mira në Prishtinë, mbase këtë edhe e bën, po ky nuk është zhvillim ekonomik, prapë po e them. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën, kryetari i Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Kryeministri ia arriti qëllimit, do të thotë që ta shndërrojë këtë debat në diçka tjetër dhe mund të jetë që është shkathtësi, por po ju kallëzoj që nuk është shkathtësi prej një xhentëlmeni, aq më tepër shkathtësi e një xhentëlmeni kryeministër, është shkathtësi tjetër, ndoshta e ka, unë nuk e di çka është, po kështu s'bën. Kjo nuk është mënyrë për të debatuar në Kuvend të një vendi, që po do të thotë që po duam të jemi evropian apo çka po di gjë unë, gjithfarë çmimesh po i japin vetes.

Tani ia kisha nisur të them që Qeveria aktuale kishte bërë mirë të shkojë edhe njëherë në Banjsko. Ka qenë një herë, u kthye prej Banjskos edhe send nuk po shohin ne, keq e me keq, kështu që ndoshta duhet të shkojë edhe njëherë ta rekapitulojë edhe një herë të diskutojë në mes veti çka të bëjnë edhe nëse shkojnë, isha lutur të mos kthen, seriozisht po flas!

Çështje tjetër është...

(Ndërhyrje: Hiç mos m'u kthye këtu Ardian, a?)

Mos m'i merr minutat, po nuk jam duke të kërcënuar hiç, po i lutëm Zotit që nëse shkoni nuk ktheheni, se do të ishte më mirë për Kosovën, po lej këto retorika, "po më kërcënon, a jo, lej.

Po, po ju kallxoj diçka për ato që i tha kryeministri, se na detyroi domethënë, për të replikuar ne. Po thotë, që e ka rritur 150% a 200% a nuk di sa e ka rritur buxhetin, i ka rritur të hyrat, e ka rritë GDP-në, prej europa.eu.int, ku e keni raportin për Kosovën për vite, në vazhdim po ju jap shifrat dhe po i lexoj, kurrëgjë tjetër, s'po bëj.

- Të hyrat vetjake buxhetore në vitin 2007 janë votuar, domethënë, në vitin 2007 për vitin 2008, s'kanë qenë këta në Qeveri, kanë qenë 943 milionë euro.
- Në vitin 2012 të hyrat vetjake të Qeverisë së Kosovës kanë qenë 1 miliard e 128 milionë euro, që bëjnë diku pak më pak se 200 milionë euro në total për 5 vjet.

Nëse kjo është 150%, atëherë unë po i them dikujt: mësoni pak matematikë. Është 15%, por ndoshta kur ia shkruajnë 15.0, po kujtojnë që 15.0 është 150 Ky është dallimi, është 15%.

Po ju lexoj prapë, prej ec.europa.eu rritjen e GDP-së, për të cilën na tha kryeministri këtu, që është rritur 70% a 80%, po ju lexoj vit për vit, shumë pak kohë marr:

- Më 2007, 6,3%
- Më 2008, 6,9%,
- Më 2009, 2,9%,
- Më 2010, 3,9%,
- Më 2011, 5, dhe
- Më 2012, 3,8%,

ndërsa për kokë banori:

- Më 2008, 5,6,
- Më 2009, 1,4,
- Më 2010, 2,4,
- Më 2011, 3,4, dhe
- Më 2012, 2,2.

Këto janë domethënë rritjet ekonomike ose të GDP-së, që u përmend këtu më përpara, të bruto-produktit vendor, për të cilat po flitet që janë 70% e 80%, kanë rënë, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, ka rënie, nuk ka rritje.

Tani, te investimet direkte, e përmendi zoti Visar Ymeri pak më përpara, nuk po ju lodhi, e keni 12.6 të GDP-së totale, investime të huaja në vitin 2007, ndërsa e keni 8.9% në vitin 2012, domethënë te investimet direkte. Edhe krejt këto që po i flas i gjeni në ec.europa.eukosova zhvillimi ekonomik, krejt i gjeni, krejt në tabela i keni, bile s'keni nevojë 80 e sa faqe për t' i lexuar.

Tani, për të folur për zhvillim ekonomik, duhet parë pak edhe qysh duket Qeveria. Shembull ta marrim, gjithmonë kur kemi diskutuar për zhvillim ekonomik, ministri i Financave ka qenë këtu. Qeveria e Kosovës, që dy muaj nuk ka ministër të Financave. Tash, ose është mungesë e lidërshiptit, ose nuk është hiç me rëndësi të ketë ministër të Financave, që një Qeveri serioze të funksionojë 2 muaj pa ministër të Financave është më zi se banale. Nuk e dimë çka bëjnë këta. Edhe hajde, se një javë nuk po mund ta bëjë , hajde se dy javë, po dy muaj pa ministër të Financave, po ju them që është problem.

Tani, po kthehem edhe paka te disa shifra, për të ju treguar që është tepër interesant kjo punë. Buxheti total në vitin 2008, i votuar më 2007-ën ka qenë 1 miliardë e 54 milionë euro, pa shitur kurrigjë, domethënë, pa e shitur asnjë aset, pa privatizuar kurrigjë edhe pa donacione, domethënë i pastër buxhet i vendit. Ndërsa, rezervat buxhetore, prapë e keni në eu.europa.ec, kanë qenë 454 milionë euro në bankë, pare të thata të Kosovës, pa i prekur kurrkush. Në vitin 2012, minus, për shkak se edhe kanë shitë letra me vlerë, domethënë tash jemi borxh, jemi borxh, edhe me shitje e me donacione e me krejt janë 1 miliard e 250 milionë euro. Kjo është rritja, domethënë, po e marrim si shembull buxhetin, se është njëfarë indikator, edhe pse nuk është indikator kryesor buxheti të tregojë rritjen, po prapëseprapë një indikator serioz është.

Çështje e rritjes ekonomike është edhe vlera e parasë së investuar, që këtu u përmend më duket nga deputetja Bajrami, vlera e parasë së investuar. Nëse një rrugë shtrohet edhe në krye të vitit duhet të shtrohet prej së pari, se është prishur, llogaritni vlerën e parasë së investuar sa është. Dhe, kështu ka ndodhur në Kosovë që pesë vjet, përsëri, përsëri, përsëri, domethënë, përsëritshëm gati në të gjitha projektet. Shkollave iu janë prishur kulmet ende pa hyrë mirë nxënësit, një rrugë shembull ta marrim, Komoran që del për në rrugë të Prizren- Suharekë, është shtruar diku nga tri herë për dy vjet, shtrohej - prishej, shtrohej - prishej, kështu projektet ka me qindra në Kosovë.

Arkat fiskale, Qeveria ka dalë me pompozitet duke thënë se do ta fiskalizojmë biznesin, janë futur arkat fiskale në gjysmën e bizneseve, janë dënuar ato biznese që kanë marrë arka fiskale, ndërsa janë favorizuar bizneset që nuk i kanë vendosur kurrë ato arka, se procesi është ndalur. Se, kompanitë që i kanë shitur arkat i kanë marrë paratë e veta, ata janë kënaqur dhe më kurrkush nuk lodhet për arka fiskale, hiç. Dhe, ky është domethënë sistemi i zhvillimit ekonomik.

Distribucioni, po dua të flas për diçka të fundit, ka lidhje shumë me zhvillimin ekonomik. Që të mos më thotë dikush, që ne jemi të majtë ose diçka, të na kallxoj më tepër, këtu po ju them që Aleanca është për privatizim. Po, po ju kallxoj diçka, vetëm monopolin për distribuim po ta kishim shitur, pa tela, pa transformatorë, pa kurrgjë, ta thirrshim një kompani të huaj dhe t'i themi : hajde këtu, krejt ke ta ndërtosh vetë, kurrgjë s'ke, po ju garantoj që nuk do të ishte shitur ndër 50 milionë vetëm monopoli, pa asnjë aset, po ju them edhe njëherë, pa asnjë tel, pa asnjë transformator, pa asnjë objekt. Ne e kemi shitur 26 milionë krejt. Dhe, prapë ky është një model i zhvillimit ekonomik.

Po dua ta përfundoj, të mos shkoj më tutje, veç po ju them edhe njëherë, çka dëgjuam këtu edhe ne duhet të kujtohem se ku jemi duke jetuar. A jeton qytetari i Kosovës më mirë, a mendon dikush prej jush, që sot qytetari i Kosovës jeton më mirë, qytetari i zakonshëm, jo ju, jo ne, a jeton më mirë se në vitin 2007? Mendoni ju, vazhdoni të mendoni. Po dilni pyetni nga pak. Duke i dëgjuar krejt ato që thashë unë thashë, me siguri jemi afër 1 prillit, dhe po më duket që 1 prilli është festa e Qeverisë dhe ia kisha uruar festën: Urime 1 prillin, Qeveri e Kosovës! Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përsëritet për Qeverinë dhe deputetët!

Koalicioni për Kosovë të Re përkrah debatin të iniciuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës për zhvillimin ekonomik në vend, duke marrë parasysh se zhvillimi i qëndrueshëm është sfidë e madhe për Qeverinë e Kosovës dhe njëkohësisht zbatimi i ligjit është sfidë e madhe për këtë Qeveri, pavarësisht kush është në Qeveri.

Nëse e shohim gjendjen ekonomike të qytetarëve të Kosovës, mund të themi se edhe ne si subjekt politik nuk mund të jemi shumë të kënaqur, ka përparime, mirëpo jo në atë efekt, çfarë duhet të atakohen qytetarët e Kosovës.

Është çështje shumë e komplikuar, që Qeveria pas këtij procesi të ndërlikuar politik të bisedimeve me Serbinë, që drejtohet definitivisht nga çështja e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Kosova në Kushtetutë është e definuar mjaftë mirë, si shtet me ekonomi të lirë të tregut dhe konkurrencë. Në rast se nisemi nga ligjet, të cilat i kemi të miratuara në Kuvend të Kosovës, atëherë mund të shohim pikësëpari nga Buxheti i Kosovës, ku e gjithë rritja ekonomike në Kosovë vjen nga investimet kapitale, të cilat ndodhin me buxhet të Kosovës.

Nga mbushet Buxheti i Kosovës, shtrohet pyetja, atë e dini të gjithë se ne jemi ata që i japim dritën e gjelbër Buxhetit të Kosovës në këtë Kuvend, nga të hyrat nga dogana dhe të hyrat nga Administrata Tatimore.

Dhe çka, kalojmë te Banka Qendrore e Kosovës, si autoritet kryesor në këtë çështje të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Në rast se shohim politikat bankare, të cilat janë në Kosovë, duhet të kërkojmë nga kryeministri dhe ministrat e Kabinetit Qeveritar, që janë sot këtu, në favor të qytetarëve të Kosovës që të ndërrojnë këto politika, për arsye se ne nuk mund të ndërtojmë fabrika të mëdha. Mirëpo, mund të investojmë në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ku kishte me qenë numri më i volitshëm i të punësuarve të njerëzve në këto ndërmarrje.

Zhvillimi ekonomik i Kosovës arrihet atëherë, kur Qeveria e Kosovës duhet të forcojë sektorin prodhues, sektorin privat prodhues në këtë rast, të stimulojë bujqësinë, se kemi ministrin këtu i cili është munduar të bëjë një punë të vet, mirëpo prapëseprapë, Kosova nuk është në gjendje të mirë ekonomike që të bëjë edhe njëkohësisht edhe kualitetin e edukimit në Kosovë, që të kemi punëtorë për treg të punës.

Në rast se shohim çështjet e investimeve të mëdha, ne kemi çështjen e investimeve në Aeroportin e Prishtinës, e cila është bërë në qeverisjen e kaluar, mirëpo ne efekt tash presim, të shohim rezultatet e tyre. Sa do të jetë rezultati i mirë i koncesionimit të Aeroportit, atëherë do të mbetet të shihet.

Kemi çështjen e ndërtimit të Autostradës, e cila ka filluar në Qeverinë e kaluar, mirëpo çështja e përfitimit nga autostrada do të jetë më e ngadalshme, për arsye se dihet mjaftë mirë që investimet nuk mund të kthehen në moment.

Çështja e privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit, në rast se investitori i cili ka privatizuar Distribucionin dhe Furnizimin jep rezultatet e tij, atëherë mund të themi se kemi arritur rezultat në këtë çështje.

Ndërsa, çështja e investimeve në Postë-Telekomin e Kosovës, më vjen shumë keq ta them, se në këtë aspekt jemi tepër të vonuar, për arsye se është dashur shumë më herët që të jepet mundësia e konkurrencës së lirë në këtë kompani publike.

Në rast se hyjmë në sektorin e energjisë, mund të themi se kemi ngelur mbrapa dhe nuk mund të jemi të kënaqur as ne si deputetë, as Qeveria, për arsye se akoma s'kemi fillimin e ndërtimit të Termocentralit Kosova e Re. Çështja e linjës 400-kilovoltëshe me Shqipërinë, besoj që është edhe shteti shqiptar duhet të kushtojë vëmendje në rast se mendon që të ketë politika të zhvillimit ekonomik në BE dhe të ketë marrëdhënie të mira me Kosovën, të japë mundësinë e ndërtimit të kësaj lindjeje.

Në total rritja ekonomike në Kosovë nga shumë parafolës u tha se do të jetë 3,2% - 3,8%, mirëpo esenca është që ne sot këtu, në këtë debat parlamentar të mos tregojmë forcën se cili di më shumë të akuzojë njëri tjetrin, po të tregojmë idetë me të cilat mund të dalë Kosova nga kjo krizë, çfarë është për momentin. Nuk është në krizë veç Kosova, janë në krizë të gjitha vendet e rajonit, mirëpo ne kemi ngelur më mbrapa dhe kërkoj në mënyrë shumë decisive, që Qeveria të dalë me politika konkrete, duke u nisur nga Ligji i prokurimit publik, të shkojë në çështjen e ambientit biznesor të jetë më i favorshëm për investitorë dhe njëkohësisht politikat doganore apo taksat të jenë më të volitshme për investitorët vendorë dhe investitorët e huaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS-ja nuk është paraqitur, "6+" nuk është paraqitur. Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka zoti Buzhala.

BERAT BUZHALA: Faleminderit, zoti Haliti!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kisha dashur ta nis, nuk qenka zonja Bajrami këtu, e cila ka folur, e ka bërë prezantimin më së pari. Do të doja të lidhem me fjalën e saj, për shkak se po thonë me qenë brenda temës.

Lidhja e Demokratike e Kosovës si subjekt ideologjik i djathtë, ne këtu na u prezantua si subjekt ideologjik i majtë. Në prezantimin e saj ajo bëri vërejtje për lirimin nga taksat të korporatave të mëdha. Kjo është një gjë tipike për partitë të cilat janë, që i takojnë spektrit ideologjik të majtë. Mandej u përmendën X-6-shat, X-5-shat, po mendoj tema kryesisht banale që nuk kanë kurrfarë lidhjeje me zhvillimin ekonomik të vendit.

Unë kisha dashur të them që më dobët se sa do ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e shoh vetëm ofertën që vjen nga opozita. Kjo është fatkeqësi e madhe, për shkak se dorën në zemër, së paku Lëvizja „Vetëvendosje“ e ka një model, po mendoj, ai model i tyre çfarë është, Visari i përmendi prej modelit të kapitalizmit të egër deri te modeli i centralizimit të egër të ekonomisë edhe tha që ekziston një vister i tërë, po nuk na shpjegoi saktë se për çka qëndron kjo lëvizje, po mendoj se është e vërtetë që ka një fushë të gjerë të mundësive brenda këtyre dy koncepteve.

Mirëpo, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, si sponsoruese e kësaj seance këtu, nuk kemi marrë bash kurrgjë hiç, kurrfarë oferte se për çka kjo Lidhje Demokratike, cila është oferta e saj për zhvillimin ekonomik të vendit.

Tash kisha dashur t'i shpreh disa pikëpamje të mia. Zhvillimi ekonomik i vendit sipas mendimit tim nuk është qëllim në vetvete, zhvillimi ekonomik i vendit është pasojë e masave të caktuara që do të duhej për t'u ndërmarrë. Për shembull, unë mendoj që rol krucial në zhvillimin ekonomik të vendit ka funksionaliteti i gjykatave. Nëse gjykatat nuk janë funksionale unë mendoj që është problem të funksionojë ekonomia e vendit.

Nëse edukimi nuk është në nivel, unë mendoj që në perspektivë zhvillimi ekonomik i vendit është jashtëzakonisht në krizë të madhe, sepse zhvillimin ekonomik të vendit nuk mund ta bëjnë vetëm investimet e huaja. Pra, ato investime të huaja që vijnë këtu duhet të jenë disa njerëz të cilët kanë për t' i menaxhuar dhe do të jetë një klasë punëtore apo një klasë e burokratëve, ose çka di unë, një klasë e ekspertëve, të cilët kanë për t' i pritur ato investime dhe do t' i vënë në funksion.

Në anën tjetër, kemi vërejtje për Distribucionin, kemi vërejtje për Valën 900. Unë mendoj që Qeveria e Kosovës, kur është fjala te privatizimi i Telekomit, jo që nuk duhet të privatizojë, po ka bërë gabim që s' e ka privatizuar më moti. Nëse Vala 900 ishte privatizuar para 10 vjetëve, vlera e saj ka qenë diku 1 miliardë euro, për shkak të mungesës së konkurrencës dhe për shkak të numrit të madh të konsumatorëve. Sot vlera e Valës 900 dikush e përmend 300 milionë, dikush e përmend 200 milionë, dikush e përmend 400 milionë, mirëpo është përgjysmuar së paku. Nëse vazhdon kështu, për shkak të konkurrencës vazhdimisht edhe për shkak që me ligj ne e kemi të obligueshme ta bëjmë liberalizimin e tregut, vlera e Valës 900 do të jetë edhe më pak.

Pra, cila është logjika për ta mbajtur Valën 900 apo secilin kompani publike nëse atyre e ke të obliguar me ligj për t' ia bërë konkurrencën. Pra, këto janë disa prej modeleve, apo disa prej mundësive për zhvillimin ekonomik të vendit.

U përmend edhe korrupsioni, u përmendën edhe sektori privat, mbipopullimi i Qeverisë, ekonomia informale e lartë. Nuk kisha dashur t' i përmend ato që i përmendi kryeministri, po me të vërtetë nganjëherë nuk është çështje çka thuhet, por kush e thotë. Pra, nëse ne mund të flasim fjalë të mëdha dhe të mira, mirëpo kryeqyteti edhe lideri ose udhëheqësi që udhëheq me kryeqytetin, për mendimin tim është personi i dytë më i rëndësishëm në shtet. Pra, kemi të bëjmë me njeriun, i cili e ka në dorë pjesën më të madhe të ekonomisë së vendit, pa zhvillim ekonomik është edhe ambienti që krijohet nga kryetari i opozitës, që ka rastis të jetë edhe kryetar i komunës më të madhe.

Në bazë të të dhënave që unë i kam, Kosova në “doing business” është renditur shumë poshtë, për shkak të komunës së Prishtinës, e cila nuk i ka punët mirë me, nevojiten 30 ditë për ta hapur një biznes në komunën e Prishtinës.

Pra, këto janë disa prej problemeve edhe ajo që po e them që, këtu mund të tingëllojnë fjalë të mira, por kush po i thotë ato fjalë. Pra, cili është modeli, a është ky model i qeverisjes së Prishtinës, që ka për ta e bartur LDK-ja dhe ka për ta bërë model të qeverisjes së shtetit? Unë po pajtohem që këtu ka ministra të dobët dhe ka keq-qeverisje dhe ka sende, mirëpo kush don ta zëvendësojë këtë qeverisje, kjo është, ka edhe deputetë të këqij normalisht, ka edhe deputetë injorantë, ka edhe deputetë të pamençur, mirëpo si

shkohet më tutje? Kisha dashur zoti Hamiti e përmendi, nuk po dua për replikë këtë, por po dua ta them që prishtinas nuk bëhesh, po prishtinas lind, pak a shumë konteksti ishte ky, që unë po dua të them që ata që po e donë Prishtinën, po ma çojnë mallin e nënës që duke u frikësuar që po i vdes fëmija prej së ftohti e ngulfatë dhe ia ndal frymën. Pra, unë nuk po e mohoj që ju e doni Prishtinën shumë, po prej dashurisë së madhe e keni ngulfatur dhe ia keni zënë frymën dhe një ditë ajo foshnjë ka për të vdekur për shkak të asfiksimit. Pra, kjo është një fatkeqësi e madhe dhe kjo është fatkeqësia më e madhe për qytetarët e kryeqytetit. Nëse Arnold Schwarzeneger, një bodybilder i lindur në Austri, ka arritur të bëhet guvernator i fuqisë së shtatë ekonomike në botë, këtu ne, një vend i vogël prej 1,7 milion banorëve, shtyhem i kush qenka i Prishtinës, kush qenka i Bradashit, kush qenka i Çabiqit dhe të gjithë ne, e sidomos edhe ju më të vjetrit, edhe WC-të i keni pasur në oborr, e tash këtu shiteni urbanë ose tregoni kush prej nga është. Kjo është fatkeqësi e madhe. Është mjerim i madh, më vjen keq...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Hamiti, replikë.

SABRI HAMITI: Edhe pozita, edhe po më thërrasin, edhe më detyruar të them, jam i detyruar se jemi publikisht ta them.

Unë e kuptoj vullnetin e kryeministrit që ngucet keq, është ngucakeq, po nuk kanë nevojë të tjerët ta duplikojnë. Unë e di atë punë, unë e njoh kryeministrin që dhjetë vjet më së paku këtu në Parlament dhe nuk është problem ajo, po mos bëni literaturën më të keqe të mundshme në emër të tij, që është literatura e laritjes. Në krejt dynjanë kjo s'vlen gjë.

Prishtinën e përmenda si shembull. Kjo vlen edhe për Pejën, pejan dhe pejanizim. Ky kolegu i ri, unë besoj që e din çka është kjo punë. Nuk është puna veç Prishtina, po gjithmonë ekziston një kulturë vendore, së cilës ardhësi i adaptohet, deshi nuk deshi. Kjo është ideja ime. Nuk ka të bëjë që kjo është më e mira se krejt dynjaja. Ka qëlluar që është kryeqytet dhe është qendra dhe e dijes pak a shumë. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër replikë, zoti Buzhala.

BERAT BUZHALA: Shiko, nëse unë i laritem kryeministrit, ndoshta ka edhe një kuptim, por një akademik t'i laritët kryetarit të partisë së vet, kjo nuk ka kuptim, po mendoj kjo është pak më keq se sa unë.

Prishtina është e vërtetë që është qendër e kulturës, po Prishtina edhe krejt Kosova është një vend ku ne me veturë 40 minuta kemi me vrapu. Pra, prurjet në Prishtinë, që është qendër e kulturës, tregomëni mua prej kah kanë ardhur. Po mendoj, janë ardhur prej rretheve, dikush prej Bradashit, dikush prej, çka po di unë, prej Ulqinit, prej Malit të Zi, dikush prej andej, dikush prej andej dikush prej këndeje, këtu pa trohë racizmi unë po dua ta tregoj një shembull. Në mëhallën time ku jam rritur, ka pasur romë dhe ashkanlinjë dhe zakonisht janë shtyrë cilët janë më poshtë se njëri-tjetri, a janë romët a janë ashkanlinjtë. Po mendoj ka qenë një gjendje e mjerë e kjo ma çon mallin pak a shumë, ne kur shtyhem

kush prej kahit është edhe çfarë referencash kulturore ka dhe ka sjellë në Kuvendin e Kosovës.

KRYESUESI: Unë veç ua kisha përkujtuar që ne jemi para kamerave dhe ju kisha lutur që të mos e ofendonin njëri-tjetrin. Zoti Ymeri e ka fjalën. Replikë me zotin Buzhala.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse u pyetëm e është shumë mirë, që u pyetëm, cili është zhvillimi ose modeli që e propozojmë në Lëvizja “Vetëvendosje”? E thashë unë, është modeli i shtetit zhvillimor. Tash ky modeli i shtetit zhvillimor edhe në teori edhe në praktikë është përdorë në vende të ndryshme dhe ka marrë përmasa të ndryshme.

Cili do të kishte me qenë ky model për Kosovën? Ky model për Kosovën do të kishte me qenë një shtet, i cili është aktivisht i angazhuar në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të cilin e bën përmes:

- Së pari, gjëja më e rëndësishme, një plani afatgjatë strategjik të asaj, se ku po do të arrijë Kosova. Pra, përbrenda këtij plani i cili do të ishte indikues për investitorët e ndryshëm, do të përcaktoheshin ato fusha, në të cilat Kosova ka dhe mund të ketë përparësi krahasuese me vendet tjera, apo jo. Për shkak se këto politika të sheshta, që i përdorë Qeveria e Kosovës, këto politika nëse ndiqen teorikisht dhe konceptualisht deri në fund, këto janë politika që synojnë autarkinë, apo jo. Pra, politika të sheshta në të gjithë sektorët, që nënkupton se duam t'i zhvillojmë të gjithë sektorët, që nënkupton që duam të bëhemi vend i vetëmjaftueshëm ekonomikisht, që nuk ka bash, ama bash kurrfarë kuptimi hiç.

Pra, politikat selektive në sektorët dhe industritë e ndryshme, në të cilat Kosova do të mund të kishte përparësi krahasuese me vendet tjera dhe të cilat do të duhej të zhvilloheshin.

Tash, sa herë që flitet nga Qeveria e Kosovës, thuhet që prioritetet janë ose sektorët më të rëndësishëm janë: energjetika, minierat, mineralet, bujqësia e kështu me radhë, domethënë, është bërë si një lloj vjershe këtu, që përdoret nga të gjithë. Cilët janë ato sektorë me përparësi krahasuese? Po, nëse merren pastaj dhe analizohen politikat e Qeverisë karshi këtyre sektorëve, e shih që në fakt këto janë prioritetet vetëm në fjalë, jo në vepër. Pra, nuk reflektohen në buxhet.

Çka do të bënte shteti zhvillimor i Kosovës? Shteti zhvillimor i Kosovës do ta rriste prodhimin domosdoshmërisht. Këtë prodhim do ta nxiste përmes ndihmesës në financim, pra qasjes në financa për edhe sektorin publik edhe privat, qasje kjo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zonja Sahatqija, a është këtu? Jo. Zoti Morina e ka fjalën.

SALI MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të mundohem që të jem në agjendën, e cila është paraparë dhe në pikën e rendit të ditës, për të cilën është thirrur dhe ka kërkuar Lidhja Demokratike e Kosovës.

Shkalla e pakënaqësisë lidhur me zhvillimin ekonomik në Kosovë, po ballafaqohet me shumë sfida dhe probleme. Si ngecje në zhvillimin ekonomik janë mungesa në prodhimtarinë vendore, apo mungesa e prodhimit vendor, mungesa e energjisë elektrike dhe ujit, mungesa e masave dhe instrumenteve për tërheqjen e investimeve të huaja, paqëndrueshmëria në konkurrencën ndërmjet të sektorit publik dhe atij privat, qëndrueshmëria e ultë e buxhetit, varfëria e lartë, korrupsioni i lartë dhe krimi i organizuar, qeverisja e dobët e kompanive publike, cilësia e ulët dhe jokonkurrese e arsimit.

Pra, të gjithë këta faktorë janë që po ndikojnë në moszhvillimin e vendit në Kosovë. Varfëria dhe papunësia i atakon në një masë të madhe, veçanërisht të rinjtë, kështu shkalla tek mosha 15 – 24 vjeç, e cila është e rregulluar me Ligjin mbi fuqizimin e rinisë është dukshëm më e lartë, se sa shkalla e përgjithshme e papunësisë së shoqërisë kosovare.

Çdo vit në Kosovë, 30 mijë të rinj i qasen tregut të punës, vetëm ¼-ta e tyre ka perspektivë për të gjetur një vend pune. Papunësia është mbi 40%, që u tha edhe nga parafolësit tjerë dhe është veçanërisht e dukshme në mesin e të rinjve më shumë se 70% e të cilëve janë pa punë.

Politikat ekonomike kanë qenë të paqëndrueshme gjatë tre vjetëve të fundit. Bizneset joformale janë ende të përhapura dhe mbesin sfidë e rëndësishme për të zhvilluar ekonominë e vendit. Kosova ka shkallën më të lartë të shmangies së tatimit në rajon dhe kjo vjen si pasojë e inspektimit të pamjaftueshëm, si pasojë e politikave fiskale jofavorizuese.

Ekonomia joformale nxitet nga dobësia e politikave të shpenzimit, mungesës së zbatimit të ligjit si dhe nepotizmit. Prezenca e shmangies së tatimit është në nivel të lartë dhe kryesisht ndodh te kompanitë e mëdha, të cilat dëmtojnë në masë të madhe buxhetin e Kosovës. Kemi deficit tregtar i cili po thellohet, importet po rriten, Investimet e jashtme po bien, si pasojë e një ekonomie jostabile dhe të paqëndrueshme.

Premtimet e Qeverisë, së planit të zhvillimit ekonomik për periudhën 2011 – 2014, e cila parashihte rritje ekonomike deri në 8%, e cila parashihet uljen e papunësisë, e cila parashihte kalimin nga ekonomia joformale në atë formale dhe ruajtjen e stabilitetit makrofiskal, kanë dështuar deri më tani dhe asnjëra nga prioritetet e paraqitura nga Qeveria në këtë plan nuk janë zbatuar.

Premtimet për rritjen ekonomike 7-8 për qind nuk ka rezultuar si e saktë, për shkak se vitin që e lamë pas kemi pas një rritje diku deri në 2.7%, kurse në këtë vit Qeveria në bazë të Marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar nuk parasheh rritje më të madhe se 3,2%, apo 3,5%.

Andaj ne konsiderojmë, që duhet të përkrahet sektori privat dhe Lidhja Demokratike e ka edhe në programin e saj, të përkrahen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pra të zhvillohet ndërmarrësia, të forcohet sektori prodhues, të stimulohet bujqësia dhe përpunimi i produkteve bujqësore dhe vetëm kështu mund të gjenerojmë vende të reja të punës dhe njëkohësisht mund të kemi një zhvillim më të mirë ekonomik në Kosovë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lila – Kusari e ka fjalën, ministresh.

MINISTRJA MIMOZA LILA-KUSARI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

U tha dhe u fol shumë, natyrisht disa statistika u prezantuan nga këndvështrime të ndryshme, megjithatë më lejoni t’u them se progres ka pasur, ai progres është i shënuar dhe ai progres është i njohur.

Pyetja është, a është ky progres çfarë e kemi dashur? Natyrisht se ka hapësirë dhe mundësi për shumë më tepër, megjithatë në luftë shkohet me ushtrinë që e ke, prandaj edhe me kapacitete të cilat ekzistojnë sot në sektorin privat, në sektorin publik, në administratën civile, Qeveria ka shënuar progres në reforma. Më lejoni t’ju përmend vetëm disa dhe po flas këtu në referenca të institucioneve ndërkombëtare.

Pas disa viteve rënie të vazhdueshme me indeksin e të bërit biznes, Kosova për herë të parë shënoi rritje, siç e përmendi edhe kryeministri, 28 vende në ranglistë, ngritja kjo më e madhja në rajon për këtë vit.

Në fakt Kosova ka shënuar ndër përmirësimet më të mëdha në botë, nëse i marrim parasysh në total të gjithë indikatorët, 170 vende përmirësim në gjithë indikatorët.

Cilët janë këta indikatorë?

Kosova ka përmirësuar treguesin e fillimit të biznesit për 44 vende, treguesit për leje të ndërtimit 33 vende, mbrojtjen e investitorëve, ka lëvizur pozitivisht 76 vende, qasjen në rrymë elektrike është përmirësuar për 6 vende, pagesa e taksave 4, tregtia ndërkufitare është përmirësuar për 9 vende dhe zbatimi i kontratave për 1 vend.

Ky përmirësim në ranglistën e të bërit biznes vërteton që politikat zhvillimore të Qeverisë së Kosovës janë duke dhënë rezultate pozitive dhe konkrete, duke ua dëshmuar të kundërtën kritikëve, ky progres tregon se ndryshimet kërkojnë punë dhe përkushtim, por mbi të gjitha janë të mundura dhe duhet të jenë konsistente.

Dëgjova këtu argumente ose pyetje se çka ka rezultuar përmirësimi i Kosovës në raportin e Bankës Botërore? Është viti i parë që kemi shënuar përmirësim. Ne duhet të tregojmë konsistencë dhe në vijim do t’ju tregoj se cilat janë edhe hapat të cilët jemi duke i bërë që vit pas viti të përmirësohemi.

Megjithatë, ende mbetet shqetësues fakti se në disa struktura në nivel komunal nuk kuptohet rëndësia e thjeshtësimit të procedurave, komunikojmë vazhdimisht me krerët e komunave në mënyrë që t'iu tregojmë se thjeshtësimi dhe lehtësimi i procedurave afatgjatë sjell më tepër të hyra se sa vënia e lejeve shtesë e cila në afat të shkurt mbush buxhetin e komunës.

Në kuadër të kësaj Ministria që e drejtoj gjatë këtyre dy viteve kanë qenë në proces dhe kanë finalizuar 26 qendra komunale për regjistrimin e bizneseve, kapacitete të cilat tani po ngritën në kuadër të promovimit të investimeve në nivelin lokal.

Për herë të parë kjo Qeveri e Kosovës ka themeluar Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me sektorin privat.

Pyetet, a diskutuat lidhur me vizionin e Qeverisë? Është mu ky këshill në të cilin janë 3 përfaqësuesit të organizatave të biznesit kryesore, të cilët kanë miratuar planin aksional të vizionit, të zhvillimit ekonomik 2011-2014.

Në kuadër të këtij këshilli janë 11 ministri përfaqësues, Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, presidenca, asociacioni i komunave, si dhe 3 asociacione të cilat i përmenda.

Çka ka bërë Këshilli? Deri më tani ky këshill ka iniciuar reformën e sistemit të licencave dhe lejeve nga një ligj ombrellë në të cilin deri në gjysmë të këtij viti 50% të licencave aktuale do të shkurtohen me një ligj ombrellë. Ky këshill gjithashtu ka aprovuar idenë e Ministrisë së Tregtisë për blerjen e produkteve kosovare në kontrata publike, gjithashtu duke filluar amendamentimin e ligjit të prokurimit publik që shpresojmë do të jetë në Kuvend deri në qershor të këtij viti.

Këshilli gjithashtu ka iniciuar edhe ndryshimin e Ligjit të festave zyrtare dhe tanimë ky ligj është në Qeveri për aprovim, si dhe ka iniciuar ndryshimin e Ligjit të punës i cili tashmë është futur në procedurë të amendamentimit.

Fuqizimi i sektorit privat. Në pengesat e shumta të cilat përmenden për zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit privat, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar t'i eliminojë këto dhe të mbështesë ndërmarrësin dhe inovacionin në mënyrë që vendi të ketë sa më shumë biznese të suksesshme.

Çka kemi bërë sa i përket qasjes së financave? Shumë studime ekonomike ashtu siç e përmendët edhe ju deputetë të nderuar, potencojnë faktin se qasja në financa paraqitet si një ndër tri pengesat kryesore për zhvillimin e mëtutjeshëm të bizneseve.

Qeveria e Kosovës së bashku me Bashkimin Evropian, përmes fondeve të IPA-s kanë siguruar 4 milionë euro për të ofruar grante për bizneset mikro dhe ato të vogla e të mesme. Grantet për mikro do të jenë prej 5 deri 25 mijë euro, kurse ato për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme deri në 200.000 euro, këto grante do të fillojnë të shpërndahen prej shtatorit të këtij viti, të vitit 2013.

Megjithatë, me qëllim të adresimit të mëturjes së ndërmarrjeve të cilat kanë kapacitet absorbimi të fondeve më të mëdha, duke marrë parasysh normën e lartë të interesit në bankat komerciale, bashkë me Agjencionin Zhvillimor Austriak dhe atë të Zvicrës, jemi në fazën fillestare të zbatimit të skemës së garantimit të kredive, skemë kjo e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e normës së interesit për shkak se një pjesë të riskut nga këto kredi do ta marrë fondi i krijuar nga Qeveria e Kosovës.

Gjithashtu krahas kësaj është edhe skema e ‘vauçerëve’ për këshillime që do t’u ofrojë këshillime profesionale kompanive vendore në Kosovë.

Një çështje tjetër e cila në vazhdimësi i përcjell problemet ekonomike, u përmend inovacioni dhe dëshira e ndërmarrësisë, edhe në kuadër të kësaj kemi plan i cili po ecë në një dinamikë që do të japë rezultate shumë shpejt.

Hapja e inkubatorëve të bizneseve në Kosovë, siç e dini dhe siç është bërë publike, tashmë kemi filluar Qendrën Inovative në Gjakovë duke ndihmuar drejtpërdrejt edhe në ngritjen e kapaciteteve të ndërmarrësve dhe synojnë të bëjnë lidhjen e qendrave të inovacionit në Kosovë, bashkë me tri tjera aktuale të cilat ekzistojnë, janë në nivelin komunal, pasi janë dorëzuar nga MTI në administratat e mëhershme, por nuk janë funksionalizuar të shërbejnë për çfarë e kanë pasur destinimin.

Zhvillimi i zonave të lira ekonomike. Ky Kuvend ka kaluar ligjin mbi zonat ekonomike i cili parasheh edhe formimin e zonave të lira ekonomike. Nga shumë edhe debate edhe diskutime me përfaqësues vendorë dhe ndërkombëtarë parashihen si elemente esenciale dhe shumë të rëndësishme për lehtësira në biznes, si për biznese vendore, ashtu edhe për ato ndërkombëtare. Gjithashtu për implementimin e këtij ligji dhe krijimin sa më të shpejtë të zonave të lira ekonomike, kemi filluar përgatitjen e gjithë legjislacionit sekondar. Tashmë kemi filluar përgatitjen e planit kombëtar për zonat ekonomike në të cilin do të përfshihen të gjitha zonat që janë aktualisht dhe kanë probleme të ndryshme në nivele lokale, krijimin e Këshillit kombëtar për zona ekonomike kur këto do të menaxhohen dhe përgatitjen e akteve nënligjore në të cilat përcaktohen kushtet dhe lehtësitat e bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë në kuadër të zonave ekonomike.

Deficiti tregtar me të cilin ballafaqohet Kosova, ka probleme të ndryshme në kuadër të kapaciteteve prodhuese. Megjithatë, tregtia ka qenë një ndër kushtet kryesore, gjithashtu për përmbushjen e kritereve afatshkurtra nga Komisioni Evropian.

Në kuadër të kësaj kemi themeluar Grupin negociator për negocimin e çështjeve tregtare në kuadër të strukturës së re negociuese për procesin e stabilizim-asociimit, që është një objektiv afatshkurtër i konfirmuar pozitivisht edhe nga Bashkimi Evropian.

Departamenti i Tregtisë, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë, ka forcuar kapacitetet për të qenë i gatshëm të përballët me sfidat me të cilat do t’i sjellë negociimi i Marrëveshjes së tregtisë së lirë dhe është kryer analiza e ndikimit financiar në buxhet në Kosovë, pas nënshkrimit të marrëveshjes së tregtisë së lirë.

Megjithatë, përveç përgatitjeve për negocimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Bashkimin Evropian, ne vetëm kemi filluar edhe negocimin e Marrëveshjes së tregtisë së lirë me Turqinë, marrëveshje kjo e cila do të jetë disproporcionale në kuptimin se nuk do të liberalizohet tregtia nga Turqia për në Kosovë në tërësi, por do të ekzistojnë masa mbrojtëse për të stimuluar biznese prodhuese në Kosovë, por lehtësira do të kenë në kuadër të importit të lëndës së parë dhe makinerisë.

Gjithashtu kemi qenë pranë kompanive kur ka pasur raste të dëmtimit të tregut kosovar nga kompanitë e huaja, duke filluar nga sektori i shpezëtarisë, nga sektori i materialit ndërtimor dhe janë vendosur ose janë rritur bazat doganore të cilat kanë mbrojtur prodhuesin vendor.

Promovimi i investimeve. Në kuadër të promovimit të investimeve vitin e kaluar janë organizuar 13 konferenca me përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, në të cilat kanë qenë mesatarisht në secilën prej tyre nga 25 biznese kosovare ku edhe kanë arritur në kontakt të drejtpërdrejtë me bizneset e vendeve ku janë prezantuar mundësitë investive në Kosovë.

Janë bërë nënshkrime të marrëveshjeve për mbrojtje dhe promovim të investimeve, inicim të marrëveshjeve gjithashtu me shtetet e mëdha si Japonia, Koreja e Jugut, Arabia Saudite, Katari, Emiratet e Bashkuara e të tjera.

Zvogëlimi i rreziqeve për kredidhënie në sektorin financiar, përmes rritjes së sasisë së cilësisë së informatave të disponueshme në regjistrin e kredive me qëllim të përmirësimit të vendimeve, zvogëlimit të rrezikut dhe zvogëlimit të kostos.

Gjithashtu, sipas rekomandimeve edhe të Komisionit Evropian edhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, kemi filluar thellësisht edhe me reformën e administratës publike që do të jetë esenciale për të mbështetur lëvizjet të cilat bëhen në sektorin privat.

Masat shtesë që janë ndërmarrë nga kjo Qeveri në kuadër të lëvizjes së lirë të mallrave. Masat e reciprocitetit me 20 korrik të vitit 2011, pas heqjes së të cilave, më 2 shtator në Bruksel, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina pranuan vulat doganore të Kosovës dhe lejohet qarkullimi i lirë i mallrave nga...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja ta përfundojë, regjia!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI- LILA: ...dhe për herë të parë Kosova u bë partner i barabartë me vendet e rajonit.

Masat preferenciale autonome me Bashkimin Evropian. Në 1 janar 2012 Kosova pasi i humbi ato gjatë vitit 2011, u rinovuan gjithashtu dhe janë në fuqi për deri sa u mundësohet produkteve kosovare të eksportohen në BE pa dogana.

Gjithashtu, pas insistimit të Ministrisë që drejtoj, Komisioni Evropian ka përfunduar draftimin e Rregullores që do t'i mundësojë Kosovës të ketë kuotën e saj për eksport të verës në BE, të cilët e kanë vetëm vendet nënshkruese të stabilizim-asociimit apo vendet anëtare candidate për Bashkimin Evropian.

Progres është arritur edhe në sektorë tjerë, të cilët ndihmojnë edhe lëvizjen e lirë të mallrave, por gjithashtu edhe shtesë në kuadër të mbikëqyrjes së tregut, mbrojtjes së konsumatorit, pronësisë industriale e të tjera.

Prandaj, deputetë të nderuar, varet se a shikojmë gotën gjysmë të mbushur apo gjysmë të zbrazët. Nëse e shikojmë gjysmë të mbushur, do të vërejmë se në raport me zhvillimet e kaluara Kosova ka progres, por Kosova nuk është një vend i izoluar, dëgjoj referencat e vitit 2007 dhe 2008, mos të harrojmë se prej vitit 2008 të gjitha vendet e zhvilluara janë ballafaquar me një krizë dhe me ulje të zhvillimit për deri sa Kosova edhe pse, po them prapë, jo aq sa do të kishte dëshiruar, ka pasur një ngritje ekonomike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!
Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Rritja ekonomike në Kosovë nuk është as e qëndrueshme dhe as gjithëpërfshirëse. Ajo bazohet në import, remitanca dhe shpenzime qeveritare. Kemi reduktim të dyfishtë, njëfarë ekonomizimi të ekonomisë, zhvillimi kufizohet në infrastrukturë dhe infrastruktura kufizohet në asfalt.

Në anën tjetër, informaliteti i përhapur i ndërmarrësve dhe tatimi joprogresiv i lë jashtë rritjes ekonomike më të varfrit. Klasa e pasur nuk ka probleme, andaj nuk sheh probleme, i dëgjuam këta, edhe këtu në sallë. Ndërkaq, aty ku klasa e mesme sheh probleme ekonomike, klasa e varfër sheh, sepse përjeton probleme sociale.

Jo vetëm tek ne, pabarazia është ajo që e përçan dhe e ndan shoqërinë. Dhe, pabarazia e sjell varfërinë. Sot, përgjithësisht, dhunë konsiderohet vetëm ajo që godet përnjëherë fizikisht. Mirëpo, dhuna më e egër është pikërisht varfëria. Kështu mediet vizive më parë e fshehin masivisht shkakun sistematik të dhunës në shoqëri sesa që e shfaqin atë. Të varfërve në Kosovë iu thuhet që qytetarët i kanë shanset e barabarta, mirëpo shanset e barabarta, pa aftësim, pa edukim, pa punësim dhe pa emancipim paraprak, jo që s'janë të barabarta, por s'janë as shans.

Shteti i Kosovës me këtë Qeveri, me orientimin dhe politikën e saj e mban njeriun në Kosovë vetëm si konsumator e jo si qytetar. Të drejtat e qytetarit i përcakton dhe i garanton Republika. Të drejtat e konsumatorit i mundëson dhe i përcakton thellësia e xhepit të tij. Shteti i Kosovës është bërë si një byro për punësim, mirëpo jo një byro për punësim që të gjen vend pune diku tjetër, por vetëm në këtë byro për punësim. Pra, byro për punësim që të punëson në vetë byronë për punësim. E mandej aty kanë përparësi familjarët e pushtetarëve. Daja i vetëm i një deputeti që u la anash, u bë prioritet i

kryeministrit. Por, nuk duhet të kufizohemi vetëm në gjykimin moral. Kjo është shprehje e mentalitetit të dyqanit, të shitores së vogël, ku njëri dajë punon paradite e tjetri pasdite. Kjo është shoqëria kosovare sot. Prandaj, neve urgjentisht në ekonomi duhet ta sjellim sa më parë pra dijen, vetëdijen dhe logjikën e prodhimit industrial modern, e jo të tregtisë së vogël feudaliste.

Ka edhe qeveri nëpër botë që i shesin ndërmarrjet publike. Ato të këqijat prej tyre, kështu e rrisin buxhetin pa i rritur taksat. Në Kosovë nuk është as kjo, Qeveria shet ndërmarrjet publike sipas parimit ideologjik neoliberal. Meqë s'ka investime e ndihma për ekonominë vendëse prodhuese, atëherë Qeveria e Kosovës lavdërohet se po krijon kushte të favorshme për investorët e huaj, ndërkohë që ndërmarrësit vendës vazhdimisht ankohen, kurse qytetarëve iu premtohet liberalizimi i vizave. Në fakt, kushtet për investime nga jashtë po ndërtohen në llogari të njerëzve dhe ndërmarrësve brenda. Dhe, sërish nuk kemi investime nga jashtë, sepse pikë së pari, siç e dimë, as mërgata jonë nuk po vjen që të investojë. Dhe, mos e neglizhoni faktin që ndërmarrësit e fuqishëm botëror e konsiderojnë edhe investimin e mërgatës së atij vendi si faktor joshës për investimet eventuale të tyre e ky faktor nuk është ekzistent në Kosovë.

Kosova e ka pësuar tranzicionin e Evropës Lindore të para dy dekadave në verzionin e tij më brutal, demokracinë e kufizuar e të përkufizuar si antikomunizëm. Demokracia si anti-komunizëm është asfalt për neoliberalizmin. Kemi liri për të zgjedhur produktet e kapitalizmit, por jo edhe llojin e kapitalizmit. Orvatja neoliberale për ta spostuar shtetin prej ekonomisë synon, në fakt, ta përjashtojë popullin prej vendimmarrjes mbi ekonominë, pra ta eliminojë vetë demokracinë. Atëherë pse të mos e ripërkufizojmë demokracinë, kur gjendja socio-ekonomike i leverdis shumicës, ja tek e kemi demokracinë në atë vend e ky vend sërish nuk është Kosova.

Orientimi në aftësim arsimor e profesional përmes diplomave të universiteteve dhe jo në punësim, që vjen prej prodhimit industrial vendës, siç ka ndodhur në Kosovë, është orientim neoliberal. Jo rritje e kërkesës agregative që vjen nga rritja e fuqisë blerëse përmes punësimit që sjell pagë, por ndryshime strukturore për ta bërë popullsinë më atraktive për investime të huaja, ndërkohë që kërkohet durim për t'i pritur ato. Kësisoj ndodh veçse brain drain apo ikja e trurit. Nëse edukimi dhe punësimi nuk sinkronizohen, por shihen si dy faza diakronike, atëherë më të diturit dhe më të mençurit largohen nga vendi.

Një profesor nga Cambridge, në të cilin alternativa qeverisëse e Lëvizjes “Vetëvendosje” e bazon modelin e saj, pra modelin e shtetit zhvillimor, me të drejtë thotë që vendet e varfëra nuk janë të varfëra për shkak të njerëzve të varfër aty, por për shkak të të pasurve aty. Të varfërit e vendeve të varfëra nuk ngelin prapa të varfërve të vendeve të pasura, madje edhe mund të jenë përpara tyre, por ato vende janë prapa për shkak të të pasurve që gjithsesi s'ia dalin dot në konkurrencë me kolegët e tyre nga vendet e pasura. Taksisti në Kosovë, bujku në Kosovë, nuk dallon shumë prej taksistit e buikut në Gjermani. Ama, deputeti jonë, ministri jonë, kryeministri jonë, të pasurit tanë, janë të pakrahasueshëm, ta zëmë, me ata në Gjermani. Dhe, prandaj, vendi jonë është i varfër, për shkak të të pasurve në vendin tonë, e jo për shkak të të varfërve në vendin tonë.

Në alternativën qeverisëse të Lëvizjes “Vetëvendosje”, që përbëhet prej 20 kapitujve në tri shtylla, të lidhura organikisht, shteti zhvillimor, shteti i së drejtës dhe shteti social, unë po ndalem vetëm në dy nënkapituj, tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi në vlerën e shtuar.

Shkalla tatimore e propozuar nga “Vetëvendosje” është kjo, për pagat 0-170 euro tatimi në të ardhura duhet të jetë 0%, për pagat 170-500 euro tatimi në të ardhura duhet të jetë 5%, për pagat 500-850 euro tatimi në të ardhura të jetë 10%, për pagat 850-1700 euro tatimi në të ardhura duhet të jetë 20%, kurse për pagat mbi 1700 euro tatimi në të ardhura të jetë 30%. Kohezioni shoqëror mbahet nëpërmjet barazisë dhe barazia nënkupton që duhet të kemi tatim progresiv, sepse e kemi situatën e njerëzve të pabarabartë.

Më tej, tatimi në vlerën e shtuar duhet të jetë i tillë që duhet të jetë i përjashtuar për prodhimet ushqimore bazë të jetës në Kosovë. Pra, TVSH-ja 0 për: bukë, vaj, kripë, sheqer, qumësht, miell, e libra. Ndërsa, produktet që konsiderohen si më luksoze dhe më të panevojshme, do të rriten deri në shkallë prej 20%, në nivel me shumë shtete të Bashkimit Evropian. Për shembull, restorantet do të kenë shkallë të TVSH-së prej 20%. Kjo politikë do ta bartë barrën e TVSH-së nga shtesa e varfër tek shtresat që qëndrojnë më mirë në shoqëri. Këta janë, për shembull vetëm dy nënkapituj, pjesërisht edhe ato s’i thashë plotësisht, të kësaj alternativës sonë qeverisëse e cila bazohet në shtetin zhvillimor që thotë: prodhimi është realja e ekonomisë, baza e ekonomisë. Pa i nënvlerësuar shërbimet dhe financat, mirëpo, prodhimi është ajo që paraqet bazën zhvillimore të një vendi. Dhe, shteti nuk është as kontrollor dhe as spektator, por është aktor.

Le të mos e ngatërrojmë liberalizimin e tregut me privatizimin e publike, sepse në një treg liberal mund të garojnë edhe ndërmarrjet publike edhe ndërmarrjet private. Nuk bëhet liberalizimi i tregut duke e eliminuar publike. Kjo është luftë ndaj publike. Prandaj, programi i Lëvizjes sonë thotë që ne duhet të përqendrohemi tek publikja, tek prodhimi dhe kjo të jetë pjesë e një plani zhvillimor strategjik afatgjatë, qysh e përmendi Visari.

Mos harroni që ai trickle-down effect, që e propagojnë këta doktrinarët e neoliberalizmit, ai nuk ndodh realisht, sepse nuk rrjedh pasuria prej lart-poshtë, siç kanë supozuar neoliberalët. Të pasurit nuk i kontribuojnë fuqisë blerëse dhe nuk i kontribuojnë prodhimit vendor, sidomos jo në Kosovë. Dhe, a e dini pse? Sepse të pasurit kursejnë, pasuria e tyre enorme bëhet shifër. E blen ai një shtëpi, dy shtëpi, tre shtëpi, një kerr, dy kerre, e mbasandaj çka të bëjë? Paratë tjera mbesin në bankë, janë shifër. Pasuria e të pasurit nuk është mirëqenie, është shifër. Dhe të pasurit blejnë mallra luksoze. A i prodhojmë ne? Jo. Prandaj ato para shkojnë jashtë. Kjo është arsyeja pse kemi nevojë për një model krejtësisht tjetër, i cili edhe realizon kohezionin social, e sjell drejtësi e zhvillim, pa e përjashtuar asnjëra këto njëra-tjetrën. Faleminderit

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,

Po dua të besoj që mediat gjatë prezantimit të kryeministrit dhe të anëtarëve tjerë të Qeverisë e kanë qitur aty në monitor një shenjë publicitet propagandistik, veç sa për të na i mbrojtur fëmijët prej të pavërtetave, sepse nuk po e di me këto prezantime që po i dëgjojmë a po flasin për Kosovën që është vendi i nëntë më i varfër në botë dhe po bëj pyetje- a jeni të vetëdijshëm që Kosova nën qeverisjen e juaj është vendi më i varfër në listë në numrin 9.

Pastaj po flisni shumë që keni ndërtuar rrugë. Unë po dua t'ju njoftoj që për çdo ditë e më shumë qytetarët e Kosovës nuk kanë naftë për të kaluar nëpër këto rrugë. Dhe jo pse janë ata fajtorë për këtë punë, por për faktin se pikërisht këto rrugë janë paguar me çmime astronomike prej parave të tyre.

Për ata flasin edhe raportet ndërkombëtare që e trajtojnë korrupsionin një ndër problemet më të mëdha në Kosovë. Në Kosovë ka korrupsion dhe ky korrupsion më së shumti është parë dhe është theksuar pikërisht aty ku ju po lavdëroheni në ndërtimin e rrugëve dhe për këta s'po na i liberalizojnë vizat.

U përmend edhe një teknologji informative dhe mua mu kujtua një projekt 12 milionë euro nën Qeverinë Thaçi, që thoshte do t'i kompjuterizojmë shkollat. Sot shkollat publike nuk janë të kompjuterizuara. Për shembull, në "Hasan Prishtinë" ku shkojnë në shkollë fëmijët e mi, nuk ka asnjë kabinet, e nuk ka as kabinet të informatikës, rrjedhimisht.

Edhe në shkollat tjera publike nuk ka kompjuterë. Ku janë shkuar ato 12 milionë euro?

Më erdh keq që u fol tepër shumë për Prishtinën, jo që po dua të them që jam e kënaqur me mënyrën si menaxhohet Prishtina, po për shembull pse s'folëm për Prizrenin, ku një kryetar i komunës, që më vjen keq ta them, e ka moshën e gjyshit tim, na bën për t'u turpëruar të gjithëve pse jemi në Kosovë, sepse keqpërdorë paranë publike, në vazhdimësi e keqpërdor paranë publike.

Dhe a është zhvillim ekonomik, u tha këtu kur një punëtor krahu duhet të shkojë në Sutomore dhe të vdesë atje për një pagesë prej 8 euro në ditë? A është kjo Kosova për të cilën ne po lavdërohemi.

Nuk po dua për t'ju dhënë sugjerimet në vijim, për të besuar që Qeveria do të reflektojë ndryshe, sepse unë besoj që kjo qeveri është papërmirësueshme, këtë e kam besuar çdo herë dhe vazhdoj të besoj, mirëpo për shkak të qytetarëve të Kosovës për të treguar që ky vend ka alternativë dhe ky vend mund të zhvillohet ekonomikisht, po i jap disa nga propozimet e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Për shembull, lirimi i lëndës së parë dhe i gjysmëprodukteve nga taksa doganore, prodhimi dhe përpunimi janë degët ekonomike të cilat ofrojnë më së shumti punësim, kur dihet se vendi ynë ka më shumë se 40% të papunë, atëherë përkushtimi jonë për mbështetjen e prodhimit dhe të përpunimit duhet të jetë primar.

Pastaj, përshkallëzimi i TVSH-së duke pasur parasysh situatën e rëndë ekonomike ku afërsisht 12% të popullatës jeton në varfëri të skajshme dhe më shumë se 37% në më pak

se 2 euro në ditë, duhet të bëhet përshkallëzimi i TVSH-së për produkte siç është: gruri, mielli, vaji dhe duhet që të ketë TVSH simbolike, diku rreth 3% për produktet agrare.

Gjithashtu, duhet të ketë një TVSH të vogël diku rreth 5% që të gjithë ata që varen nga agrobiznesi të kenë mundësi të ofrojnë produktet me një fitim më të mirë në treg, pastaj lirimi i pagesës në kufi të TVSH- së për importuesit e lëndës së parë.

Pagesa e taksave dhe tatimeve për para shitjes së mallit është një lloj takse jo e mirë dhe nuk praktikohet në ekonominë moderne, sidomos pagesa e taksave në kufi për lëndë të parë dhe pajisje pune, ndikon direkt në pengimin e zhvillimit ekonomik. Prandaj duhet që të ndërmerren hapa urgjent që dalëngadalë lënda e parë të lirohet nga pagimi avancë i taksës të cilat e ngarkojnë prodhuesin apo përpunuesin me obligime paraprake financiare.

Pastaj, modernizimi i Administratës Tatimore. ATK-ja për momentin luan rolin e taksambledhësit, por jo edhe të mbrojtësit të tatimpaguesit. Që nga ekzistenca e ATK-ës, asnjë kompani e vetme nuk ka shkuar në bankrot të detyruar për shkak të bilancit negativ e që për momentin janë krijuar kompani piramidale të cilat e kanë borxhin shumë më të madh se kapitalin dhe do të ketë ndikim shumë negativ në zhvillimet ekonomike në të ardhmen në vend.

Pastaj, të zbatohet ligji. Konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë joligjore, është masa e cila duhet të ndërmerret në këtë vend dhe në fondet të cilat janë krijuar në mënyrë të paligjshme të krijohen fondet sociale.

Lirimi nga taksat doganore i të gjitha produkteve me origjinë nga SHBA-të. Deri sa vazhdon të jetë ekonomia më e fuqishme në botë, SHBA-ja në Kosovë është me një prezencë shumë simbolike përmes kompanive të saj ose krejt të vogël. Prezenca e kompanive nga SHBA-të në vendin tonë do të krijonte zhvillim ekonomik, gjithashtu edhe stabilitet politik, prandaj duhet të merren hapat fillestar për një lidhje të tillë si një hap drejt hapjes së rrugës për investitorë të interesuar.

Stimulimi i investitorëve. E kam thënë edhe këtu, Kosova në mediet botërore trajtohet si perëndim i egër, sepse të gjithë ata njerëz që kanë ardhur në Kosovë, përjashtimisht të kompanive që kanë sjellë para për pastrim, janë sjellë rrugëve dhe shumica e kompanive serioze janë ik, sepse kanë pasur kërkesë të ryshfetit, janë penguar, ka pasur burokraci dhe shumë pak prej tyre kanë dalë në Kosovë, edhe ato që kanë dalë, kapitali i tyre është ndoshta 1% prej asaj çka është paraparë fillimisht.

Prandaj stimulimi i investitorëve pasi që nuk kemi investime direkte të huaja dhe papunësia është shumë e lartë, duhet të shkohet me stimulim dhe atë të gjithë investitorëve që punësojnë më shumë se 100 punëtorë brenda një viti. Atyre duhet t'u garantohet lirim nga tatimi në fitim 1.000 euro, për shembull, për një punëtor të punësuar, kështu e bëjnë edhe vendet në rajon dhe ju këtë e dini.

Dhe, në fund, transparenca, apo mosvjedhja dhe moskeqpërdorimi i parasë publike. Kisha dashur t'i shtoj edhe disa pyetje atyre që sot do të dalin sigurisht dhe do të replikojnë,

shumë drejtpërdrejt - Sa investitorë të huaj kanë ardhur në Kosovë, me numër? Cila është vlera e investimeve që ka ndodhur? Sa vende pune janë hapur? Në cilët sektorë dhe në cilat komuna dhe sa njerëz janë punësuar?

Dhe krejt për fund, u përmend edhe energjia, s'po mund pa e thënë, është për keqardhje në fundin e mandatit të dytë për t' u lavdëruar që ne kemi një projekt për ndërtimin e një termocentrali, projekt i cili e dimë që ka qenë aty në vitin 2007 kur ju keni ardhur në pushtet dhe që atëherë ka qenë i paraparë të përfundojë diku në vitin 2010, me 1 200 megavat orë energji elektrike dhe ju e keni fuzionuar, e keni dëmtuar, e keni vonuar dhe tani nuk ekziston fare, ndërsa ndërkohë janë mbi 200-300 milionë euro, të cilat janë dhënë prapë para të qytetarëve të Kosovës, jo para tuaja, qysh pretendoni se ne Kosovën e kemi nxjerrë nga terri.

Qytetarët e Kosovës e kanë paguar rrymën dhe atë 10 fish më shtrenjtë, për shkak se ju keni bërë kontrata të dëmshme, për shkak se ju keni pasur interes për të importuar energji elektrike prej kompanive të dyshimta, prej vendeve të cilat nuk e njohin as shtetësinë e Kosovës. Dhe pse ka ndodhur kjo, ju e dini dhe besoj që në një të ardhme të afërt do të tregoni edhe para institucioneve përgjegjëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pra, para se t'ia jap fjalën Fadil Demakut, ju ministrat duhet të disiplinoheni. Është mirë deputetët t'i kryejnë punët, ju i shënonin çka po diskutojnë. Shikoni, merrni shënime, mos na e bëni debatin tërkuzë se duhet të ndërpritet diku. I mbani shënimet dhe pas një kohe i jepni përgjigjet.

Debati është i Kuvendit, nuk është i Qeverisë. Jo, ju lutem, duhet ta respektojmë një farë rendi se nuk mundemi ne kështu tërë ditën. Edhe grupet parlamentare duhet t'i koncentrohen pak, t'i definojnë deputetët të cilët donë të diskutojnë dhe mos të shkojnë tash tërë ditën duke u shtyrë njëri me tjetrin. Ta bëjmë një kulturë në debat.

Fadil Demaku e ka fjalën.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Të thuash se jemi vend i varfër në Evropë, se kemi papunësinë më të madhe, ekonominë më të pazhvilluar, asgjë të re nuk kemi thënë.

Ata që janë të vetëdijshëm e dinë se sa e vështirë është të ndryshosh renditje. Mos ta harrojmë, jemi vendi i fundit që kemi fituar lirinë dhe kur ne ballafaqoheshim me luftën dhe shkatërrimin, vendet tjera i kishin të rregulluara çështjet të cilat na sfidojnë ne sot si shoqëri.

Nuk e them këtë për arsyetim. Gjërat duhet t'i shohim në kontekstin kohor dhe me mundësitë. Nuk krijohet asgjë duke mohuar gjithçka.

Të thuash se papunësia dhe varfëria sot janë më të larta se para 5 vjetësh, nuk qëndron aspak, e sa për kënaqshmërinë e qytetarëve me qeverisjen e atëhershme që varfëria dhe papunësia paskan qenë në nivel më të ulët, siç thuhet nga arsyetimi që është bërë aty se sa tani, patën vendosur atëherë qytetarët në zgjedhjet e vitit 2007.

Që të thuash këtë duhet të injorosh në fakt të gjitha raportet dhe analizat ekonomike të bëra për vendin tonë ndër vite e mes tjerash raportin e FMN-së dhe atë të Bankës Botërore.

Në vijimësi duhet të themi se përgjegjësia për zhvillim ekonomik nuk është çështje e një subjekti politik apo i vetëm një periudhe qeverisëse, por deshëm ta pranojmë apo jo politikisht ne këtu, kjo çështje është sfiduese gjatë gjithë periudhës kohore që nga përfundimi i luftës. Megjithatë, nuk mund të mos sjellim në mendje se gjatë kësaj periudhe Kosova ka shënuar progres të pakontestueshëm në kuptim të përmirësimit të normës së rritjes ekonomike, të rritjes së nivelit të investimeve të huaja në vend, si dhe përmirësimit të ambientit dhe të bërit biznes me qëllim të stimulimit të prodhimit vendor.

Përpjekje konkrete për të përkrahur sipërmarrësit dhe nxitur investimet janë bërë që nga viti 2009 e këndej, me zvogëlimin e normave tatimore sipas të cilave bizneseve u lihen më shumë para për të investuar, si dhe një varg politikash lehtësuese të cilat janë evidentuar pozitivisht edhe në raportin e fundit të të bërit biznes.

Spektori fiskal ka vazhduar t'i kontribuojë zhvillimit të sektorit privat, buxheti i Kosovës është bazuar në programin e Qeverisë, i cili ka dhënë prioritetet e zhvillimit ekonomik, zhvillimit të kapitalit njerëzor, qeverisjes së mirë si dhe mirëqenies së qytetarëve.

Të hyrat buxhetore kanë vazhduar të rriten dukshëm krahasuar me periudhën e kaluar për arsye të masave të cilat janë ndërmarrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Investimet kapitale kanë vazhduar të absorbojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore me qëllim të vazhdimësisë së implementimit të prioritetëve që ndërlidhen me përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Spektori më i ndjeshëm vazhdon të mbetet ai i tregtisë, ku eksportet janë ende në nivele të vogla, por që duhet të theksohet se në bazë të raportit vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2011, norma e mbulueshmërisë së importeve me eksporte ka ardhur duke u rritur.

Pavarësisht këtyre shifrave pozitive ato janë mjaft të vogla, duhet të jemi objektiv se nuk janë shfrytëzuar sa duhet nga bizneset raportet që krijohen nga CEFTA dhe raporteve preferenciale me BE-në.

Në rastin e parë dihet që janë arsye politike, ndërsa në të dytin mund të jenë mungesa e informimit jo të plotë të bizneseve për mundësitë që i ofron ky raport tregtar me BE-në.

Unë besoj në iniciativën private e cila ka të integruar shpirtin e ndërmarrësisë, krijimi i mekanizmave përkatës me qëllim të identifikimit të problemeve me të cilat është duke u ballafaquar sektori privat, janë disa nga hapat më të rëndësishëm të Qeverisë për të siguruar që ky sektor të prodhojë efekte konkrete në ekonomi.

Në vijimësi të kësaj është me rëndësi të nënvizohet që shteti ynë me sukses ka arritur të ruajë stabilitetin e sistemit financiar në vend si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm, gjithashtu sistemi bankar e karakterizon Kosovën si një ndër vendet me rritjen më të shpejtë të kreditimit në rajon, nivelin më të ulët të kredive jo performuese, si dhe nivelin më të lartë të mbulueshmërisë në kapital. Mirëpo, zhvillimi ekonomik varet kryesisht nga rritja bizneseve me të cilën ndikohet niveli i punëzënies.

Bizneset e vogla dhe të mesme janë ndikuar nga normat e interesit të cilat janë të larta dhe jo atraktive për të nxitur investime private.

Që nga pas lufta këto norma kanë qëndruar në nivel po thuaj se konstant dhe për kundër faktit se numri i institucioneve financiare është rritur ndjeshëm. Kjo tregon një asimetri në raportet e agjentëve ekonomikë në këtë fushë dhe që nuk duket në përputhje me ligjet ekonomike sipas të cilave çmimi dhe sasia duhet të ishin në lidhje inverse me njëra - tjetrën.

Prandaj, konsideroj se debati i sotëm mbi zhvillimin ekonomik është i nevojshëm për disa pjesë të tij, por megjithatë ai kërkon trajtim shumë dimensional dhe me një përfshirje më të gjerë që i tejkalon përmasat e një debati parlamentar.

Zhvillimi ekonomik natyrisht varet nga shumë faktorë të cilët ndikojnë tek njëri-tjetri në formë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, mirëpo është e rëndësishme se Qeveria tanimë ka ndërtuar infrastrukturën legislative, administrative, juridike për një ambient sa më atraktiv për biznese të huaja dhe vendore, por duhet të përshpejtojë hapat në transformimin e pronës si një nga elementet për përmbylljen e procesit të tranzicionit.

Meqenëse Kosova është cilësuar si një vend i pasur me pasuri të ndryshme, por esenciale është sa dhe si mund të bëhet shfrytëzimi i tyre, prandaj ajo duhet të investojë me kujdes në njërin nga faktorët kyç të rritjes ekonomike e që është forca punëtore e kualifikuar dhe inovatore që lidhet me krijimin e një strategjie të qartë dhe mekanizmave të cilët do t'i shërbenin krijimit të sa më shumë profileve arsimore të atilla që do të ishin në funksion të dinamikës së tregut, të punësimit, për të baraspeshuar kërkesën me ofertën për punë.

Anëtarësimi në institucione financiare ndërkombëtare, sikur se janë Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe anëtarësimi në mekanizmat e tjerë rajonal, dëshmojnë qartë se Kosova ka arritur maturi shtetërore si dhe ka strategji për të realizuar prosperitetin e dëshiruar ekonomik.

Megjithatë, duhet t'i përshpejtojë përpjekjet për të shfrytëzuar këtë anëtarësim dhe për ta kthyer në rezultate konkrete.

Në përgjithësi indikatorët e lartpërmendur konfirmojnë se përkundër faktit që Kosova ka filluar zhvillimin ekonomik të saj, nga një nivel i paqëndrueshëm dhe pa perspektivë, përmes vizionit për zhvillim ekonomik dhe politikave përkatëse është arritur që të realizohet performancë e konsiderueshme pozitive për të stimuluar rritje ekonomike e cila do të rezultojë me mirëqenie dhe standard më të mirë jetësor për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Gjendja ekonomike si dhe pozita sociale në vend është duke u përkeqësuar çdo ditë e më shumë, derisa Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim me qëllim që së paku t'i stopojë këto trende, për fat të keq te të gjithë qytetarët e vendit ajo dështimet vazhdon t'i quajë si të arritura.

Kjo sjellje neve edhe më shumë na e forcon bindjen se Qeveria nuk donë të merret me këto çështje, madje mund të themi lirisht se nuk vizion si t'i qaset ekonomisë në Kosovë.

Duke pasur parasysh këtë gjendje, Lidhja Demokratike e Kosovës e ka parë të arsyeshme që pikërisht në këtë Kuvend të vlerësojmë se kah po shkon ekonomia e Kosovës, të shohim se çfarë dëmi po i shkaktohet asaj me vendime e paqëlluara të Qeverisë, si dhe të kërkojmë zgjidhje.

Këtë përgjegjësi duhet ta pranojmë, meqenëse së paku ne si LDK duam të jemi të përgjegjshëm para votuesve, të cilëve iu kemi premtuar një jetë më të begatshme dhe më dinjitoze, por për fat të keq jemi thellë të bindur se me këtë Qeveri dhe me politikat që ajo po i implementon nuk do të mund ta përmbushim këtë obligim ndaj qytetarëve të Kosovës.

Se kjo është e vërtetë, dëshmojnë të gjitha zhvillimet në ekonomi, duhet të mendohemi shumë gjatë nëse mund të gjejmë ndonjë ngritje meqenëse të gjitha parametrat janë në rënie të theksuar. Me këtë rast po veçoj vetëm disa që janë më qenësore.

1. Norma e rritjes së GDP-së po bie mesatarisht 05% për çdo vit. Me këtë rënie kosovarët edhe më shumë vite do të jenë populli më i varfër në Evropë. Ky është kulmi i të gjitha dështimeve të kësaj Qeverie.

Të përkujtoj se kjo Qeveri ka marrë vendim me një rritje të GDP-së 5.6%, ndërsa ajo tani ka rënë për katër herë.

Sado që Qeveria këtë dështim vazhdon ta mbulojë duke thënë se kemi rritjen më të lartë në rajon, por asnjëherë nuk përmend se GDP për kokë banori në Kosovë është 2 herë e gjysmë më e ulët se në Shqipëri, ose 3 herë e gjysmë më e ulët se në Maqedoni, apo sa për të arritur nivelin e zhvillimit që ka Bosnja me supozim se ajo do të ngecë. Ndërsa,

norma e zhvillimit të Kosovës të ecë me ritmin aktual, na duhen së paku 15 vite të ardhshme, ndërsa për të arritur aty ku është sot Shqipëria në duhen edhe 10 vjet tjera.

Ecuritë e këtilla, padyshim se janë reflektuar në pozitën sociale të popullatës. Sipas të dhënave të grupit të ekspertëve të LDK-së të cilat janë burim nga agjencionet zyrtare të vendit, në vazhdimësi është duke rënë numri i të punësuarve. Përderisa në vitin 2010 kemi pasur 18 750 persona të punësuar, në vitin 2012 kishim vetëm 6 500, domethënë gjatë vitit kjo parashikohet, paralelisht me këtë është rritur numri i të papunëve. Në vitin 2010 si kontingjent i ri i të papunëve kanë qenë 6 250 veta, në vitin 2012 kjo shifër arriti në 18 500 persona.

Gjendja është edhe më e rëndë se sa paraqitet, pasi që është shumë e saktë se ata që kanë nevojë për punën nuk paraqiten në qendrat e punësimit, meqenëse nuk kanë besim që kjo Qeveri mund ta zgjedhë problemin e tyre, ndërkaq, të dhënat nga regjistrimi i fundit të popullsisë tregojnë se shkalla e punësisë është hiq më pak se 45% e tash paramendoni se kur mund të eliminohet kjo papunësi me normën e zhvillimit aktual që kemi.

Politikat që është duke i udhëhequr kjo Qeveri nuk ka pasur asnjë ndikim në përmirësimin e bilancit tregtar të vendit. Ai është duke u përkeqësuar me një ritëm tepër të shpejtë nga 1.7 miliardë euro sa ishte deficitin në vitin 2008 ai vjet ishte 2.2 miliardë euro. Vjet eksporti ishte 14% më i ulët se në vitin 2011, ndërsa 9% më i ulët në vitin 2010. Kjo gjendje nuk mund të arsyetohet me rënien e çmimit të metaleve apo me krizën që po përjeton Evropa.

Se kjo është e vërtetë, po përmendi vetëm një fakt, Qeveria nuk bëri asgjë për së paku për një përqindje të zëvendësojë importin me produkte vendore. Ajo vazhdon duke shpenzuar parat në projekte elektorale. Bujqësia ndihmohet vetëm me 8 milionë euro në vit, kurse në asfalt futen 560 milionë euro, ndërsa për importin e ushqimit shpenzohen mbi 500 milionë euro në vit, aq sa janë edhe dërgesat nga diaspora.

Në politikat e këtilla Qeveria ka stimuluar eksportin e parasë, deficitin tregtar, dobësimin e sektorit të bujqësisë dhe varfërimin e fshatit. Kosova ka bërë përparim në listën e të bërit biznes, madje sipas Bankës Botërore ngritja e saj për 19 vende është më e larta në botë.

Krejt në rregull, por pse ky përparim në përmirësimin e ambientit për biznes nuk solli asgjë të mirë për qytetarët e Kosovës apo për biznesin tonë? Se kjo reflekton vetëm gjendjen formale, tregon fakti se investimet e huaja direkte në Kosovë vjet ishin 321 milionë, që janë 50 milionë më pak se parvjet me 108 milionë euro më pak se në vitin 2007.

Nëse i referohemi të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, këtu gjendja është edhe më e keqe, meqenëse në shtator investimet e jashtme ishin 42% më të ulëta se para një viti.

Pse ndodhin këto zhvillime? Meqenëse Kosova vazhdon të jetë vendi me shkallë të lartë të perceptimit të korrupsionit, ajo radhitet në vendin 105, ndërsa krahasuar me rajonin më keq është vetëm Shqipëria që mban vendin e 113-të.

Meqenëse administrata publike është e stërngarkuar, e burokratizuar dhe e pa përgatitur për t'i dalë në ndihmë qytetarit, këtë nuk e ka sjell askush tjetër, pos nepotizmi dhe punësimi mbi bazat partiake duke e injoruar aftësinë profesionale.

Meqenëse sistemi gjyqësor është jo efikas, për të cilën dëshmojnë të gjitha raportet për Kosovën, meqenëse ka mos koordinim të veprimeve dhe të masave ndërmjet institucioneve, si në rrafshin horizontal ashtu edhe në atë vertikal, Qeveria ndërhyr në punët e rregullatorit të pavarur ku thotë se nuk do të shtrenjtohet energjia elektrike, se nuk e ka atë të drejtë të ndërhyjë, dhe kështu ndodhi pa marrë parasysh kërkesat që ishin nga operatorët ekonomikë.

Ose rasti i dytë është ndërhyrja e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nga zonja ministre Mimoza Kusari, që Qeveria ku e vuri taksën e çimentos së importuar nga Shqipëria. Meqenëse Qeveria nuk ka fuqi të shtyjë përpara asnjë projekt serioz, ka shumë mundësi të dështojë privatizimi i PTK-së meqenëse u pa që u paraqit vetëm një ofertues, ndërkaq këtu ka shumëçka të kontestueshme, duke filluar nga vendimi për privatizim, shtyrje e vazhdueshme e afateve dhe ndryshimi i subjekteve të interesuara për pjesëmarrje në këtë proces.

Meqenëse Qeveria nuk po bën asnjë veprim për përmirësimin e situatës energjetike, në këtë sektor ndodhi një privatizim, i cili buxhetit të vendit nuk i solli asnjë të mirë, por nuk premton se duke përmirësuar dhe stabilizuar furnizimin me energji elektrike do të përfitojnë bizneset apo qytetarët e Kosovës.

Projekti “Kosova e Re”, ende është në nivelin e dëshirave. Dinamika e punëve nuk premton se do të tejkalojnë krizën energjetike, madje ajo pritet të thellohet edhe më shumë pas vitit 2017.

Me politikat fiskale kjo Qeveri, përkatësisht me ndryshimin e normës së tatimit në paga dhe asaj të TVSH, tatimit në pronë, janë goditur qytetarët me paga të ulëta, ndërsa janë stimuluar ata që kanë fitime të mëdha, ndërsa bizneset individuale ngarkesën tatimore e kanë 80% më të lartë. Meqenëse politikat e këtilla stimulojnë ministrat, deputetët, drejtorët e agjencioneve, menaxherët e pozitave të larta në sektorin privat, në banka e në kompani të mëdha, si dhe në korporatat e mëdha.

Në fund dua të them se jam munduar të gjej edhe zhvillimet pozitive, thjesht jo vetëm për korrektësi, por që të mos i injoroj ato, por nuk i kam gjetur deri më sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Afrim Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Do të flas për lidhjen në mes të zhvillimit ekonomik dhe bujqësisë dhe po filloj fjalimin me një shembull që lidhet me një prodhues të vajit në Kosovë e i cili sot gjendet para vështirësive të shumta si shumë prodhues të tjerë.

Ky prodhues tani për shkak të vështirësive ka një numër të vogël të punëtorëve pasi e ka të vështirë të depërtojë në treg. Parajsa për të ishte periudha e reciprocitetit në mallra me Serbinë. Në atë kohë kjo fabrikë punonte me 3 ndërrime, tregu e absorbonte vajin që prodhonte ai, punëtorët siguronin rrogat me punën e tyre dhe ishte shpresë për përmirësim të jetesës për ta.

Ndërprerja e reciprocitetit i hodhi ata në rrugë. Nevoja për vajin e kësaj fabrike ra rrjedhimisht edhe fati i këtyre punëtorëve u përcaktua nga kjo ndërprerje.

Ata punëtorë u detyruan t'i kthehen tokës që të siguronin mbijetesën, secili parcelës së vogël që pati. Priteshin të ardhura nga patatet që do të shiteshin. Nuk mund të shiteshin, ato përfunduan të kalbura në lumë, kështu çfarëdo shprese për fshatarin ra.

Dhe tani kë ne duhet ta fajësojmë këtu? Fabrikën që prodhon vajin, bujkun që prodhon produktin bujqësor? Ky shembull e tregon rolin e shtetit në raport me prodhuesit, e në këtë rast prodhuesin bujqësor.

Ajo fabrikë po të mbrohej nga shteti do të kishte sukses. Punëtorët e saj do të punonin dhe toka e tyre do të vihet në shërbim të saj së paku me luledielli, do të krijoheshin kushtet për parcelat e mëdha, ku njëherësh do të punonte tokën e atyre që punonin në fabrikë me një qira të caktuar. Bujku do të kishte prodhim të sigurt po të kishte pikat grumbulluese ku do të duhej ruajtur prodhimi i tij në pritje të çmimit të volitshëm. Do të kishte rritje të produktit dhe cilësisë po të kishin sistemin e ujitjes. Prapë është dora e shtetit ajo që e mundëson këtë.

Dhe si hallkë e fundit në këtë linjë, dora e shtetit me mënyra të ndryshme, siguron pasimin e këtij produkti. Pra, në këtë proces është shteti ai që e përcakton suksesin, në secilin hall të tij, që nga mbjellja e deri te shitja.

Kur flasim për hallkën e parë që është mbjellja, duhet të mos e harrojmë fatin e tokës bujqësore që në mënyrë brutale i nënshtrohet shkatërrimit përmes ndërtimit të pakontrolluar.

Privatizimi i tokës së ndërmarrjeve shoqërore bujqësore nuk ka shkuar në dobi të prodhimit. Toka bujqësore iu morr pronarëve dhe u shndërrua në plazh të shitjeve e stërshitjeve dhe si e tillë ajo iu nënshtroa transformimit në tokë ndërtimore. Kjo u bë pengesë për zhvillim.

Të mos harrojmë se Kosova importon farë, plehra artificiale të cilësisë së dyshimtë, në vend që të krijojë potenciale për prodhimin e tyre. Kosova dikur i ka prodhuar këto, edhe këtu shteti mungon.

Fermat e vogla, parcelat e vogla nuk mund të ndryshohen vetvetiu. Orientimi i shtetit nga prodhimi e ndikon këtë. Kjo do të sillte shfrytëzimin racional të tokës, pajisjeve bujqësore dhe fuqisë punëtore. Kjo shpie drejt bujqësisë intensive dhe e tëra varet nga mbrojtja e produktit bujqësor.

Çka po bën shteti sot për bujqësinë? Kemi rastin të dëgjomë vazhdimisht për subvencionet, respektivisht për pagesat me para në dorë që pushteti ia bën qytetarëve në zona rurale, kjo dhe asgjë tjetër.

A sjell kjo zhvillim? Në politikën e BE-së ku të gjitha vendet kanë bujqësi më të zhvilluar se sa ne, ndajnë qartë buxhetin në mes të subvencioneve dhe investimeve në zhvillim rural. Ne që në aspektin e zhvillimit rural jemi tejte mbrapa, të gjitha paratë e ndara për këtë fushë ia ndajmë subvencioneve.

Është e lehtë, shumë e lehtë të shpërndash para dhe t'i shpërndash të gjitha parat që i ke, vetëm për t'i blerë qytetarët, por ato para nuk do të sjellin zhvillimin e mundshëm pa investime me vizion afatgjatë. Me vite e vite paratë për rehabilitimin e sistemit të ujitjes ndahen dhe asnjë punë nuk bëhet. Vitin që shkoi ato para u bartën në subvencione, pra para kesh për qytetarët.

Njëjtë është edhe me pikat grumbulluese, vitin që shkoi nuk u bë asnjë punë dhe paratë u bartën në linja të tjera. Subvencionet janë të nevojshme, por ato duhet të aplikohen si stimulim në rritje të prodhimit dhe atë pse jo në forma tjera, përse jo vetëm me para kesh, pleh artificial, farë e tjera.

Vitet e humbura në investimet në sistem të ujitjes, pikat grumbulluese do të vonojnë çfarëdo mundësie për zhvillim të bujqësisë, e zhvillimi ekonomik tek ne nuk mund të jetë as i imagjinueshëm pa zhvillimin e bujqësisë.

Që të ndodhin të gjitha këto, shteti duhet të shndërrohet si shtet në interesin e prodhuesve dhe jo vetëm të tregtarëve si është tani. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Do të bëj përpjekje që të jem mjaft i shkurtër për arsye se dëgjova shumë mendime të zhvillimit ekonomik dhe si student në vitin 1984 e kam pasur një lëndë - Zhvillimi i mendimit ekonomik, ku ka qenë profesor edhe Muhamet Mustafa dhe asnjë koncept i asaj lënde s'po më përputhet këtu, por besoj se ndoshta këto koncepte tona do të kishin hyrë në atë libër.

Në radhë të parë do të bisedoj që Kosova edhe në këtë vit po hyn pa një strategji të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik dhe kjo është duke i munguar Kosovës. Prandaj, është një detyrë qoftë e kësaj Qeverie po edhe qeveritë tjera që do të vijnë duhet të kenë një strategji se kah duhet të shkojë zhvillimi ekonomik i Kosovës. Kjo i ka munguar Kosovës dhe kjo është prioritet që duhet të bëhet.

Një diçka tjetër që do të ndalem, është rreth privatizimit. Ne duhet të analizojmë se çka ka ndodhur me privatizimin në Kosovë, se privatizimi a ka sjell numër më të madh të punësuarve apo nuk ka sjell. Ne e dimë që nuk ka sjell. E dimë që privatizimi është proces i dhembshëm, mirëpo është pritur që privatizimi të ketë zhvillim ekonomik dhe kjo nuk ka ndodhur. Gjithashtu, është bërë edhe vonesa e privatizimit për arsye se privatizimi është dashur të kryhet, është dashur që të gjitha ndërmarrjet tani veç të jenë të privatizuara.

Në lidhje me investimet e huaja dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, më vjen keq që ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk është këtu, mirëpo ajo e jepi një plan që do të ndodhë në vitin 2013 apo 2014. Të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë bartëse të zhvillimit ekonomik. Kjo është treguar me praktikat më të mira të vendeve të cilat kanë një zhvillim ekonomik, mirëpo për të pasur ndërmarrje të vogla dhe të mesme të zhvilluara duhet të ketë edhe investime, duhet të ketë edhe subvencione. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë nuk kanë pasur investime në to, nuk kanë pasur lirime nga aspak dhe për ata kemi ngec. Të gjitha ndërmarrjet e vogla në Kosovë janë ndërmarrje individuale, janë ndërmarrje që janë duke siguruar vetëm ekzistencën familjare, për arsye se në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme një person është menaxher, një person është kontabilist, është pastrues dhe të gjitha funksionet i kryen në atë ndërmarrje. Prandaj, ndërmarrjet e vogla te ne nuk paraqesin zhvillim ekonomik, por vetëm sigurojnë ekzistencën e atij ose asaj familje.

Prandaj, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duhen të jenë prioritet jo vetëm i kësaj Qeverie, por i gjithëve, por edhe i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për arsye se në kuadër të kësaj ministrie i ka dy-tri agjenci, një agjenci që merret me promovimin e investimeve të huaja, një agjenci që merret me promovimin dhe investimet në ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe në këtë Kosovë janë mbi 34 agjencie, u kërkua dhe edhe një agjenci për shkencë, të bëhen 35 dhe asnjëra nuk është duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të Kosovës, andaj duhet të ndalemi t'i analizojmë dhe të shohim se ku jemi.

Dhe do të ndalem tek ndërmarrjet publike. Ndërmarrjet publike i kemi devalvuar aq shumë sa që sot në treg janë shumë, do të shiten me vlerë të vogël. Kjo është shumë thjeshtë dhe mund ta kuptojë edhe vetë populli që një mall kur e ke në treg e shan, e devalvon, e shkatërron, atëherë ajo do të kushtojë shumë lirë. Prandaj, edhe ne ndërmarrjet publike i kemi prurë në këtë situatë sa do të shiten shumë lirë për arsye se i kemi devalvuar.

Dhe, për fund, pasi ministri Beqaj erdhi këtu, për ndërmarrjet publike ku duhet 10% të punësuarve edhe nga komunitetet, dua t'i them që nga komuniteti egjiptian as në KEK dhe as në PTK nuk është asnjë i punësuar, do të thotë as atë obligim ligjor nuk e ka kryer. Faleminderit!

KRYETARI: Tani pauzë, debatin e vazhdojmë në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Po e vazhdojmë seancën. Zoti Kurtan Kajtazi e ka fjalën.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Kur po flasim për gjendjen e sotme ekonomike në Kosovë, duhet të kemi parasysh patjetër edhe rrethanat, nëpër të cilat kaloi vendi ynë gjatë viteve të fundit.

Situata e sotme ekonomike dhe shkalla e zhvillimit të vendit do të ishte shumë më ndryshe, sikur vendi ynë të mos kalonte një luftë shkatërrimtare, e cila paraprakisht asgjësoi kapacitetet fizike dhe ekonomike të vendit tonë. Edhe ato fabrika dhe objekte që shpëtuan e humbën tregun për shkak të vjetërsisë teknologjike, amortizimit si dhe faktorëve tjerë.

Për këtë arsye nuk qëndron fakti kur në qarqe të caktuara thuhet që rritja e bruto produktit vendor, e cila në Kosovë në 5 vjetët e fundit çdo vit ka qenë deri në 5%, nuk është e mjaftueshme dhe reale, pasi që Kosova doli nga lufta e shkatërruar dhe për këtë arsye baza e saj ishte e ultë dhe si e tillë nuk mund të merret si indikator krahasues.

Normalisht që është e kuptueshme, se pas një lufte asnjë vend nuk mund të startojë me një shkallë të lartë të zhvillimit ekonomik dhe me indikatorë sikur dhe të vendeve, të cilët nuk kanë pasur luftë. Mirëpo, është shumë i rëndësishëm trendi i rritjes së normës së rritjes dhe shtimi i tij në vitet e fundit. Rritja ekonomike e Kosovës është fakt dhe ajo mund të matet me të gjithë indikatorët makro-ekonomik. Ky fakt madje, konfirmohet edhe me mekanizmat nga mekanizmat e rëndësishëm dhe relevantë ndërkombëtarë, sikurse janë Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim e tjerë. Të gjitha këto organizata në raportet dhe analizat e tyre të rregullta potencojnë rritjen e bruto-produktit vendor për kokë banori, e cila për vite të tëra është më e larta, krahasuar me vendet fqinjë, po edhe më gjerë.

Kjo gjë u potencua edhe në vizitën e fundit tash në mars nga misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar në Kosovë, gjatë rishikimit të marrëveshjes stand by. Rritja e vlerës formale të bruto-produktit vendor ka arritur në rreth 5,4 miliardë euro, kurse bruto të ardhurat kombëtare vlerësohen në 6 miliardë euro. Prodhimi vendor në shumë sektorë të ekonomisë është duke u rritur dhe tash në disa prej tyre Kosova i plotëson tërësisht nevojat e veta. Kjo është bërë edhe duke iu falënderuar politikave favorizuese dhe mbështetjes së kompanive dhe bizneseve të vendit, pastaj edhe të hartimit të legjislacionit, i cili i shoqëron këto politika.

Për këtë arsye edhe eksporti i mallrave, por edhe i shërbimeve është në rritje të vazhdueshme. Edhe pse të gjithë ne do të donim që sasia e eksporteve të jetë më e lartë se kjo ekzistuese, duhet ditur se më e rëndësishmja është trendi i vazhdueshëm i rritjes së

nivelit të eksporteve dhe mallrave dhe shërbimeve. Kjo tregon dhe është dëshmi se bizneset tona kanë arritur që edhe përkundër rrethanave dhe kushteve të vështira, sidomos të konkurrencës së ashpër, të krijojnë produkte, të cilat suksesshëm janë duke zënë vendin në tregjet ndërkombëtare.

Rënia e sasisë së eksporteve, që është shënuar në periudhën e dytë të vitit të kaluar, ka të bëjë me rënien e çmimeve të metaleve në bursat ndërkombëtare, përderisa në të njëjtën kohë eksporti i produkteve tjera ka shënuar një rritje të konsiderueshme.

Është gjithashtu shumë e rëndësishme edhe numri i bizneseve të reja, që regjistrohen çdo ditë e që është 10 herë më i lartë se sa ato që mbyllen. Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, niveli i papunësisë është duke shënuar rënie. Zhvillimi ekonomik i vendit shihet edhe nga aspekti i buxhetit të shtetit, i cili nga viti në vit është duke shënuar një rritje në gjithë kategoritë buxhetore. Mjafton që të analizohet, për shembull trendi i rritjes së pagave, pastaj investimeve kapitale, por edhe i subvencioneve dhe transfereve. Kështu për shembull, buxheti i këtij viti ka arritur në të hyrat me vlerë prej 1,423 miliard euro ose rreth 3% më shumë se i vitit të kaluar dhe kjo në kohën kur shumë vende fqinje dhe të Evropës të ballafaquar me krizën ekonomike, kanë një rënie të hyrave dhe detyrohen të bëjnë shkurtime buxhetore.

Në anën tjetër, kategoria e shpenzimeve buxhetore për këtë vit është 1.586 miliardë euro ose rreth 4% më shumë se vitin e kaluar, duke shënuar rreth 40% investime kapitale për prononcimin e shumë projekteve të rëndësishme të infrastrukturës, të cilat janë duke dhënë efekte të fuqishme në zhvillim ekonomik.

Nëse këto vlera krahasohen me ato vlera më parë, atëherë shihet qartë se në shumë prej tyre ka rritje prej 2 e më shumë herë. Një rritje të tillë brenda një kohe aq të shkurtër nuk është shënuar në asnjë vend dhe kjo tregon për trendin e rritjes ekonomike të vendit. Stabiliteti ekonomik shihet dhe me nivelin e inflacionit, i cili vitin e kaluar ishte 2.5% dhe ky element tregon një parakusht të rëndësishëm për intensifikimin e zhvillimit ekonomik.

Në fund, dëshiroj të përmend se Qeveria ka vendosur si prioritet të lartë zhvillimin ekonomik dhe kjo reflektohet në dokumentet strategjike të ministrive të linjës po dhe të Qeverisë, sikurse janë programi i punës së Qeverisë, plani për zhvillimin ekonomik të Kosovës, korniza afatmesme e shpenzimeve dhe plani i veprimit të partneritetit evropian. Në këto dokumente janë vendosur objektiva të qarta, të cilat kanë për qëllim një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe rritjen e mirëqenies dhe standardit jetësor të qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zonja Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryesues,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra,
Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,
Diskutimi im do të fokusohet tek sektori i bujqësisë.

Bujqësia ka qenë dhe është një ndër degët më të rëndësishme ekonomike. Ajo luan rol të rëndësishëm, sidomos në zbutjen e shkallës së varfërisë dhe papunësisë.

Kosova vazhdon të jetë një importues i madh i produkteve bujqësore edhe pse kemi tokë të mirë dhe klimë të favorshme për kultivimin e këtyre produkteve. Dikur ne plotësonim nevojat tona, të paktën me qumësht dhe mish, tani varemi krejtësisht nga importi. Mungesa e përkrahjes dhe zhvillimit strategjik i sektorit të bujqësisë ka kthyer Kosovën në një importues masiv të ushqimeve elementare.

Statistikat tregojnë se gjatë vitit importojmë mbi 500 milionë produkte bujqësore. Industria ushqimore vazhdon të jetë larg përmbushjes së nevojave të ushqimit me prodhime vendore, sepse shumë degë të industrisë ushqimore punojnë me lëndë të parë të importuar.

Në këtë mënyrë mbështetja për zhvillimin e industrisë ushqimore duhet shikuar si shumë më komplekse, më shumë specifike në krahasim me ndërmarrjet e sektorëve të tjerë. Përgjegjësia e lartë e sigurisë ushqimore për zhvillimin e popullsisë, veçanërisht një siguri e produkteve ushqimore për tregun, do ta vendosnin rolin e Qeverisë në prioritet më të lartë të masave mbështetëse dhe mbrojtëse. Kjo lidhet në radhë të parë me vendosjen në pozita të barabarta në treg dhe në kontrollin e rreptë të çdo produkti që shitet.

Duke siguruar laboratorë të nivelit të lartë dhe modern, në mënyrë që qytetarët të mos konsumojnë miell dhe grurë, siç ishte ai nga Serbia, ku dyshohej të ketë pasur përmbajtje të rritur të metaleve të rënda. Kosova ka importuar nga Serbia hiç më pak se 9 500 tonë grurë gjatë dy muajve të parë të këtij viti. Jemi dëshmitarë të lajmeve të shpeshta në media për cilësinë e ushqimit, posaçërisht për nivelin e kontrollit të cilësisë së ushqimit. Ky është një problem me të cilin Qeveria duhet të merret shumë seriozisht, pasi ka të bëjë direkt me shëndetin e popullsisë, siç patëm rastin me praninë e aflatoksinës në qumësht, ku sipas rezultateve në bazë të analizave përfundimtare nga Laboratori i akredituar në Bashkësinë Evropiane për aflatoksinë, mediet e paraqitën një listë të gjerë të këtij qumështi që shitej në Kosovë.

Mendoj si bazë e mirë për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të industrisë ushqimore në vend janë sidomos projektet me partneritet me sektorin privat. Pastaj, Qeveria do të duhej të ndante buxhetin e veçantë për zhvillimin e zonave rurale, gjë që nuk e ka bërë, sepse pa zhvillim të zonave rurale nuk ka zhvillim të përgjithshëm.

Kjo qasje e Qeverisë ndaj bujqësisë tregon më së miri pse Kosova ka deficit të lartë tregtar, 2,2 miliardë euro.

Sipas raportit të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, indeksi i tërësishëm i çmimeve të konsumit në Kosovë, është më i lartë për 0.1% në muajin shkurt 2013,

krahasuar me muajin janar 2013, derisa shkalla e inflacionit e matur në muajin shkurt 2013, me muajin shkurt 2012, ishte 2,6%, gjë që reflektohet tek shporta e konsumatorit që çdo ditë është më e varfër.

Ngritja e çmimeve në Kosovë ka goditur më së shumti qytetarët, të cilët edhe ashtu e shpenzonin pjesën më të madhe të të ardhurave për ushqim. Qytetarët ankohen se e kanë të vështirë mbijetesën nëse vazhdon një trend i tillë i çmimeve. Ngritja e çmimeve vërehet tek perimet, buka, drithërat, mishi, vajrat dhe yndyrat, furnizimi me rrymë, ujë dhe shërbime të ndryshme që kanë të bëjnë me ekzistencën.

Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se bujqve kosovarë u nevojitet përkrahje më e madhe, në mënyrë që ata të bëhen konkurrentë me bujqit në rajon. Të mundësohen investime madhore në sistemin e ujitjes, i cili do t'i zvogëlonte shpenzimet e bujqve dhe do të rriste produktivitetin.

Të mundësohen kredi të favorshme për bujqit me kamata më të ulëta, pastaj të mbështesë bujqit që po përballen me çmime gjithnjë më të larta të naftës, farërave, plehrave dhe pesticideve bujqësore.

Premtimi, se norma 16% e TVSH-së do të zvogëlohet në 7% për disa artikuj ushqimor, siç janë: buka, drithërat, qumështi, vaji, pastaj produktet farmaceutike, nuk pritët të ndodh.

Qeveria duhet aplikuar gjithashtu një paketë të re ligjore, që do të heqë çdolloj tarife doganore për gjithçka që nevojitet për prodhim bujqësor: makineri, kemikate, çdo lloj tatimi që rëndon direkt apo indirekt mbi fermerët.

Nga këto fakte tregojmë se ekonomia e Kosovës po shndërrohet në një ekonomi konsumuese e varur nga importet, të cilat paguhen kryesisht nga remitancat e emigrantëve.

Në përgjithësi Kosova ka bërë një përparim të kufizuar në bujqësi jo shumë të kënaqshëm dhe duke mos pasur prioritetë të qarta për sektorë të caktuar. Subvencionet më shumë janë kthyer në ndihma sociale, sesa që janë instrument për avancimin e prodhimit bujqësor.

Është shumë e rëndësishme që të analizohet efekti i subvencioneve në bujqësi, pasi që përveç disa numrave fiks nuk kemi ndonjë analizë më detaje për to, bile në politika të Bashkësisë Evropiane, subvencionet janë duke u tërhequr, sepse nuk nxisin zhvillim konkurrues të fermerëve. Pastaj, duhet trajtuar tokën bujqësore, sepse tokat dikur pjellore janë kthyer në zona banimi, ku në vend të zarzavateve po mbijnë shtëpi dhe ndërtesa.

Agjencia e Veterinarisë dhe e Ushqimit e Kosovës ende mbetet në Zyrën e Kryeministrit, që paraqet një anomali të veçantë në organizimin e institucioneve.

Pra, mendojmë që përkundër mundësive që kemi pasur, përparimet në këtë sektor janë tepër të kufizuara, sepse ka hapësirë për të bërë më shumë, sepse bujqësia është sektori kyç në ekonominë e Kosovës, për të absorbuar të papunët dhe për të krijuar efekte multiplikuese ekonomike nga zinxhiri prodhues në prodhimin, përpunimin dhe tregtinë me produktet bujqësore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit shumë, i nderuari kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë dua të falënderoj Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike për një debat të tillë të nxitur, i cili na jep mundësi që edhe një herë para qytetarëve t'i shfletojmë të gjitha sfidat, por njëkohësisht edhe të gjitha të arriturat, të cilat kjo qeverisje i ka bërë në fushën e zhvillimit ekonomik.

Sigurisht se është periudhë e rëndë e krizave financiare në nivel botëror. Kosova nuk është e izoluar nga këto, por është jashtëzakonisht e rëndësishme të thuhet që Kosova në këtë periudhë jo vetëm që ka ruajtur stabilitetin makroekonomik, por ka pasur edhe rritje të bruto produktit vendor. Dhe, kjo rritje është vlerësuar lart nga institucionet financiare ndërkombëtare, siç janë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, gjë që gjatë qëndrimit të tyre, pa hezitim në Republikën e Kosovës e thanë që Kosova, sa i përket stabilitetit e disiplinës financiare, por dhe ruajtjes së orientimeve të veta zhvillimore është model për rajonin.

Sigurisht që nëse u referohemi ligjeve të Republikës së Kosovës do ta shihni që borxhi publik është i kufizuar në 40% nga GDP-ja dhe ky borxh publik nuk është më i madh se sa në mbi 8%, që tregon që realisht është një sistem jashtëzakonisht i balancuar, i cili mundëson që të gjitha projektet zhvillimore të Republikës së Kosovës janë duke u zhvilluar.

Pra, stabiliteti makroekonomik është qendër e politikave ekonomike të Kosovës, por njëkohësisht qendër e këtyre politikave ekonomike të Kosovës është reforma strukturale, krijimi i vendeve të reja të punës, rritja ekonomike dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë janë krijuar politika funksionale, të cilat kanë hapur rrugën njëherë e mirë për qytetarët tonë jo vetëm të përjetojnë rritje të pagave, por të përjetojnë orientim afatgjatë zhvillimor, gjë e cila ka munguar me shumë vite.

Kjo rrugë, ky orientim është treguar shumë qartë në vizionin ekonomik dhe planin e veprimt, i cili në baza mujore komunikohet dhe diskutohet edhe me përfaqësuesit e biznesit, të cilat janë pjesë e Komisionit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe është për herë të parë në shtetin e Kosovës, që një debat i tillë bëhet në mes të bizneseve. Pra, kemi një dialog të plotfuqishëm, jo dialog politik, por dialog ekonomik, i cili na mundëson që prioritetet të cilat vijnë nga ekonomia, të jenë pjesë e politikave, qoftë atyre politikave

ekonomike, qoftë të legjislacionit apo qoftë të orientimeve, të cilat mund të jenë afatmesme.

Këto reforma strukturore në vendet tjera kanë treguar se ndikojnë ekonomikisht në mënyrë pozitive në të gjitha vendet të cilat i kanë implementuar, sepse rrisin rolin e forcave të tregut, rrisin konkurrencën në ekonomi, rrisin liberalizimin e sektorit financiar, liberalizimin e tregtisë, të energjisë, sektorit të telekomunikacionit, bujqësisë e tjerë.

Këto janë zhvillimet të cilat janë duke ndodhur dhe të cilat po reflektojnë në buxhet më të madh, në investime më të mëdha, në zhvillim dhe mirëqenie më të mirë në krijim të vendeve të reja të punës. Sigurisht që u përmenden këtu, në mënyra të ndryshme sektorët, të cilët janë pjesë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe ato në sektori i energjisë, minierave, telekomunikacionit dhe ndërmarrjet publike.

Dua të ju them që sektori i energjisë është i rregulluar tanimë plotësisht me të gjitha legjislacionet adekuate dhe nuk kemi pasur ligje, këto ligje kanë munguar deri më tani dhe ne gjatë vitit të kaluar i kemi harmonizuar të gjitha bazën tonë legjislative me paketën e dytë, e cila kërkohet nga Bashkimi Evropian.

Por, dua t'ju them, që është referuar këtu se qytetarët paguajnë çmim më të shtrenjtë në Evropë për energji elektrike për njësi. Po ju them, që çmimi i energjisë elektrike në Republikën e Kosovës është më i ulëti, jo në Evropë, por në rajon, flasim për çmime të njësisë.

Sigurisht që gjatë javës së kaluar ne kemi pasur edhe një vizitë nga Sekretariati i Energjisë, i cili në mënyrë publike e tha hapur, që planet kohore të cilat i ka bërë Republika e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, janë më të avancuarat në aspektin e harmonizimit edhe me legjislacionin tjetër, që ka të bëjë me politikat e ambientit.

Në vazhden e reformave ne kemi vijuar me përgatitjen për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re. U tha këtu shumë shpesh se kemi dështuar, është dështuar, po ju them që Ministria e Zhvillimit Ekonomik me kompetencën më të plotë, në kuadër të Komisionit i cili merret me ndërtimin e Kosovës së Re, tanimë e ka bërë të gjitha përgatitjet dhe shumë shpejtë do të hapet ftesa për ofertë, ftesë e cila i atribuohet mundësive reale të Republikës së Kosovës.

Normalisht, që kemi pasur planifikime edhe 2 000 megavat edhe 1 000 megavat, por asnjëherë këto planifikime nuk kanë korresponduar me fuqinë dhe obligimin buxhetor, të cilin do ta merrte shteti i Kosovës në këtë këndvështrim.

Pra, është bërë një riformulim, kemi arritur që të kemi të gjitha kompanitë e nivelit ndërkombëtar tani pjesë të këtij procesi dhe mund t'ju them që kjo është në vijim e sipër dhe do të realizohet shpallja e fituesit gjatë këtij viti.

Lidhur me procesin e privatizimit të Distribucionit, me të drejtë apo pa të drejtë shumë herë po citohet duke, ndoshta mos pasur informacionin e duhur, u përmend këtu që janë

shitur asetet, por në asnjë rast nuk u përmend që të gjitha asetet janë për përdorim publik. Asnjë aset nuk është për përdorim privat. Dhe, çdo shitje e këtyre aseteve do t'u kthehet qytetarëve përmes tarifës, të cilën ata do ta përfitojnë në formë të çmimit.

Ju lutem, shikoni dokumentet dhe në bazë të këtyre dokumenteve do ta shihni se kjo është gjendje reale, se nuk është gjendje reale ajo çka ne nganjëherë komunikojmë vetëm në bazë të medieve.

U tha këtu, se IFC-ja si organizatë ndërkombëtare që është përgjegjëse, ka kërkuar dhe ka bërë një koment që nuk është harmonizuar baza ligjore dhe nuk është sipas standardeve. Unë e kisha lutur deputeten, që të ma bien një letër të tillë mua dhe publikut, e cila konfirmon që IFC-ja ka thënë një gjë të tillë. Unë po ju them që IFC-ja ka qenë përgjegjëse për ligjshmërinë dhe këtë e ka konfirmuar edhe me shkrim pas spekulimeve të cilat kanë dalë në media, por nëse deputetja e ka, do të ishte me interes për qytetarët, për anëtarët e Kuvendit, që ta kemi një letër të tillë, të cilën ne për momentin nuk e kemi.

Dhe, çmimet në ekonominë e tregut nuk i përcakton as Qeveria, por i përcakton tregu, Qeveria ka kërkuar investime afatgjate të cilat do të jenë në vlerë prej 300 milionë eurosh dhe të cilat do të vazhdojnë të krijojnë vende të reja të punës dhe një stabilitet shumë më të mirë në furnizimin me energji elektrike.

U përmend linja 400 kilovoltëshe. Dua të ju them që linja 400 kilovoltëshe për Kosovën është akt i kryer, sepse ne i kemi kryer të gjitha procedurat, procedurat kanë mbetur në Republikën e Shqipërisë dhe Republika e Shqipërisë këtyre ditëve pritet t'i përfundojë dhe ne besojmë që gjatë këtij viti. Por, po e them edhe një herë, Kosova ka kërkuar ndarjen, sepse ajo çka neve jemi duke bërë tani është, jo të ndërtojmë linjë 400 kilovoltëshe, por jemi duke bërë përgatitjet për integrimin e tregut energjetik të Republikës së Kosovës me atë të Republikës së Shqipërisë, përmes përgatitjeve ligjore dhe teknike.

Nëse flasim për privatizimin e PTK-së, sigurisht që ne jemi të interesuar për një procedurë jashtëzakonisht të rregullt, procedurë të plotë transparente, e cila ruan dinjitetin e ndërmarrjeve tona dhe ne nuk do të ngutemi në asnjë rrethanë të marrim vendime, të cilat do të na kushtonin, në esencën e asaj që do të kishim oferta më të ulëta.

Qeveria merr për obligim që këtë proces të cilin e ka filluar me transparencën maksimale, me rregullat e nivelit ndërkombëtar, që ta çojë deri në fund dhe ta reformatizojë në formë të plotë një qasje të tillë në fushën e telekomunikacionit, sepse ky treg ka nevojë edhe për liberalizim. Dhe, është hera e parë që kjo Qeveri ka filluar procedurat për vënien e plotë të sistemit të gjeneratës së tretë dhe gjeneratës së katërt të telefonisë.

Pra, ky është një proces i cili është në vijim konform vendimeve, të cilat i ka marrë në Kuvend dhe konform politikave qeveritare.

Dhe, dua t' ju them për fund, që investimet kapitale në ndërmarrjet publike vetëm në dy vjetët e fundit janë 34 milionë euro investime në ndërmarrje publike, të cilat kanë mundësuar qytetarët tanë të kenë shërbime më të mira.

Ndërsa, ne kemi arritur që brenda këtyre vjetëve të kemi mbi 135 milionë euro kontrata afatgjate dhe këtu hyjnë: komuna e Prishtinës me mbi 34 milionë euro për impiantin e ujërave, Prizreni për trajtimin e ujërave të zeza me mbi 22 milionë euro, Gjakova me impiantin për ujëra të zeza mbi 12 milionë euro, rajoni i Kosovës Juglindore për trajtim të ujërave dhe ujëra të pijshëm në zonat rurale, e cila është mbi 8.4 milionë euro nga Qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës.

Këto janë veprime të cilat Qeveria është duke i marrë dhe këto janë veprime, të cilat qytetari i Republikës së Kosovës është duke i përjetuar për çdo ditë, prandaj, unë ju bëj ftesë të gjithë deputetëve, të cilët kanë ide të mira, të cilët kanë interesim jo vetëm për të debatuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zonja Alma Lama.

ALMA LAMA: I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë,

Unë nuk kisha ndonjë pritje tjetër nga ky debat, ku nga njëra anë do të ishin deputetët e opozitës që sjellin fakte të institucioneve kredibile, të cilat thonë vetëm një gjë, që Kosova është një nga vendet më të varfra në botë dhe kjo varfëri sa vjen e thellohet edhe nga ana tjetër do të dëgjonim kryeministrin dhe ministrat e tij, që bëjnë avokatin e varfërisë në një mënyrë propagandistike, që flasin për rritje ekonomike kur vendi është përfshirë nga një krizë e thellë ekonomike.

Por, ajo që nuk prita ishte që kryeministri sot të bënte edhe komedianin për një çështje shumë serioze. Mirë që na kursyen së paku nga përmendja e planit zhvillimor të Banjskos, kur në fillim të këtij mandati shkuan në Bullgari për t'u qetësuar pasi që siguruan kolltukët qeveritarë.

E vërteta është, se kjo qeveri e ka pasuruar vetëm veten, ka rritur luksin qeveritar në mënyrë të shfrenuar dhe ka rrënuar jetën e qytetarëve të thjeshtë. Kryeministri spekulon kur thotë se janë rritur pagat. Në fakt luan me patriotizmin dhe me shtresat me nevoja sociale, sepse çmimet janë dyfishuar.

Faktet që ripërtërihen çdo vit nga CIA, për shembull, të publikuara më 11 shkurt 2013, thonë që Kosova është në vendin e 9-të në botë për nga niveli i varfërisë. Besoj të gjithë e merrni me mend se cilat janë vendet e tjera.

Indeksi i varfërisë është 56,6%, inflacioni 8,3%, ndërsa papunësia 45,3% sipas këtyre të dhënave. Këto janë shifra alarmante të cilat rrëzojnë të gjitha argumentet e kryeministrit dhe të ministrave, apo tani do të thonë se edhe CIA po gënjen.

Natyrish, ne jemi të arsyeshëm, nuk mund ta akuzojmë Qeverinë, sepse Kosova nuk është vendi më i pasur në botë, por ama kemi plotësisht të drejtë të pyesim, se pse jemi gati më të varfrit në botë? Ne dhe gjithë qytetarët e tjerë kemi të drejtë të pyesim se pse këto të ardhura që janë, që ekzistojnë shpërdorohen në mënyrën më të keqe, pse investohen pa vizion dhe pse keni instaluar praktika korruptive?

A e dini zoti kryeministër, se për çdo 1 euro që keqpërdoret në mënyrë korruptive, i kushton shtetit dhe qytetarëve 1.7 euro. Pra, për çdo 1 euro që vidhet qytetarit i merret nga xhepi gati 3 euro.

Por, kryeministri pati të drejtë kur tha se Kosova është në një fazë rritjeje e ajo është faza e rritjes së korrupsionit, jo me 100% po 300% apo 400%. Kjo qeveri nuk ka një ide se si të hartojë politika ekonomike, nuk ka pikë vizioni. Por, për më keq kjo qeveri nuk ka as interes të hartojë politika ekonomike, të cilat do të sillnin zhvillim, kjo për një arsye të thjeshtë, sepse zhvillimi ekonomik për Kosovën është i lidhur me investimet e huaja, e këto janë të lidhura ngushtësisht në sundimin e rendit dhe të ligjit.

Të gjitha studimet tregojnë se korrupsioni në vendin pritës është një pengesë e madhe për investitorët e huaj. Ka plot kompani të huaja që kanë shprehur dëshirën të vijnë dhe të investojnë në Kosovë, por sapo kanë vënë këmbën këtu janë ndeshur me kërkesa korruptive, janë parë dhe janë trajtuar si objekte për t'u zhvatur dhe në raste të tilla, natyrish që ata janë tërhequr.

I tillë është, për shembull, edhe rasti i mihjeve në Obiliq, ku një kompani austriake kishte shfaqur interes për të investuar dhe madje edhe të na shpëtonte nga ndotja e tmerrshme, por dikush ia zuri rrugën dhe e përzuri. Por, kjo sjellje nuk është vetëm me bizneset e huaja, Kosova ka një ambient tërësisht të rrënuar biznesor dhe fenomene me anomali nga më të ndryshmet. Korrupsioni është njëra anomali, konkurrenca e padrejtë është tjetra.

Sipas një raporti të Organizatës Demokraci për Zhvillim, qytetarët në Kosovë paguajnë edhe një taksë të fshehtë e ajo është taksa e korrupsionit. Ka dëshmi që shumë produkte kushtojnë dukshëm më shumë në Kosovë se sa në vendet fqinje. Çmimet më të larta shtrenjojnë koston e jetesës për shumicën e qytetarëve. Si rezultat, indeksi i çmimeve të konsumit është rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë shtatë vjetëve të fundit, që është edhe koha kur kjo qeveri po qeveris.

Fakti që sektorët e ekonomive familjare dhe të bizneseve varen shumë nga importet, vetëm e rrit presionin e çmimeve. Gjetjet tregojnë se ka prani të madhe të joefektshmërisë së tregut dhe praktikave të fryrjeve të çmimeve.

Sektorë të veçantë të tregut janë të dominuar nga kompani private, që kanë krijuar monopole duke ngritura barriera të hyrjes për konkurrentë të rinj. Një shembull tipik është sektori i arkave fiskale, që paraqet dukuri monopoliste dhe në Kosovë bizneset kanë paguar 3-4 herë më shtrenjtë për arkat fiskale në krahasim me vendet e rajonit, apo të mos përmendim këtu shembullin e çimentos, e cila ishte skandal i llojit të vet.

Një ekonomi e tregut me konkurrencë të lirë është një nga dispozitat bazike të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe është njëri nga kriteret kryesore për anëtarësim në BE. Kjo qeveri po e shkel Kushtetutën për çdo ditë, sepse nuk po garanton zhvillimin e një tregu të lirë. Mekanizmat e tanishëm të kontrollit janë joefikas në sigurimin e mbrojtësve të tregut. Këto mekanizma sfidohen në vazhdimësi nga niveli i lartë i kontrabandës, krimit të organizuar dhe mungesa e implementimit të Ligjit të konkurrencës.

Shikoni vetëm këto fakte, në raportin për zhvillimin njerëzor, të përgatitur nga UNDP, thuhet se 34% e të punësuarve sigurojnë vendin e punës përmes lidhjeve familjare. Dhe, e dini ku ndodh kjo, pikërisht në institucionet publike, administratë, Postë, KEK e tjerë.

Kosova nuk mund të prosperojë apo të zhvillohet e zhytur në korrupsion e familjarizim, sepse ky e ngulfat ekonominë e lirë të tregut. Mjedisi nuk mund të krijohet pa zbatimin e ligjeve dhe as pa zhvillimin e mëtejshëm të kornizës së tanishme ligjore, e cila kështu siç është e ekspozon tregun e Kosovës tërësisht ndaj produkteve të rajonit duke ia hequr çdo mundësi prodhuesve vendor që të prosperojnë.

Më herët duke u munduar të na japë mend, ministrja e Tregtisë zonja Kusari përdori këtu metaforën e konsumuar të gotës gjysmë të mbushur. Zonja ministre dhe gjithë Qeveria është mirë ta dimë, se mënyra se si e shikon gotën nuk e ndryshon realitetin brenda gotës. Madje, kur je i etur aq sa jemi ne të varfër, ujin mund ta pish me symbyllur. Ajo që ka rëndësi është se kjo sasi nuk po na e shuan etjen, sepse siç e din ministrja, por dhe të gjithë ministrat dhe siç e dimë të gjithë ne, 30% e popullsisë jetojnë nën kufirin e varfërisë, ndërsa rreth 11% jetojnë në më pak se 2 dollarë në ditë.

Kosova ka një Ministri të Zhvillimit Ekonomik, por nuk kemi kurrfarë zhvillimi ekonomik, madje, nuk kemi as fond zhvillimor. I vetmi fond është fondi për veriun, që vjen si rezultat i negociatave me Daçiqin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zonja Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi të vetëdijshëm se situata ekonomike në Kosovë është mjaft e rëndë me vazhdim të përkeqësimit të mëtejshëm, nga shkak i rrethanave të ndryshme socio-politike, në të cilën gjendet vendi ynë.

Kjo situatë është si pasojë e keq qeverisjes në Kosovë. Këtë situatë të rëndë ekonomike po e përjeton një pjesë e madhe e popullsisë, e cila jeton në kushte të vështira shkak i papunësisë. Pastaj, kategoritë e caktuara në përkujdesje të mbrojtjes sociale nga shteti, ku të ardhurat janë të ulëta e që nuk arrijnë të mbulojnë ekzistencën fizike të familjeve nën minimumin e çdo kushti ekonomik për shportën e tyre jetësore. Pastaj, pensionistët, kategoritë tjera nën mbikëqyrjen e përkujdesjes sociale, ku gjendja e tyre është e keqe.

Papunësia si një problem akut e ka përcjell dhe po e përcjell edhe më shumë rininë kosovare, pa një perspektivë të qartë për t'u punësuar dhe krijuar mirëqenien e tyre.

Është e ditur se për papunësinë flitet me përqindje, 40% e qytetarëve të Kosovës, ndërsa papunësia te të rinjtë arrin deri në 70%, gjendje alarmante. Ne si shtet dhe shoqëri, që po aspirojmë në integritet evropian duhet të përqendrohemi më fuqishëm dhe më seriozisht në zhvillimin ekonomik të vendit në parametrat që janë të pranueshëm edhe në BE, ngase BE-ja nuk do të na pranojë si vend ku ka varfri ekstreme, papunësi të lartë, korrupsion të lartë, moszhvillim ekonomik.

Në mënyrë urgjente duhet të ndërmarrim masa për uljen, evitimin e kësaj gjendjeje të rëndë ekonomike për qytetarët e Kosovës. Nxjerrja dhe zbatimi i Ligjit për investime të huaja, ku investitorët e huaj do të investonin kapitalin në biznesin e tyre në hapjen e vendeve të reja të punës, pastaj që ligji t'u mundësojë që investitorët e huaj të jenë të barabartë me subjektet vendore, ngase siç e dimë, shumë investues shkojnë nga Kosova, për shkak të konkurrencës jolojale.

Qeveria duhet të orientohet në rritjen e bizneseve të vogla, sidomos në fushën e bujqësisë, blegtorisë, zejtarisë e tjera, ku do të stimuloheshin këto biznese me grande qeveritare me një përqindje shumë më të lartë, se deri më tani.

Fondi i mjeteve të grumbulluara i privatizimit të ndërmarrjeve të privatizuara të hyjë në funksion të zhvillimit ekonomik, gjegjësisht krijimit të vendeve të reja të punës, inkurajimi i diasporës kosovare që kapitalin ta investojë në Kosovë në ngritjen e partneritetit publiko- privat.

Qeveria e Kosovës duhet të vijë në kontakt me shtetet evropiane për arritjen e marrëveshjeve për punësimin e përkohshëm në këto shtete, sipas nevojave të tyre.

Luftimi i korrupsionit në çdo nivel e sidomos i atyre dukurive antiligjore e që kanë për qëllim dekurajimin e investitorëve të huaj, të cilët pengohen në aktivitetin e tyre biznesor nga grupe të ndryshme kriminale të interesit dhe në këtë mënyrë e pengojnë zhvillimin dhe aktivitetin e lirë ekonomik në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues,
Të nderuar përfaqësues të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Mendoj se është mirë që po zhvillojmë një debat më gjithëpërfshirës për situatën ekonomike, për arsye se të gjithë e dimë se ekziston një brengë lidhur me ecuritë, lidhur me situatën dhe ndoshta nëse do të dëshironim që të japim një diagnozë shumë përmbledhëse, trendët dhe situatën e tashme, do të mund ta përshkruanim si një vazhdimësi e status-quo-së në situatën ekonomike, në stilin e qeverisjes, por që ka gati dy vjet që kjo status-quo po rrëshqet në përkeqësim. Pra kemi përkeqësim, fatkeqësisht. E kur shihet ky përkeqësim?

Në rend të parë, në rënien e normës së rritjes ekonomike prej rreth 4% në 3,2; 2,7 e tjera, 2,7, sa pritjet sivjet ose 3 diku.

Rënia e rritjes ekonomike në fakt ishte dashur të jetë e pritshme dhe është e shpjegueshme me faktin, se ka edhe probleme në tregun global, por rritja ekonomike vjetëve të fundit është bazuar në një injeksion, që ka rritur pothuajse dyfishimi apo trefishimi i investimeve publike, në sajë të tepricës së akumuluar buxhetore dhe rritjes së buxhetit dhe kjo ka dhënë injeksionin. Investimet prej 200 milionë kanë mbërri në 500-600 milionë dhe më nuk ka hapësirë që të rriten ato investime.

Investimet publike, që ishin gjenerator i rritjes ekonomike e kanë mbërri maksimumin në vitin 2011 dhe 2012, prandaj nëse nuk bëjmë kthesë në nxitjen e investimeve private, ne do të shohim për çdo vjet keqësimin e trendit të rritjes ekonomike deri në uljen e tij me tendencë kah recesioni.

Derisa investimet publike, pra nuk kanë më hapësirë në Buxhetin e Kosovës që të rriten, vjet i kemi pasur 560, sivjet janë 600, domethënë kjo diferencë në vëllimin e investimeve publike nuk mund të rritë GDP-në, as nuk mund të krijojë rritje ekonomike, në krahasim me vitin e kaluar. Trendi më brengosës është rënia e investimeve të sektorit privat edhe te investitorët e jashtëm edhe te investitorët e brendshëm.

Trendi tjetër brengosës është keqësimi i bilancit tregtar, i llogarisë tregtare të Kosovës dhe zvogëlimi i eksportit dhe jo vetëm me përqindje, por edhe në mënyrë absolute. Ajo që duhet ta brengosë Qeverinë e unë për çudi unë nuk po shoh asnjë brengosje për situatën te kjo Qeveri dhe ajo është që më brengos mua më së shumti, nuk është qysh diskutojmë ne, nuk është konfrontimi politik për mua, pse pres, domethënë një konfrontim politik mes opozitës dhe opozitës, por ajo që është për brengosje, është pse unë nuk shoh asnjë dozë të brengosjes te ministrat apo tek përgjegjësit e kësaj Qeverie, te kryeministri për këta trendë dhe për këtë situatë.

Përndryshe, po të kishte një vetëdijesim dhe një brengosje për këtë situatë, ne sot do të thoshim: “po, ka filluar rënia e normës së rritjes ekonomike, ne e dimë, është keq, ne do t’i marrim këto masa për ta tejkaluar.” Po, jo me thënë që gjithçka është mirë, gjithçka po ec mirë, sepse nëse ne nuk vetëdijesohemi se nuk janë mirë disa gjëra, se duhet t’i përmirësojmë, atëherë nuk mund të jemi optimistë.

Dhe, mu për këtë, nëse e bëni një anketë, nëse e bëni një studim me bizneset edhe me familje, ju do të shihni se pritjet e tyre nuk janë se situata po shkon duke u përmirësuar, po situata po shkon duke u keqësuar. Dhe, në çdo qeverisje moderne ekonomike, pritjet e familjeve, konsumatorëve dhe pritjet e investitorëve dhe bizneseve janë sinjali kryesor i një qeverisjeje. Nuk jam i sigurt se kjo qeveri po i merr seriozisht ose bile që është duke i detektuar pritjet, cilat janë pritjet e popullatës dhe cilat janë pritjet e bizneseve dhe cilat janë pritjet e investitorëve?

Prandaj, çështjet janë shumë më serioze se sa një diskurs dhe një diskurs i ashpër opozitar dhe pozitar, i opozitës dhe i pozitës. Ne nuk kemi nevojë edhe ta bëjmë gjendjen më të

keqe se që është, sepse është, domethënë, ka edhe rezultate aty- këtu dhe nuk është mirë tash të dalim e të themi që na jemi në mesin e 9 vendeve më të varfra, e di e kam lexuar edhe unë atë, po ai studim është joserioz. Ka shumë vende në krejt botën, që janë më të varfra se Kosova, sa që por, prapë s'mund të jemi të lumtur ku jemi, sepse Kosova nuk mund të jetë në mesin e vendeve më të varfra të botës, aty, por trendi nuk është i mirë. Vetëdija për këtë trend është shumë problematike për mua, në mesin e Qeverisë, duke filluar prej kryeministrit e deri te të gjithë ministrat.

Nuk mund ta bëjmë verë punën këtu dhe ta zhvillojmë për një çështje shumë serioze të zhvillojmë një diskurs shumë të thjeshtë, po pret me opozitën ose me një komunë të caktuar e tjera, e tjera. Ne duhet të krijojmë një qasje shumë më serioze.

Punësimi. Ne nuk e dimë kah po shkon punësimi, nuk kemi të dhëna. Qeveria, as Statistika, as BQK, as institucionet financiare nuk e përcjellin punësimin, nuk e dinë sa vende të reja të punës, edhe njëherë e kam thënë, dhe s'ka ndryshim, s'ka brengosje për këtë punë. Prandaj, nëse i kemi këto trende, atëherë qeverisja makroekonomike dhe qeverisja zhvillimore është në krizë, është problematike dhe sa më herët që kjo qeveri bëhet e vetëdijshme për këtë, do të jetë më mirë për Kosovën, më mirë për të gjithë neve.

Ku janë këto probleme me qeverisjen makroekonomike dhe qeverisjen e zhvillimit të Kosovës?

Nën 1, është mënyra e marrjes së vendimeve, mënyra e përcaktimit të prioritetëve, kualiteti dhe cilësia e informacionit, kualiteti dhe cilësia e statistikave. Ne shumë herë kemi folur a kemi strategji apo s'kemi strategji. Ne i kemi bërë disa strategji shpejtë e shpejtë edhe është fakt që nuk e kemi një dokument konsistent dhe është mirë për ta bërë atë dokument. Ne marrim vendime për investime qindra milionëshe pa studime fizibiliteti. Kjo është për brengosje, ju lutem.

E dyta, ku shihet prapë që s'po mbërrijmë, ne kemi një kapital të madh të imobilizuar, ndoshta 1/3-ën e GDP-së e kemi të imobilizuar, nuk prodhon efekte ekonomike. Dihet fondi i privatizimit e të tjera, nuk po e përsëris, por ne e çekim këtë me vite dhe asnjë ndryshim pozitiv nuk është bërë. Megjithëse, është e mundur, janë dhënë propozimet, janë dhënë sugjerimet, edhe ishte dashur të përmirësohet situata këtu.

Dobësia në qeverisjen është edhe te politika tregtare. Ju shihni çfarë zigzagesh kemi në tregti, çfarë incidentesh na ndodhin me vendet fqinje, çfarë incidentesh na ndodhin me tregtinë tonë. Ne s'mundemi as me Shqipërinë t' i rregullojmë këto marrëdhënie, njëherë na del çimento, të dytën herë na dalin patatet, të tretën herë del qumështi, të katërtën herë del mielli edhe s'jemi në gjendje për t' i paraparë këto gjëra e për t' i tejkaluar. Kush pret sot, presin 100, sa kamionë presin atje në kufi?

Dhe, ne jemi, jemi shumë mirë që e kemi përmirësuar indeksin doing business e kemi përmirësuar, i kemi bërë do ligje, shumë mirë që janë bërë, duhet për t' i mbështetur, po nëse i pyetni bizneset: a e keni situatën më mirë sivjet, ato do t'u thonë: Jo. Jo, edhe investimet kanë rënë.

Prandaj, ne duhet t'i mbështesim ato që i ka marrë Ministria e Tregtisë që t'i thjeshtësojë disa sende, por nuk mund të jemi të kënaqur, në qoftë se pritjet e bizneseve dhe disponimi i bizneseve është në nivel të ulët. Prandaj, politika tregtare, çka po ndodh, pse, në çimento, ose në miell, ose në qumësht, ose në patate, në politikat tona dhe në aktet e Qeverisë duket se ndikojnë grupet e interesit, qarqet biznesore, sepse nuk mund të shpjegohen ndryshe këto.

Politika tatimore, sigurisht ka pasur disa tentime, janë bërë disa përmirësime, por kanë mbetur fragmentare. Nuk kemi një sistem të harmonizuar në zbatim. Këtu duhet shkuar edhe më tutje në përmirësim.

Prandaj, mendoj se do të kishim një produkt nga ky debat, në qoftë se Qeveria na thotë: janë këto probleme dhe janë këto probleme, por ne mendojmë t'i ndreqim në këtë mënyrë, ne kërkojmë prej Qeverisë një kurs të tillë.

Dhe, në bazë të kësaj, ajo që është esenciale, pra se po të dëgjojmë ne sot qysh foli ministri këtu dhe qysh foli kryeministri, atëherë ishte dashur për ta thirrur edhe Merkelin edhe Obamën, me ju thënë: "hajde këqyr çka është qeverisja e mirë, ti këtu." Po, në qoftë se e dëgjoni edhe njërin edhe tjetrin kur del në Parlament të vetin, ai thotë "kemi këto probleme, kemi këto tendenca negative, ne po punojmë në këtë mënyrë..."

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa. Fjalën e ka zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

Zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Këtu u diskutua shumë sot që Kosova është një ndër vendet më të varfra në botë. Mirë që pak më përpara profesori e theksoi, dhe më erdhi mirë që s'ishte pajtuar me ato statistika që janë nxjerrë, sepse faktikisht Kosova nuk është në mesin e atyre vendeve, me atë varfri çfarë e kanë ato. Mirëpo, mua pak po më befasojnë subjektet politike, të cilat kanë qeverisur me vite Kosovën dhe unë ju kisha bërë pyetje, në cilin vend ka qenë Kosova kur kanë qenë këta duke qeverisur?

Ne do të donim të ishim ndoshta sikur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të donim të ishim sikur Gjermania, por nuk duhet ta harrojmë faktin se prej ku jemi nisur, ku kemi filluar dhe nuk duhet të harrohet nga deputetët, se në çfarë gjendje ka qenë ekonomia e Kosovës, kur kemi filluar me qeverisjen tonë dhe çfarë gjendje ka qenë ekonomia e Kosovës në vitin 2008, kur është marrë pushteti nga një qeverisje tjetër.

Ne mund të themi se gjendja ekonomike po shkon gjithnjë duke u shkatërruar, gjithnjë duke u përkeqësuar, siç u tha këtu, mirëpo nëse dalim dhe e bëjmë një hulumtim tek qytetarët, ata nuk e kanë të njëjtin opinion, sepse të arriturat të cilat kanë ndodhur në këtë qeverisje janë të prekshme për qytetarin dhe ata e pranojnë se ka të arritura. Prandaj, do të

kisha dashur shumë që të arriturat të mos shikohen me skepticizëm, por nuk duhet të heshtet edhe për mundësitë për t'u shtuar këto të arritura.

Republika e Kosovës ka ecur me hapa të shpejtuar drejt progresit duke ngritur dhe konsoliduar institucionet demokratike, që kanë iniciuar e po iniciojnë një numër reformash të zhvillimit ekonomik, të luftës kundër varfërisë dhe po zbatojnë masa për integrim euro-atlantik.

Në Kosovë janë bërë hapa progresivë në aspektin ekonomik, financiar por edhe social. E them këtë sepse është arritur të rruhet stabiliteti makroekonomik si një garanci për një zhvillim të qëndrueshëm në vitet në vazhdim. Rritja ekonomike, përkatësisht bruto-produkti vendor gjatë viteve të kaluara në Kosovë, vazhdimisht ka qenë më e lartë krahasuar me vendet tjera në rajon dhe më gjerë, duke arritur 4-5% në baza vjetore. Në vitin 2012 rritja reale e bruto-produktit vendor është 3.9%, kurse niveli i inflacionit 2.5% dhe në këtë mënyrë Kosova ishte ndër vendet e pakta ku rritja ekonomike ishte më e lartë se ajo e çmimeve.

Vitin e kaluar rritja e investimeve ishte në nivelin prej 5,9 për qind, kurse rritja e konsumit në nivelin 2%. Rritja ekonomike pavarësisht nga baza krahasuese e kësaj rritjeje dhe kriza globale, ajo përbën një tregues pozitiv dhe premtues. Është punuar intensivisht për përmirësimin e infrastrukturës në përgjithësi, duke ngritur këtu shpenzimet për investime kapitale nga 155 milionë, që kanë qenë në vitin 2007, në 550 milionë në vitin 2012. Investimet kapitale kanë qenë investime, të cilat janë të prekshme për qytetarin, sepse kanë qenë investime në infrastrukturë, në shëndetësi, në bujqësi dhe në sektorët, ku kanë përfituar qytetarët.

Këto investime, si dhe ato në përgjithësi janë duke i zvogëluar efektet negative të krizës në euro-zonë. Janë bërë politika të matura të shpenzimeve, duke pasur qëllim primar ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale dhe njëkohësisht duke mos e ngarkuar biznesin me tatime të larta. Pavarësisht se këtu diskutohet në frymë pesimiste, duhet të theksohet realiteti, se që nga viti 2008 buxheti ka filluar të reflektojë në zhvillimin ekonomik.

Po ashtu, edhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve nga viti në vit ka trend të rritjes, gjë kjo që tregon për zhvillimin e sektorit të prodhimit të shërbimeve tjera. Janë aplikuar politika të reja fiskale që kanë qenë kërkesë e vazhdueshme për t'u krijuar lehtësi investitorëve të brendshëm e të jashtëm, e që përmbledhen në pakon e ligjeve të reja me reforma në Administratën Tatimore, që reflektojnë në ndërtimin e një administrate efikase fiskale. Është ulur tatimi në fitim i korporatave, por edhe norma e tatimit në të ardhura.

Është e rëndësishme të përmendim, që nga viti në vit ka pas rritje të të hyrave. Në vitin e kaluar kishte rritje të të hyrave buxhetore pa ndryshim të normave tatimore. Mbi 90% e të hyrave buxhetore, që grumbullohen nga Administrata Tatimore dhe nga Dogana, bëhen në bazë të deklaratimit vullnetar. Kosova edhe më tutje vazhdon të jetë në mesin e shteteve me ngarkesa më të ulëta tatimore, nëse shikohen në raport me bruto-produktin vendor. Të hyrat në raport me bruto-produktin vendor janë 27.8%, rritja e të hyrave buxhetore ka

ardhur duke u rritur nga viti në vit, kështu që nëse shikojmë, se u dhanë këtu edhe statistika të ndryshme, në vitin 2007 kanë qenë të hyrat 898 milionë, kurse në vitin 2012 janë 1 miliardë e 538 milionë euro, çka do të thotë se ka pas mbi 60% rritje të të hyrave.

Përkundër faktit, se normat e interesit janë relativisht të larta, kreditë kanë vazhduar të rriten edhe sot raporti i kredive ndaj depozitave sillet rreth 80%, ndërkaq që numri i kredive joperformuese është më i ulëti krahasuar me vendet e rajonit. Rritja e kreditimit të ekonomisë është shenjë se në vitet në vijim sektori bankar do të jetë financuesi i investimeve të reja, qoftë atyre që vijnë nga investitorët vendor, ashtu edhe nga ata të jashtëm.

Nuk duhet të neglizhohet apo të mos theksohet edhe raportet, që i ka ruajtur Kosova me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ka kaluar nga programi monitorues nga stafi, në programin stand-by. Realizimi i suksesshëm deri më tash i tri rishikimeve të programit stand-by, në kuadër të vlerësimit pozitiv të gjendjes makroekonomike dhe fiskale, ka bërë që deri më tash të disbursohen rreth 69 milionë euro nga programi stand by i Fondit Monetar në Buxhet.

Si rezultat i plotësimit të kriterëve të marrëveshjes në vitin 2013, marrëveshja është paraparë të kalojë në statusin e kujdesit paraprak. Pranimi i mbështetjes financiare buxhetore në vlerë prej 37 milionë euro nga Banka Botërore për programet e punësimit të qëndrueshëm nuk duhet të nënvlerësohet. Për herë të parë është hartuar strategjia e partneritetit të Bankës Botërore me Kosovën në periudhën 4-vjeçare, kurse vazhdon edhe më tutje implementimi i 8 projekteve të Bankës Botërore, të cilat sjellin rezultate në Kosovë.

Po ashtu, anëtarësimi në Bankën Evropiane për Zhvillim, marrëveshjet e shumta financiare ndërkombëtare, marrëveshjet për eliminimin e tatimit të dyfishtë, janë çështje të cilat duhet të vlerësohen në aspektin ekonomik në Kosovë, siç duhet vlerësuar edhe deficitin, i cili në sajë të udhëheqjes së politikave makrofiskale dhe disiplinës financiare, gjatë 3 vjetëve të fundit ka qenë më i ulëti krahasuar me vendet e rajonit dhe mesatarisht ishte në nivelin prej rreth 1,8%. Borxhi publik te vendi është më i ulëti krahasuar me vendet tjera në regjion, por edhe më gjerë. Ai aktualisht është 7.8% të bruto-produktit vendor.

Janë bërë po ashtu, ndryshime të mëdha sa i përket normave apo politikave fiskale. Unë dua t'i përmend vetëm disa të arritura në këtë drejtim.

- Normat e interesit në Administratën Tatimore të Kosovës janë aplikuar norma të reja, që kanë reflektuar në uljen e normës së interesit për pagesat e vonuara tatimore të biznesit;
- Rritja e normës së interesit në rimbursimet e vonuara nga Administrata Tatimore e Kosovës;
- Rritja e normës së interesit në pagesat e tatimit, të kontestuara nga Administrata Tatimore e Kosovës;
- Ndryshimet e mënyrës së pagesës së akcizës në duhan dhe në produktet e duhanit;

- Është bërë zvogëlimi i numrit të dokumenteve të nevojshme për procedura doganore në import dhe eksport të mallrave nga 9 në 3 dokumente;
- Riorganizimi i Bordit për rishqyrtimin e ankesave në Divizionin fiskal në kuadër të sistemit gjyqësor;
- Tatimi në akcizat në lojërat e fatit, domethënë për herë të parë është rregulluar kjo çështje vitin e kaluar;
- Ndryshimi i plotësimit të Kodit doganor dhe akcizave, ku ndër të tjera rregullohet zgjedhje e kontesteve në mes të tatimpaguesve dhe Doganës në mënyrë alternative; si dhe është bërë
- Ulja e kundërvajtjeve doganore nga 5000 në 500 euro;
- Është bërë lirimi i medieve nga TVSH-ja;
- Lirimi i bartësve privatë të arsimit të lartë nga TVSH-ja;
- Është bërë lirimi i shërbimeve spitalore dhe kujdesit mjekësor nga TVSH-ja; dhe
- Është vazhduar periudha e lirimeve nga TVSH-ja të imputeve të ndryshme në sektorin e bujqësisë.

Siç e dini, të nderuar deputetë, ne i kemi në përfundim e sipër edhe dy ligje, të cilat janë në Kuvend dhe së shpejti do të dalin në miratim, në shqyrtim të dytë, është Projektligji për tarifën e veçanta të akcizës së prodhimit fillestar dhe prodhimin e produkteve alkoolike dhe Ligji për lirin nga tatimi doganor në mallrat me tatim doganor zero, që do të ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Mendoj se debatet e tilla janë të shëndetshme për Kosovën dhe Qeverinë e saj. Qasja se çfarë i bëri kryeministri, mua ma rriti brengën. Nuk zgjidhen problemet duke e kthyer akuzën në kundër akuzë, duke e bartur problemin nga problemi i përgjithshëm, e kemi temë diskutimi Kosovën, veçohemi tani në një komunë.

Nëse mendon se në atë mënyrë e ka arsyetuar, mendoj se para publikut i ka rënë edhe më keq. Do të kishte qenë shumë e shëndetshme, që ai t'i dëgjojë, sepse ne dimë të bëjmë ndryshim të performancës brenda Qeverisë nëpër sektorë dhe atij do t'i shërbenin shumë mirë ato, që në të ardhmen të reflektojnë në aspektin pozitiv. Më vjen keq që ai nuk e shfrytëzoi këtë rast dhe rastet tjera.

Unë kam shkruar shumëçka, por është shumë çka dhe do ta shkurtoj diskutimin tim. Më nxiti kolegja kur numëroi një varg procesesh pozitive, që ka marrë që t'i lehtësojnë proceset biznesore, por nuk u ndal në çështjet thelbësore - dështimi i arkave fiskale. Është dështim shumë i rëndë, dështim që Kosovës i kushton dhe ajo bëhet vetëm për disa grupe shumë të vogla të interesit. Nuk u ndal në parashkrimin e obligimeve tatimore ndaj obliguesve. Si ka ndodhur, cila është shumica dhe cilat janë ato që kanë dëmtuar buxhetin?

Nëse bëjmë krahasime të tilla për ta mbuluar, të tregojmë një performansë, atëherë unë ju preferoj, shkoni në vitin 2000 dhe e merrni, se buxheti ka qenë vetëm 200 milionë dhe bëni krahasime. A është në ndonjë interes ai?

Pastaj, nëse mendoni se do të amortizoni kuptimin e asaj që të reflektohet në debate për të hedhur në sipërfaqe çështjet që të jenë më mirë me krahasime, atëherë duhet ta merrni para pavarësisë dhe pas pavarësisë.

Të mos harrojmë, se në periudhën para pavarësisë ke pasur Këshillin Ekonomik Fiskal, të cilit i ke raportuar. Unë si ministër betimin e kam bërë para Shajnerit, jo para Kuvendit. Mos të harrojmë ato mekanizma, prandaj, krahasimet duhet t'i bëjmë, epërsitë tona, sukseset tona, dështimet tona duhet t'i krahasojmë brenda periudhës së pavarësimit.

Unë jam ndalur vetëm në disa fusha, ose përciptazi do t'i them vetëm disa fusha, në të cilat mendoj se ka nevojë për një reflektim, për një qasje tjetër. Po ndalem te ndërmarrjet publike. Janë 11 sosh, vetëm 4 operojnë me bilanc pozitiv. Fatkeqësisht, krahasuar me vitin 2010 dividenda e tyre është më e vogël, 15 të tjera janë me humbje. Po e marr jo rastësisht, sepse këtu ndikimi i Qeverisë është i drejtpërdrejtë dhe me në 15 sish, sipas raporteve të auditorit, asnjë mbledhje vjetore e aksionarëve, ku Qeveria e ka rolin e vet në kuptimin e dëgjimit të problemeve që ndodhin nëpër organizata të caktuara, të bëjë politika reforma në politika dhe të kërkojë monitorimin dhe zbatimin e tyre. Asnjë mbledhje nuk e ka mbajtur. Ligji e obligon ta mbajë. Mos ta harrojmë këtë punë

Jam ndalur te procesi i prokurimit. Po dëgjoj se edhe sot ka pasur një debat atje rreth ndryshimit të Ligjit të prokurimit. Mendimi im është që ligji është i shkëlqyeshëm, por sa po zbatohet ai dhe si po zbatohet dhe pse nuk po zbatohet ai? Po ju përkujtoj, se kemi tri mekanizma që e rregullojnë këtë sferë të prokurimit,

1. Zyra e Prokurimit në secilën organizatë buxhetore;
2. Agjencia e Prokurimit Publik;
3. Komisioni Rregullativ dhe
4. OSHP.

Janë tre mekanizma, që duhet të mbërrijnë deri te i katërti të OSHP-ja. Dhe, unë tash po i referohem, në tekstin pak më vonë do të shihni se sa kanë lëshuar këto dy autoritete, gjegjësisht tri autoritete lëshime, që japin elemente korruptive të drejtpërdrejta. Bazuar në raportin vjetor të punës së OSHP-së dorëzuar në Kuvend, për aktivitetet vjetore të punës së këtij organi, del se gjatë vitit 2011 ka pasur gjithsej 419 ankesa. E unë jam i bindur, sipas të gjitha përvojave që kemi, ky është 1/3-ta e të gjitha ankesave, sepse të tjerët kanë hezitur, janë shantazhuar, janë zhvatur, iu është premtuar dhe ata janë tërhequr dhe s'ka pasur ankesa. Por, unë po ndalem te numri i ankesave, të cilat faktikisht kanë mbërritur në OSHP. Këto janë nga organizatat kontraktuese, të cilat kanë kundërshtuar vendimin e autoriteteve kontraktuese për dhënien e kontratës. Nga 419 ankesa, 386 ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomik, kundër vendimit të autoriteteve kontraktuese për dhënien e kontratës, 30 janë të autoritetit kontraktues për shqyrtimin e vendimit të APP-së.

Tri janë për KRPP-në, shtrohet përgjegjësia e këtyre institucioneve pra, këtu është korrupsion nëse dom dhe hulumtojmë, janë tejkalua 3-4 mekanizma dhe fund del atje që kemi diçka tjetër.

Në 190 raste janë aprovuar vendimet e autoriteteve kontraktuese si të bazuara. Në 106 raste penali shqyrtues ka marrë vendim për rivlerësim të ofertave, ndërsa 71 raste ka marrë vendim për anulim të kontratave të prokurimit, 8 janë tërhequr, arsyet nuk i di pse, mund të jenë edhe kërcënimet edhe favorizimet për proceset e ardhshme.

Edhe një çështje tjetër që më ka brengosur është mungesa e vizionit të Qeverisë për vizionin. Çfarë vizioni ju lutem, nëse vetëm gjatë vitit 2011 nga 56 raporte ku shikojmë investimet kapitale na del se 90% të investimeve kapitale janë pa planifikim buxheti, ju lutem, pa zotim mjeteve hyhet në procese kontraktuese, ku është vizioni. 90% po them nëse i heqim 7 kontrata të Ministrisë së Infrastrukturës në mesin e tyre e Behtel&Enka do të thotë marrë shumë e përgjithshme del 90% janë investime pa planifikim, po ky është kundërshtim, ku është ligji, ku është prokuroria, kjo është shkelur me të gjitha normat, këto shënime unë po i referohem Zyrës së Auditorit që janë diskutua një për një dhe thashë ne dimë të bëjmë ndryshim dhe vlerësim individual sektorial. Prandaj, çdo njeri kthehuni sektorit të juaj dhe do ta gjeni veten sa jeni e sa nuk jeni. Unë nuk e jap vlerësimin e përgjithësuar për Qeverinë, por po flas për raste konkrete që janë prezantuar. Prandaj, shifrat janë tepër të sakta dhe nuk mund të kontestohen.

Një çështje tjetër që më ka brengos akomodimi i institucioneve qeveritare. Ne kemi pas diskutuar edhe në vitin 2002 dhe kemi pas gjetur gjithçka. Tani në një analizë që e kem marrë nga Ministria e Shërbimeve Publike na del se Kosova paguan mbi 10 milionë euro në vit për qira, ka ndarë 78 milionë investime për akomodim të Qeverisë dhe brenda viteve janë rialokuar, domethënë formalisht i kanë qitur dhe vazhdojnë përsëri me hapësira që ia marrin që as nuk janë funksionale dhe i kushtojnë Qeverisë, domethënë asnjëherë nuk është bërë një analizë tjetër.

Një çështje tjetër që është shumë brengosëse është E sistemi, trajtimi i pasurisë. Ne në Kosovë i kemi dy modele, e kemi friballancin që e kem pas marrë në fillim si donacion prej Kanadës dhe mandej ka fillua me modula e tjera e tjera dhe e kem sistemin pas pavarësisë ku Ministria e Shërbimeve Publike e nxjerr E sistemin me do module për ta korrigjuar të parin. Ç'është e vërtetë i fut dy elemente që ai i kishte në lëshim që bënte regjistrimin nën vlerë 1000 euro dhe bënte edhe regjistrimin material, por nuk e ka të ngërthyer vetvete shkallën e zhvlerësimit të automjeteve dhe këto dy sisteme funksionojnë të ndara, nëse për të njëjtën çështje i njëjti individ bazuar në sisteme del me dy raporte të kundërta.

Sot Qeveria nuk e dinë çka ka në dy depo që i ka më të mëdha, janë shuma të mëdha mund të na duken qesharake për dike. Po e shoh se Besim Beqaj po qesh, le të qesh, por realisht këtu kur ja kemi tërhequr vërejtjen në Komision tash po i dalin në rrugë e tjera e tjera, megjithëse këto janë thënë një vit përpara.

Ka depo në objektin e “Rilindjes” edhe ka në Graçanicë, as nuk e di çka ka në to, jo vetëm shumë po as llojet e tyre. Aty ka material si....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë përmbyle diskutimin. Regjia, edhe një minutë zotit Sadriu.

ALI SADRIU: Po i referohem shënimeve të cilat i kemi marrë prej Ministrisë të Shërbimeve Publike. Ka bërë një lloj regjistrimi, por nuk ka, është në fazë të regjistrimit që ne mendojmë si Komision ta shtyjme edhe më tutje, por ajo çka mua më brengos, aty ka material të vitit 2000 dhe ato janë shuma të mëdha, janë kapacitete të Ministrisë. Qeveria nuk e di sa automobila ka, sa material ka, cila është pasuria e tij dhe kjo është e dhimbshme, sepse e le objekt manipulimi, keqpërdorimi e tjera, e tjera. Do të thotë keni shumëçka për të korrigjuar, mos u barikadoni në mbrojtje por urdhëroni çdonjëri pastroni shtëpinë e juaj dhe si shtëpi do të dalim më e pastër dhe më në rregull, e jo barrikadime çfarë unë sot i pashë aty duke e hedhur problemin prej niveli të përgjithshëm shumë të argumentuar me një problem tjetër.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Qeveria e Kosovës duket që zhvillimin ekonomik të Kosovës e paramendon vetëm me krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme e që sipas tyre krijojnë vende të reja të punës.

Dikasteret përkatëse në mënyrë specifike ajo e Tregtisë dhe Industrisë kanë paraqitur dokumente prej më të ndryshmeve ku radhisin qëllimet e tyre strategjike e të cilat në plotëni vazhdojnë me përqendrimin në krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme duke përfunduar kështu në një lloj strukture ekonomike e cila është komplet e fokusuar te ndërmarrjet e vogla.

Pra, në krijimin e një ekonomike në të cilën vendet e reja të punës krijohen nga ndërmarrjet e reja të vogla dhe të mesme, një ekonomi ku këto ndërmarrje do të konkurronin me ndërmarrjet e rajonit dhe Evropës, ndërmarrje të cilat janë asgjë më pak se industri të etabluara e që kanë produktivitet të lartë.

Qeveria me anë të dokumenteve që prezanton, na tregon që 98% e bizneseve në Kosovë janë mikro, pra kanë më pakë se 10 punëtorë, ndërsa 1,4% janë biznese të vogla me më pak se 49 punëtorë, derisa të mëdha janë 0,06% e bizneseve apo ato që kanë mbi 250 punëtorë.

Për më shumë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë, kryesisht janë të përqendruara në tregti me pakicë rreth 50%, transport, deponim dhe distribucion 14%, produkte ushqimore, pije dhe duhan 9% si dhe hotele dhe restorante gjithashtu 9%.

Pra, nëse 99% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme kjo i bie që e tërë ekonomia është strukturuar rreth bizneseve që janë të kufizuara dhe rrjedhimisht nuk e kanë produktivitetin e kompanive rajonale apo evropiane me të cilat do të duhej të konkurronin.

Duke mos qenë konkurrentë të njëjtat nuk rriten dhe rrjedhimisht edhe nuk mund të punësojnë. Pra, ekonomi e strukturuar rreth ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, shërbyesit që nuk janë produktive sa konkurrentët e tyre e që për pasojë nuk rriten dhe nuk punësojnë.

Për fat të keq strategjia e Qeverisë sheh zhvillimin ekonomik dhe zvogëlimin e papunësisë duke rritur numrin e këtyre ndërmarrjeve e jo në politika që mundësojnë rritjen e ndërmarrjeve ekzistuese. Pra, në vend të rritjes kualitative dhe me produktivitet këta duan të rrisin numrin e ndërmarrjeve si mënyrë për të zvogëluar punësimin. Pra, as nuk mendojnë në zhvillimin e industrive të ndryshme rrjedhimisht duke ndryshuar proporcionin së paku për të siguruar punësim nëse jo zvogëlimin e deficitit tregtar.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë edhe pse përbëjnë mbi 99% të ndërmarrjeve, totali i qarkullimit të tyre në vitin 2010 ishte rreth 32% e bruto produktit vendor, derisa bizneset e mëdha edhe pse janë vetëm 0,6% kishin pjesëmarrje me 13,5% në bruto produktin vendor.

Edhe vendet evropiane që kanë strukturë të ngjashme ekonomike me Kosovën, pra kur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë numrin dhe përqindjen më të madhe të ndërmarrjeve, kanë produktivitet më të vogël. Rrjedhimisht edhe janë më konkurrencte.

Statistikat evropiane tregojnë se prodhuesit në Evropë që kanë 250 apo më shumë punëtorë janë 30 deri 40% më produktiv se bizneset me më pak se 10 të punësuar.

Këtë lloj të ndërmarrjeve në shumicë i gjeni në Kosovë apo në Greqi ose Portugali, por nuk mund t'i gjejmë dot në Gjermani, Francë apo edhe në Irlandë.

Derisa kemi biznese që nuk rriten, kemi kufizime në produktivitet, rrjedhimisht jemi më pak konkurrent se të tjerët që kanë industri në sektorët që Kosova eventualisht do të mund të konkurronte.

Për më tepër derisa Kosova nuk ka asnjë lloj rrjeti për mbrojtje sociale, pra për sigurime shëndetësore, pensionale apo edhe sigurime shoqërore, do të kemi punëtorë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që mund të kenë ide shumë gjeniale, por që janë të varur nga paga, pra janë të varur nga paga që ja u jep pronari i biznesit. Dhe, rrjedhimisht kanë edhe kufizime të patejkalueshme në marrjen e rrezikut i cili është i asociuar në formimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Me këso strukture ekonomike që është duke vazhduar që nga përfundimi i luftës sigurohet vetëm mirëmbajtje të themi ashtu edhe deficitit tregtar i papunësisë, derisa rritja ekonomike ndërlidhet me numër të ndërmarrjeve e jo me rritje apo madhësi të këtyre ndërmarrjeve.

Pra, që nga pas lufta proporcioni ka mbet i njëjtë mbi 98% e ndërmarrjeve janë të vogla edhe për pasojë kemi mbi 45% që është e papunë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Meqë u tha mjaftë unë do të shkoj në mënyrë kronologjike sa për të bërë një konstatim në fillim.

Pra, vetë mungesa dhe rënia e investimeve, pra mungesa e parasë së freskët që do të gjeneronte zhvillim, rritja e importit në raport të eksportit apo stagnimit të themi rastit më të mirë që është 80 me 20, zhvlerësimi i ndërmarrjeve publike ose në rastin konkret të “Trepçës” ku edhe sot e kësaj dite pas shumë viteve nuk i hiqet litari prej qafës, pra një ndërmarrje kaq të rëndësishme që për një periudhë 3 deri 5 vjeçare do të kishte mund të krijojë mbi 1000 vende të punës, pastaj kamatat e larta dhe mungesa e një banke për zhvillim që do të stimulonte ndërmarrësit edhe sektorët që do të kishim mund të gjenerojnë zhvillim, informaliteti i lartë në ekonominë tonë si dhe shpenzimi mbi 400 milionë të rezervave shtetërore dhe mbi të gjitha që shumë pak e theksojmë, shpenzimi mbi 800 milionë euro nga Konferenca e Donatorëve që ndodh një herë por nuk ndodhë çdo ditë, vërtet të ven deri të një pikëpyetje se cilat janë rezultatet e gjithë kësaj.

Ne kemi ngecje në zhvillimin ekonomik dhe ajo rritje e kalkuluar prej më pak se 3% e prek një numër shumë të vogël të institucioneve dhe qytetarëve dhe mund të konstatojmë se kjo rritje fare nuk e prek qytetarin. Qytetarët janë zhytur dhe rritja e varfërisë është e përditshme, rritja e papunësisë po ashtu, ndërsa qytetarët kanë blerë pak qetësi për një kohë të shkurtër duke u zhytur nëpër kredi, dhe po të marrim të nxjerrim mesataren e cila është afër dy kredi për ekonomi familjare, tregon se cila është gjendja. Dhe unë besoj se të gjithë po pajtohem se kemi një gjendje të rëndë në ekonominë e Kosovës.

Prandaj, në këtë rast unë mendoj se duhet të kemi dy qasje.

E para, Qeveria duhet të dalë me një program të menaxhimit më të mirë të fondeve publike si dhe programin e kursimeve ngase unë mendoj dhe mund të provohet në çdo kohë se kemi një shërbim tepër të shtrenjtë për buxhetin që e kanë qytetarët tanë, pra me një administratë shumë të madhe, si dhe

Qasja e dytë duhet të jetë rritja e zhvillimit ekonomik duke eliminuar faktorët që thamë më herët duke i identifikuar se cilat janë resurset dhe cilat janë prioritetet në të cilat shoqëria kosovare duhet të ketë një orientim.

Dhe, ky debat unë mendoj që nuk duhet shikohet nga një anë se kush e ka iniciuar apo kush duhet të japë përgjigje, ky është një debat ku të gjithë në rend të parë Qeveria, po edhe gjithë deputetët duhet të dhënë kontributin e tyre ngase qytetarëve ju intereson cili është rezultati përfundimtar pozitiv apo negativ. Unë i mirëpres të gjitha iniciativat se cilat janë idetë e mira që kishim mund t'i kontribuojnë kësaj fushe.

Disa prej atyre janë të cekura edhe në përfundimet që propozohen nga zonja Bajrami, por pse jo për një afat shumë të shkurtër, siç u tha dyjavor, lidhur me idetë e veta dhe vetë Qeveria që t'i ndajnë bashkërisht dhe të kenë konkluzione të cilat vërtet, nëse jo sot, qytetarit së paku ia krijojnë optimizmin se nëse jo sot çka pas dy vjetëve, çka pas tri vjetëve dhe cila është strategjia dhe cila është rruga që Kosova do ta ndjekë në vjeçarin e ardhshëm, pavarësisht nga programet partiake.

Prandaj, unë e përshëndet dhe ky debat është një rast i mirë që të konstatojmë se gjendja është jo e mirë dhe është e domosdoshme që të merren veprime konform kësaj që u tha apo edhe të tjerat, në mënyrë që të shihet se a ka resurse, a ka forma, a ka dije, a ka strategji, Kosova si Qeveri por edhe me begatimin e ideve nga opozita në mënyrë që ta ndryshojë këtë gjendje të rëndë për qytetarët e Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Idrizi e ka fjalën.

NJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Këtu u tha shumëçka, edhe të përsëriten gjërat nuk është shumë mirë, por më duhet ta theksoj një fakt që edhe pse eksporti ka stagnuar, megjithatë ne kemi një eksport të mirë. Kjo po ndodh për fatin se ne kemi shumë përvoja të mira të njerëzve tanë që kanë punuar në tregun evropian të punës dhe nga atje këtë përvojë e kanë sjell me çka ata po arrijnë që herë pas here të depërtojnë në këto tregje në mënyrë të suksesshme.

Po ashtu këtë fakt e mbështes edhe me faktin që në Kosovë kanë filluar të certifikohen shumë kompani me standarde të BE-së, me çka duket qartë se kompanitë duan që po rendin kah cilësia dhe kah tregjet e jashtme.

Edhe importi po ashtu është duke u rritur, madje sipas të dhënave nga doganat kjo rritje më shumë ka të bëjë me marrjen e pajisjeve teknologjive dhe lëndëve të para të cilat po shërbejnë si prodhim në vend.

Dua ta them edhe një fakt se herë pas here Qeveria ka ndërhyrë me pako fiskale për ta përmirësuar gjendjen e disa sektorëve të ekonomisë, duke e pasur si referencë tregun dhe gjendjen sociale në vend.

Nga obligimet doganore janë liruar lëndët e para, sidomos ato që nuk gjenden në vendin tonë të cilat u duan prodhuesve për t'i vu në funksion të prodhimit.

Për fat të keq në vendin tonë në Kosovë për një kohë të gjatë mungon një strategji, një program kombëtar i zhvillimit i cili tash është bërë pengesë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Ky dokument duhet hartohet sa më shpejtë që të jetë e mundur nëse nuk duam që përherë të varemi nga arbitrariteti i grupeve të interesit.

Institucionet tona së bashku me donatorët për vite të tëra kanë hartuar strategji sektoriale, nënsektoriale, kanë shpenzuar shumë para në këtë drejtim por këto nuk kanë qenë të bazuara as në inventare as në shkencë, prandaj, edhe si të tilla, një pjesë e madhe e tyre janë mbyllur në inventarë edhe nuk mund të shërbejnë madje as si referenca për punë të mira.

Hartimi i programit kombëtar të zhvillimit duhet t'i paraprijë një lloj, një inventarizim i cili në Kosovë ende nuk ka përfunduar, por i cili inventarizim do të ishte një impusht shumë i mirë për njerëzit që do të merreshin me këtë punë.

Hartimin e një programi të tillë është mirë që ta bëjnë ekspertët eminentë botërorë dhe ne kemi nevojë si Kosovë që t'i shpenzojmë një pjesë të parave për ta poseduar, për ta pasur një dokument të tillë.

E mira e këtyre dokumenteve që duhet të hartohen është se këto dokumente nuk tregojnë vetëm se çka duhet të bëhet po me të vërtetë edhe për më mirë këto dokumente tregojnë se çka nuk duhet të bëhet me qëllim që ne mos të derdhim para që nuk japin efikasitet, zhvillim ekonomik.

Kosova nuk mund të zhvillohet pa aktivizimin e resurseve të veta sipas një programi afatgjatë që e përmendëm, por edhe pa orientimin e edukimit dhe arsimimit drejt këtyre resurseve.

Deri tash në arsim kemi investuar më shumë në infrastrukturën shkollore, në objekte, tash duhet të investohet në dije duke i pajisur ato me teknologji informative, me laboratorë, me fushat eksperimentale, me institute e të tjera.

Edhe suksesi i plotë i universiteteve të shumta që po hapen nëpër Kosovë nëpër regjione të ndryshme duhet ta bazojë arsimimin dhe edukimin e vet në resurset e atyre regjioneve, përndryshe ne me fakultete të tilla si ekonomik e juridik nuk do të dimë se çka do të bëjmë me atë fuqi punëtore.

Dua ta theksoj faktin se ka një kohë të gjatë që buxheti i Kosovës, por edhe donatorët po i mbështetin subvencionet dhe grantet nëpër sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Subvencionimi i prodhimit të ushqimit është një mundësi e mirë për shfrytëzimin e resurseve tona, rritjen e punësimit dhe qarkullimin e parasë në vendin tonë. Duhet të bëhet subvencionimi për mendimin tim më i madh i ujitjes për faktin se subvencionimi i një varg kulturave po varet në radhë të parë nga vetë ujitja.

Për shkak të ngrohjes globale ne tash kemi në tokat tona ujë deri në fillim të muajit qershor, nga kjo kohë asnjë bimë nuk është në gjendje që potencialin e vet ta japë pa e pasur këtë sistem të ujitjes.

Është interes të dihet se çka po ndodh me projektin e Ibër-Lepencit, për shkak se ky projekt i madh i Bankës Botërore, në të kaluarën e ka mbuluar një pjesë të territorit të Kosovës, por që tashti një pjesë tjetër e territorit të Kosovës ka mbetur e pambuluar dhe kjo është një arsye që institucionet tona duhet të kyçen për ta rregulluar këtë çështje për faktin se një pjesë e fermerëve tanë janë të diskriminuar në tregun e konkurrencës së lirë për shkak se ata nuk janë në gjendje që të konkurrojnë barabar me ata që i kanë sistemet e ujitjes.

Sa i përket subvencionimit në industri mendoj që nuk është mirë të mbështetet ky subvencionim. Këto janë resurse posaçërisht mbështetja e subvencionimit të nxjerrjes së mineraleve në “Trepçë” nuk është e mirë. Këso resurse janë të paripërtëritshme dhe ne nuk kemi mundësi si Kosovë që ta risim vlerën e tyre në zinxhirin e përpunimit, prandaj, këtu është mirë t’i lihen një kohe tjetër.

Unë nuk njoh ndonjë shtet që është zhvilluar duke i shitur lëndët e para në vendet tjera vetëm përmes koncentreve, por duke i shfrytëzuar ato, duke i rritur në zinxhirin e vet të prodhimit.

Më duhet tash ta theksoj edhe një fakt, ne duhet të vazhdojmë me privatizimin dhe dhënien me koncesion të pasurive dhe ndërmarrjeve publike.

Gjysma e tokës së Kosovës është tokë publike e cila nuk është duke dhënë kontribut në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo tokë për më keq është duke marrë investimet e taksapaguesve tanë për ta mirëmbajtur atë dhe është bërë barë jo vetëm për buxhetin e Kosovës, por edhe për taksapaguesit. Është mirë që me këtë pasuri shteti të bëjë diçka, këtë pasur është mirë ta japë te njerëzit që e punojnë dhe kujdesen për të.

Një shembull të mirë të dhënies me koncesion është edhe Aeroporti “Adem Jashari”, siç jeni në dijeni gjatë gjithë kohës sa ne e kemi administruar këtë aeroport, ky aeroport nuk ka arrit t’i japë as 10 milionë për buxhetin e Kosovës, ndërsa vetëm për këto 3 vjet ky aeroport duke përfshirë edhe këtë vit do të japë rreth 10 milionë e për më shumë ka investime në terminalin e ri të cilat janë jashtëzakonisht të pëlqyeshme.

Edhe një fakt dëshiroj ta përmend, duhet nxiten komunat që ta grumbullojnë tatimin për shkak se ato kanë mbetur jashtëzakonisht mbrapa dhe nuk po arrijnë që ta japin kontributin e vetë për investimet e tyre kapitale në komunat e tyre. Shembull për të mirë në një rast është komuna e Graçanicës e cila edhe pse është një komunë e re ka arritur që të grumbullojë tatim në pronë më shumë se komunat e mëdha. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Afrim Kasolli, e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Dhe të nderuar deputetë,

Se gjendja ekonomike në vend është alarmante kjo nuk do shumë koment. Shkalla e lartë e papunësisë deri në 48%, niveli i lartë i varfërisë deri në 38% të shoqërisë si dhe niveli më i ulët i GDP për kokë banori se çdo vend tjetër të Evropës dhe rajonit, janë vetëm disa nga statistikatat e përgjithshme që e paraqesin humnerën ekonomike ku janë katandisur qytetarët e Kosovës.

Sidoqoftë kjo gjendje ulet ku ndodhemi padyshim se është pasojë edhe e cilësisë tejet të ulët që dominon edhe në sferën e arsimit në Kosovë dhe ky degradim i sistemit arsimor nuk ka dyshim se është produkti i një mentaliteti politik që ka dominuar gjatë këtyre viteve të fundit, por që ka marrë përmasa ekstreme veçanërisht nën udhëheqjen e kësaj Qeverie, e cila nuk e ka vlerësuar arsimin si një prioritet madhor dhe potencial për zhvillim të përgjithshëm ekonomik, por vetëm si një instrument shtesë për kontroll politikë.

Në fund të fundit me 1/4 e popullatës së përfshirë në arsimin formal dhe më shumë se 40% papunësi e ardhmja e Kosovës varret drejtpërdrejtë nga e ardhmja e arsimimit të qytetarëve të saj. Pra, ngritja e cilësisë në arsim përbën kushtin kryesor për zhvillimin e burimeve njerëzore të cilat pastaj kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Qytetarët e arsimuar kanë rol qendror në çrrënjosjen e varfërisë, në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në përgjithësi në sigurimin e mirëqenies së vetë dhe të familjeve të tyre.

Në këtë aspekt Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron se pikërisht puna kërkimore shkencore në kuadër të kësaj sfere është barometri i zhvillimit të një shoqërie, shoqëria është aq e zhvilluar sa ka potencial të krijojë njohuri të re dhe të shfrytëzoj atë për mirëqenien e qytetarëve të vetë.

Dhe ky aspekt i ngritjes së cilësisë apo i punës kërkimore- shkencore përpos që duhet të jetë prezent në institucionet e arsimit të lartë dhe në institute shkencore, po ashtu duhet të transferohet edhe në ndërmarrje publike dhe privat për të shërbyer si shtysë për inovacion në ekonomi dhe shoqëri. Pra, këto dy sfera qëndrojnë në një lidhje imanente njëra me tjetrën. Mungesa e njërës automatikisht është edhe mungesë e tjetrës e në këtë aspekt është e ditur se intenca kryesore e strukturës aktuale oligarkike në pushtet nuk ka qenë e orientuar kah prodhimi, zhvilli dhe hulumtimet, por pikërisht kah rrjedhat afariste e ndërmjetësimi. Prandaj, edhe kjo është arsyeja kryesore sepse si pasojë e kësaj politike deficiti tregtar sot është aq i lartë dhe se tregtia në vend të prodhimit është bërë aktiviteti kryesor ekonomik gjatë viteve të fundit.

Sidoqoftë ekzistojnë shembuj të plotë eklatant që e prezantojnë këtë vizion strategjikisht, katastrofal për mos zhvillimin e vendit.

Këtu mund të ndalemi vetëm në dy, nga më të njohurit që kohën e fundit kanë qenë tema kryesore diskursit politik dhe publik, ai i ndërtimit të autostradës si dhe shitja e distribucionit.

Ndërtimi i autostradës, përkundër megalomanisë së kësaj Qeverie, është pikërisht një vepër arkitektonike që më së paku kemi të drejtë të krenohemi ne, sepse në fund të fundit puna kryesore teknike dhe planifikuese është udhëhequr nga kompani jo vendore me personel të huaj, inxhinierët vendor mungonin plotësisht, punën e bënë ekspertët e huaj, ekspertiza teknologjike dhe aplikimi i dijes shkencore ishte i tyre. E vetmja gjë që na takon neve është që të paguajmë faturën e stërfryrë para Behtellit dhe kompanive tjera që realizuan punimin.

Pra, pikërisht kjo mënyrë e investimeve tregon se si po humbin resurset njerëzore si pasojë e politikave të kësaj Qeverie. Sipas kësaj qasje Kosova si duket më nuk ka nevojë për inxhinierë, specialistë dhe njerëz të tjerë të profilit të lartë profesional pasi që nevoja ekonomike për ta po zhduket si pasojë e një politike zhvillimore që favorizon investime dhe kompanitë vetëm të jashtme, ndërsa lë në harresë investimin e resurseve njerëzore të brendshme. Kjo është një tragjedi e përmasave të mëdha me pasoja që do të ndihen me gjenerata, sepse është provuar gjithmonë dhe gjithkund në histori se investimi në burimet njerëzore, në kapacitetet punuese, organizative, teknike e shkencore, janë motori më i madh i çfarëdo zhvillimi ekonomik, aq më tepër sot në ekonominë e informatizuar globale.

E njëjta karakteristikë do ta përcjellë edhe shitjen e distribucionit, sepse fillimisht ky model përbën grushtin e vdekjes para traditë të paktë dhe ashtu të brishtë inxhinierike dhe menaxheriale të Kosovës.

Ka pak gjasa që kompania e huaj do të udhëheqë punën me ekspertë kosovarë, jo vetëm pronarët, por edhe menaxherët, inxhinierët e lartë të kësaj kompanie do të jenë ekspertë të jashtëm dhe nën efektet e këtij modeli të shitjes nxitet krijimi i një varësie dhe subordinimi të ri, jo vetëm në kapitalin ekonomik, por edhe në kapitalin njerëzor të jashtëm.

Investimet gjatë shumë dekadave më herët që ju bëjnë për ndërtimin e një kapitali njerëzor profesionist dhe teknik në Kosovë, shkatërroun me një të rame të lapsit nga kryeministri Hashim Thaçi.

E dyta, po ashtu privatizimi i aseteve publike në Kosovë siç janë PTK apo nesër pa dyshim ndoshta edhe “Trepça” sipas kësaj Qeverie dhe burimeve tjera, do të ndjekin të njëjtën vijë. Politika aktuale garanton që baza e resurseve njerëzore të Kosovës të degradojë edhe më tej pasi kosovarëve iu zvogëluar shanset për marrjen e pozitave udhëheqëse, vendimmarrëse dhe teknike në kompanitë që veprojnë në Kosovë dhe sipas këtij vizioni të mbrapshtë ekonomik të qeverisë aktuale, duket se qytetarët e Kosovës janë të vlefshëm vetëm si punëtorë krahui dhe konsumatorë, por jo si ekspertë, ndërtimtarë, krijues, organizatorë dhe shkencëtarë.

Dhe kjo politikë e privatizimit e të çdo gjëje pikërisht ka si pasojë degradimin total të burimeve njerëzore të ekspertizës dhe njohurisë modeste teknologjike kosovare, shndërrimin e Kosovës në një burim të lëndëve të para dhe natyrore dhe njerëzore, por pamundësi të zhvillimit, prodhimit dhe avancimit të kapitalit njerëzor. Faleminderit!

KRYETARI: Unë veç po ju njoftoj edhe 15 janë. Para, do të ishte mirë që ata vetë t'i reduktojnë diskutimet në 5 minuta. Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kosova edhe 14 vjet pas përfundimit të luftës dhe 5 vjet nga pavarësimi i saj vazhdon të ketë nivel të ulët të zhvillimit ekonomik, sepse qeverisë së vendit po i mungon një plan nacional i zhvillimit ekonomik.

Pengesat që ndërlidhen me qasjen në financim, korrupsioni, pengesa të karakterit burokratik dhe politikat e gabuara ekonomike, janë faktorë kryesorë në moszhvillimin ekonomik.

Është e vërtetë se po të pyetshin qytetarët e thjeshtë me siguri se nuk do të shfaqni ndonjë reflektim pozitiv në kuptimin e gjendjes ekonomike në vend, veçmas nëse bazohemi në shumë indikatorë mjaftë shqetësues për të gjithë ne.

Rritja e varfërisë çdo ditë e më shumë, rritja e numrit të papunëve, rënia drastike e investimeve të huaja, rënia e remitencave dhe çka është më shqetësuese fakti i rënies së eksportit të produkteve vendore, paraqesin sot një zbehje optimizmi të qytetarëve dhe janë pasqyrë e një gjendje të rëndë ekonomike në Kosovë.

Për fat të keq një konstatim i tillë qëndron. Agjenda politike është ajo që dominon në përditshmërinë kosovare. Pra, është agjenda politike që gjatë gjithë këtyre viteve rëndon pa asnjë mëshirë mbi vizionin e shëndoshë të një agjende ekonomike.

Në qoftë se dëshirojmë të kemi një ngritje të gjitha niveleve, shëndetësi të shëndoshë, arsim cilësor, krijim të vendeve të reja të punës, përmirësim të imazhit dhe rritjes së mirëqenies sociale edhe ashtu shumë të rëndë në Kosovë, atëherë zhvillimi ekonomik duhet të jetë prioritet i prioriteteve.

Deri kur qytetarët e pashpresë për një vend pune duhet të presin që dikush të dalë në pension apo diçka tjetër.

Duke mos parë perspektivë të sigurt në këtë vend sot gati çdo i ri mendjen e ka gjetkë, shpresën e vetme për jetë më të mirë e kanë jashtë vendit. Ata po thuaj se çdo ditë promovojnë mundësi të ndryshme për të lëshuar Kosovën. Të gjitha sondazhet flasin në favor të kësaj gjendje mjeruese. Pse po ndodh kjo?

Procesi i privatizimit në Kosovë, i filluar në vitin 2003, ishte parë si një mundësi mjaftë e mirë për zhvillimin ekonomik të Kosovës, por pritjet nga ky proces kanë qenë krijimi i

një stabilitet ekonomik- social dhe krijimi i vendeve të reja të punës, por për fat të keq ndodhi e kundërta.

Nuk mund të ketë stabilitet politik në qoftë se nuk kemi një stabilitet ekonomik. Nëse duam të përshpejtojmë drejt një procesi të integritimeve evropiane patjetër duhet të kemi stabilitet politik, kjo është udha jonë.

Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë hapa konkret me përgjegjësi institucionale për një arsye të vetme dhe shumë fundamentale si garanci për një shtet të qëndrueshëm është në radhë të parë zhvillimi ekonomik i vendit. Kjo mbas është kërkesë e qytetarëve tanë. Kosovës me të vërtetë i duhet një platformë, një vizion i cili vërtet do të ketë mundësinë e implementimit në realitetin kosovar dhe është koha e fundit ku duhet të ketë një qasje substanciale në krijimin e një vizioni të tillë zhvillimor. Është koha e fundit të ndalet procesi i eksportimit të parasë së gatshme nga vendi në mënyrë që Kosova të mos bëhet vend i jo stabilitetit ekonomik dhe social, të mos jetë shtet importues, por të krijohet një stabilitet përmes shtimit të numrit të prodhuesve të rinj me ç'rast do të krijohen edhe shumë vende të reja të punës. Bëj thirrje për këtë vetëdijesim të spektrit qeveritar, i cili për çudi është distancuar krejtësisht nga realiteti i hidhur në vend. Për këtë arsye, pa 1001 arsye të tjera, është momenti i fundit ku agjenda politike duhet të zhvendoset në agjendën ekonomike. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ekonomia e një vendit nuk ka asnjë kuptim nëse ajo nuk është në funksion të ngritjes së mirëqenies së popullatës. Për të arritur këtë asaj i duhen politikat e mira qeveritare, ambient miqësor për biznes dhe nivel i lartë i sigurisë për njerëzit dhe për kapitalin.

Ndikimi i gjithë këtyre faktorëve më së mirë vërehet përmes hartës sociale të vendit, përkatësisht përmes ngritjes së standardit të jetës, shkallës së punësimit dhe uljes së nivelit të varfërisë.

Te këta parametra krejtësisht ka dështuar kjo Qeveri, kjo Qeveri nuk ka arritur së paku as një përqindje ta ulë nivelin e papunësisë, ndërsa rritja e zbehtë ekonomike prej 3,8% reflekton në ngritjen e mirëqenies së një kategorie të caktuar të qytetarëve, përkatësisht të atyre që kanë mundësi të dirigjojnë mënyrën e shpenzimit të parasë publike.

Problem tjetër është ai i kujdesit shëndetësor ndaj popullatës, këtu nisin të gjitha të zezat. Me qenë se Qeveria nuk ka arritur të garantojë një minimum të mbrojtjes shëndetësore, gjendja në institucionet publike shëndetësore është e mjerë, ka mungesë të barërave dhe të materialit elementar për trajtimin e pacientëve, ka korrupsion, ka keqpërdorime. Pacientët janë të detyruar që vetë t'i sigurojnë ilaçet madje edhe shtrojnë e mbulojnë me qenë se ajo në këto institucione është, pra nuk mirëmbahet mirë.

Kjo qeveri nuk ka bërë asnjë investim serioz në shëndetësi, krejt çka ka bërë është kujdesur vetëm që ta financojë mjerimin në këtë sektor. Shifrat tregojnë qartë se shëndetësia në totalin e shpenzimeve qeveritare merr pjesë me 7% dhe me këtë pjesëmarrje do të mbetet edhe për 2 vjetët në vijim.

Një shumë e madhe e parave të qytetarëve tanë shkojnë jashtë vendit dhe konsiderohet se rreth 26 milionë euro çdo vit shkojnë për shërim jashtë vendit në Serbi dhe në vende tjera të rajonit që i kemi afër nesh dhe kjo është si pasojë e mungesës së vullnetit të Qeverisë për të ndikuar që ta rehabilitojë sado pakë këtë sektorë.

Investimet kapitale në shëndetësi në totalin e shpenzimeve kapitale marrin diku rreth 2%, të tilla do të mbeten deri në vitin 2015, sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve. Pra, nuk parashihet asnjë investim serioz në këtë sektor.

Problemet pra nisin që nga kujdesi shëndetësor ndaj popullatës e vazhdojnë me standardin dhe cilësinë e jetës. Të gjithë parametrat janë në rënie me qenë se është duke u rritur niveli i varfërisë dhe i papunësisë.

Buxheti për asistencë sociale po rritet nga viti në vit, që konfirmon se varfëria po thellohet. Ky buxhet nga 201 milionë euro në vitin 2012, në vitin 2013 parashihet të jetë 207 milionë euro, mirëpo as këto para nuk mjaftojnë për të mbuluar tërë shtresën e varfër të qytetarëve.

Një person i përfshirë në këtë skemë duhet të mbijetojë pra me 1.6 euro në ditë e që ju e dini shumë se sa e vështirë është ta kaloni një ditë me 1.6 euro.

Rritja e kostos së jetës po e varfëron më tutje tryezën, rreth 34 mijë familje që përfitojnë ndihmë sociale, asnjërës familje nuk i mjaftojnë 70 euro për mbulimin e nevojave elementare për jetë.

Numri të papunëve të regjistruar arrin rreth 336 mijë persona, ndërkaq për këto vjet të qeverisjes nga PDK-ja, shkalla e varfërisë mbetet konstante rreth 45%.

Kjo gjendje e mjerë u vërtetua me indeksin e mizorisë i cili e rendit Kosovën në vendin e nëntë në botë pas Zimbabvesë, Liberisë, Bjellorusisë, Turkmenistanit e të tjerë.

Për sqarim, po përmend se indeksi i mizorisë është një matës i përgjithësuar i gjendjes ekonomike dhe sociale bazuar në të papunët dhe inflacionin.

Gjendja e rëndë dhe gati e pashpresë vërehet qartë edhe kur krahasojmë zhvillimet në vend me ato të vendeve të rajonit, për shembull norma e papunësisë në Kosovë është tri herë më e lartë se në Malin e Zi, dy herë më e lartë se në Bosnje e Hercegovinë dhe 50% më e lartë se në Maqedoni dhe këto vende nuk janë larg nesh që të kemi një dallim kaq të madh.

Varfëria vjen si rezultat si papunësisë dhe i mungesës së të ardhurave, prandaj qytetarët e Kosovës, krahasuar me ata të vendeve fqinje, ushqehen shumë më keq, shëndeti i tyre është më i dobët dhe incidenca e sëmundjeve është shumë e lartë.

Dhe si rezultat i të gjitha këtyre zhvillimeve vijnë statistika tjera që vërtet janë alarmuese. Pra, qytetarët e Kosovës mesatarisht jetojnë 10 vjet më pak se qytetarët e Sllovenisë, 6 vjet më pak se qytetarët e Bosnjës dhe 5 vjet më pak se qytetarët e Maqedonisë dhe Malit të Zi. Kur kemi parasysh këto fakte atëherë nuk mund të na bëjnë aspak përshtypje fjalët dhe vetë lëvdatat e Qeverisë për rritjen ekonomike, për investimet publike e ato të sektorit privat apo për ecuritë të tjera në rrafshin makro-ekonomik.

Gjendja sociale e qytetarëve të Kosovës është pasqyra më e mirë për situatën që e kemi në ekonomi dhe për politikat zhvillimore që zbaton kjo Qeveri.

Shifrat në sferën sociale tregojnë se gjendja është shqetësuese dhe për brengosje. Ato tregojnë qartë se dështimet e kësaj Qeverie janë të vazhdueshme, pra shihet qartë që nuk ka vizion dhe nuk ka asnjë strategji apo asnjë plan konkret se si do ta nxjerrë popullatën nga kjo varfëri. Faleminderit!

KRYETARI: Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ju përsëndes, do dëshiroja ta përsëndes edhe debatin.

Gjithsesi arsyetohet një debat për gjendjen ekonomike në Kosovë, për të dëshmuar se edhe për mua është ky shqetësim i dorës së parë, tamam, dua vetëm ta theksoj një vërejtje që kam në qasjen e përgjithshme zhvillimit ekonomik dhe investimeve në aspektin e gjithë përfshirjes së Kosovës.

Besoj që ju ka bërë përshtypje ta zëmë vetëm një fakt, gjysma e Kosovës, magjistratja Mitrovicë-Shkup, prej QMI-së e kah lindja nuk ka asnjë kilometër rrugë me katër korsi, madje asnjë 10 metërsh nuk e ka, nuk ka asnjë investim të rëndësishëm dhe nuk ka asnjë ministër në Qeveri. Mendoj që s'do koment.

Po unë e mora fjalën më shumë për të theksuar diçka tjetër dhe lus për mirëkuptimin e kolegëve që kanë iniciuar këtë mocion në parim e dua debatin, e pëlqej shkëmbimin e hapur të pikëpamjeve, ballafaqimin e tyre, po me mirëkuptim vërejtja ime ka të bëjë me prirjen tonë që t'i qasemi këtyre në një rrugë gjithmonë të lëndueshme procedurale.

Me mocionin e Grupit Parlamentar është kërkuar debat parlamentar për gjendjen ekonomike në Kosovë. Ju e merrni me mend si mund të zhvillohet tash një debat për gjendjen ekonomike, si të thuhet si disa gazetarë që kërkojnë hajt një prononcim për gjendjen politike në Kosovë, si ta bësh atë. Është një konferencë, një simpozium dhe është pak. Dhe çka kërkohet në fund. Kuvendi i Republikës të rekomandoj që të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës një afat prej dy javësh t'i raportojë Kuvendit për gjendjen ekonomike dhe alternative të qeverisjes për dalje nga kjo gjendje, në rregull. Po

nëse vjen raporti i Qeverisë që duhet të vijë me shkrim, çka duhet të bëjë Kuvendi, duhet të bëjë prapë një debat dhe pse atëherë nuk e vëmë këtë qasje në rrugë më normale si e bënë gjithë bota. Kërkohej Qeverisë një debat dhe atëherë pastaj një raport dhe atëherë pastaj bëhet debati.

Për më tepër kjo nismë është mbështetur në dispozitën e Kushtetutës, nenin 65 që vetëm thotë cilat janë funksionet e Kuvendit dhe është referenca te Rregullorja, nenin 15 që veç përmend mocionet përmbajtjesore, kurse te mocionet përmbajtjesore thuhet qartë çka është mocioni përmbajtjesor në praktikën tonë. Debat si i tillë nuk hyn në këtë referencë dhe po e theksoj këtë, sepse na është bërë praktikë që të bëjmë debat pas debati dhe nuk besoj që janë produktive sa po marrin kohë. Prandaj, edhe sugjerimi im është që të përqijemi t'i racionalizojmë këto.

Kemi ligje që i sjell Qeveria, janë rast i mirë për të bërë debat, kemi mundësinë që në sjelljen e raporteve, strategjive të zhvillojmë debat për fusha të ndryshme të ekonomisë, e kemi buxhetin çdo vit së paku dy herë, është rasti më i mirë për t'i diskutuar këto çështje.

Përndryshe tash duke biseduar për gjendjen ekonomike ne po bisedojmë për aspektin social, arsimin, e shëndetësinë, e kulturën dhe të gjitha dhe kur të bisedohet për të gjitha, praktikisht nuk kemi dhënë rrugë të zgjidhjes asgjë, madje, as atë vërejtjen që e thashë unë. Pyeti tash njerëzit nuk besoj që e kanë mbajtur në mend, prandaj edhe sugjerimi im është që të vëmë në rrugë normale funksionimit të raportit midis legjislativit dhe ekzekutivit.

Legjislativi ka të drejtë të kërkojë raporte, por kur të merren raportet atëherë të diskutohen dhe të diskutohen, siç ka paraparë Rregullorja, me propozim të rezolutës ose interpelancës ose besimit e mosbesimit të Qeverisë, por këto janë instrumentet që ka paraparë edhe praktika jonë edhe praktika e përgjithshme parlamentare për funksionimin e raporteve ekzekutiv, legjislativ e të tjera. Ju faleminderit dhe besoj që kam mirëkuptimin tuaj!

KRYETARI: Fjalën e ka Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Me të vërtetë ka pasur nevojë për një debat për zhvillim ekonomik, mirëpo siç tha edhe parafolësi do të na duhej sigurisht një kohë më e gjatë të flasim për këtë temë, sepse është një segment shumë i gjerë.

Por, shumë ka nevojë për hapa konkret dhe veprime konkrete për përmirësimin e kësaj gjendje.

Deputetët saktësuan me shifra gjendjen e papunësisë që është 45%. Kjo papunësi është e lartë, sidomos tek të rinjtë, diferencat janë tepër të larta në mes meshkujsh e femrash.

Mbi 90% të papunëve janë të papunë për më shumë se një vit. Pra, janë të papunë në kohë afatgjatë. Në fakt shumica janë të papunë prej kohës kur kanë vendosur të kërkojnë punë, kjo tregon qartë mungesën e perspektivës për të rinj, gjë për të cilën ne krenohemi se kemi përqindjen më të madhe të popullsisë së re.

Nën qeverisjen Thaçi, Kosova në çdo aspekt largohet nga Evropa, në fakt fal modelit unik të qeverisjes së zhvatjes dhe korrupsionit. Kosova nuk krahasohet as me vendet e rajonit e lere më me Evropën. Disa shifra të tilla i paraqiti edhe kolegja nga partia, Rita Hajzeraj.

Papunësia e lartë dhe mungesa e zhvillimit ekonomik i kanë shuar shpresat e të rinjve për të ardhmen, kjo është arsyeja pse tendenca për të emigruar është tepër e lartë, gjë që ka pasoja edhe në procesin e liberalizimit të vizave.

Papunësia e lartë dhe në rritje e ka thelluar varfërinë në mesin e qytetarëve të Kosovës. Të dhënat nga organizatat ndërkombëtare tregojnë se 40% e qytetarëve të Kosovës jetojnë në varfëri të thellë me vetëm një euro në ditë ose në të ardhurat që marrin nuk arrijnë të sigurojnë konsumin e nevojshëm për zhvillimin afatgjatë.

Rrjedhimisht qytetarët e Kosovës, mesatarisht jetojnë 10 vjet më pak se qytetarët e Sllovenisë, 6 vjet më pak se ata të Bosnjës dhe 5 vjet më pak se ata të Malit të Zi dhe Maqedonisë.

Të gjitha politikat e Qeverisë Thaçi sa i përket uljes së papunësisë përmbledhen në Ligjin e ri për regjistrimin e të papunëve. Me këtë ligj diskriminohen të papunët, obligohen që të regjistrohen në zyrat e punësimit të administruara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ky ligj ka plotë anomali dhe shkel të drejtat elementare njerëzore, e rrit moshën nga 15 në 18 vjeç, që një person mund të kualifikohet dhe regjistrohet si i papunë. Kjo është në kundërshtim me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ku një i papunë regjistrohet në moshën 16-vjeçare.

Një anomali tjetër, një i papunë obligohet të përgatisë plan individual për të gjetur punë, gjë që i kërkohet një personi me shkollë fillore a të mesme për një plan aktivitete, që është anomali e llojit të vetë.

Një nen tjetër thotë: i papunësuar obligohet gjithashtu të mos e refuzojë punësimin dhe aftësimin e ofruar nga zyrat e punësimit, nen që është në kundërshtim me të drejtën e personit për të zgjedhur punën dhe me fat janë të papunët që Qeveria nuk ka shkuar më tej me këtë ligj që të parashohë edhe masa ndëshkuese për ata që refuzojnë punësimin e ofruar nga zyra e punësimit ose që nuk kërkojnë punë në mënyrë aktive.

Duke i parë të gjitha këto shifra, 38 mijë familje marrin ndihmë sociale nga 70 euro për muaj. Dhe unë befasohem me kryeministrin Thaçi dhe me disa miq të tij të afërt që e ndjejnë veten super mirë, por si mund të ndjejnë veten super mirë kur kjo kategori e

njerëzve është në këtë gjendje kur i kemi këto shifra para vetes. Do të doja të ndija asisoj nëse ngritët cilësia e jetës së qytetarëve, nëse këta njerëz nuk jetojnë në varfëri të thellë dhe sa herë flasim me këto shifra i dhemb shumë atij dhe tenton ta devijojë debatin duke shndërruar në politika lokale për t'iu shitur dokrra qytetarëve, por qytetarët tashmë janë mësuar dhe nuk i marrin këto dokrra. Faleminderit!

KRYETARI: Unë e kam një kërkesë që t'i përmbaheni rendit të ditës se deputetja foli më tepër për ligjin që e kemi miratuar këtu se sa për zhvillimin ekonomik. Ju kisha lutë qëndroni temës për të cilën jemi duke debatuar. Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Arritjet e Kosovës në fushat ekonomike janë të matshme. Këto arritje bëhen edhe më të rëndësishme duke marrë parasysh faktin se Kosova për ndryshim nga shtetet tjera evropiane tranzicionin ekonomik, përfshirë këtu edhe reforma tatimore i kanë bërë në ndikimin e faktorëve dhe rrethanave mjaftë specifike politike.

Në vazhdim do të shkoqis vetëm disa prej arritjeve që ka realizua Kosova në fushën e ekonomisë.

Vlerësimet e deritashme, qoftë ato nga institucionet kosovare ose ato ndërkombëtare rreth rrjedhave ekonomike, tregojnë se Kosova ka shënuar një rritje ekonomike dhe se kjo do të vazhdojë edhe në vitin 2013.

Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian, produkti i brendshëm bruto në shtetet e Evropës Juglindore, në pjesën e parë të vitit 2012, u karakterizua me recesion prej 1,2% rënie kjo e ndikuar nga rënia e kërkesës së përgjithshme.

Kroacia shënoi në nivelin më të thellë të recesionit në 1.8%, pasuar nga Serbia me 1.7%, nga Maqedonia e Mali i Zi më 1,1%, përderisa Kosova vlerësohet të ketë pasur normë pozitive të rritjes ekonomike në vitin 2012 dhe sipas të gjitha vlerësimeve të institucioneve vendore dhe të atyre ndërkombëtare, rritjet do të vazhdojnë edhe në vitin 2013.

Kosova sot ka një sistem të qëndrueshëm të financimit publik. Buxheti i Kosovës, përkundër presioneve fiskale në ndikimin e rritjes së aktiviteteve shtetërore e në fusha të ndryshme është në funksion të financimit të projekteve shumë të rëndësishme kapital, në funksion të plotësimit të nevojave sociale dhe nevojave të cilësuar si prioritare të shoqërisë kosovare.

Kosova në këtë kuadër me asistencën e institucioneve ndërkombëtare po ashtu ka arritur të krijojë një kornizë të qëndrueshme ligjore në fushën e financimit publik dhe të transparencës buxhetore.

Është arritur që të krijohet një sistem i të hyrave publike që nga viti 1999, Kosova ka shënuar rritje permanente të të hyrave dhe që krahasuar me shtetet tjera në rajon cilësohet me ngarkesën më të ulët fiskale.

Korniza ligjore e sistemit të të hyrave publike është cilësuar si e thjeshtë dhe në përputhje me nivelin e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Në qershor të vitit 2009, Kosova u bashkua me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Kosova filloi shlyerjen e pjesës së vetë të borxhit të ish -Jugosllavisë.

Së fundi, Kosova u anëtarësua edhe në BERZH dhe kjo është e një rëndësie të veçantë për integrimet e Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Veç po ju njoftoj, jemi duke folur për zhvillimin ekonomik. Po shkojmë rend qysh janë. Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Je i respektuar, faleminderit!

Deputetë të nderuar,

Pak paskan mbetur sallë për të diskutuar në fund për çështjet të cilat janë ngritur për zhvillimin ekonomik.

Ishte qëllimi i mirë por devijoi në fillim. Unë nuk u habita pse kryeministri e devijoi këtë çështje dhe doli në atë që nuk është ajo të cilën ne e kemi kërkuar, nuk është ekonomia, gjendja e ekonomisë në përgjithësi.

Nuk isha i befasuar aspak për arsye se nuk është i vetmi kryeministër që nuk e njeh lëmin e ekonomisë. Ne kemi pasur edhe kryeministrat e parë, njëri ka qenë jurist, tjetri historian, tjetri ushtarak, përsëri historian edhe normalisht që njohurit e tyre për probleme ekonomike janë më të vogla.

Por është e vërtetë që Lidhja Demokratike asnjëherë nuk ka pasur kryeministër, asnjëherë edhe që i ka fituar zgjedhjet disa herë, kështu që gjithmonë kryeministri është çelësi i shtetit, është ai njeri i cili orienton politikën zhvillimore. Por duhet të jemi objektiv dhe real që është vështirë dikujt t'i bëhet me gisht gjendja ekonomike, arsyeja është se në mandatet kur ka fituar LDK-ja dhe që kemi qeverisur në koalicion, lidhshipi ka qenë i orientuar të merret me çështjen e bisedimeve rreth statusit të Kosovës, pas pavarësisë apo kjo Qeveri e kryeministrit Thaçi, është i orientuar të bëjë bisedime politike rreth veriut dhe kështu ekonomia e Kosovës vazhdimisht mbetet në planin e dytë.

Po të bëjmë një vlerësim të gjendjes ekonomike do të marrim një bazë. Baza është ajo e trashëguar a potenciali ekonomik i trashëguar. E kam fjalën i trashëguar nga ish-Jugosllavia. Një potencial ekonomik i ri, më i vogli, më i pamjaftueshmi në krejt republikat e ish- Jugosllavisë, pa një kapacitet ekonomik prapë kryesisht i ri. E vërteta ishte që atëherë kishte një treg ekonomik me 22 milionë banorë dhe sot kemi një treg

ekonomik me më pak se 2 milionë banorë dhe problemet lindin. Lindin me ndryshimet e sistemeve, kur duhet të bëhet tjetërsimi i pronës.

Prej Qeverisë kam pritur jo ta bëjë një strategji të mirë të zhvillimit ekonomik, por kam pritur që ta marrë një iniciativë të formimit të një trupi kombëtar prej pozitës dhe opozitës që do të bënte bashkërisht një zhvillim, një strategji zhvillimore të detajuar, afatgjatë i cili do të ratifikohej në Parlament dhe i cili dokument do të respektohej, pavarësisht prej atyre që janë në pushtet. Kjo është më se e domosdoshme që të ketë një vizion edhe një orientim të zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Përndryshe çdo Qeveri i ka prioritetet e veta dhe për t'iu shmangur këtyre prioritetëve politike dhe premtuese gjatë elektoratit është dashur ta ketë një trup kombëtar që do të bënte një strategji të përbashkët zhvillimore. A do të ishte ajo me përparësi, në energjetikë për shkak të rezervave më të mëdha të linjtit në Kosovë, a do të ishte një prioritet i cili do të stimulonte edhe do të përkrahte minierat dhe mineralet për shkak se Kosova është e njohur për këtë apo do të përkrahte bujqësinë, për shkak të kushteve natyrore, do të ishte çështje e një strategjie të përbashkët, por gjithqysh të shoqërohej me një reformë të mirëfilltë të arsimit, në kuptimin e asaj që nuk kemi më nevojë si Kosovë që të kemi sasi, po kemi nevojë që të kemi njerëz të arsimuar të kenë cilësi, atë që e thoshte Rugova në vitet e '90-ta do të vijë koha që Kosova do të ketë nevojë për punëtorë, për njerëz të përgatitur dhe sot ne kemi numerikisht po s'kemi njerëz që e mbulojnë vendin e punës.

Atë që unë kisha dashur ta potencoj që do të ishte në interes si faktor determinues në zhvillimin ekonomik të Kosovës, të diskutohet apo të ridiskutohet apo të merren qëndrime të reja lidhur me politikat fiskale, politikat financiare, politikat bankare, politikat buxhetore.

Sistemi financiar në Kosovë është jo i mirë për arsye se dy fondet, Fondi i Trustit Pensional dhe Fondi i AKP-së të dyja së bashku janë të barabarta sa buxheti i Kosovës dhe asnjë shtet në botë nuk e duron një presion të tillë të qarkullimit të mjeteve jashtë vendit të nivelit sa është edhe paraja buxhetore.

Politikat fiskale të vendit duhet të jenë konkurruese në regjion, të keni parasysh, shtetet që na rrethojnë janë duke bërë disa politika të favorshme për investime të huaja. Ne përveç të asaj që ofron shteti si shitje si ashet shtetëror ku janë të interesuar investitorët ndërkombëtarë thuaj se nuk kemi më të interesuar në investime private, kjo vërehet edhe sidomos gjatë shitjeve të ndërmarrjeve shoqërore në AKP, ku gati më s'ka asnjëherë të interesuar te investitorët e jashtëm që të blejnë këto asete.

Është menduar që privatizimi i Kosovës të jetë më i shpejtë në kuptimin e asaj që të gjitha ndërmarrjet shoqërore të shiten më shpejt, që të rivitalizohen ato të hyjnë në funksion dhe të gjenerojnë vendet e reja të punës, por ajo nuk ndodhi. Nuk ndodhi për shkak të problemeve të ndryshme, por nuk ndodhi edhe për shkak të gjendjes së sigurtisë në përgjithësi, kur investitorët potencialë nuk duan të derdhin para kur nuk u garantohet. Nuk është buxheti i Kosovës determinues për zhvillimin ekonomik. Determinues për

zhvillimin ekonomik është që krijohet biznesi brenda biznesit, tregtia brenda tregtisë, jo biznesi i varur prej buxhetit prej kategorisë së investimeve kapitale, dhe kjo është ajo që e ka ngulfatur krejt këtë sistem ekonomik në mungesë të qarkullimit të parasë dhe unë mendoj në mungesë të një biznesi të mirëfilltë.

Unë po shpresoj që kjo ide e formimit të një trupi të përbashkët pozitë-opozitë, i ekspertëve, do të ishte në interesin e përgjithshëm kombëtar, një nismë e cila duhet të përkrahet dhe një nismë e cila do të na e tregonte rrugën drejt zhvillimit ekonomik. Kështu jemi të humbur, kështu e kemi një ekonomi spontane, e kemi një zhvillim jo të pritur, jemi në telashe, jemi të humbur pas bisedave politike dhe thjesht nuk e kemi kuptuar që politika më e mirë është ekonomia.

Derisa lidhshipi nuk e kupton këtë, ne do të jemi në këso gjendje ekonomike të vajtueshme, të papunë, gjendje të keqe sociale, do të shtyhem kush do të përfitojë më tepër nga ky buxhet i mjerë dhe kështu do të vazhdojë edhe më tutje, dhe ne do të jemi të varfër. E derisa jemi të varfër, nuk do të na respektoj askush, nuk do të na pranojë askush, nuk do të na dojë askush. Por, shpresoj që të merremi më seriozisht me probleme konkrete, me problemet njerëzve, me ngritjen e mirëqenies, punësimin, arsimimin më të mirë, afrimin e mundësive për biznes sa më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Duke kërkuar të diskutohet për zhvillimin ekonomik në Kosovë, Lidhja Demokratike ia ka bërë një shërbim të mirë vendit. Edhe në qoftë se do të trajtohej kjo temë me një ashpërsi edhe më të madhe se që u trajtua këtu, megjithatë ky shërbim prapëseprapë do të ishte i mirëseardhur dhe i domosdoshëm. Kështu, ne, pavarësisht që mund të kemi mungesa në formimet tona për temën që e kemi trajtuar, pavarësisht prej tendencave që mund të jenë manifestuar, pavarësisht prej deficiteve profesionale në formimet tona, gjesti, veprimi, leksioni që ka dhënë Lidhja Demokratike duhet të çmohet nga të gjithë qytetarët dhe nga opoenca e tyre. Më mirë të trajtohen problemet e vendit në Parlament sesa të tundet toka dhe të buçasë qielli përjashta.

Nga këto debate, mund të jenë gjithfarë, por leksionet janë të mëdha dhe konkrete. Nga gjithë kjo që dëgjuam tani dhe nga gjithë ato paraqitje që manifestuam këtu, unë e nxjerr një konkluzion në pyetjen se çka është ekonomia. Ekonomia më imponohet tani, nuk është asgjë tjetër, përveçse shprehje e koncentruar e politikës. Pastaj, nëse pajtohemi me këtë, na imponohet pyetja tjetër, ç'është politika? Edhe politika nuk është asgjë tjetër veçse shprehje koncentrore e ekonomisë dhe nëse pajtohemi me këtë teori, atëherë të mobilizohemi me këto formime që i kemi, me këtë edukatë që e kemi, ta bëjmë më sociale këtë politikë, ta bëjmë më njerëzore këtë politikë dhe ta humanizojmë politikën.

Duke i bërë këto veprime dhe duke i ngritur në institucion këto koncepte, ne ia bëjmë shërbimin më të mirë vendit dhe shërbimin më të domosdoshëm që mund ta bëjmë dhe duhet ta bëjmë dhe mbase më së lehti është që na ngarkohet si detyrë imediate, e vetme, dhe nga më të lehtat që mund t'i kryejmë ne.

Unë për veten time e kisha bërë një koncept më të gjatë dhe u mundova ta sintetizoj gjithë fjalën time, por në momentin kur u ula për ta shkruar dhe për ta sintetizuar atë që e kisha hedh në letër, më erdhi radha. Faleminderit!

KRYETARI: Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOLLCA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Varësia e zhvillimit ekonomik të një vendi, në nivelin e sundimit të ligjit, është fakt i pamohueshëm. Mungesa e zbatimit të ligjit, si dhe mungesa e qasjes në drejtësi, ashtu sikur edhe zbatimet e vendimeve të drejta, krijon pasiguri juridike, jo vetëm për investorët e huaj, por edhe për të gjitha bizneset vendore. Këto të fundit nuk mund të shpresojnë në konkurrencë të lirë, e cila garantohet me ligj, përveç nëse janë të lidhura me pushtetin dhe jetojnë nga tenderët e premtuar qysh më herët, në kohë fushate.

Ekonomia në tërësi ka pasqyrë të zymtë, përderisa përkushtimi për sundim të ligjit në vendin tonë është po ashtu i zymtë. Imazhi ndërkombëtar i Kosovës po përkeqësohet çdo ditë me skandale të panumërta që e kanë burimin në këtë Qeveri dhe organizohen e ekzekutohen po nga kjo Qeveri.

Raporti i fundit, ai i fizibilitetit, i përgatitur nga Komisioni Evropian, e përshkruan situatën ekonomike në Kosovë si sfiduese, duke theksuar se politikat fiskale të Kosovës në tre vjetët e fundit janë ekspansioniste dhe të paqëndrueshme dhe kanë ardhur si rezultat i vendimeve të gabuara që kanë pasur si pasojë zvogëlimin e hapësirave fiskale për t'i financuar shpenzimet që mund të kontribuojnë në përmirësimin e kohezionit fiskal dhe në perspektivën për punësim të qëndrueshëm afatgjatë dhe rritje ekonomike, por mbi të gjitha vendi ynë pasqyrohet si shtet i dështuar në fushën e sundimit të ligjit që natyrisht ndikon edhe në zhvillimin ekonomik.

Mungesa e veprimeve konkrete për luftimin e krimit dhe korrupsionit, çdo ditë e më shumë i largon investorët e huaj nga Kosova, numri i të cilëve po dëshmohet se po shënon rënie drastike. Këto investime kanë rënë rreth 45% gjatë viteve të fundit, si rezultat i keqqeverisjes, abuzimit të pushtetit dhe shkeljes së rregullave elementare të ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së lirë.

Bizneset nuk mund të llogaritin as në parashikueshmëri juridike, e as në zbatim të ligjeve ekzistuese, për të cilat Qeveria mburret se janë në përputhje me standardet evropiane. Ato ligje për biznese, qofshin vendore, qofshin ndërkombëtare, mbeten asgjë tjetër, pos një copë letre që nuk ka kurrfarë efekti në praktikë dhe nuk siguron as mbrojtjen minimale të të drejtave që këtyre bizneseve u takojnë.

Bizneset e huaja hezitojnë të lidhin kontrata me ato kosovare, duke e parë praktikën e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe praktikën e moszbatimit të këtyre kontratave nga gjykatat.

I vetmi ligj që po sundon për momentin në Kosovë, është ai i kërimit të përqindjes si mitë nga bizneset që duan të investojnë. Ky është ligji, të cilit nuk mund t'i ikën askush nga bizneset dhe natyrisht që ato që nuk i pranojnë këto kushte edhe nuk lejohen të investojnë dhe rezultati dihet - bizneset ikin, investitorët potencialë ikin dhe qytetarët e Kosovës po ashtu duan të ikin, sepse kjo Qeveri nuk u ofron perspektivë, nuk u ofron jetë normale, nuk u ofron punësim në bazë të meritave, e nuk ua ofron as mundësinë minimale për zhvillim dhe shfrytëzim të potencialeve të tyre.

Militantizmi partiak apo lidhjet familjare me PDK-në janë dy kriteret e vetme që duhet plotësuar për punësim në sektorin publik, por në masë të madhe edhe në atë privat, të cilin e ka zaptuar partia në pushtet. Raportet e tjera ndërkombëtare, siç është ai i 'Transparens International' dhe 'Freedom House' e vërtetojnë mungesën e transparencës dhe të fjalës së lirë në Kosovë. Qeveria e fsheh nga qytetarët çdo dokument apo kontratë me interes publik, përdërisa vazhdon ta shtypë fjalën e atyre që e ngrenë zërin kundër këtyre fenomeneve.

Për më tepër, strategjia e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim i konfirmon këto sfida dhe faktin që ato ekzistojnë kryesisht për shkak të gabimeve në qeverisje, duke e përmendur kështu rritjen e inflacionit dhe të dukurive të tjera të cilat natyrisht po ndikojnë zhvillimin ekonomik. Të gjitha këto konstatime thonë se reformat për të cilat flet Qeveria nuk janë duke ecur përpara, por përkundrazi ka ngecje të mëdha.

BERZH-i konfirmon se reformat strukturore pengohen nga kapaciteti i ulët institucional dhe administrativ, dekurajomi i investitorëve dhe zhvendosja e vëmendjes së politikëbërësve nga zbatimi i reformave gjithëpërfshirëse strukturore. Prandaj, nga këta politikëbërës, që nuk janë të interesuar për zbatim të ligjit dhe reforma e esenciale nuk mund të pritët as zhvillim ekonomik. E vetmja që mund të pritët nga kjo Qeveri, është ngritja e pozitës së Kosovës në indeksin e mjerimit. Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministri Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që të flas për dy tema: e para do të jetë për kontributin e Ministrisë së Drejtësisë në zhvillimin ekonomik dhe, e dyta, pak sa e imponuar, për diskursin në tërësi për politikën e Kosovës, në veçanti këtë Kuvend, duke filluar prej koleges sime Vjosës.

Më lejoni të them që Ministria e Drejtësisë, në kuadër të kompetencave të saj që i ka, ka tentuar që të kontribuojë drejtpërdrejt në mundësinë për zhvillim ekonomik, në krijimin e kushteve më të mira, në veçanti në kushtet ligjore që nga fillimi, të ndërtimit të mundësive për biznes në ushtrimin e tij e deri në realizimin e të drejtave të tyre dhe

ekzekutimin e vendimeve në raste të caktuara kur ato nuk ekzekutohen me vullnet. Ne kemi ndërtuar një varg mekanizmesh, që pastaj mbeten punë e implementimit të sistemeve tjera. Më lejoni të ju njoftoj, të nderuar deputetë, se ne tanimë kemi filluar me arbitrazhin në Republikën e Kosovës, që është një pozitivitet besoj në sistemin juridik të vendit tonë, një mundësi shumë më e madhe për njerëzit e biznesit dhe po ashtu dua të them një mundësi shumë më e mirë që të zgjidhen kontestet ndërmjet subjekteve ekonomike më shpejt, me më efikasitet dhe besojmë në mënyrë më profesionale. Natyrisht që këtu e kemi plotësuar Ligjin për procedurën kontestimore, që e ka eliminuar gjithë kolizionin me Ligjin për arbitrazhin dhe po ashtu dua të them që e kemi ndërtuar ligjin e ri për arbitrazhin, i cili tanimë është më funksional dhe ju njoftoj me kënaqësi se ka raste që në Kosovë tanimë zgjidhen konteste nëpërmjet arbitrazheve.

Po ashtu, më lejoni, në këtë drejtim, të them që zgjidhja alternative në drejtësi që e kemi funksionalizuar tani më sistemin e noterisë në Republikën e Kosovës dhe ky sistem tanimë është më funksional. Tani njerëzit i zgjidhin problemet e tyre në këtë sistem, pa pritur në radhë nëpër gjykata, besoj më shpejt dhe në mënyrë profesionale. Këtij sistemi brenda muajit prill do t'i bashkëngjiten edhe 40 noterë të rinj. Më lejoni të them që gjatë këtij mandati të qeverisjes, si ministër i Drejtësisë, e kemi miratuar Ligjin për detyrime, natyrisht për marrëdhënien e detyrimeve me mbështetjen e Kuvendit të Kosovës, ku e kemi ndërtuar një mundësi të madhe për ndërtimin e së drejtës private, nëse më lejohet ta them, në përgjithësi, dhe për përmirësimin e ambientit më të mirë për subjektet ekonomike, në veçanti në fushën kontraktuale.

Gjatë hartimit të këtyre ligjeve gjithmonë i kemi marrë parasysh edhe subjektet ekonomike nga biznesi privat, por dhe nga subjektet ekonomike publike. Ne kemi ndërtuar dhe tanimë është miratuar Ligji për procedurë përmbarimore, dhe në këtë sistem kemi përfshirë tanimë, përveç përmbaruesve publikë, nga 1 janari i vitit 2014, edhe përmbaruesit privatë që do të na ndihmojnë shumë në ekzekutimin e vendimeve, të cilat vijnë nga procedura jokontestimore dhe të cilët do të ndihmojnë përmbaruesve privat t'i kryejnë edhe obligimet në mes të subjekteve të ndryshme ekonomike.

Më lejoni të theksoj që ne kemi ndihmuar në zbatimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim, duke përgatitur akte nënligjore dhe tanimë e kemi filluar procedurën dhe kemi emëruar administratorët likuidues. Natyrisht që Gjyqësori në këtë drejtim do ta ketë punën më të madhe dhe përgjegjësinë. Më lejoni të them që e kemi filluar nismën për ta rregulluar çështjen e pronësisë në Kosovë, përfshirë edhe kthimin apo ristituimin e pronës dhe hartimin e kodit të ri në Republikën e Kosovës, që do të ketë reflektim të madh në fushën e ekonomisë.

Ne i kemi edhe disa ide, besoj se do ta kemi mbështetjen edhe të Kuvendit, që përveç në strukturimin e gjykatave, që i kemi themeluar tanimë degët e veçanta që merren me çështje ekonomike në gjykatat themelore, unë e kam një ide që ta kemi një departament të veçantë për investorët e huaj dhe po ashtu një grup punues për zgjidhjen e lëndëve të pazgjidhura, i cili do të funksiononte për mandatin dyvjeçar në Republikën e Kosovës.

Më lejoni, të nderuar deputetë, të merrem pak edhe me diskursin që po përmendet këtu. Është e vërtetë që debati ka inercion dhe këtë inercion nëse ne do ta themi që gjendja ekonomike në Kosovë është pozitive në tërësi, do të ishte pak iluzore, por edhe ata që po thënë se nuk ka ndodhur asgjë në Kosovë, po ashtu janë në të njëjtën vijë dhe inercioni për të keq shkon më shumë se për të mirë. E di që po ju them shumë kur po e kritikojmë Prishtinën, por për nder edhe po na dhembë kur po na kritikoni, kështu që ta keni parasysh sa herë që hapni debat, sa herë që bëni tema të tilla dhe fitoni nga një logjikë, prej vajtimit deri në ofendime, unë po them do të jemi të kujdesshëm. Po na e testoni durimin nga pak, e mos na e testoni durimin me fjalë të tilla, të cilat nganjëherë nuk u takojnë deputetëve të Kuvendit.

Ju mund të thoni ide, mund të thoni kritika, mund të thoni alternativa, e ne po i kemi tri lloj diskursesh këtu. Diskursin opozitar e kuptoj në tërësi, absolutisht, unë kam qenë vetë, kam qenë njëri prej atyre të zëshëm që kam qenë në emër të diskursit opozitar dhe e kuptoj këtë. E kuptoj edhe diskursin që dëshiron të bëjë promovime ose partiake, dhe në këtë drejtim Lëvizja “Vetëvendosje” e tha një variant, zoti Kurti, që po më vjen që nuk është këtu, ose zoti Ymeri, që është i pranishëm, dhe unë besoj se varianti i tyre është për fushatë elektorale. Ne kemi koncepte të ndryshme filozofike, në momentin që i fiton votat e heq TVSH-në, i bën të gjitha tjerat.

Por çka dua të them? Propozimet që vijnë, prej kujtdo të jenë, duhet të jenë funksionale për Kosovë. Unë e them shpeshherë, edhe për ekonomi. Rrobaqepësi më i mirë botë nuk mund t’i presë rrobat mirë nëse nuk e mat trupin. Nuk i bien Kosovës të gjitha ligjet, të gjitha librat. Kosovës i bien tamam vetëm ato që janë për Kosovën, me modele të mira, me orientim kah të tjerët.

Një diskurs tjetër i tretë, që besoj se ky duhet të jetë, është diskursi që unë e bëjë një dallim, edhe prej asaj që kam dëgjuar dhe kam lexuar, mes burrërisë dhe trimërisë. Trimëria është ta ruash veten prej të tjerëve, burrëria është t’i ruash të tjerët prej vetes. Po na e testoni pak burrërinë, dhe po e them në këtë drejtim, mos na vini në pozita, edhe kolegja ime Vjosa, ‘kjo Qeveri, këta njerëz’. Mos e bëni atë logjikë, se po të flas unë, tani edhe unë them kjo opozitë. Nuk shkon ashtu. Nuk i ndihmohet vendit me këtë diskurs. Vendit i ndihmohet duke na kritikuar, duke na përmirësuar, duke na korrigjuar, por në momente të caktuara. E tha zoti Osmani, që unë e marr si pozitive, nëse është e gatshme Lidhja Demokratike, unë po them në emër të Qeverisë, pajtohem për një grup të përbashkët.

Çështja e sigurisë, çështja e ekonomisë, çështjet e drejtësisë, nuk janë çështje të një mandati qeveritar. Nuk pajtohem me diskursin tonë që themi kjo Qeveri para dy vjetëve keni bërë kështu, ju LDK-ja që keni qenë me ne, se pikë të referencës, po më vjen keq ta them, nuk e kam para dy vjetësh, as në jetën time, as para pesë vjetëve. Pikë të referencës e kam kah duam të shkojmë. Po ta krahasoj veten me disa, unë, po e zëmë, po të shkoj në fshatin tim dal më i mençuri ndoshta, kur po dal më jashtë po e shoh që ka edhe të tjerë më të mençur. Ta bëjmë një logjikë kështu: a e bëjmë logjikën krahasuese me pozitivitetet dhe logjika krahasuese me pozitivitetet na ndihmon edhe juve, edhe neve, edhe të gjithë të tjerëve. Dhe, unë e them në momente kur një vend, një individ, një parti nuk ka filozofi

politike, politikën e bën personale dhe unë po e them që vlerat nuk i takojnë një partie, një individ.

O ka vlera të përbashkëta ky vend, o nuk ka asnjë. Por, në asnjë parti nuk janë krejt engjëj, në asnjë parti nuk janë krejt dreqër. Mos na e bëni kështu logjikën partizanë-gjermanë, pothuaj bardh e zi. Bëjeni pak më ndryshe. Dhe po, janë frikësuar një herë. Në Kuvendin e Kosovës kanë thënë kështu: Po frikësohemi që po doni të na detyroni të koritemi. Singërisht e kam. Dhe, nëse dikush e thotë në këtë vend, po e marr shembull, më vjen keq që nuk është zoti Gjini, 'shkofsh e mos u kthefsh!' Mos, se edhe ne kemi fëmijë, edhe na kemi familje, mos na detyro të themi 'edhe ti shkofsh e mos u kthefsh!', se nuk fiton vendi kështu.

Logjika jonë do të jetë kështu: cila është alternativa për vendin? Dhe, në fund, më lejoni të them pak për këtë logjikën provincialiste. Diskursin që e e përmendi profesori Sabri, po e përmendi kështu me emër, unë e kuptoj si diskurs të logjikës integruese. Prishtina dhe Kosova janë vendet më integruese në shqiptari, dhe unë besoj jam prej një atyre. Unë kam jetuar më shumë në Prishtinë se në vendin e lindjes. Besoj edhe shumica prej neve. Por, logjika, nëse e bën një parti politike, që mund ta udhëheqësh Prishtinën ose jo, nëse ke lindur ose jo, është e gabuar. Pse e them këtë? Nëse e konsideroni si sundimtar kryetarin e Prishtinës, nuk bën të udhëheqë dikush prej Dukagjini, prej Drenice. Nëse e konsideroni si shërbëtor, bën. Unë po ju them, në Slloveni, një mjek që ka ardhur ka punuar atje, është i racës së zezë dhe ai tani është kryetar i një qyteti. Çfarë dua të them? Mos na sillni në pozitën që 'ju nuk jeni të Prishtinës, nuk keni shans', ose e kundërta. Ne nuk jemi fajtorë ku kemi lindur, por jemi me fat që kemi lindur në Kosovë.

Po e them shumë shkurtimisht, shtetësia nënkupton lidhje juridike me një shtet që fiton të drejta ekonomike, politike sociale. Kush e ka vendbanimin në Prishtinë është i Prishtinës, kush është shtetas i Kosovës, është i Kosovës. Të mos i bëjmë këto dallime dhe krejt në fund, ajo që to të them, politika, në veçanti ata që kanë qenë, në institucione, e di çka i ndihmon njeriut? Asgjë mos i ndihmoftë, ia heq pak iluzionet. Unë kam pasur iluzione më të mëdha pa hyrë në institucione. Kur hyn brenda në institucione, e sheh që nuk fluturohet pak krahë. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër, unë besoj që ju e kuptoni që mbi 80% të asaj që unë sot e lexova, është pjesë nga raporti i fizibilitetit, siç edhe e citova, nga strategjia e BERZH-it, siç edhe e citova, nga raportet e Transparens International dhe 'Freedom House' dhe, në fund, nga 'Indexi i Mjerimit'. Në qoftë se mendoni edhe këto organizata ndërkombëtare po ju bëjnë opozitë, unë mendoj që kritikën më mirë është të pranohen si të tilla dhe të adresohen, sesa të merren si lëndim i burrërisë, siç e karakterizuat ju.

Së dyti, një gjë që e thashë, që imazhi ndërkombëtar i Kosovës, është përkeqësuar me skandalet e fundit në fushën e sundimit të ligjit, ishte citim nga ministrja e Integritetit Evropian, zonja Vlora Çitaku. Pra, krejt çka thashë nuk ishin kualifikimet që i kam bërë

unë sot, janë kualifikime që i kanë pranuar edhe anëtarët e Qeverisë së Kosovës, por i kanë theksuar edhe organizatat ndërkombëtare. Përfundimisht, unë pajtohem me ju që duhet ta kemi logjikën e integritetit për një fushë kaq të rëndësishme për vendin në interes të qytetarëve, prandaj në qoftë se të gjithë duam ta japim këtë mesazh, duhet t'i votojmë rekomandimet që i ka propozuar LDK-ja sot në këtë debat.

KRYETARI: Urdhëro, një minutë!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

E nderuara kolege Vjosa,

Unë po e kundërshtoj dhe në këtë Kuvend i kundërshtoj mendimet tua, qëndrimet tua. Profesori Hamiti dje tha me të drejtë që këtu e përfaqëson dike dhe këtu e përfaqëson popullin dhe ata votues tu, unë me ta e kam respektin për ju personalisht, por edhe për ata që i përfaqësoni. Çfarë shkruan nëpër organizata, ne për atë e kemi dhënë mendimin dhe ju nuk jeni duke i dhënë lajmet këtu, por jeni duke folur si deputete. Përndryshe, unë i marr ato, i hap në internet, i lexoj në lajme dhe i kryejmë ato punë. Unë besoj që kjo është politikë, nuk është më të thuhet i kam lexuar. Po i marrin gazetatat, po ua shpërndajmë deputetëve dhe po merremi me gazeta.

KRYETARI: Ju lutem, nuk ta ka përmendur emrin, më duket. Ia ka përmendur. Replikë, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

E tha zëvendëskryeministri Kuçi se "Vetëvendosje" po bën fushatë. Pak a shumë kështu e tha, nëpërmjet Albin Kurtit dhe Visar Ymerit. Unë mendoj që askund më e vlefshme sesa këtu nuk është fjalia, që në fakt kategorizuesi ose kategorizimi flet më shumë për kategorizuesin sesa për të kategorizuarit. Pra, kjo që ju vazhdimisht secilën lëvizje të "Vetëvendosjes", çka do që bën "Vetëvendosje", e cilësoni si fushatë elektorale të "Vetëvendosjes", tregon se ju në fakt mendoni përherë vetëm për fushatë elektorale. Pra, tregon më shumë për vete, sesa për ne.

E dyta, natyrisht që kemi programe të ndryshme, dhe ku do të ishte ideja e pluralitetit politik po të ishim pajtuar të gjithë? Atëherë nuk do të kishte nevojë të kemi subjekte të ndryshme politike dhe programe të ndryshme, apo jo? Do të kishim qenë vetëm në një, partia-shtet, atë që me gjasë ju, në deklaratimet tuaja, të paktën, edhe po synoni ta bëni.

Edhe çështja është që programi ynë është ai që ne mendojmë që është më i miri për Kosovën. E këtë e argumentojmë. Pra, kemi program politik, kemi alternativë qeverisëse, e cila merret me të gjitha sferat e rëndësishme të funksionimit të shoqërisë dhe atë mendojmë që ne ta zbatojmë. Natyrisht që nuk jemi këtu në Kuvend të ju japim juve ide që ju t'i zbatoni për shkak se përbrenda një politike të keqe, një ide e mirë nuk bën asgjë, përveçse i ndihmon politikës së keqe për t'u zgjeruar, prandaj edhe nuk ka kuptim kjo 'na jepni disa ide, e ne i zbatojmë', për shkak se as nuk i zbatoni, e edhe nëse i zbatoni, i zbatoni për të keq. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, shkurt, a!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Zoti Ymeri, unë për vete prej asaj dite që jam në politikë bëj fushat çdo ditë dhe kjo është normale. Ai që është në politikë e nuk bën fushatë, duhet ta lërë politikën. Nuk është gjë e keqe të thuhet se po bën fushatë, por a s'është e keqe të tregoj unë që ma bëre për fushatë këtë fjalim. Edhe ti thuamë mua se po bëj fushatë. Por, ajo çka dua ta themi ne, ne kemi dallime, e thatë në prezantimin tuaj, konceptuale. Këto dallime i pranoj, po i pranoni ju vetë, edhe ne po i pranojmë. Dallimet janë kështu: ju dilni para qytetarëve, i fitoni votat, i sillni ligjet, e hiqni TVSH-në që e përmendet. Ne i kemi fituar votat, po i sjellim këto ligje. Kjo logjika demokratike, ana tjetër, edhe ju në opozitë, edhe ne e mbrojmë interesin publik. Mos thuaj, unë nuk jap ide. Ti duhet të japësh ide për interesin publik. Ne dallohemi aty ku ju mendoni që nuk po e mbrojmë interesin publik. Aty ku mbrohet interesi publik, ne duhet të jemi të përbashkët, nuk është me rëndësi e kryen Hajredini apo Visari këtë punë. Pozita dhe opozita janë pjesë e Kosovës, pjesë e spektrit politik dhe nëse flitet për logjikë institucionale, edhe ju jeni pjesë e kësaj logjike.

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar!

Zoti Kuçi, zëvendëskryeministër me funksion,

Shiko, unë i kam thënë tri fjalë sot dhe mund t'i përsëris edhe tridhjetë mijë herë. Problemi është nëse i kuptojnë njerëzit drejt. Ashiqare nuk janë kuptuar drejt. Nëse ju mendoni që unë e identifikoj Komunën e Prishtinës, pra Prishtinën, qendrën, me Isa Mustafën, jeni naivë. Nëse ju mendoni që kur unë flas për Kosovën e identifikoj me Hashim Thaçin, se është kryeministër i Kosovës, ju jeni dy herë naivë. Jo, nuk po thua ti, por kushdo që e mendon, prandaj është simplifikuar krejt gabimisht.

Unë kam folur për Prishtinën si institucion, si mile, si mes, si nivel, si standard dhe e kam thënë atë që e kam thënë, nuk po e përsëris, por raporti në këto mile i njerëzimit kudo, hajde po themi me Parisin, apo kë të doni, me Madridin, ka parisienë dhe parinisuar, të londonizuar, të kalifornizuar. Ky është problemi i njeriut që e dëshiron një vend tjetër dhe e do, por meqë e do e idealizon dhe kur mbërrin atje nuk është krejt si e ka fantazuar dhe ia nis e kritikon, dhe tash kalojmë te lakmia. Raporti ndërmjet dashurisë dhe lakmisë është universal. Kuptojeni çfarë kam dashur të them. Kështu mendoj, kështu mendoj edhe sot, edhe nesër, edhe pasnesër. Kjo nuk ka të bëjë me fushatë zgjedhore. Unë kur dal të bëj fushatë zgjedhore, unë them filani është më i miri, me emër. Nuk ka pasur të bëjë kjo me këtë. Kjo ka të bëjë me kriteret e një vendi që e krijon një standard dhe njeriu e idealizon, kërkon edhe më tepër që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, kundër-replikë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Unë besoj se edhe në fjalën time e bëra një dallim ndërmjet asaj që keni thënë ju dhe besoj që e kam kuptuar drejt dhe dua të besoj që ashtu keni thënë, që ka logjikë integruese. Por, nëse në politikën time, në jetën time, unë i lidhi nga pak mozaikun, nëse

e shoh çfarë ka thënë Lidhja Demokratike para një viti, para 6 muajve, para tre muajve, që e thonë disa deputetë sot, po mundohem ta bind LDK-në që Prishtina nuk është LDK, që as Kosova nuk është PD, por pak më gjerë, dhe njerëzit kur flasin për Prishtinën, shumica e tyre po e marrin si raport personal me Isa Mustafën ose me LDK-në. Unë nuk i shoh ashtu. Ky është mendimi im dhe po ashtu dua ta them logjikën e ndërdijes kulturore, që po e përmendni Profesor, te kuptimi i integritetit, provincializmi, është krejt çështje tjetër. Por, qasja politike, nëse thotë - tash po jam më konkret, nëse thotë dikush prej jush 'kujt nuk i pëlqen Prishtina, le të kthehet prej nga ka ardhur', për mua në ndërdijen e tij është esencë e racizmit. Unë po e them shumë publikisht.

Në anën tjetër, debati që ka të bëjë me ju, nuk ka të bëjë me qasjen, se unë nuk besoj kurrë që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: E kemi në debat zhvillimin ekonomik. Faleminderit! Arben Gashi e ka fjalën

ARBEN GASHI: Faleminderit!

U bë interesant kjo dashuria për qytetin dhe kryeqytetin, edhe për vendin, dhe besoj që dashuria dhe emocioni duhet ta përcjellin shoqërinë. Gjithmonë dashuria është emocion, varet qysh e interpreton.

Mirëpo, të kthehemi te koncepti ekonomik, i cili sot nuk u prezantua këtu. Koncepti ekonomik nuk u paraqit prej Qeverisë dhe ne nuk pamë realisht se çfarë koncepti ekonomik ka kjo Qeveri - konceptin e zhvillimit ekonomik. Ajo çka kryeministri në mëngjes, ishte një paraqitje segmentare e mundësive që nëpërmjet buxhetit të shtetit të ketë përmirësim të kualitetit të jetës. Është një rrugë, mirëpo nuk është mozaik i zhvillimit ekonomik, sepse zhvillimi ekonomik është më i gjerë, është kualitet qeverisjeje, është kualitet shërbimesh, është kualitet mundësish dhe është program, mbi të gjitha.

Çka nënkuptojmë me program? Me program nënkuptojmë, jo vetëm programin për ndërtim rrugësh dhe autostradash, që janë të mira, por nënkuptojmë program për mundësi zhvillimi, nënkuptojmë program për qasje në mjete financiare, nënkuptojmë program që këto mjete financiare të kushtojnë më lirë, nënkuptojmë program që këto mjete financiare të kthehen në zhvillim ekonomik.

Nëse e marrim dhe e shohim se çfarë i ka ndodhur këtij vendi në 14 vjetët e fundit - ju e dini se rreth 800 milionë euro nga Fondi i Privatizimit janë jashtë Kosovës. Ju e dini se rreth 800 milionë euro nga Fondi Pensional janë jashtë Kosovës. Ju e dini që rreth 800 milionë euro që kanë shkuar për autostradën, pjesa më e madhe e tyre janë jashtë Kosovës. Ju e dini që 140 milionë euro nga institucionet mirofinanciare dhe institucionet financiare jobankare janë abuzuar dhe janë keqpërdorur. Ju e dini që norma e interesit e kredive është më e larta në rajon. Ju e dini që këto elemente, kur mbledhen së bashku,

kalojnë 2,5 miliardë euro dhe këtij vendi të varfër t'i merren 2,5 miliardë euro nuk besoj që mund të thoni se po bëni zhvillim ekonomik.

Nuk besoj se mund të thoni ka qasje për zhvillim ekonomik. Nuk besoj që ju mund të thoni sot se ne, nëse e shesim Postën e Kosovës 400 milionë euro dhe këto 400 milionë euro i futim në autostradën që shkon për Shkup, ne ia kemi garantuar zhvillimin ekonomik vendit. Nuk besoj që e thoni këtë. Nuk besoj se ju mund të thoni se ne e shitëm 25 milionë euro Distribucionin e KEK-ut dhe kjo shitje apo dhënie me konsesion ia ka garantuar furnizimin me energji elektrike vendit, apo kualitetin e ofrimit të energjisë elektrike. Nuk besoj që i thoni këto, se nëse i thoni - nuk e thoni të vërtetën dhe kur nuk e thoni të vërtetën po i bëni një shërbim të keq vendit.

Prandaj, ne duhet të shohim se si ta ndërtojmë konceptin e zhvillimit ekonomik. Koncepti i zhvillimit ekonomik është koncept i promovimit, koncept i ndërtimit, koncept i ofrimit, koncept i dhënies së mundësisë, qasjes në mjete financiare dhe koncept i mundësisë që këto mjete financiare të kthehen në zhvillim dhe ky zhvillim të kthehet në prodhim dhe ky prodhim të kthehet në konsum dhe ky konsum të kthehet po ashtu në mirëqenie, dhe ky prodhim, përveçse në konsum, të kthehet edhe në eksport, dhe ky eksport ta ulë importin. Sepse, ju e dini, se përveç këtyre, tri herë nga 800 milionë euro që i përmenda, janë edhe nja 600 milionë euro tjera që shkojnë për të blerë mallra jashtë Kosovës. 600 milionë euro në vit ne importojmë vetëm mallra të konsumit dhe këto mallra të konsumit janë mallra për të cilat paratë dalin jashtë. Ne i konsumojmë, e nuk gjenerojmë zhvillim.

U fol këtu shumë për konceptin e zhvillimit ekonomik, që e ka Prishtina. Nuk desha të lëshohem në këtë temë, por meqë po e kanë kaq për qejf po lëshohem. Ju e dini, zëvendëskryeministra dhe ministra, që Prishtina është qendra e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ju e dini se aktiviteti kryesor ekonomik në Kosovë është ndërtimi. Ju e dini se këto vitet e fundit, mbi 80% e aktivitetit të ndërtimit zhvillohet në komunën e Prishtinës. Ju e dini se nëpërmjet të zhvillimit të aktivitetit të ndërtimit, jepet mundësi e efektit të multiplikatorit, sepse rritet tregtia, rritet qarkullimi i parasë, garantohet zhvillimi i sistemit bankar, sepse njerëzit që blejnë banim, shtëpi banimi, ata marrin kredi dhe duke marrë kredi bëjnë qarkullim nëpër banka, dhe në të njëjtën kohë rritet edhe tregtia, sepse ato shtëpi së pari duhet të ndërtohen, pastaj duhet të furnizohen dhe duhet të mirëmbahen.

Përveç çështjes sociale që rritet, mirëqenia sociale nëpërmjet rritjes së banimit, rritet qarkullimi ekonomik, rritet qarkullimi tregtar dhe rritet mundësia e zhvillimit ekonomik. Kjo është ajo që zhvillohet në komunën e Prishtinës. Ju e dini se disa qindra miliona euro aktivitet ekonomik zhvillohet në komunën e Prishtinës. Nëse nuk i dini, dilni pak në ballkonin e Kuvendit dhe i shihni ndërtesat të cilat bëhen, ndërtesat të cilat janë me plan rregullativ, ndërtesat të cilat janë me leje, ndërtesat për të cilat lejet i ka Komuna e Prishtinës, e kjo që ju thoni se Komuna nuk po zhvillohet, Prishtina nuk po zhvillohet, është demagogji. Sikur të thoshte dikush se nuk është ndërtuar rruga, rruga është ndërtuar. Se cila rrugë është ajo, ndoshta është rruga që çon te shtëpia e kryeministrit, ndoshta te shtëpia ime, ndoshta te shtëpia e atij tjetrit, por pak rëndësi ka kjo. Rëndësi ka që të shihen të dhënat makroekonomike dhe rëndësi ka që të shihet se si kjo po ndikon në zhvillimin ekonomik dhe ndikimi i zhvillimit ekonomik nga aktiviteti ekonomik dhe

mundësia për aktivitet ekonomik në komunën e Prishtinës është jashtëzakonisht e madhe, është e pakrahasueshme dhe është bartëse kryesore e zhvillimit ekonomik në Kosovës, e këtë nuk mund ta mohoni. Nuk mund ta mohoj askush, sepse është e vërtetë, sepse kjo mund të shihet me sy. Ju mund ta shihni zonën e Arbërisë apo ish-Dragodanit. Janë me dhjetëra pallate që janë ndërtuar aty, të gjitha me leje, të gjitha të standardeve moderne. Aktivitet ekonomik është ai. Janë qindra milionë euro aty.

Shiheni çdo zonë të Prishtinës që ndërtohet. Ky është zhvillimi ekonomik dhe aty nuk ndërtojnë njerëzit e LDK-së, por edhe të LDK-së, edhe të PDK-së. Ndërtojnë njerëzit që kanë para, që kanë mundësi, që kanë ide, që kanë projekte, ndërtojnë zhvillojnë dhe japin aktivitet ekonomik në këtë vend. Prandaj, unë nuk mendoj se duhet të bastardizohet...

(Ndërhyrje e kryetarit: Paratë nuk dihet bash mirë kah janë.)

...atëherë nëse parat nuk dihet mirë kah janë, është një zgjidhje e lehtë. Janë krimet ekonomike, është Administrata Tatimore, sistemin e keni në dorë. Merrini, kontrollini, kush i ka të paligjshme, merreni dhe çojeni në burg. Kjo çështje është shumë e thjeshtë. Por, aktiviteti ekonomik si i tillë ndodh, se a është paraja e pastër a e papastër, unë nuk e marr përsipër ta them. Unë nuk garantoj se ajo para është e pastër apo e papastër, sepse unë e di se shumë njerëz që janë të lidhur edhe me kryeministrin edhe me Qeverinë, ndërtojnë. Ndërtojnë plot ndërtesa dhe shumë mirë që ndërtojnë. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që i kanë paratë e pastra apo të papastra.

Prandaj, aktiviteti ekonomik që zhvillohet në Kosovë, kryesisht zhvillohet në Prishtinë, dhe koncepti ekonomik që i ofrohet nga Qeveria është ajo çka tha kryeministri këtu sot, është shitja e Postës - ndërtimi i autostradës. Po nis autostrada edhe për Shkup. Ju e dini çka ju tha FMN-ja. Fondi Monetar Ndërkombëtar para dy javësh këtu tha nuk mund të ndërtohet autostrada nëse nuk e shitni Postën. Duhet shitur Postën. Nëse nuk e shitni Postën, e futni buxhetin në krizë. Nëse e futini buxhetin në krizë, ju e dini se të gjithë treguesit janë për ngadalësim ekonomik. Kosova ka ngadalësim ekonomik dhe ky ngadalësim ekonomik është katastrofal. Kosova duhet pasur rritje dyshifrore për t'i zënë vendet e rajonit, e ju këtu flisni për gjërat që janë absolutisht jorelevante në situatën në të cilën gjendet vendi. Prandaj, mendoj se ne duhet të jemi të saktë dhe të shohim se cilat janë mundësitë dhe instrumentet që ne kapitalin ekonomik dhe financiar të Kosovës ta aktivizojmë, sepse janë minimalisht 2 miliardë e 400 milionë euro. Është kapital jashtëzakonisht i madh. Ky kapital i bllokuar. Një vendi të vogël me 1 milion e 800 000 banorë, nuk mund t'i thuash se janë investuar vitin e fundit 50 milionë euro, prej të cilave shumica janë para që janë gjeneruar në Kosovë dhe nuk janë eksportuar. Nuk janë dalë jashtë, por janë riinvestuar në Kosovë dhe keni thënë që janë investim direkt i jashtëm, se bie në kundërshtim me konceptin. Nuk mund të thoni që me 50 milionë euro investime të jashtme duam ta zhvillojmë vendin, kur i kemi 2 miliardë e 400 milionë euro tonat.

Kur na pyesin ndërkombëtarët pse nuk investoni, ne u themi sepse nuk ka instrumente të sigurta, sepse tregu është i pasigurt në Kosovë. Kjo është përgjigjja që e merr nëse shkon në cilindo prej institucioneve të Kosovës, bile edhe në Bankën Qendrore. Prandaj, ky

koncept i ekonomisë nuk është koncept i zhvillimit dhe kjo ekonomi nuk mund të zhvillohet kështu. Faleminderit!

KRYETARI: A ia përmendi emrin, a? Urdhëro, replikë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Zotit Gashi dua t'ia them tri gjëra për këtë që e përmende.

E para, edhe unë në diskutimin tim, por edhe në tëndin nuk the për filozofi ekonomike kurrëgjë dhe besoj se këtu jemi zero-zero. Pse po e them këtë? Ndërtimi i objekteve nuk është diçka që ti mund të lavdërosh që është filozofi ekonomike.

E dyta, kryeministri dhe të gjithë ne nuk po themi pse keni punuar, por pse nuk keni punuar më shumë. Kjo do të jetë.

E treta, po e them pak në shaka, kryesorja që më kupton drejt. Ia kemi gjetur çelësin, sa herë të doni të debatohet për diçka, do të flasim për Prishtinën dhe keni për t'u kthyer në Prishtinë.

RYETARI: Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BAERISHA-SHALA: Faleminderit kryetar!

Po bëhen gati 8 orë që ne po debatojmë për gjendjen ekonomike në Kosovë, dhe të debatosh për gjendjen ekonomike këtu në Parlamentin e Kosovës është një diçka e shëndetshme, është e mirë. Më mirë të debatohet këtu sesa në rrugë. Mirëpo, shpesh këto debate po rrëshqasin dhe po dalin nga qëllimi i vet dhe, siç tha më herët, diçka më ndryshe e formulojë kolegu Hydajet Hyseni, gati se po shndërrohen në një 'hajt pak', dhe nuk po nxirret esenca për të cilën edhe po thirren debatet.

Patëm rast ne, bashkërisht me qytetarët e Kosovës, të cilët na kanë ndjekur, të dëgjojmë debate prej më të ndryshmeve, me qasje ose diskurs, siç tha zëvendëskryeministri, afirmativ, me qasje negative mohuese, e pak pati qasje utilitare dhe të mesme, dhe ajo mbi të gjitha që mua më shqetëson është mirë që t'i kursejmë qytetarët e Kosovës nga terrorizimi me këto qasje skajshmërisht negative. Ne duhet ta pranojmë gjithsesi dhe duhet të dimë se gjendja ekonomike në Kosovë nuk është e mirë, ama ne duhet të dimë dhe ta pranojmë se është më mirë sesa ishte dhe duhet të përpiqemi dhe të punojmë që të bëhet më mirë se sa që është tani, dhe të gjithë kemi obligim, pavarësisht nga pozicionet në të cilat jemi, pozitë ose opozitë, çfarëdo detyre që kemi, shtetërore dhe profesionale.

Paradite patëm rast, në hapje të këtij debati, të dëgjojmë, ta quaj ekspozenë në emër të thirrësit të debatit, një fjalim, i cili mua personalisht më befasoi, dhe kur flasim këtu në ulëset e Parlamentit, në emër të Grupit Parlamentar, e kemi një përgjegjësi shumë më të madhe sesa kur flasim në emrin tonë personal si deputet. Dhe, ajo që mua më ra në sy, e midis tjerash, diskutuesi bëri krahasime banale. Më falni për shprehjen, në qoftë se mund ta përmend, bëri prapë krahasime dhe nuk po mund t'u ikën krahasimeve ndërmjet komunave të caktuara në kuptimin e zhvillimit dhe Prishtinës. Dhe ma kujtoi një seancë më herët para Vitit të Ri, kur këtu u bënë disa krahasime me Skenderajn dhe u alarmua e

lëshuan sallën deputetët e partisë së caktuar, dhe tani e bën një krahasim me Malishevën, për ç'gjë unë e kisha një sugjerim për kolegët e mi deputetë, se duhet të lirohen nga disa deputetë në LDK nga ajo mendësi e tillë, nuk po them të gjithë, le të lirohen, sepse në këtë mënyrë nuk mund ta marrin pushtetin derisa ta bindin veten se duhet t'i trajtojnë qytetarët e Kosovës të gjithë njëjtë, kudo që janë...

(Ndërhyrje e kryetarit: Ju lutem, përmbaju rendit të ditës!)

...në Deçan, në Malishevë, në Skenderaj dhe në Prishtinë.

Pikërisht në rendin e ditës jam, i nderuar kryetar i Parlamentit, se po flas në emrin tim personal dhe besoj që pasojat janë më pak sesa të flas në emër të një grupi në tërësi dhe e marr përgjegjësinë personale vetë.

Po të ishte këtu kolegja ime deputete, Teuta Sahatqija, do të thoshte se e kam marrë rolin e mësueses, për të cilën nuk e di se nxënëse e kujt është ajo. T'i kthehem tash debatit.

Kosova tashmë është përcaktuar për ekonomi të lirë të tregut, rritje të konkurrencës e tjera. Kështu që në këtë drejtim duhet punuar cilado qeveri, kjo edhe të tjerat që vijnë në vazhdim. Është e kuptueshme lehtë për dikë të dilet nga mendësia e përvojës shumëvjeçare për individë të caktuar sesa mosha e shtetit të Kosovës që të përcaktohet për ekonomi të lirë të tregut, sepse mendësia e tyre ka mbetur shumë mbrapa. Andaj, ne mund të debatojmë me ditë të tëra në rrjedhën se si po shkon ky debat dhe në fund të mos ngelë asgjë pozitive që do t'u ndihmonte që do të shkonin në favor të zhvillimit ekonomik.

Ajo që dëshiroj ta theksoj - është e ditur se Kosova ende ballafaqohet me shumë sfida. Këtë e dimë të gjithë. Duke dashur të mbështetem në debatin me shpresë të unifikimit të qasjeve pozitive, më lejoni të them se Kosova nga viti 2010, megjithatë, ka pasur një rritje të ndjeshme ekonomike dhe kjo duhet t'u thuhet qytetarëve të Kosovës, edhe pse ata e dinë, sepse të arriturat janë shumë të prekshme, përkundër asaj që kriza ekonomike ka përfshirë shumë shtete të botës. Përkundër shumë sfidave, nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë, Kosova viteve të fundit ka arritur të bëhet anëtare e institucioneve ndërkombëtare financiare, siç është Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Kështu, këto institucione do të vazhdojnë ta ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit. Dhe duhet ta themi se kjo është e rëndësishme, sepse Kosova nëpërmjet tyre do t'i realizojë projektet e mbetura nga segmentet e ndryshme zhvillimore, siç është infrastruktura, energjia, madje deri te sektori privat.

Anëtarësimi në këto institucione ndërkombëtare, si dhe anëtarësimi në mekanizmat e tjerë rajonalë, dëshmon qartë se Kosova ka arritur maturi shtetërore dhe kësaj duhet t'i gëzohemi të gjithë. Mandej, Kosova ka vizion dhe strategji konkrete për të realizuar prosperitet, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Krahas mbështetjes nga institucionet e lartpërmendura financiare, Qeveria e Kosovës ka punuar edhe në drejtimin e krijimit të politikave ekonomike në funksion të mbështetjes të

sektorit privat dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Mendoj që sektori privat duhet të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes ekonomike, se më herët njëri prej diskutuesve nga Lidhja Demokratike e përmendi dështimin e shumicës së ndërmarrjeve publike dhe ky është një tregues që ne duhet të ikim nga mendësia e ndërmarrjeve publike dhe sa më parë ta gjejmë një zgjidhje tjetër.

Identifikim i problemeve me të cilat ballafaqohet ky sektor janë disa nga hapat e rëndësishëm të Qeverisë për të siguruar që ky sektor të prodhojë efekte konkrete në ekonomi. Përmirësimi i imazhit të ndërmarrjeve vendore, duke garantuar që prodhimet vendore janë konform standardeve ndërkombëtare të kualitetit, trajtimi i barabartë i ndërmarrjeve vendore me ato të huaja, shkurtimi i procedurave për marrjen e lejeve dhe licenca në favor të përmirësimit të ambientit biznesor, janë disa nga parakushtet që çojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e nivelit të eksportit në tregjet e jashtme dhe kështu uljen e deficitit tregtar.

Duhet përmendur gjithashtu se stagnimi ekonomik, që është trashëguar edhe nga qeveritë e mëparshme, duhet të vazhdojë të jetë mësim për krijimin e politikave të reja zhvillimore, nëpërmjet të cilave do të arrihet qëllimi afatgjatë zhvillimor ekonomik, si gjenerator i ardhshëm i rritjes së eksportit dhe punësimit. Këto njëherësh janë edhe politikat që përfshijnë kriteret, në bazë të të cilave arrihet anëtarësimi në të ardhmen e Bashkimit Evropian si qëllim afatgjatë gjeostrategjik i Kosovës, për të cilin jemi të interesuar dhe duhet të angazhohemi të gjithë.

Mandej, mendoj që zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme duhet të jetë prioritet orientimi, sidomos në zonat rurale. Kjo do t'i ndihmonte shpopullimit të fshatrave, nxit zhvillimin bujqësor me të gjitha produktet bujqësore, e do të ndikojë, jo vetëm në uljen e importit, por do ketë një varg efektesh zinxhirore për vendet e punës, e kështu me radhë.

Krejt në fund, mendoj se ne si deputetë kemi obligim, para së gjithash, të interesohemi për ligje të mira, t'i monitorojmë ato ligje se sa janë në favor të zhvillimit ekonomik, gjithsesi bashkërisht t'i bashkojmë energjitë pozitive sepse kemi borxh karshi Kosovës dhe karshi qytetarëve të saj. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, përmbajuni pikës së rendit të ditës - zhvillimi ekonomik, se as raportet ndërkombëtare, e as anëtarësimi në institucionet ndërkombëtare nuk është zhvillim ekonomik. Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit kryesues!

Mirë që po na vjen rendi dikur dhe po jua përmend një fakt, zoti kryesues. Kur unë e kam shtypur butonin për ta kërkuar fjalën, dikush ka qenë jashtë shtetit. Mbajeni rendin se këtu s'ka deputet të rendit të parë dhe të rendit të dytë, dhe më lejoni...

KRYETARI: Deputete, merre fjalën, se unë e bëj rendin e mbledhjes.

LIRIJE KAJTAZI: ...të shërbehem me një fjalë të Sokratit që thotë kur ka takuar perandorë, ka thënë nëse kam parë njerëz nuk do të thotë që kam parë koka dhe mendje.

Prandaj, mos i bëni qejf vetes këtu që dikush është i rangut të parë, e dikush i rendit të dytë.

Një kohë të gjatë e konsumoi kryeministri, ia la amanet zëvendëskryeministrit, dhe ai në këtë formë, si zakonisht e merr edhe televizionin prapa, i cili është i disponuar veç fjalët e tij t'i reklamojë.

Çka mund të ofrojnë ata ndryshe? T'i pranojnë dështimet? Jo. T'i pranojnë aferat korruptive dhe kriminale që ia bëjnë ata Kosovës? Jo. Ta pranojnë se resurset e Kosovës po i hanë të verdha, të pranojnë se në vend të investimeve të mirëfillta ekonomike, ai krekoset se investon në politika sociale, me ç'rast e deformon zhvillimin e personalitetit të individit, apo e pasivizon, duke e shndërruar në lypsar, në mënyrë që më mirë t'i nënshtrohet regjimit të tij.

Normalisht se ai kurrë nuk mund t'i pranojë këto dhe, siç e pamë në fillim, krejt e devijon debatin, duke folur për çështje tjera.

Po është normale, aty ku nuk ka shtet ligjor, lejohet gjithçka.

Fjalën time e kam përqendruar në tri pika, në faktorët që ndikojnë në rritjen ekonomike, arsimimin në funksion të zhvillimit ekonomik. Sfidë mbetet sigurimi i cilësisë së aftësisimit që u përgjigjet nevojave të tregut të punës. Shumë katedra janë shndërruar vetëm në nivelin e përfitimit të një letre apo diplome universitare për një individ të caktuar sesa që kanë ndihmuar në ndërtimin e politikave të mirëfillta të një sektori të caktuar.

Sistemi i arsimit duhet të jetë në përputhje me nevojat e individëve, si e drejtë ekonomike e tregut, duke i shfrytëzuar në mënyrë optimale burimet njerëzore që shkojnë në zhvillim të politikave të shtetit, në funksion të politikave të shtetit.

Pati një zbrërthim më të gjerë zoti Kasolli dhe do ta reduktoj në këtë pjesë, ndërkohë që do të përqendrohem në pjesën e potencialit turistik që ka Kosova, që nuk shfrytëzohet, e që është në funksion të rritës ekonomike të saj.

Kosova shquhet për vlera të rralla të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Mungesa e investimeve në këtë drejtim, mungesa e promovimit të tyre, shfrytëzimi i pakontrolluar i lë të pashfrytëzuara këto segmente të zhvillimit ekonomik të rëndësishme për Kosovën, që do të kishin shërbyer me të madhe në zhvillimin e turizmit, rekreacionit, sportit dhe në çështje të shëndetësisë dhe të zhvillimit të përgjithshëm.

Malet, ujërat, shpellat, banjat shëruese, pasuritë minerale, llojet e ndryshme bimore e shtazore janë resurse shumë të rëndësishme për Kosovën, për të cilat pushtetarët kujtohen vetëm kur ua vënë syrin për uzurpim. Pjesëmarrja e madhe e ekonomisë turistike në produktin shoqëror vendor i zbulon dobësitë e sektorëve tjerë të ekonomisë.

Dhe, nga kjo do të lidhem në çështjen tjetër, në pjesën e tretë, te çështja e mërgimtarëve, i ashtuquajtur i turizëm i diasporës dhe krejt kjo po ashtu në funksion të zhvillimit ekonomik, çfarë politikash përdorim në trajtimin e diasporës, apo i kemi vetëm për t'i konsumuar.

Kosova kot pret edhe investime të huaja, kur këtë nuk mund ta bëjë as diaspora jonë, me gjithë dëshirën e madhe që të investojë në Kosovë. Këto i pengon sistemi tatimor, doganor, korrupsion i pasigurisë e tjera.

Studimet flasin se diaspora është fuqi e lartë ekonomike me kontributin e saj, qoftë si vizitorë, me dërgesa financiare, blerjen e mallrave, konsumin brenda, blerjen e pronave e tjera, që kjo Qeveri u vë barrierë mbi barrierë, taksë mbi taksë, e ata për çdo ditë nga barriera ndihen edhe më të largët, edhe më të huaj.

Si shenjë e pakujdesisë së kësaj Qeverie, bashkëvendësit tanë pas gjithë asaj pune në vendet tjera, nuk po mund t'i gëzojnë as pensionet, siç po ndodh me pensionet e pensionistëve tanë nga Zvicra, të cilët për shkak të një pune, për shkak të një marrëveshjeje që është dashur ta bëjë Qeveria jonë me shtetin zviceran, kanë ngelur pa i gëzuar këto pensione, disa edhe po vdesin, duke i pritur.

Është shumë e domosdoshme t'u thuhet atyre se sa të rëndësishme janë politikat e Kosovës, në mënyrë që të mos ndihen të huaj edhe në Kosovë, edhe në vendet në të cilat ata kanë shkuar.

Faleminderit për fjalën, e besoj se nëse e respektoni rendin, e respektoni edhe veten.

KRYETARI: E nderuara deputete, ke qenë e 26-ta me radhë, kur është bërë në fillim. Unë e kam listën këtu, vetëm 2 deputetë të Lidhjes Demokratike kanë folur para teje, ndoshta pa rend, e sidomos Arbeni dhe Vjosa, asnjë tjetër. Rendin e ke pasur kur ka folur Arbeni, e ke marrë ti. Por, që ta dini, neni 40, pika f, deputetët e tjerë diskutojnë për projektligjin ose mocionin përmbajtjesor, sipas rendit të caktuar nga kryetari i Kuvendit. Ky është pra neni 40, pika f e Rregullores së Kuvendit.

Unë isha korrekt, të tregova si ka qenë realisht. Absolutisht s'i kam hyrë në hak askujt. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Duke i përgëzuar iniciuesit e këtij debati dhe duke i përshëndetur të gjithë ata që kontribuan me diskutimet e tyre në këtë debat, do të mundohem që të mos i përsëris gjërat që u thanë nga parafolësit, si nga deputetët e opozitës, të pozitës, apo edhe nga ministrat e Qeverisë.

Siç e dimë të gjithë, ekonomia e Kosovës në vitin 1999 është shkatërruar gati 90% dhe deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës ajo ka qenë kryesisht e shtyrë nga ndihmat ndërkombëtare dhe për këtë nuk është befasi gjendja në të cilën jemi sot.

Që nga shpallja e pavarësisë e deri sot, kur po flasim, edhe pse jo në masë të kënaqshme, konsiderohet se janë bërë hapa të konsiderueshëm dhe janë marrë vendime të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe janë bërë hapa konkretë në reforma, si për shembull ulja e tatimeve në shkallën 10%, futja e arkave fiskale, ligji për lizing e tjera. Edhe anëtarësimi në institucionet financiare ndërkombëtare duhet vlerësuar dhe konsideruar si një hap i rëndësishëm për vendin.

Konsideroj që edhe më tutje duhet të fuzionohen të gjitha ministritë, të cilat i përfshijnë sektorët përkatës që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik.

Ministria e Ambientit duhet ta bëjë një plan të qartë në lidhje me tokat pjellore në Kosovë. Qytetarët e Kosovës duhet ta dinë se tokat pjellore nuk duhet dhe nuk mund të shndërrohen në vendbanime. Qeveria e Kosovës duhet edhe më tutje t'i stimulojë bujqit që ta punojnë tokën e tyre dhe të bëjë subvencionimin e fermerëve të suksesshëm, siç është duke bërë edhe tani. Të ulen taksat doganore për plehra dhe farat që duhen për ta mbjellë tokën. në mënyrë që të ndihmohet dhe inkurajohen bujqit që t'i kultivojnë tokat e tyre.

Duhet të ketë ndërhyrje në lirimin e naftës që përdoret për bujqësi, sepse me të vërtetë çmimi aktual i naftës është i papërbalueshëm për fermerët. Kosova i ka përparësitë e saj, sepse e ka një fuqi punëtore të re dhe në rritje, e cila ka nevojë për arsimim dhe trajnim, me qëllim të përmbushjes së nevojave të vendit për ekonomi të tregut.

Autostrada Vërmicë-Merdar, që është në përfundim e sipër, dhe autostrada Prishtinë-Shkup, që pritet të fillojë së shpejti, konsideroj se janë dy arterie kryesore dhe bazë e fortë e bashkëpunimit rajonal në zhvillimin ekonomik.

Qeveria e Kosovës duhet të vazhdojë edhe më tutje t'i japë prioritet sektorit privat, pasi ky sektor krijon kushte më të mira për punësim dhe të rinjtë tanë çdo ditë e më tepër po e gjejnë veten në këtë sektor.

Për fund, dua të them se edhe arsimimi i brezave e luan një rol shumë të fuqishëm për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, prandaj konsideroj se Qeveria duhet të investojë në kuadro deficitarë dhe të mendojë që për një periudhë të caktuar të mos prodhojë kuadro që në Kosovë, fatkeqësisht, janë në suficit të madh. Faleminderit!

KRYETARI: Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Ishte një debat bukur i gjatë, mendoj një debat i rëndësishëm, pasi zhvillimi ekonomik nuk është vetëm një temë, e cila duhet të flitet në debate, por është me të vërtetë diçka, të cilën qytetarët e Kosovës e kërkojnë dhe duhet të bëhet.

Por para se ta nis fjalimin, kisha dashur ta përmend edhe mënyrën sesi është zhvilluar debati. Mendoj se nuk ka qenë debat konstruktiv, pasi pa marrë parasysh a jemi pozitivë apo opozitivë, Kosova është e të gjithëve, dhe interesi ynë është që Kosova të zhvillohet ekonomikisht dhe mendoj që çdo fjalim yni, pa marrë parasysh a është kritikë, apo është lëvdatë, do të duhej që të shkojë në funksion të marrjes së vendimeve për t'u korrigjuar ato çka nuk janë në rregull.

E kolegja ime, Sala, unë e dëgjova, këtu isha, ajo ende nuk po mund të shkapet prej rolit të mësueses, sikur dje, edhe sot, që t'i mësojë deputetët çka duhet lexuar, menduar e si duhet votuar, por kësaj here e rriti atë dhe u shndërrua edhe në kujdestare të analizës së çdo fjalimi të deputetëve të LDK-së, që mendoj se nuk ka qenë intencë e këtij debati.

Por, gjithashtu, edhe prej ministrit të Zhvillimit Ekonomik e dëgjuam një fyerje të inteligjencës, kur na tha që duhet të jeni të sigurt që Distribucioni, edhe pse është shitur, këtu është. Ndoshta mendonte që është Distribucioni para autobusi, e po shkon në Turqi, po shqyr që mbeti këtu dhe ne do t'i shfrytëzojmë ato dhe mendoj se duhet të jemi pak më seriozë, të kemi pak më tepër respekt për njëri-tjetrin dhe për temën.

Gjithashtu, dëshiroj ta përsëris të vetmin ministër këtu, i cili qëndroi heroikisht dhe po e dëgjon debatin, ndërsa ata të cilët duhen, nuk janë këtu.

Ju lutem, fjalimin tim për këtë ta merrni me të vërtetë si një fjalim për Kosovën, dashamirës për Kosovën. Dhe, Kosova edhe pas 5 vjetësh pavarësie, ende nuk e ka vizionin apo strategjinë e zhvillimit ekonomik. Nuk dua të kthehem në luftën e para 13 vjetëve, apo në Luftën e Dytë Botërore, apo në kohën e Turqisë, apo në kohën kur kemi luftuar me romakët. Duhet të shohim sot dhe të punojmë për nesër.

Mungesa e planifikimit afatgjatë se nga do të shkojë Kosova me zhvillim dhe cilat do të jenë fushat apo sektorët bosht të zhvillimit, si do të orientohen sektorët mbështetës të fushave boshte, orientimi i planifikuar i edukimit për t'i mbështetur këto fusha. Kjo strategji e planifikimit do t'u jepte garanci edhe investitorëve të huaj, por edhe atyre vendorë se investimi i tyre do të jetë afatgjatë dhe profitabil, si dhe kuadrove të reja që dalin nga edukimi i planifikuar mbështetës do të sigurojnë punë të qëndrueshme dhe të dinjitetshme, e jo siç u pa nga hulumtimi i NDP-së që ata që e mbarojnë masterin janë të detyruar të punojnë si kamerierë apo automekanikë në mungesë të vendpunimeve adekuate për të cilat janë aftësuar për shkak të mungesës së një vizioni strategjik afatgjatë, që do t'i akomodonte këta të rinj në punë.

E shohim fatkeqësisht që vendimet nuk janë të planifikuara, por janë ad hoc dhe ndryshojnë nga dita në ditë, gjë që tregon se është larg planifikimit të duhur. Planifikimi i ndërtimit të Termocentralit "Kosova e Re" apo TCC, apo quajeni si të doni, sikur ka ndryshuar, sikur duke luajtur me shifra prej 2 000 megavatësh, 1 000 megavatësh, 2 herë nga 300 megavatë, pastaj kjo odise vazhdoi edhe me futjen e termocentralit B, e pastaj me heqjen nga pakoja tenderuese dhe shumë ndryshime tjera, vetëm që i trembën investitorët, në vend se t'i japin hapësirë të duhur biznesit dhe sektorit të energjisë, ku energjetika do të duhej të jetë fushë, e cila e ndihmon zhvillimin ekonomik, pasi asnjë

vend nuk mund ta paramendojë një zhvillim ekonomik nëse ekonomia nuk e ka një furnizim të sigurt me energji elektrike.

Duke pasur parasysh se Kosova fle mbi thëngjill dhe i cili është i qasshëm pa problem nga sipërfaqja, do të mund të konkludohej se në Kosovë nuk duhet të ketë probleme energjetike. Në fakt, Kosova ballafaqohet me probleme të shumta lidhur me energjetikën, e cila do të jetë edhe fusha të cilën dëshiroj ta mbuloj në hapësirën e zhvillimit ekonomik.

Kapacitetet gjeneruese dhe kapacitetet ekzistuese - e dimë që në vitin 2017 Kosova është si teknologji e vjetruar dhe si ndotëse e ambientit, duhet të ndalet. Këto janë edhe rekomandimet nga BE-ja dhe nuk pritet që Kosova do ta përmirësojë në afat të shkurtër problemin apo nevojën për energji elektrike. Por, përkundrazi, Kosova në të ardhmen e afërt do ta rrisë problemin me furnizim.

Çështja duket edhe më e rëndë, kur e kemi parasysh se edhe Kosova B ka nevojë për remont. Atëherë e shohim se shumë shpejt, një pjesë e madhe e buxhetit tonë që mblihdhet nga firma pak nga pak do të shkojë në blerjen e energjisë elektrike, gjë e cila do të ndikojë gjithashtu në ngritjen e çmimeve dhe në uljen e produktivitetit të kompanive.

Në qoftë se flasim për kapacitetet menaxhuese, në debatin e kaluar për energji faturat e janarit e tjera është parë mungesa enorme e kapaciteteve menaxhuese të KEK-ut, por edhe të Ministrisë së Zhvillimit. U përmend tenderi, i cili ndryshoi pandërprerë.

KEK-u është shndërruar, krahas në PTK, në byro punësimi, ku kualifikimi i nevojshëm është librezë partiake, e jo aftësia profesionale, që nuk do të duhej të ndodhte kështu.

Me rastin e Ferronikelit, ku për shkak të menaxhimit katastrofal nga KEK-u ka qenë i detyruar, paramendo, të importojë thëngjill në Kosovë.

Të gjitha këto rëndojnë mbi këtë sektor vital të ekonomisë dhe pengojnë që energjetika të jetë vërtet krah i zhvillimit ekonomik.

Në qoftë se flasim për linjën e interkonjeksionit, ministri na tha që çdo gjë është e kryer. Nuk është çdo gjë e kryer. Nuk është pengesa vetëm mospërgjegjja e Shqipërisë. Ka pengesa ende edhe në ministrinë e atij ministri, që mendon se Distribucioni është autobus i Turqisë.

Sistemi energjetik i Kosovës vazhdon të jetë një sistem shumë vulnerabil me mungesë të redundancës dhe mundësisë së zëvendësimit të kapaciteteve energjetike në rastin e remonteve, të avarisë apo të shpenzimeve të jashtëzakonshme. Sistemi ynë është ndërtuar shumë moti, e dimë, nga që ata pensionistë të cilëve ne s'po ua ofrojmë fort veshin, si pjesë e një sistemi energjetik jugosllav, i përbërë nga kapacitete të shumta termo dhe hidro, dhe mundësitë e mbulimit të njëri-tjetrit, sot ka mbetur si sistem i vetmuar, i rrethuar tashmë me shtete nga të cilat në rast të nevojës, do të thotë të një shpenzimi enorm e tjera, blen energji nëpërmjet vetëm një shteti, vetëm nëpërmjet sistemit energjetik të Serbisë. Dhe lidhja e interkonjeksionit 400 kilovoltë është e planifikuar ta

lidhë Kosovën me Shqipërinë si dy shtete me sisteme energjetike që e plotësojnë njëra-tjetrën, termon në Kosovë dhe hidron në Shqipëri, por kjo lidhje interkonjeksioni mbetet ende në letër dhe kjo neglizhencë vazhdon ta rëndojë qytetarin e Kosovës me çmime të larta të blerjes së energjisë dhe çmimet e ulëta dhe shitjes së energjisë nga sistemi ynë energjetik.

Në qoftë se flasim për energjinë e ripërtëritshme apo alternative, shihet se kjo energji nuk e paraqet vetëm një luks për konsumatorin tonë, por e paraqet një obligim ndërkombëtar për të mbuluar 20% e mbulimit me këtë lloj të energjisë, krahas me energjinë e fituar nga linjiti. Por, kompanitë vendore të cilat kanë dëshirë të merren me ndërtimin e kapaciteteve energjetike, përveç shumë pengesave, ballafaqohen edhe me vonesa enorme për marrjen e licencës dhe të kompetencave, si dhe pa dije për t'u përgjigjur.

Privatizimin e Distribucionit apo atij autobusi që shyqyr s'ka rrota e na mbetet këtu dhe mund ta shfrytëzojmë shërbimet e tij dhe të instalimit të njehsorëve digjitalë pas kryerjes së privatizimit, mendoj që është folur mjaft dhe nuk dëshiroj më tepër, se është një skandal i llojit të vet.

Kogjenerimi apo përqindja e shpenzimit të energjisë elektrike në Kosovë është më e madhe në sektorin e amvisërisë se sa në atë të biznesit. Nga ky numër e shohim mungesën e zhvillimit ekonomik dhe interesimit të të huajve për investime në Kosovë, por njëkohësisht edhe një politikë pa nikoqirllëk. Sistemi civil nuk po u mundëson qytetarëve që të përdorin mënyra tjera të ngrohjes, por mënyrën më të shtrenjtë të mundshme dhe atë të shndërrimit të nxehtësisë në energji dhe përsëri të energjisë elektrike me nxehtësi, për ç'gjë që është ngrohja më e shtrenjtë në botë.

Kogjenerimi ka mbetur fjalë në letër dhe ende larg ndërtimit. Dhe, përderisa nuk realizohet kjo, amvisëria do ta ketë primatin në shpenzimin e energjisë elektrike dhe do të tregojë që industria është vërtet larg të dëshiruarës.

Gjithashtu, këtu krahas me kogjenerimin, do të duhej që qytetari të ketë mundësi të blerjes së qymyrit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Pasi veç jemi në fund të debatit, fjalimin tim do t'ia dorëzoj Sekretarisë së Kuvendit për ta kursyer kohën tuaj. Faleminderit!

Diskutimi dorëzuar me shkrim

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Nuk duhet harruar se Kosova ishte vendi më i pazhvilluar në ish-Jugosllavi, ndërsa pas luftës ishte i shkatërruar pothuajse tërësisht, me shtëpi, shkolla, qytete, e fshatra tërësisht të shkatërruara. Rindërtimi i Kosovës filloi që nga rindërtimi i shtëpive, shollave dhe fabrikave.

Pas lufte, ekonomia kosovare gjendej në gjendje të mjerueshme, dhe kjo gjendje erdhi si pasojë e pushtuesit, i cili në vitet e '90-ta dhe gjatë luftës së fundit kishte shfrytëzuar, vjedhur, shkatërruar shumë fabrika dhe nuk kishte lejuar zhvillim ekonomik dhe investimet në Kosovë.

Kosova pas lufte dalëngadalë e fillon rimëkëmbjen ekonomike, duke filluar me investime dhe hapje të fabrikave dhe me nënshkrim të marrëveshjeve për tregti të lirë ndërmjet shteteve ballkanike. Gjithashtu, një gjë e tillë po vazhdon sot edhe me tregun ndërkombëtar.

Kur flasim për ekonomi, nuk duhet harruar rëndësinë e zhvillimit të infrastrukturës rrugore në zhvillim ekonomik. Investimet në infrastrukturën rrugore kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e zhvillimit ekonomik.

Përkundër vështirësive të krizës ekonomike globale dhe sfidave të ndryshme, ne prapë kemi arritur që të ecim me një rritje ekonomike, të gjithë e dëshirojmë që të jetë më shumë, por edhe kjo është për t'u vlerësuar.

Bizneset kanë arritur të prodhojnë ose të kryejnë shërbime të tjera dhe ta krijojnë një afarizëm të suksesshëm, përkundër vështirësive me të cilat janë ballafaquar ato.

Zhvillimi ekonomik i vendit varet edhe prej zhvillimit të sektorit privat dhe bizneseve, duke filluar prej ndërmarrjeve të vogla, të mesme, e deri te ato të mëdhatë. Zhvillimi i tyre varet prej shumë faktorëve, menaxhimit, planifikimit afarist, gjetjes së tregut dhe këtu mendoj se nevojitet edhe ndihma nga shteti, nëpërmjet infrastrukturës ligjore favorizuese, duke krijuar kushte më të mira për investime, me një strategji të qartë zhvillimore.

Një nga faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të një vendi është infrastruktura ligjore, për t'i thithur investimet e jashtme, dhe në këtë kuadër e kemi bërë dhe jemi duke e bërë infrastrukturën ligjore për të mirën e vendit tonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke parë krizën e shumë vendeve ballkanike, por edhe evropiane, në çdo strategji të zhvillimit ekonomik sot duhet pasur parasysh:

Evitimin e krizave dhe krijimin e bazës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet forcimit të strukturës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe nëpërmjet stimulimit të prodhimit industrial, përfshirë këtu bujqësinë dhe eksploatimin e minierave dhe të mineraleve. Që kjo strategji të ketë sukses, nevojiten investime të huaja me konceptet të qarta për nxitje të investimeve, duke i shfrytëzuar këtu edhe potencialet e diasporës sonë.

Me një punë të përbashkët dhe me një përkushtim të gjithëve, ne mund ta krijojmë një vend të zhvilluar. Sigurisht se sot si Kosovë jemi më mirë se kemi qenë dje, dhe në vitet ardhshme do të jemi edhe më mirë sesa jemi tani. Faleminderit!

Bekim Haxhiu, d.v.

KRYETARI: Qeveri, e doni fjalën që tash, a në fund? Në fund e ka Hykmetja.

(Ndërhyrje)

Kush e merr prej Qeverisë, merruni vesh. Urdhëro! Zëvendëskryeministri, zoti Kuçi e ka fjalën, pastaj Hykmete Bajrami e merr fjalën përfundimtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Pasi s'ka debatues tjerë, më lejoni që në emër të Qeverisë të ju falënderoj për debatin. Natyrisht të kërkoj mirëkuptimin tuaj edhe për ndonjë pikë, ose shkarje po e quaj, nga debati nga Qeveria, cilido të ketë qenë prej nesh. Dua të them se çdo debat kontribuon pozitivisht, edhe ato idetë e mira që kanë qenë, pa marrë parasysh prej kujt do që vijnë. Ne do të tentojmë t'i përmirësojmë dhe, në anën tjetër, besoj se pjesa e debatit është pjesa e asaj që shtrohet në demokraci. Unë e kuptoj shumë drejt që demokracia nuk mësohet përmendsh, por shkon duke u ushtruar dhe në këtë drejtim s'kemi përjashtim asnjë. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe, fjalën përfundimtare, në emër të kërkuesit të debatit, e paraqet Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Do të provoj të flas shkurt, meqenëse u zgjat, u debatua në forma të ndryshme, shpeshherë vërtet edhe të devijuar. Pati vërejtje edhe për mënyrën e parashtrimit të debatit. Kërkesa ka shkuar në Kuvend dhe nuk kemi pasur vërejtje dhe të gjitha debatet që janë bërë në këtë legjislaturë janë bazuar pikërisht në ato nene të Kushtetutës, në atë nen të Rregullores e tjera. Ndoshta ka qenë mirë të kërkohej raport prej Qeverisë, por ne vazhdimisht i lexojmë raportet e Qeverisë dhe në raporte nuk ka asgjë më tepër, përpos atyre lëvdatave që u thanë këtu pa fund dhe shifrave që u prodhuan këtu për këtu.

Unë do ta përmbledh debatin dhe i kam disa pyetje:

- A ka korrupsion në Kosovë, meqenëse gjendja na qenka shumë e mirë;
- A ka pasur ndonjëherë më shumë afëra korruptive se në dy vjetët e fundit të qeverisjes Thaçi;
- A është papunësia në Kosovë 45%?
- A ka premtuar Qeveria se do ta ulë numrin e të papunëve në vit 8 deri 10%?
- A ka qenë rritja e GDP-së 6,9% në vitin 2008 dhe sa është në vitin 2012?
- Deficiti tregtar në vitin 2007 a ka qenë 1,4 miliard dhe në vitin 2012 a është 2,2 miliardë?

- A është e vërtetë se Kosova ka importuar produkte bujqësore në vlerë prej 560 milionësh në vitin 2011? Nuk i kemi të dhënat për 2012. Për këtë pyeteni Agjencinë e Veterinës dhe të Ushqimit në kuadër të Kryeministrit.
- A kanë qenë investimet e huaja direkte 429 milionë euro në vitin 2007 dhe sa janë ato në vitin 2012? Në vitin 2012 janë 2033.
- A nuk janë normat e interesit në Kosovë më të lartat në rajon, dhe a i keni pyetur bankat komerciale pse, e përgjigja është sepse nuk ka rend dhe ligj, nuk ekzekutohen vendimet e gjyqeve, zgjidhja e kontesteve ndërmjet bankave dhe bizneseve merr me vite.

Në këtë gjendje, pyetja vjen se çfarë po bën Kryeministria me 623 persona brenda saj, çfarë bëjnë 19 ministri, a nuk është e tepërt që për një buxhet të varfër t'i kemi 19 ministri, 64 zëvendëskryeministra dhe anëtarë të kabineteve qeveritare?

Dhe, unë ju them, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë të Kosovës, se këto janë fakte, kjo nuk është retorikë politike, ky nuk është mllef opozitar, ky është realitet nën qeverisjen tuaj, kjo është jeta e qytetarëve tanë të varfër.

Andaj, jo që presim shumë rezultate, por këto debate janë për t'i sfiduar qeveritarët tanë të famshëm dhe për t'ua hapur sytë qytetarëve të Kosovës, për t'u treguar atyre që ne po angazhohemi në ndërrimin e kësaj qeverie.

Andaj, të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i LDK-së, në mbështetje edhe të deputetëve tjerë, do të thotë tuajin në këtë rast, kërkojmë që të votohen këto dy rekomandime:

Rekomandimi i parë është që në afat prej një muaji Qeveria t'i raportojë Kuvendit.

Ne këtu dëgjuan prej ministrave që kanë plane, kanë strategji, janë duke e përgatitur ndërtimin e termocentralit të Kosovës së Re dhe përgatitjet kanë filluar qysh para 10 vjetëve, me sa e di unë e tjera, mirëpo nuk patëm shifra. Ne duam që pas një muaji Qeveria të vijë dhe të raportojë se cilat janë rezultatet e masave të ndërmarra deri më tani në luftimin e papunësisë dhe të varfërisë. Të tregohet se si është luftuar, të shprehet në numra, të thuhet kaq ka qenë numri i të varfërve, kaq ka qenë papunësia dhe kaq është tani.

Efektet ekonomike të pakos fiskale që është implementuar në dy vjetët e fundit, të raportojë për efektet në rritjen e prodhimit vendor nga subvencionet e dhëna në bujqësi, efektet ekonomike nga privatizimi i ish-ndërmarrjeve publike, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", efektet e pritura nga privatizimi i Distribucionit dhe Furnizimit me energji elektrike dhe jo vetëm të thuhet se asetet janë këtu për shfrytëzim publik, sepse zonja Sahatqija e tha se nuk është autobus që të çohet në Turqi, po natyrisht se janë këtu, por ne i blejmë shërbimet dhe ky çmim i shërbimeve po na dyfishohet. Të na tregohet për efektet ekonomike.

Pastaj, në afat prej dy javëve, Qeveria të raportojë në Kuvend lidhur me qëndrimet e korporatës financiare ndërkombëtare, se procesi i privatizimit dhe Distribucionit të

Furnizimit të energjisë nuk është bërë në përputhje me praktikat më të mira, është mirë që Qeveria të shkojë, sepse këta kanë qenë të involvuar në proces edhe të bisedojnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mirë, Hykmete, edhe rekomandimin e fundit, por je zgjatur shumë, a?

HYKMETE BAJRAMI: Edhe rekomandimi i dytë, të nderuar deputetë, është të pezullohet procesi i privatizimit të Postë-Telekomit të Kosovës dhe në afat prej 2 muajsh Qeveria ta sjellë strategjinë e re dhe vendimin për aprovim në Kuvend për privatizimin e PTK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Debati ka përfunduar. Të pranishëm janë 45 deputetë, edhe një paska ardhur më vonë, 46 gjithsej.

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar deputetë, ne e kemi edhe një raport, raportin e performansës. Nëse mund ta diskutojmë këtë raport, me këtë numër që e kemi, por kur të vijë puna e votimit, nuk kemi mundësi. Urdhëro, nënkryetari Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Unë jam ihtar i planifikimit dhe i durimit. Do ta përsëris atë që e kam thënë në Kryesi. Le të studiohen mirë kur vendoset për pikat e rendit të ditës dhe le të kryhen brenda ditës.

Unë votoj që të vazhdojmë për atë që mund të punojmë, dhe le të mësohen deputetët që rendi i ditës krijohet për t'u kryer, e jo për të vazhduar prej jave në javë.

KRYETARI: Faleminderit, nënkryetar! Ju e dini që edhe atë ditë kam thënë dhe kam kërkuar nga kryetarët e grupeve parlamentare që vërtet të bisedojmë me deputetë dhe t'u tregohet atyre që është mirë seanca të vazhdojë deri sa të kryhen të gjitha pikat.

Unë nuk desha ta marr fjalën për pikën që e përfunduam, për faktin se të ju them të drejtën, dola për një moment në pozitën e qytetarit, e po të mos e kisha të qartë çka është zhvillimi ekonomik, unë sot nga ky debat nuk do ta dija se çka është zhvillimi ekonomik. Më shumë janë folur çështje të tjera, sesa për zhvillimin ekonomik.

Por, po vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, në pajtim me dispozitat e Rregullores, e ka shqyrtuar raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, Zenun Pajazitin, për ta arsyetuar raportin me rekomandime. Zenuni, nuk është këtu. Atëherë, fjalën ia jap kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputetit Ali Sadriu, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin për performansën në ndërmarrje publike dhe gjatë këtij shqyrtimi të këtij raporti ishin të pranishëm ministri i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, përfaqësuesit nga njësia për monitorim të ndërmarrjeve publike, si dhe avokati i përgjithshëm.

Raporti për performansën e ndërmarrjeve publike u referohet raporteve vjetore të ndërmarrjeve publike, raporteve vjetore të zyrave rregullative dhe raporteve të auditimit të jashtëm.

Raporti kryesisht përmban informata lidhur me përgjegjësitë dhe detyrat e bordeve dhe të drejtorëve, si dhe detyrimet tjera të dala nga Ligji për ndërmarrjet publike, por nuk përmban ndonjë analizë për performansën e ndërmarrjeve publike. Pra, është më shumë përshkrim i ligjit dhe i referohet ligjit.

Disa nga arritjet e rolit monitorues të ndërmarrjeve publike janë prezantuar, pastaj numri i projekteve të kryera nga ndërmarrjet publike është prezantuar, por të arriturat e prezantuara nuk kanë të bëjnë me performansën e ndërmarrjeve publike.

Raporti nuk e prezanton rezultatin dhe ndikimin lidhur me qëllimin e përgjithshëm të pronësisë, nuk përmban informata për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga kompanitë publike, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet publike.

Është me rëndësi të veçantë të theksohet se të gjitha këto ndërmarrje publike, përpos PTK-së, KEK-ut, KOST-it dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, funksionojnë me humbje, ndërsa edhe këto ndërmarrje publike të cilat operojnë me fitim në disa prej tyre në vitin 2011, krahasuar me vitin 2010, janë zvogëluar fitimet.

Ndërmarrjet tjera publike qendrore apo regjionale, të cilat kanë operuar me humbje, humbjet gjatë vitit 2011 i kanë të njëjta, ose në të njëjtin nivel, ose edhe kanë rritje krahasuar me vitin paraprak.

Prandaj, bazuar në këto fakte të prezantuara në raportet e performansës financiare, ku kemi të bëjmë me një performansë financiare tejet negative, në raport nuk është

prezantuar menaxhimi joadekuat i pasurisë publike, si dhe jemi dëshmitarë të rasteve të shumta të gjetjes edhe në raportet e auditorit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Në këtë raport nuk janë dhënë të dhënat e mjaftueshme me interes për Kuvendin dhe opinionin, në përgjithësi. Pra, në përgjithësi raporti nuk i përmban treguesit, të cilët do t'u mundësonin deputetëve ta shohin performansën e ndërmarrjes publike.

Të gjeturat e GZAP-it flasin për mungesën e kontroleve financiare të kompanitë e ujit, kontrollet joadequate të të hyrave të KEK-u, të të gjitha kompanitë ka pasur prokurime dhe menaxhim jo të kënaqshëm të pasurisë. Bordi dhe menaxhmenti i këtyre ndërmarrjeve nuk ka siguruar mjedis të duhur të kontrollit për të siguruar menaxhimin efektiv dhe efikas të parasë publike.

Megjithatë, gjatë shqyrtimit të raportit, komisioni e ka pasur parasysh edhe afatin kohor se kur po e shqyrtojmë këtë raport dhe për ndryshimet e gjendjes së ndërmarrjeve publike mbetet për të shikuar mbikëqyrjen apo raportin që e presim, të vitit 2012.

Bazuar në këtë, Komisioni ka rekomanduar mosmiratimin e raportit për performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2011. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike, Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

E kam kënaqësinë që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së ta jap vlerësimin për raportin mbi performansën e ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2011.

Sipas nenit 8 të Ligjit për ndërmarrjet publike, Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik raporton në bazë vjetore në Kuvend për performansën e ndërmarrjeve publike.

Ky raport në vete përmban edhe të dhënat e vitit 2010 dhe 2011 që tregojnë për performansën e ndërmarrjeve publike në vitin 2011.

Spektori i energjisë - Siç dihet në raport këtë vit, në krahasim me vitin paraprak është prodhuar më shumë tënjgjill për 3,2%, është gjeneruar më shumë energji për 2,6%, është inkasuar më shumë nga faturimi për 2,48%, ndërsa janë zvogëluar humbjet e përgjithshme të energjisë në KEK për 3,07%.

Gjithashtu, në KOST janë reduktuar humbjet në transmision për 0,32% dhe është rritur kapaciteti nga 1 500 megavatë në 1 800 megavatë.

Sektori i telekomunikimit - Tregu i përgjithshëm i telekomunikacionit në Kosovë kap vlerën e 250 milionë eurove. Pjesën më të madhe të të cilit 80% e përfshin telefonja mobile, pjesa tjetër mbulohet nga telefonja fikse dhe interneti.

Sektori i ujit - Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizim, të ofruar nga kompanitë publike paraqesin ofruesin kryesor të këtyre shërbimeve në Kosovë.

Aktualisht numri i popullsisë së shërbyer nga KRU është rreth 1 375 000 apo rreth 70%, të cilët pranojnë shërbimin e ujësjellësit, përderisa vetëm 50% e marrin shërbimin e kanalizimit në raport me totalin e popullsisë së Kosovës.

Te sektori i ujit të pijshëm e kemi një progres të prodhimi i ujit për 4,5%, në krahasim me 2010. Po ashtu është rritur inkasimi nga faturimi për 3%, sikur që është rritur numri i konsumatorëve për 15 406 konsumatorë të rinj.

Sfidat e sektorit të ujit - Borxhi i konsumatorëve është 85 milionë euro. Lëndë në gjykatë janë 1 900, rastet sociale, borxh janë 15 milionë euro.

Përkrahja financiare nga Qeveria - Në përputhje me KASH-in dhe në koordinim me FMN-në, Qeveria ka bërë reduktimin e subvencioneve për 26,5%, në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, nëpërmjet projekteve të reja ka investuar 12,3 milionë euro në ndërmarrjet publike, si KOST-i, Hekurudha dhe ndërmarrjet publike të ujërave dhe mbeturinave.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, Qeveria i ka subvencionuar ndërmarrjet publike, siç janë KEK-u, Trainkos, ndërmarrjet e ujërave dhe hekurudhave, si dhe ngrohjet qendrore me një shumë prej 35,5 milionë euro.

Kjo ka qenë një ndihmë financiare e dhënë nga Qeveria me qëllim të sigurimit të mjaftueshëm të energjisë elektrike, mbulimit të kostove operative për qarkullimin e trenit të lirë për qytetarët, sigurimit të ngrohjes qendrore, si dhe mbulimit të kostove për shërbimeve të ujit dhe mbeturinave.

Auditimi i jashtëm - Te të gjitha ndërmarrjet ka përfunduar auditimi i jashtëm për vitin 2011. Raporti i fundit, ai i PTK-së, është pranuar në fund të gushtit 2012. Mungesa e ligjit bazik mbi ndërmarrjet publike, që nuk ka përcaktuar afate, përndryshe me amendamentin e Ligjit mbi ndërmarrjet publike ndërmarrjet publike obligohen t'i auditojnë pasqyrat financiare deri më 31 maj të vitit paraprak.

Në krahasim me vitin paraprak, ka një progres në opinionet e auditorëve të jashtëm. 10 nga to kanë opinion të pakualifikuar, që domethënë opinion më të mirë, 1 ka opinion të kualifikuar, 6 si të kualifikuar me theksim çështjeje.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e ka kryer auditimin e performansës së menaxhimit të kompanitë e ujit dhe kompania e menaxhimit të deponimeve të Kosovës.

Nga raportet e auditimit kanë dalë disa rekomandime mbi të gjeturat. Të gjeturat janë marrë me seriozitet dhe pothuaj se tanimë janë evituar.

Të nderuar deputetë,

Investime nga Qeveria dhe donatorët - Më lejoni t'i paraqes para jush investimet, të cilat janë bërë gjatë dy vjetëve të fundit në ndërmarrjet publike nga buxheti i Kosovës dhe nga donatorët.

Projektet e financuara nga buxheti i shtetit 2010/2012, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik - Në 2010/2012, nga BRK janë financuar 60 projekte kapitale, në vlerë të buxhetuar prej 34 milionë eurove për sektorin e energjisë, hekurudhave, ujit të pijes dhe mbeturinave, si dhe për tetë projekte, me vlerë 19 milionë euro.

Për hekurudha financohen 9 projekte, në shumën 7,5 milionë euro, për ujësjellësit dhe ujin financohen 22 projekte, në vlerë të tërësishme prej 4,5 milionë euro, ndërtesa administrative e ujësjellësit në Gjilan, Suharekë e Malishevë, shtimi i kapaciteteve të ujit në Prizren e tjera.

Fabrika e Ujit në Vushtri, e financuar nga Qeveria e Kosovës, është në fazën e zbatimit në vlerë prej 8,5 milionë, e financuar nëpërmjet Ministrisë së Financave.

Për mbeturina financohen 9 projekte, prej të cilave 7 projekte të kompanive lokale me pronësi komunale në vlerë të tërësishme prej 3 milionë eurove për blerjen e makinerive për grumbullimin e mbeturinave dhe kontejnerë për mbeturina. Projektet e financuara nga donatorët kapin afro 135 milionë euro.

Linja energjetike 400 kilovoltë Kosovë-Shqipëri, e financuar nga KfV, në vlerë prej 33,5 milionë euro, nga të cilat 16,5 milionë grante e 17 milionë kredi e butë.

Ndërtimi i stacionit energjetik 110 kilovoltë në Gjilan, i financuar nga SDZ, në vlerë prej 10,2 milionë franga.

Fabrika e Ujit në Prishtinë në vlerë prej 35 milionë, e financuar prej KfV 20 milionë, 5 milionë nga Komuna e Prishtinës dhe 5 milionë nga Qeveria e Kosovës.

Gjendja e projektit është në fazën e përzgjedhjes së kompanisë konsulente për implementim të projektit.

Impianti i ujërave të zeza në Prizren, në vlerë parallogariture 22 milionë, i financuar nga KfV, 12 milionë, Qeveria e Kosovës 5 milionë dhe Komuna e Prizrenit 5 milionë.

Gjendja e projektit është në fazën e përzgjedhjes së kompanisë konsulente për implementimin e projektit.

Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në zonat rurale në Kosovën juglindore me vlerë parallogaritë prej 8,1 milionë dhe me financim të SDC me 6 milionë dhe Qeverisë së Kosovës dhe komunave prej 2 milionë euro.

Gjendja e projektit është në vijim të implementimit. Projekte të ndërrimit të rrjetit të ujësjellësve në Pejë, Prizren dhe Istog, financuar nga USAID me 10 milionë.

Fabrika e Ujit në Mitrovicë, e financuar nga Komisioni Evropian në vlerë prej afro 13 milionë euro. Projekti është në fazën përfundimtare.

Ndërrimi i sistemit të ujësjellësit në Mitrovicë, i financuar nga Qeveria e Luksemburgut, në vlerë prej 4,5 milionë euro. Projekti është në fazën përfundimtare.

Bazuar në këtë raport, konsideroj se është bërë një punë e konsiderueshme për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të vendit. Gjithashtu, dëshiroj t'i përsërisht masat e marra nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik në përmirësimin e gjendjes në këto ndërmarrje, siç janë ato në rregullimin e të ardhurave për bordet menaxhuese, rregulloret për shfrytëzimin e veturave të ndërmarrjeve publike dhe ajo për udhëtime jashtë vendit.

Megjithatë, mbetet akoma mjaft punë për të bërë dhe në këtë drejtim dëshiroj ta afrojmë mbështetjen e komisionit dhe të grupeve parlamentare në përmirësimin e mëtejshëm të kësaj gjendjeje.

Prandaj, të nderuar deputetë, ju thërras që ta miratojmë dhe votojmë raportin për performansën e ndërmarrjeve publike qendrore në vitin 2011. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit të LDK-së, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Vetëm dëshiroj që të konfirmoj atë që e tha kryetari i Komisionit. Ky është qëndrim njëkohësisht edhe i Lidhjes Demokratike të Kosovës që përputhet plotësisht me të gjeturat, me lëshimet, me atë që nuk është bërë ashtu siç do të duhej të bëhej, me gjithë ato të gjetura që janë konstatuar gjatë punës së Komisionit dhe ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk do ta votojmë, përkatësisht do të votojmë kundër këtij raporti të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011.

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes" është lajmëruar deputeti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Duke qenë se kemi të bëjmë me vlerësimin e raportit për performansën e ndërmarrjeve publike për vitin 2011, është tejet e arsyeshme që parimisht ta trajtojmë natyrën e këtij dokumenti.

Në këtë aspekt, duke pasur parasysh se raporti ka për qëllim pasqyrimin sa më objektiv të gjendjes aktuale për çështjen të cilën e trajtojmë. Në këtë aspekt, mund të themi se në një

pjesë e madhe ky dokument nuk i përgjigjet natyrës dhe qëllimit parimor. Kjo ngase në shumë pjesë janë përfshirë përshkrime ligjore sesa përshkruhet gjendja faktike e ndërmarrjeve publike.

Raportuesi, konkretisht njësia për monitorim të politikave të ndërmarrjeve publike, pra të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ka autorizim për monitorimin e punës së ndërmarrjeve publike. E njëjta bart përgjegjësi për përmbajtjen e këtij raporti.

Në këtë aspekt, në pikën 2 të raportit theksohet korporatizimi i ndërmarrjeve publike. Në këtë pikë është shpjeguar se korporatizimi i ndërmarrjeve publike është bërë sipas parimit të OCD për qeverisje të korporatave. Nëse analizohet ky parim formalisht, ai ka të bëjë me tendencën e menaxhimit të korporatës nga një bord efektiv, i cili do ta siguronte një menaxhim më efikas dhe cilësor. Në këtë pjesë ceket se Qeveria e Kosovës, si bartëse e aksionit të ndërmarrjeve publike, e ka përvetësuar qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike qysh në vitin 2006.

Për më tepër, në këtë pjesë të raportit në mënyrë të ekzagjeruar flitet për misionin, vizionin dhe përgjegjësinë e ndërmarrjeve publike.

Vlen të theksohet se te pjesa e përgjegjësisë së ndërmarrjeve publike, hasim në një përshkrim ligjor të kompetencave, që është sanksionuar me Ligjin për ndërmarrjet publike. Pas përshkrimit të përgjegjësisë së ndërmarrjeve publike dhe strukturës udhëheqëse dhe profesionale, në pikën 1.1.5 janë përfshirë të arriturat e ndërmarrjeve publike, kështu që në këtë pikë është theksuar se gjatë vitit 2011 monitorimi i punës së bordeve të ndërmarrjeve publike është bërë nëpërmjet shqyrtimit të procesverbaleve. Në këtë mënyrë është evidentuar se gjithsej janë mbajtur 185 mbledhje të bordeve të drejtorëve, 138 mbledhje të komisioneve të auditimit dhe 73 mbledhje të komiteteve të përkohshme.

Në raport ceket se ndërmarrjet publike i kanë monitoruar nëpërmjet analistëve gjithsej 37 mbledhje të bordeve të drejtorëve, edhe pse kjo e paraqet një fakt të një pasiviteti të ndërmarrjeve publike, në anën tjetër shihet pikërisht te mbledhjet e komisioneve të auditimit që ndërmarrjet publike asnjëherë nuk e kanë monitoruar punën e tyre.

Me gjithë faktin se çështja e auditimit e paraqet çështjen ndër më të rëndësishmet për vërtetimin e performansës reale të ndërmarrjeve publike, përkundër asaj se në pikën 2.2.2 mbi politikat pronësore Qeveria e Kosovës si aksionare primare e ndërmarrjeve publike i ka konsoliduar politikat e përgjithshme mbi pronësinë në ndërmarrjet publike mbi bazën e 8 komponentëve, e që 2 nga këto janë të rëndësishme, ato janë përzgjedhja dhe emërimi i drejtorëve dhe struktura e kapitalit.

Kur jemi te përzgjedhja e drejtorëve, edhe pse në kuptim të parimit të qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike ndër qëllimet kryesore është funksionimi i bordeve që do ta ofronin një menaxhim profesional dhe të efektshëm në praktikë, është dëshmuar krejtësisht ndryshe.

Sot kemi ndërmarrje publike që udhëhiqen nga bordet e drejtorëve, anëtarëve të të cilave u ka skaduar mandati dhe ky ngërç ndodh vetëm për shkaqe të pazarllëqeve politike ndërmjet partnerëve të koalicionit qeverisës.

Në anën tjetër, struktura e kapitalit është tejet e rëndësishme në vërtetimin e zhvillimit dhe rritjes së ndërmarrjeve publike, gjë për të cilën e kundërta do të vërtetohet në vazhdimin e përmbajtjes së raportit.

Në pikën 2.3, raportuesi e ka përfshirë çështjen e konfliktit të interesit. Në këtë pjesë nuk janë dhënë konkretisht se ndaj disa zyrtarëve janë ndërmarrë masa ligjore për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesit gjithashtu në asnjë vend nuk është përmendur se ka pasur ndonjë tendencë për bashkëpunim të ndërmarrjeve publike me Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Në pikën 2.6, hartuesi i raportit e ka paraqitur përfshirjen e sektorit privat dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve publike. Duke e analizuar këtë pjesë të raportit, vijmë në përfundim se nuk janë përfshirë fare objektivat dhe të arriturat nga ristrukturimi dhe përfshirja e sektorit publik në pronësinë e aseteve publike. Kjo më së miri tregon se në kuadrin e politikave qeverisëse, ristrukturimi edhe në shërbim të përfshirjes së sektorit publik në interes të këtij të fundit, përndryshe vetë qëllimi i ristrukturimit qëndron mbi bazën e efikasitetit dhe funksionalitetit të ndërmarrjes.

Te pika 2.7.1 lidhur me përgjegjësitë dhe detyrat e Bordit të Drejtorëve kemi të bëjmë me një përshkrim tipik ligjor, i cili më shumë ngjan në një interpretim se sa sqarim plotësues në shërbim të këtij raporti.

Në frymë të njëjtë, kjo pikë ka bërë përshkrimin e procesit të selektimit të bordit, kompensimin dhe vlerësimin e Bordit të Drejtorëve dhe e gjitha kjo për të vazhduar në mënyrë të ekzagjeruar lidhur me raportimet periodike të ndërmarrjeve publike, sipas Ligjit për ndërmarrjet publike.

Në pikën 3.3 lidhur me përkrahjen financiare të Qeverisë, në tabelën 2 janë përfshirë subvencionet dhe investimet kapitale në ndërmarrjet publike. Shihet qartë se PTK si ndërmarrje publike me kontribut më të madh të dividendave, në krahasim me ndërmarrjet tjera nuk ka përfituar fare nga përkrahja financiare qeverisëse. Kjo më së miri e tregon tendencën e Qeverisë se nuk është fare e interesuar ta rrisë kapitalin e ndërmarrjeve publike, duke qenë aksionare në asetet e ndërmarrjeve publike.

Në pjesë tekstuale të kësaj pike është theksuar se si pasojë e përcaktimeve të përkufizuara në kornizën afatmesme të shpenzimeve, në krahasim me vitin 2010, qeverisja e ka zvogëluar përkrahjen për gjithsej 26,5%. E gjithë kjo theksohet se edhe është bërë në koordinim me FMN-në. Duhet të theksohet se këto shkurtime buxhetore janë edhe pasojë e politikave të këqija qeverisëse, e cila në mënyrë vetjake e ka krijuar këtë situatë, e sidomos në rritjen e pagave të shërbyesve publikë. Kjo situatë, përpos që në masë të madhe e ka dëmtuar rritjen e kapitaleve të ndërmarrjeve publike, gjithashtu ka ndikuar edhe në trendet makroekonomikë. Kjo më së miri mund të vlerësohet me të dhënat e

Agjencisë së Statistikave të Kosovës, meqë për vitin 2011 inflacioni në Kosovë ka shënuar ngritje për gjithsej 8%.

Pika 3.4 mbi performansat financiare të ndërmarrjeve publike, shihet se PTK-ja, ende kompania më profitabile, është ende kompania më profitabile nga i gjithë sektori publik. Në këtë mënyrë, ajo e ka shënuar një profit prej 33 396 milionë euro. Totali i të hyrave nga ndërmarrjet publike është vlerësuar prej gjithsej 49 545 milionë euro. Në pjesën tekstuale theksohet se do të ishte e mirëseardhur edhe një e hyrë, por se kjo tani është e pamundësuar për shkak të konsensionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.

Kjo edhe një herë më së miri e argumenton dështimin e Qeverisë si bartëse e aksioneve të ndërmarrjeve publike.

Në anën tjetër, te pika 3.5 për performansën operative të sektorëve, konkretisht sektori i telekomunikacionit, në krahasim me vitin paraprak shihet qartë një rënie, si në aspektin e shtrirjes së shërbimit, ashtu edhe në numrin e konsumatorëve.

Si duket, Qeveria me qëllim është duke e sabotuar afarizmin e sektorit të telekomunikimit dhe vetëm për privatizimin e këtij sektori.

Po ashtu, edhe Grupi i Lëvizjes “Vetëvendosje” mendon se ky raport nuk duhet miratuar, sepse është e qartë tendenca e shtrembërimit të gjendjes faktike, në anën tjetër miratimi i këtij raporti do të nënkuptonte admirimin e politikave qeveritare, të cilat janë argumentuar se nuk janë në shërbim të zhvillimit të sektorit publik, por përkundrazi janë të orientuara në shkatërrimin e sektorit publik dhe në shërbim të atij privat. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk jam ngritur në këmbë për të folur kurrë, por po them - diku janë nja 3-4 deputetë të PDK-së, nja 3 të Aleancës, e nja 7 a 8 të LDK-së, më së shumti ka dhe të “Vetëvendosjes”. Po ma merr mendja që do të ishte mirë ta kryejmë shpejt këtë punë, se nuk kemi as kuorum, e duhet të vijmë prapë. Po më duket që ndoshta duhet provuar që në Rregulloren e re të futet që deputetëve t’u hiqet mëditja kur duhet të votojmë. Të shihet a janë në fillim të seancës, a jo, se vërtet nuk bën të punojmë kështu me 20 deputetë në sallë.

Sidoqoftë, meqenëse më duhet që në emër të Grupit Parlamentar ta jap mendimin për raportin, ne do ta votojmë kundër. Pra, Aleanca voton kundër raportit për performansën e ndërmarrjeve publike dhe pa dashur ta shpjegoj më tutje, mendoj se në Kosovë po t’i tregojmë dikujt qysh performojnë ndërmarrjet publike, është pak problem, por edhe po ta krahasojmë raportin me atë që e dimë ne, është edhe më problem.

Sidoqoftë, atë që e thashë për praninë e deputetëve, ma merr mendja që në Kuvendin e Kosovës duhet filluar të mendojmë si ta rregullojmë atë, për shkak se nuk po mund të punojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Vetëm të ju përkujtoj se ky raport është bërë për vitin 2011, e jo për 2012. Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Shefja e Grupit Parlamentar do të japë mendimin në emër të Grupit për raportin vjetor 2011 për performansën e ndërmarrjeve publike qendrore. Duhet të themi se ne i kemi miratuar raportet e Zyrës së Rregullatorit të energjisë, nën një. Dhe, raportin e Rregullatorit të Telekomunikacionit, nën dy, për vitin 2011.

Më fal Ardian, unë të dëgjova. Të lutem!

Dhe, në rast se i kemi miratuar të gjitha këto raporte, në këtë raport, i cili është sjellë për njësinë për monitorim të ndërmarrjeve publike, në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike, këta nuk kanë bërë kurrgjë tjetër, veç e kanë përshkruar. Jo që ka diçka këtu të mirë, por po ju them shumë sinqerisht, këtu s'ka të mirë kurrgjë, mirëpo ne i kemi votuar ato raporte dhe ato raporte kanë ecur në seancë. I njëjti dokument është, kurrgjë s'ka ndryshim, vetëm disa rekomandime që të bëjnë të qeshësh. Unë u kam thënë edhe atyre kur kanë qenë në mbledhjen e komisionit, dhe këqyr çka thotë: trajnimi i stafit të ndërmarrjeve publike për përmbushjen e kënaqësisë së konsumatorëve. Dhe, kënaqur na kanë!

Këta kërkojnë të shkojnë në shtëpi, se kënaqur na kanë. Sinqerisht po ju them! Kjo është votuar një herë dhe e votuam s'e votuam sot, ne i kemi votuar raportet e agjencive të pavarura. Ky dokument është fotokopje e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Hashim Deshishku e ka fjalën, i fundit.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit kryetar!

Të flasim për një raport të vitit 2011, më duket sikur të flasim për borën e parvjetshme.

Ky raport, siç tha edhe kryetari i Komisionit, Ali Sadriu, i ka të gjitha vërejtjet. Edhe unë kam shumë vërejtje në këtë raport që është bërë për vitin 2011, e me të vërtetë nuk ka asnjë logjikë që të flitet për një raport pas dy vjetëve, prandaj unë do ta dorëzoj me shkrim diskutimin tim për arsye se po më duket e thjeshtë për t'u lexuar tash vërejtjet, të cilat janë bërë atëherë për një raport. Faleminderit!

Diskutimi i dorëzuar me shkrim

I nderuari kryetar i Parlamentit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Raportin për performansën e ndërmarrjeve publike sot po e shqyrtojmë vetëm sa për adet, meqenëse ai e ka humbur çdo aktualitet.

Është e kotë, që tash në vitin 2013 të flasim për atë që ka ndodhur në vitin 2011. Ne mund të flasim për ndërmarrjet publike dhe për gjendjen kaotike që është në këtë sektor, por asnjë nga konkluzionet nuk guxojmë t'i bazojmë në këtë raport.

Çka është edhe më absurde, ne tash duhet të flasim për ndërmarrjet, të cilat kanë përjetuar ndryshime të mëdha, apo duhet të flasim për njerëzit në borde, ose në struktura menaxhuese, të cilët më nuk janë aty, ose për dëmet që ua kanë shkaktuar këtyre kompanive. Ata janë në bankën e të akuzuarve.

Fillimisht po them se ne nuk duhet ta miratojmë këtë raport, së pari pse është shumë i vonë dhe, së dyti, meqenëse disa kompani tash e kanë një strukturim krejtësisht tjetër, krahasuar me atë që thuhet në raport.

1. Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”, pas konsensionit e ka një fizionomi, ndërsa në raport as që përmenden këto ndryshime. Ai figuron në këtë raport, madje pa asnjë sqarim se këtu bëhet fjalë vetëm për “kullën”, përkatësisht kontrollin ajror;

2. Korporata Energjetike e Kosovës, pas ndarjes dhe privatizimit të distribucionit, duket krejtësisht ndryshe;

3. Është bërë ndarja e Postës dhe Telekomit të Kosovës;

4. Hekurudha e Kosovës e ka pësuar një transformim rrënjësor;

Pra, tash kemi të bëjmë me një situatë tjetër, e jo ashtu si pasqyrohet në raport.

Çështja tjetër, e cila është diskutabile dhe e kontestueshme, është se raporti gati nuk merret hiç me të. Fjala është për legjitimitetin e bordeve. Shumicës së anëtarëve të tyre kaheerë u ka skaduar mandati, ndërkaq në dhjetor të vitit 2011 ai është vazhduar me një vendim të diskutueshëm të Qeverisë së Kosovës.

Tash ka kaluar më shumë se një vit prej kur janë ata me mandat të vazhduar dhe të kontestueshëm. Ata janë jolegjitimë, meqenëse asnjë ligj nuk e thotë se mandati mund të vazhdohet aq sa ka dëshirë Qeveria.

Pastaj, me vonesë të madhe ndodh emërimi i Bordit të Përkohshëm për Distribucionin. Ndërkaq, asnjë ligj nuk e lejon mundësinë për emërimin e Bordit të Përkohshëm.

Unë e kam të qartë se Distribicioni, pas ndarjes nga KEK-u, duhet ta ketë bordin, mirëpo ai nuk është dashur të jetë i përkohshëm, por me mandat deri sa të ndryshojë statusi pronësor i kompanisë. Për këtë problem, Qeveria është kujtuar vonë, madje pas nënshkrimit të kontratës me blerësin.

Kur jemi te bordet, po theksoj se ata kanë dështuar tërësisht, çështje që përmendet edhe në raport. Por, është absurde se si këta njerëz ende ndodhen në këto pozita, kurse nuk

kanë treguar performansë të mirë, apo janë treguar si të dëmshëm për kompaninë, siç është rasti me Kompaninë për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë.

Paralelisht me problemet rreth mandatit, ka raste kur një kryetar i bordit është akuzuar për përkrahjen e kontratave të dëmshme për kompaninë, për çka është edhe në një proces gjyqësor. Për habi, performansa e këtyre bordeve vlerësohet pozitive në raport.

Kur është në pyetje performansa e ndërmarrjeve publike, po përmend se ato edhe më tej janë të varura nga buxheti i Kosovës, posaçërisht KEK-u, i cili mori 35,5 milionë euro, nga 47,8 milionë euro, sa ishte shuma e përgjithshme.

Qeveria nuk pret që të përmirësohet performansa e NP-ve, meqenëse ato do të vazhdojnë të subvencionojnë me nga 31 milionë euro secilin vit.

Ndonëse janë dhënë në formë tabelare, raporti nuk merret shumë me disa çështje problematike:

a) investimet kapitale janë në rënie. Kjo tregon qartë se këtu po ngec zhvillimi;

b) Në vitin 2010, me humbje kanë afaruar dhjetë ndërmarrje, ndërsa në vitin 2011 - 11 ndërmarrje. Humbjet janë dyfishuar, krahasuar me vitin 2010. Nga 4,8 milionë euro, ato arritën në 9,3 milionë euro. Nuk ka përgjigje se pse po rriten humbjet;

c) Vështirësi të konsiderueshme kanë ndërmarrjet për furnizim me ujë, ku faturimi është shumë i ulët. Ai askund nuk kalon mbi 50% të sasisë së ujit të prodhuar, por ka raste kur sillet kah 30%, si “Hidrodrini”. Kjo gjendje vazhdon për një kohë të gjatë dhe dëshmon se askush nuk brengoset me këtë problem, as bordi, as menaxherët.

Kur është në pyetje KEK-u, raporti ka anashkaluar, përkatësisht i ka heshtur disa zhvillime, që për mua janë shqetësuese.

1. Raporti fare nuk merret me problemin e kërkesave të KEK-ut nga konsumatorët.

2. Është shqetësuese rënia e faturimit të energjisë në dispozicion për shitje. Nga 80%, sa ishte në vitin 2010, ka rënë në 74,35%. Kur i kemi parasysh këto fakte, atëherë del se rritja e të hyrave 7,7% ka ndodhur për shkak të rritjes së çmimeve, se sa për shkak të përmirësimit të performansës.

Gjendja është duke u përkeqësuar edhe në PTK. Sado që thuhet se njëri prej objektivave është zgjerimi i tregut dhe rritja e numrit të konsumatorëve, këtu po ndodh e kundërta. Ajo është duke i humbur konsumatorët dhe tregun.

Operatori i telefonisë mobile “Vala” ka mbi 25 mijë konsumatorë më pak, kurse nga 70% të tregut, tash e ka 67% të tij.

Pastaj janë 6 550 konsumatorë më pak te interneti, ndërsa këtu e ka vetëm çerekun e tregut, nga 34% sa kishte në vitin 2010.

Kur është në pyetje Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, në raport duhet të thuhet qartë se për cilat pjesë të tij bëhet fjalë, meqenëse kështu si është thënë, shifrat dalin të deformuara dhe të pakuptueshme.

Po ashtu, meqenëse Aeroporti, pas dhënies në koncesion, nuk e ka ndryshuar pronësinë, ne duhet të kemi raport për realizimin e marrëveshjes së koncesionit. Meqenëse ka mekanizëm për mbikëqyrjen e saj, atëherë një raport i këtillë duhet t'i prezantohet Kuvendit të Kosovës.

Për arsyet e përmendura, unë propozoj që raporti të mos miratohet, ndërsa raportet tjera të mos merren fare në shqyrtim, nëse ato vijnë pas shtatorit të vitit pasues. Faleminderit!

Hashim Deshishku, d.v.

Diskutim i dorëzuar me shkrim

BLERTA DELIU: I nderuar kryetar,

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Te nderuar kolegë deputetë,

Gjatë disa viteve të fundit, ekonomia e Kosovës ka shënuar progres të rëndësishëm gjatë gjithë tranzicionit nga ekonomia e planit në një sistem të bazuar në treg dhe në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik.

Ekonomia e Kosovës vazhdon të gjenerojë rritje dhe stabilitet makroekonomik, dhe në këtë kuadër do ta veçoja sistemin dhe politikën fiskale dhe sistemin financiar. Indikatori më i fuqishëm që e mbështet këtë konstatim është niveli i normës pozitive të rritjes ekonomike.

Edhe përkundër rreziqeve në rritje nga sektori i jashtëm, ekonomia e Kosovës edhe në vitin 2013 pritet të shënojë normë pozitive të rritjes.

Kosova është orientuar drejt ekonomisë së tregut të lirë, duke aspiruar për të qenë anëtare e BE-së dhe e rrjedhave të ekonomisë botërore. Në këtë kuadër, Kosova ka arritur ta krijojë një sistem dhe politikë tatimore, e cila është kompatible me ecuritë e zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore të vendit, por edhe të regjionit. Pas shpalljes së pavarësisë, është e një rëndësie të madhe se Kosova bëri reformimin e sistemit dhe politikës tatimore, duke iu qasur me më shumë seriozitet shqyrtimit të funksioneve ekonomike të sistemit dhe politikës tatimore. Më konkretisht, në vitin 2009, Kosova e ka reformuar sistemin e saj tatimor, duke i reduktuar normat, ridefinuar bazën tatimore, si dhe duke bërë amandamentimin e ligjeve ekzistuese të tatimit në të ardhura personale, tatimi në të ardhura të korporatës dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. Këto ndryshime në normat tatimore dhe në legjislacionin tatimor kishin për qëllim krijimin e një sistemi tatimor konkurrues

për investime të jashtme dhe joshjes së obliguesve tatimorë, që të kalojnë nga sektori i ekonomisë joformale në sektorin e ekonomisë formale.

Sektori financiar i Kosovës, përkundër krizës financiare globale, mbetet i qëndrueshëm dhe stabil. Sistemi bankar i Kosovës, me gjithë përkeqësimin e ambientit të jashtëm makroekonomik dhe rënien e profitabilitetit, ka arritur të bëjë menaxhim të mirë të tri rreziqeve, me të cilat ballafaqohet sistemi bankar i Kosovës: si rrezikun e likuiditetit, atë kreditor dhe rrezikun e solvencës.

Blerta Deliu, d.v.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Besim Beqaj, shkurt!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit shumë, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Do të flas shumë shkurt. Një gjë dua të sqaroj, pse është vonesa. Vonesa është për shkak të Ligjit të ndërmarrjeve publike dhe obligimet që ndërmarrjet publike i kanë pasur për t'i dorëzuar raportet e tyre të auditimit.

Raporti është bërë mbi bazën e raporteve të auditorëve të pavarur, auditorëve të brendshëm dhe raporteve të rregullatorëve, të cilët i përmendi deputetja Selmani.

Pra, flasim për raportet, të cilat kur ka plasur konflikt të dhënave ndërmjet auditorëve dhe rregullatorëve, janë marrë parasysht të dhënat e rregullatorëve.

Një, është jashtëzakonisht e rëndësishme të thuhet se këto ndërmarrje kanë qenë keq, këto ndërmarrje mbeten edhe më tutje, ka shumë hapësirë për të përmirësuar, por nëse e krahasojmë nga viti në vit, dua të ju them që secila prej tyre ka efekte më pozitive, në krahasim me vitin e kaluar.

Është shumë me rëndësi të thuhet që raportet e auditimit të tyre në shumicën e rasteve kanë treguar që janë pa asnjë lloj vërejtje, gjë që është inkurajuese, ka mangësi te regjia, por po e them që energji ka më shumë, ka mangësi te uji, te inkasimi, te furnizimi, te humbjet, por humbjet te uji janë për shkak se ka raste që mbi 40 vjet asnjë investim në mirëmbajtje nuk është bërë dhe humbja është për çështje teknike, respektivisht ka edhe mangësi të shirave dhe ujërave, të cilat s'kanë mund të bëjnë kurrgjë më shumë.

Në drejtim tjetër, është shumë me rëndësi të thuhet që Qeveria i ka reduktuar subvencionimet. Subvencionimet janë reduktuar edhe për energjinë, edhe për ndërmarrjet e tjera që i shkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë qytetarit. Janë mbi 26,5 milionë euro, të cilat janë reduktuar vetëm nga viti 2010 në vitin 2011, janë investime të cilat realisht kanë mundur të bëhen. Ato investime që i ceka janë investime kapitale, të cilat janë bërë, qoftë nëpërmjet buxhetit, qoftë edhe nëpërmjet donatorëve, të cilët u përmendën nga deputeti më herët.

Është e vërtetë se gjatë vitit të kaluar, një numër i madh i këtyre çështjeve janë adresuar, është e vërtetë që në vitin e kaluar kemi bërë mbi 130 milionë euro kontrata, të cilat shkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e performansës së këtyre

ndërmarrjeve, është e vërtetë se vetëm në vitin e kaluar ka mbi 60 milionë euro të angazhuara, qoftë në nivelin komunal, qoftë në nivelin qendror, apo edhe të donatorëve, në mënyrë të përbashkët për këto ndërmarrje dhe ajo çka është jashtëzakonisht e rëndësishme, janë marrë masa për reduktimin e shpenzimeve në ndërmarrje publike, siç janë rregulloret, të cilat u përmendën, qoftë për pagat, qoftë të rregulloret për udhëtime zyrtare, qoftë për rregulloret e përdorimit të mjeteve motorike që ata i kanë.

Është shumë me rëndësi të thuhet se është e vërtetë që mandati i bordeve ka skaduar, por bordet nuk janë pa mandat, sepse ato emërohen me vendim të Qeverisë dhe me vendimin e saj ato janë zgjatur.

Ndërsa, u përmend konflikti i interesit. Dua të ju them se të gjitha rastet, të cilat janë identifikuar si konflikt interesi nga Agjencia Kundër Korrupsionit, ata njerëz janë shkarkuar nga Qeveria e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë, ne këtu e ndërpresim seancën, por ndoshta është mirë që në Rregulloren e Kuvendit ta bëjmë edhe një ndryshim, pasi e kemi përgjegjësinë për ta ndryshuar, që diskutimet, siç është në Rregulloren e Bundestagut të zhvillohen jo duke lexuar, po duke diskutuar.

Do të vendosim në mbledhjen e Kryesisë të martën se si do të veprojmë për pikat e mbetura. Mirupafshim në seancën e radhës!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes së filluar më 29 mars 2013

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 29 mars 2013.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të pranisë. Votojmë tash!

Prania është 69 deputetë, me elektronikë 69 deputetë, kurse prania fizike 75 deputetë. Si qëndron puna, kush mund të na e shpjegojë. Atëherë, kush nuk ka kartelë? Do të thotë, nuk ka pa kartela. E më vonë, nëse kërkohet votimi pa kartelë, nuk do të pranohet. Ta dini këtë paraprakisht.

Edhe një herë, e votojmë praninë me elektronikë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Prania elektronike është 76, prania fizike 77.

1. Votimi i rekomandimeve të debatit parlamentar për gjendjen ekonomike në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen plenare, të mbajtur më 29 mars 2013, mirëpo në mungesë të kuorumit Kuvendi nuk ka mundur të procedojë me votimin e rekomandimeve të paraqitura nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Para se të vazhdojmë me votimin e rekomandimeve, unë kërkoj nga iniciuesi që t'i rilexojë rekomandimet. Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon mbështetjen e të gjithë juve për votimin e këtyre rekomandimeve:

1. Në afat prej një muaji, Qeveria t'i raportojë Kuvendit për rezultatet e masave të ndërmarra deri më tani në luftimin e papunësisë dhe varfërisë;
 - Për efektet ekonomike të pakos fiskale të implementuara në dy vjetët e fundit;
 - Për efektet ekonomike të masave të ndërmarra për përmirësimin e ambientit për biznes në Kosovë;
 - Efektet në rritjen e prodhimit vendor, të subvencioneve të ndara për bujqësi;
 - Efektet ekonomike nga privatizimi i ish-ndërmarrjeve publike, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”;
 - Efektet e pritura ekonomike nga privatizimi i Distribucionit dhe Furnizimit me energji elektrike;
 - Në afat prej dy javëve, Qeveria të raportojë në Kuvend lidhur me qëndrimet e Korporatës Financiare Ndërkombëtare se procesi i privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit nuk është bërë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare...

KRYETARI: Deputete, vetëm një moment! Deputetë, ju lutem t'i dëgjoni rekomandimet, pastaj mos thoni nuk e kemi ditur çfarë po votojmë!

HYKMETE BAJRAMI: ...dhe, rekomandimi?

2. Të pezullohet procesi i privatizimit të Postë-Telekomit të Kosovës dhe në afat prej 2 muajsh Qeveria ta sjellë në Kuvend strategjinë e re dhe vendimin për aprovim në Kuvend për privatizimin e kësaj ndërmarrjeje.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë, i lexuam edhe një herë rekomandimet për të jua përkujtuar për votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votimin e rekomandimeve. Votojmë tash!

Konstatohet se 38 me 38 nuk miratohen. Ashtu nuk miratohen. 38 me 38, rekomandimet nuk miratohen dhe ju lus të mos përziheni. E dini shumë mirë se asnjë nuk është lajmëruar që nuk ka kartelë.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Votimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen plenare, të mbajtur më 29 mars 2013, mirëpo në mungesë të kuoromit, Kuvendi nuk ka mundur të procedojë me votimin e raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011.

E dini që kanë qenë dy komisione. Një komision ka qenë me rekomandim për t'u votuar raportet, e një komision ka qenë për të mos i votuar. Do të thotë, dihet se rekomandimet janë nga këto komisione.

Prandaj, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 38 vota për, 35 kundër dhe 7 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Zgjedhja e një anëtari të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media e ka shqyrtuar nominimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin për miratim.

E ftoj kryetaren e Komisionit ad hoc, deputeten Xhevahire Izmaqu që ta arsyetojë rekomandimin.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

R e k o m a n d i m:

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës që të bëjë zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Medieve me votim të fshehtë.

Për një anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komitetit shumicë shqiptar propozohen kandidatët si në vijim:

- Lumturije Blakaj dhe
- Driton Qeriqi.

Kuvendi, prej dy kandidatëve, do ta zgjedhë njërin nga këta dhe Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Medie, pas intervistimit të këtyre kandidatëve, i propozon Kuvendit emërimin e një anëtari të Këshillit.

Anëtarët e KKPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Medie.

Mandati i anëtarëve të KKPM-së caktohet me short.

2 anëtarë me mandat dyvjeçar,
3 anëtarë me mandat trevjeçar, dhe
2 anëtarë me mandat katërvjeçar.

Shorti për mandatin e anëtarëve të KKPM-së është bërë pas zgjedhjes së 5 anëtarëve të KPM-së, më 30 gusht 2012.

Pas tërheqjes së shortit, për mandatin e anëtarëve të KPM-së ka mbetur një pozitë për mandat trevjeçar.

Andaj, mandati i këtij anëtari që do të zgjidhet sot, do të jetë trevjeçar. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 11 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Medie dhe në pajtim me rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar janë propozuar dy kandidatë, ndërsa Kuvendi e zgjedh vetëm njërin me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe votojnë, me votim të fshehtë.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një Komisioni votues, me përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar, në mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

E ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë kandidatët.

Grupi Parlamentar i PDK-së, kryetari Adem Grabovci, kë e kandidoni për anëtar të Komisionit?

ADEM GRABOVCI: Ne për anëtar të komisionit e propozojmë njeriun me përvojë, zotin Idriz Vehapi.

KRYETARI: LDK-ja, kryetari i Grupit, Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Edhe ne gjithashtu e propozojmë dikë me përvojë të madhe, e ky është Salih Morina.

KRYETARI: “Vetëvendosja”! Edhe ju, nëse mund ta gjeni dikë me përvojë të madhe!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Do ta them edhe qëndrimin e Lëvizjes “Vetëvendosje” karshi kandidatëve që janë propozuar për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe në ndërkohë do ta propozojmë edhe anëtarin për komision.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, nuk do ta votojë asnjërin prej kandidatëve që janë sjellë për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve.

Si edhe në çdo bord tjetër, agjenci apo institucion të pavarur, ashtu edhe për këtë komision, na janë sjellë njerëz apo kandidatë, të cilët janë shumë të afërt me këtë pushtet.

Fatkeqësisht, kandidatët më profesionalë nuk kanë kaluar në komision, krejt kjo për shkak të numrit të deputetëve të pozitës në komision, pra 5 nga pozita dhe 4 nga opozita.

Veçanërisht më duhet të them se njëri prej kandidatëve, pra Lumturije Blakaj, gjatë punës së saj si gazetare ka shpifur për deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”. Pra, gjatë punës së saj si gazetare i ka shërbyer këtij pushteti dhe në fund qëndrimi ynë në sallë do të jetë për t’ia pamundësuar zgjedhjen ndonjërit prej kandidatëve.

Për komision e propozojmë Albana Gashin. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e propozojmë deputeten Teuta Haxhiu, e cila ka edhe më tepër përvojë se këta përpara! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re. Nuk është këtu. Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e propozon një deputete me mjaft përvojë, Suzan Novobërdaliu.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i SLS-së, Sasha!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička grupa Samostalne liberalne Stranke predlaže čoveka koji treba da istekne iskustvo, to je Murselj Haljilji.

KRYETARI: Nga “6+”, kryetarja Mufera Shinik.

MUFERA SHINIK: Faleminderit, kryetar!

Grupi “6+” e propozon deputetin Albert Kinolli!

KRYETARI: Faleminderit! Lus deputetët që me ngritje dore, formalisht ta votojmë komisionin. Atëherë shumica janë për, kundër 2.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve të Komisionit.
Atëherë, lus deputetët e propozuar për komision që t'i zënë vendet e tyre.

Të nderuar deputetë, fillojmë me votimin e fshehtë dhe ftoj deputetët të votojnë:

Adem Grabovci; Afërdita Berisha-Shaqiri; Afrim Hoti; Afrim Kasolli; Gëzim Kelmendi; Agim Kuleta; Ahmet Isufi; Albana Fetoshi; Albana Gashi; Albin Kurti; Albulena Haxhiu; Ali Sadriu; Albert Kinolli; Alma Lama; Anton Çuni; Arben Gashi, Ardian Gjini; Armend Zemaj; Aurora Bakalli; Azem Sylaj; Bahri Thaçi; Arsim Bajrami; Bali Muharremaj; Berat Buzhala; Behar Selimi; Amir Ahmeti; Bekim Haxhiu; Biserka Kostiq; Blerim Shala; Blerta Deliu-Kodra; Burim Ramadani; Danush Ademi; Daut Haradinaj; Donika Kadaj-Bujupi; Duda Balje; Elmi Reçica; Emilija Rexhepi; Enis Kervan; Nait Hasani; Eqrem Kryeziu; Etem Arifi; Fadil Demaku; Fatmir Limaj; Fatmir Xhelili; Jeton Svirca; Flora Brovina; Florin Krasniqi; Ganimete Musliu; Glauk Konjufca; Goran Marinković; Nijazi Idrizi; Haki Demolli; Halit Krasniqi; Hamza Balje; Hydajet Hyseni; Hashim Dëshiraku; Hasime Krasniqi; Hykmete Bajrami; Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi; Imri Ahmeti; Ismet Beqiri; Jakup Krasniqi; Jasmina Zhivković...

(Mbledhjen e merr nën drejtim nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: ...Jelena Bontiq; Justina Pula; Kimete Bajraktari; Latif Gashi; Liburn Aliu; Lirije Kajtazi; Lumniçe Morina, Lutfi Haziri; Lutfi Zharku; Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik; Muhamet Mustafa, Mursel Halilj, Myzejene Selmani; Naser Osmani, Nazane Breca; Kimete Bytyçi, Sasha Milosavljeviç; Petar Miletiq, Rada Trajković, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci; Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sash Gjokiq, Milivoje Stojanović, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todorović, Sreten Ivanović, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhevahire Izmaçu, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti, Lutfi Haziri.

Ia japim fjalën Komisionit që ta konstatojë rezultatin e votave. Fjalën e ka kryetari i Komisionit.

IDRIZ VEHAPI: Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Driton Qeriqi, Lumturiçe Blakaj, e pavlefshme, Driton Qeriqi, e pavlefshme, Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Driton Qeriqi, e pavlefshme, Lumturiçe Blakaj, e pavlefshme, Lumturiçe Blakaj, e pavlefshme, Lumturiçe Blakaj, Lumturiçe Blakaj, Driton Qeriqi, Lumturiçe Blakaj, Driton Qeriqi, e pavlefshme, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, e pavlefshme, Driton Qeriqi, Driton

Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, e pavlefshme, Lumturije Blakaj, Driton Qeriqi, Lumturije Blakaj, e pavlefshme, Lumturije Blakaj, Driton Qeriqi, Lumturije Blakaj, Driton Qeriqi, Lumturije Blakaj, Lumturije Blakaj, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Lumturije Blakaj, Lumturije Blakaj, Driton Qeriqi, e pavlefshme, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, e pavlefshme, e pavlefshme, e pavlefshme, Driton Qeriqi, Lumturije Blakaj, Lumturije Blakaj, Lumturije Blakaj, Lumturije Blakaj, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Lumturije Blakaj, Lumturije Blakaj, Driton Qeriqi, e pavlefshme, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, e pavlefshme, Lumturije Blakaj, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, e pavlefshme, Lumturije Blakaj, Lumturije Blakaj, e pavlefshme, Driton Qeriqi.

KRYESUESI: Ju kisha lutur, meqenëse jemi këtu të të gjitha grupeve parlamentare, në qoftë se jeni dakord ta bëjmë një pauzë 5-minutëshe dhe të vazhdojmë me seancën tjetër. Të mos e lëmë deri në orën 13:00, e pastaj e marrim pauzën e drekës. Kemi hapësirë kohore të mjaftueshme besoj, ose nëse doni e ndërpresim. Asnjë problem që dua të ju njoftoj. Qeveria ka mbledhje në orën 14:00. Qeveria si qeveri ka mbledhje në orën 14:00 dhe ministri që është i thirrur në interpelancë, është i obliguar të shkojë në mbledhje dhe ka kërkuar gjysmë ore hapësirë kohore, nga 14:00 deri 14:30, që të ketë mundësi të jetë në mbledhje.

(Reagime)

Në rregull, unë nuk kam asgjë kundër, vetëm në qoftë se ju doni ta shfrytëzojmë kohën, të mos merret koha në atë pjesën, t'i shpenzojmë dy pikat e para, ajo për deklarime jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare, si dhe ndonjërin nga ligjet, e pastaj kalojmë në interpelancë.

Thjesht, për ta shfrytëzuar kohën. Atëherë fillojmë në orën 14:30, sipas kërkesës së Qeverisë. Ta kini parasysh.

Në rregull, mos u ankoni pastaj për televizionin.

Fjalën e ka zoti Vehapi për të sqaruar lidhur me votimin.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni votues për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Medie paraqet këtë:

Raport

Për rezultatin e votimit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Medie, në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Medie, dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar me vendim të Kuvendit, më 4 prill 2013, në përbërje nga një përfaqësues i secilit grup parlamentar, Idriz Vehapi, Grupi Parlamentar PDK; Salih Morina, Grupi Parlamentar LDK; Albana Gashi, Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, Grupi Parlamentar AAK; Suzan Novobërdaliu, Grupi

Parlamentar AKR; Murselj Haljilji, Grupi Parlamentar SLS; dhe Albert Kinolli, Grupi Parlamentar “6+”.

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Medie, në mbledhjen plenare të mbajtur më 4 prill 2013, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë 93 deputetë, të pavlefshme janë 17 fletëvotime. Votat e fituara për kandidat të propozuar janë, si në vijim:

- Lumturije Blakaj i ka fituar 39 vota,
- Driton Qeriqi i ka fituar 37 vota,

Prandaj, në bazë të rezultatit të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se:

Asnjëri nga kandidatët nuk zgjidhet anëtar i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Medie.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk e sqarove që në bazë të ligjit, konkursi duhet të përsëritet, që të mos e futim në votim nesër pastaj prapë.

Ligji qenka kështu, shumicën e votave po shihet kush i ka dhënë, abstenimi e ka përjashtuar, ose votat e pavlefshme.

(Reagime)

Kështu po ma interpretojnë këta specialistët tanë, unë nuk di çfarë të bëj. Shumicën e votave i ka fituar Blakaj, megjithatë le të interpretohet. Si të doni, unë nuk kam asgjë.

Mirupafshim në orën 13:00, në seancën e radhës! Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*